



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATONET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Z. Imer Hoxha

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 95 Datë 27.11.2017

Kryetari i Bashkisë

Z. Besnik Dushaj

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË TROPOJË
STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.2, Datë 09.12.2017

DPKZHT: HASAN ÇUKA

STUDIO KONSULENTE "STUDIO B&L": ERMAL BLETA, Nr.Liç. A.0925/4

STUDIO B & L
Sh p k
Tiranë Albania



Strategjia Territoriale, Plani i Veprimeve Strategjike/Prioritare, Investimet Kapitale dhe Projektet Pilot të Zhvillimit janë përgatitur në kuadrin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë.

Përgatitur nga:

Studio B&L me Pier Vittorio Aureli dhe Martino Tattara.

Doriana Bozgo Bleta; Ermal Bleta; Roland Lika - *Endri Kiçaj, Jueta Guri, Saimir Duçellari*

Martino Tattara; Pier Vittorio Aureli - *Antonio Paolillo; Ezio Melchiorre; Ian Lowrie; Luciano Aletta; Matteo Novarino; Tommaso Mola Meregalli*

Andrian Vaso; Bukurosh Onuzi; Devis Agaraj; Genti Neschwatal; Ilia Kristo

Kontakt: studio@arkitekt-bl.com
info@dogma.name

Me mbështetjen e:




HELVETAS
Swiss Intercooperation



**FAZA 2 | STRATEGJIA TERRITORIALE DHE PLANI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE/PRIORITARE,
INVESTIMET KAPITALE DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT
BASHKIA TROPOJË**





PASQYRA E LËNDËS

1		ANALIZË DHE VLERËSIM I TERRITORIT	11
1.1		Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga planet kombëtare dhe sektoriale	13
1.1.1		Parashikimet që rrjedhin nga plani i përgjithshëm kombëtar Kombëtar (VKM Nr.881, Datë 14.12.2016)	13
1.2		Përmbledhje e analizës territoriale. Analiza e territorit	20
1.2.1		Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor and infrastrukturor	20
1.2.2		Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit natyror	21
1.2.3		Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit ujqor	29
1.2.4		Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit bujqësor	36
1.2.5		Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit urban	46
1.2.6		Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit infrastrukturor	57
1.3		Analiza metabolike e territorit	69
1.4		Rekomandime për problematikat e identifikuar	71
2		VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE	77
2.1		Tropoja dhe territoret e bashkive fqinje	79
2.2		Vizioni dhe strategjia e zhvillimit territorial për bashkinë e Tropojës	81
2.2.1		Objektivat strategjike	87
2.3		Programet strategjike (përshkrimi i detajuar i programeve për zbatimin e objektivave strategjike)	95
2.4		Sistemet territoriale	156
2.4.1		Konvertimi nga një sistem në tjetrin	156
3		PLANI I VEPRIMEVE PRIORITARE, INVESTIMEVE STRATEGJIKE/ KAPITALE DHE PROJEKTET PILOT	165
3.1		Strategjitë, veprimet dhe projektet	167
3.2		Ndarja e territorit në njësi strukturore	257
3.2.1		Projektet Pilot të Zhvillimit	259



4	KONSULTIMET ME PALËT E INTERESUARA	323
4.1	Raporti i takimeve me komunitetin	325
4.1.1	Takimi në Lekbibaj	325
4.1.2	Takimi në Fierzë	333
4.1.3	Takimi në Tropojë (e vjetër)	339
4.1.4	Takimi në Bujan	347
4.1.5	Takimi në Margegaj	352
4.1.6	Takimi në Llugaj	359
4.1.7	Takimi në Bytyç	365
4.1.8	Takimi me përfaqësues të komunitetit në Tiranë	371
4.2	Forumi i bashkërendimit për Planin kombëtar për zhvillimin e turizmit në alpe	375
4.3	Dëgjese publike për strategjinë territoriale dhe planin e veprimeve strategjike/prioritare, investimet kapitale dhe projektet pilot.	379



1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971

1971



LISTA E HARTAVE

- 1 | HARTA E VIZIONIT STRATEGJIK
- 2 | HARTA E HIERARKISË URBANE
- 3 | HARTA E MBROJTJES SË NATYRËS
- 4 | HARTA E HIERARKISË URBANE
- 5 | HARTA E STRATEGJISË SË KONSOLIDIMIT URBAN
- 6 | HARTA E PROJEKSIONIT TË POPULLSISË PËR VITIN 2032
- 7 | HARTA E KATEGORIVE RRUGORE DHE PROPOZIMEVE
- 8 | HARTA E STRATEGJIVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE
- 9 | HARTA E STRATEGJIVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE
- 10 | HARTA E PROPOZIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË FURNIZIMIT ME UJË
- 11 | HARTA E PROPOZIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË UJËRAVE TË ZEZA
- 12 | HARTA E STRATEGJISË BUJQËSORE
- 13 | HARTA E STRATEGJISË SË TRANSPORTIT KOLEKTIV
- 14 | HARTA E STRATEGJISË SË TURIZMIT
- 15 | HARTA PËRMBLEDHËSE E STRATEGJIVE
- 16 | HARTA E PËRDORIMIT TË PROPOZUAR TË TOKËS
- 17 | HARTA E VEPRIMEVE PRIORITARE
- 18 | HARTA E PROJEKTEVE PILOT
- 19 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 1




- 20 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 2
- 21 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 3
- 22 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT - FAZA 4
- 23 | HARTA E FAZAVE TË ZHVILLIMIT
- 24 | HARTA E PESË SISTEMEVE TERRITORIALE
- 25 | HARTA E SISTEMIT NATYROR
- 26 | HARTA E SISTEMIT UJOR
- 27 | HARTA E SISTEMIT BUJQËSOR
- 28 | HARTA E SISTEMIT URBAN
- 29 | HARTA E SISTEMIT INFRASTRUKTUROR
- 30 | HARTA METABOLIKE MBI PRODHIMIN E MBETJEVE
- 31 | HARTA METABOLIKE MBI PËRDORIMIN E ENERGJISË
- 32 | HARTA METABOLIKE MBI FLUKSIN E USHQIMIT
- 33 | HARTA METABOLIKE MBI PËRDORIMIN E UJIT



112
113
114
115
116
117
118
119
120
121
122
123
124
125
126
127
128
129
130
131
132
133
134
135
136
137
138
139
140
141
142
143
144
145
146
147
148
149
150
151
152
153
154
155
156
157
158
159
160
161
162
163
164
165
166
167
168
169
170
171
172
173
174
175
176
177
178
179
180
181
182
183
184
185
186
187
188
189
190
191
192
193
194
195
196
197
198
199
200

1 ANALIZË DHE VLERËSIM I TERRITORIT





1.1 Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga planet kombëtare dhe sektoriale

1.1.1 Parashikimet që rrjedhin nga plani i përgjithshëm kombëtar Kombëtar (VKM Nr.881, Datë 14.12.2016)

“Plani i Përgjithshëm Kombëtar (VKM Nr.881, Datë 14.12.2016) “Shqipëria 2030”, është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë.

Në bazë të parimeve, objektivave dhe specifikimeve të tij, do të detajohen planet e hierarkive më të ulëta.

PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit për 15 vitet e ardhshme, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik e social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij, mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës.”

Organizimi i territorit nga PPK

Ashtu si përcaktohet edhe nga rregullorja e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit PPK përcakton 5 Sistemet territoriale dhe vendos prioritete për secilin prej tyre:

Sistemi URBAN - PPKvë theksin tek “Zhvillimi policentrik, inteligjent dhe gjithpërfshires” dhe tek metodologjia e “hierarkizimit të qëndrave urbane”. Ky plan propozon:

Konsolidim dhe Rigjenerim- Metropoli, Qendrat Primare Urbane

Perforcim dhe Rigjenerim - Qendrat e treta (terciare) Urbane Qëndrore

Fuqizim dhe Rigjenerim - Qytetet Porta dhe Qendrat Urbane Lindore

Kooperim - në nivel Kombëtar

Sistemi UJOR - në mbrojtjen e sistemit ujqor PPK i referohet ligjeve në fuqi që përcaktojnë distancat për mbrojtjen e brigjeve, brezat mbrojtës sanitarë si dhe veprimtaritë e ndaluara. Ujt përbën një burim madhor për vendin. Rëndësia e tij është e lidhur edhe me rëndësinë e përdorimeve:

99% e energjisë që përdorim vjen nga shfrytëzimi I burimeve ujore

14 miliard m3 ujë –përdoren nga sektori energjitik

1.5 miliard m3 ujë përdoren për sektorin bujqësor

Politikat e densifikimit të zhvillimit urban dhe korridoret natyrore përgjate luginave të lumenjve janë politikat primare që PPK sjell në ndihmë të këtij sistemi.

PPK vendos vijën Blu të mbrojtjes së burimeve ujore nga përdorimet e ndaluara si edhe nga shfrytëzimi privat.

200 m distance nga vija e bregut detar dhe njekohesisht izoipsin 2 m për bregdetin fushor dhe izoipsin 60 m për bregetin shkembor

Për rrjedhat lumore 100 m distance nga bregu i lumit ndalim i cdo aktiviteti, dhe 1km brezi i korridoreve natyrore që shoqerojnë rrjedhen e tyre ruhet vetëm për përdorim me



perparësi natyren

Për sistemin ujqor në shërbim të bujqësisë objektivat kryesore të PPK janë:

Plotesimin e qëndrueshëm të nevojave për ujë, nëpërmjet rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve ujites

Menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes nëpërmjet ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisve për operim, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, ndërmjet pushtetit qendror, njësive administrative dhe organizatave të përdorimit të ujit

Garantimin e kullimit me përparësi të sipërfaqes bujqësore në ultësirën perëndimore nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit të infrastrukturës egzistuese dhe rritjes së kapacitetit të hidrovoreve

Zvogëlimin e rrezikut nga përmytjet lumore dhe detare, nëpërmjet rikonceptimit të strukturave mbrojtëse duke konsideruar zhvillimet e reja urbane pranë lumenjve dhe grykderdhjeve të tyre

Sistemi INFRASTRUKTUROR - është i një rëndësie thelbësore në realizimin e vizionit të PPK 2030, për Shqipërinë si një Hub energjistik për rajonin dhe qendër ndërlidhëse për europën juglindore.

Integrimi hapësinor i vendit dhe shpërndarja e balancuar e flukseve brënda territorit, varet nga rritja e kapacitetit të transportit të njerëzve, mallrave, energjise dhe informacionit. Përmirësime për sa i përket efijencës në kohë, uljes së kosos dhe shkurtimit të distancave.

Sistemi NATYROR - PPK e sheh sistemin natyror jo si një sipërfaqe të ruajtur nga veprimtaria e njeriut, por një aset që ruhet në shërbim të njeriut dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Mjedisi perfaqeson trashëgimie natyroere dhe kulturore, karakteristikat fizike të territorit natyror por edhe të atij të ndërtur. Në këtë kuptim, dy janë tiparet kryesore të Sistemit natyror:

është pjese e pasurise Kombëtare

forma dhe karakteristika e tij varen njekohesisht nga veprimtaria natyrore dhe njerezore. Përqsasja e PPK për këtë sistem shprehet nëpërmjet dy koncepteve: PROMOVIM dhe AKSES.

Në këtë kuadër, zgjidhjet që propozon PPK janë rritja e zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore për gjate luginave të lumenjve.

Propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohet edhe rrjeti Emerald për të krijuar Rrjetin Ekologjik Shqiptar. Ai përfaqëson një rrjet ku ekosistemet, habitatet, llojet, peizazhet dhe veçoritë e tjera natyrore me rëndësi Pan Europiane do të duhet të ruhen, sipas kriterëve dhe dizpozitave të ligjit "Për zonat e mbrojtura".

Në sistemin e zonave të mbrojtura bëjnë gjithashtu pjesë edhe Korridoret natyrore, të cilët duhet të konsiderohen si hapësira të përshtatshme për insertimin e infrastrukturës 'GREEN'.

Arritja e targetit 20% zonë tokësore e mbrojtur dhe 15% sipërfaqe detare e mbrojtur



Krijimit i hapësirave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjate luginave të lumenjve
Rrjeti kombëtar i biçikletave i cili akseson dhe përshkon zonat natyrore dhe ato të trashëgimisë historike e kulturore

Rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje dhe zbatimin e vendimeve për mirëmenaxhimin e sistemit natyror

Konsolidimi dhe rritja e performancës për mirëmenaxhimin e natyrës, ZM dhe të Biodiversitetit, për aktorët qendror e lokal.

Integrimin e planeve të menaxhimit me sistemin e planifikimit dhe me planet vendore PPV të zhvillohet në një kohe me planet e menaxhimit, në mënyrë që të arrihet kohezioni i instrumentave të planifikimit, në parashikime dhe afate kohore.

Rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura detare dhe bregdetare në 10 % të sipërfaqes ujore të vendit në linje me Aichi targets të Konventes së biodiversitetit për 2020

Përkrahja e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit natyror për dy qëllime rekreative dhe për të promovuar ekoturizmit

Menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme ekologjike dhe ekonomike i zonave të mbrojtura
Integrimi i Shqipërisë në kontekstin ballkanik dhe ate european nëpërmjet Di-naric Arc Ecoregion dhe European Green Belt

Futja e sistemit natyror në zinxhirin ekonomik dhe ate politikë

Projekte ripulëzimi dhe rigjenerimi në zonat e degraduara nga dukuri si erozioni dhe përmytje

Sistemi BUJQËSOR - PPK ka si objektiv rritjen e eficences për sistemin bujqësor dhe politikat që mbështet në këtë drejtim janë ato të ruajtjes konsolidimit dhe modernizimit. Me miratimin e Planit Kombëtar 2030 nuk lejohen ndërtime të reja në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore duhet të arrihet nëpërmjet vendosjes së një rrjeti të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim- grumbullim- përpunim- eksportim.

Integrim dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë të ekonomisë:

Bujqësi-Turizëm- ku veçantia e sektorit turistik shqipëtar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.


Bujqësi- Transport— infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore

Bujqësi – Energji- ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme

Krijimit të qëndrave/ poleve bujqësore dhe profilizimi i tyre sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor

Krijimi i markave të produkteve karakteristike bujqësore shqipëtare Made in Albania. Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqipëtare:





Bimë Mjekësore
Pemë frutore arnore
Ullinj dhe Vreshta
Perime karakteristike të vendit
Produkteve bujqësore të përpunuara

Vizioni shqipëria 2030

“Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor European, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkurruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t’u shndërruar në një destinacion autentik. “

PPK vendos një prioritet strategjik parësor, realizimin dhe finalizimin e Projekteve strategjike të integritit të vendit me Europën. Për arritjen e qëllimeve të deklaruara nga ky vizion PPK parashikon një seri aksionesh. Një pjesë e këtyre prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë territorin e bashkisë Tropojë duke shprehur qartazi drejtimin që zhvillimi i këtij territori duhet të marrë.

Aksi Lindor. Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Tropoja së bashku me Hasin, Kukësin, Dibrën, Bulqizën, Përrenjasin, Pogradecin, Ersekën dhe Leskovikun do të lidhet nga Aksi Lindor i Shqipërisë. Për shkak të karakteristikave fizike të territorit, kryesisht malor dhe kodrinor, kjo lidhje nuk është e zbatueshme lehtësisht, por konsiderohet si një prioritet për investimet në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës rrugore ekzistuese dhe aty ku është e mundur, devijime dhe lidhje të shkurtuara midis lokaliteteve dhe qendrave urbane. Kjo lidhje është e rëndësishme për përmirësimin dhe fuqizimin e “Portave Lindore” të vendit, në të njëjtën kohë ky përmirësim zbut marginalizimin e qendrave urbane në Shqipërinë lindore periferike.

Rajonalizimi. Për të mbështetur rajonalizimin e suksesshëm të vendit, PPK përcakton 7 pole ekonomike parësore në nivel kombëtar si rezultat i shtimit të bashkëpunimit të qendrave urbane brenda zonave ekonomike. Një nga këto zona është ajo e Kukës – Has – Tropojës. Sipas studimeve të INSTAT, zonat ndahen në 6 nën-njësi lokale. Zona e Tropojës është pjesë e “grupit të Dytë”. Bashkitë e këtij grupi karakterizohen nga një zone e vogël territoriale. Ajo përcaktohet si grup “i vogël/Periferik” sepse përbëhet nga bashki me nivel të ulët të ndërveprimeve hapësinore ditore (duke marrë në konsideratë numrin dhe dendësinë e popullsisë). Niveli i rrethinave hapësinore midis bashkive të këtij grupi është i ulët.

Nën-njësitë lokale, siç edhe janë përshkruar në vizionin e PPK-së, janë hapësira të rëndësishme territoriale, pjesë e polit ekonomik të Kukës – Has – Tropojës. Kjo do të thotë që politikat territoriale për këto zona duhet të sigurojnë fuqizimin e tyre në infras-




PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR SISTEMI URBAN

- Hierarkia e Qendrave Urbane
- Alderësia Hapësore e Zonave Funktionale



AKPT
AGJENCIA QENDRORE E PLANIMIT
DHE RREGULLIMIT TERRITORIAL



Parimi
Niveli i parë i planit kombëtar të sistemit urban duhet të jetë i përbërë nga qendrat më të mëdha dhe më të mëdha të vendit, të cilat janë të afta të shërbejnë si qendër të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social për territorin dhe për të gjithë popullin e vendit.

Prirja të përgjithshme
Niveli i parë i sistemit urban duhet të jetë i përbërë nga qendrat më të mëdha dhe më të mëdha të vendit, të cilat janë të afta të shërbejnë si qendër të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social për territorin dhe për të gjithë popullin e vendit.

Prirja të përgjithshme
Niveli i parë i sistemit urban duhet të jetë i përbërë nga qendrat më të mëdha dhe më të mëdha të vendit, të cilat janë të afta të shërbejnë si qendër të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social për territorin dhe për të gjithë popullin e vendit.

LEGJENDA

- Qyteti kryesor
- Qytet i madh
- Qytet i mesëm
- Qytet i vogël
- Qendër urbane
- Zona metropolitane
- Zona funksionale
- Rrugë
- Rreze hekurudhore
- Aeroporti
- Porti
- Vendi ujor
- Park kombëtar
- Vendbanim i trashëgimit botëror
- Zona e mbrojtur
- Zona e mbrojtur mjedisore
- Zona e planimit urban

© 2015 AKPT. Të gjitha të drejtat rezervohen. Kjo hartë është e përbërë nga të gjithë të dhënat dhe informacionet e disponueshme në ditën e hartimit.



strukturën e transportit dhe komunikimit ashtu si edhe në atë sociale dhe të shërbimeve. Për të përmbushur rolin e tij në zhvillimin e suksesshëm policentrik të Shqipërisë, ky rajon duhet të rrisë peshën e tij në ekonominë e vendit. Për këtë arsye, PPK i sheh si të rëndësishme nga pikëpamja strategjike investimet në Infrastrukturën Kombëtare si rruga e Kukësit dhe e Arbrit, fuqizimin e poleve bujqësore, investimet në industrinë e përpunimit të ushqimeve, si edhe nxitjen e investimeve në zhvillimin e turizmit malor, liqenor dhe të aventurës në këto zona.

Rajoni i specializuar Malësi e Madhe - Shkodër - Tropojë. Është një nga rajonet më pak të arritshëm deri tani, ndërkohë që përfaqëson vlera të larta për zhvillimin e turizmit malor; sipas PPK atraksionet kryesore në territorin e bashkisë Tropojë për këtë lloj zhvillimi janë, lugina e Valbonës, dhe liqeni artificial i Fierzës.

Sipas hierarkisë së qendrave urbane, qendrat e bashkisë Tropojë kategorizohen si më poshtë:

Tropojë, qendër sekondare;

Njësitë administrative të Fierzës dhe Bujanit, qendra lokale të specializuara.

Rajoni është i veçantë për terrenin e përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarive turistike si:

Liqen – përgjatë liqenit të Fierzës;

Mal – në zonën e Alpeve;

Natyror – Kanioni i Shoshanit dhe lugina e Valbonës.

Projekte prioritare në përmirësimin të infrastrukturës:

Vlerësimi i potencialeve natyrore në aspektin e diversifikimit të energjisë së rinovueshme, duke përdorur erërat e forta në grykët e lumenjve;

implementimin e linjave të ndërlidhjeve 400kV të cilat do bëjnë lidhjen Elbasan - Fierzë - Kosovë dhe Burrel - Skavicë - Kosovë;

Linja e gazit IAP – Kosovë;

Aktivizimi i aeroportit të Kukësit bazuar në faktin se ai mund të jete një potencial për rajonin dhe Veriun e vendit;

Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse midis qendrave, Kukës – Has – Tropojë dhe qendrave urbane kufitare në Kosovë, Prizren – Gjakovë – Pejë. Infrastruktura do të shkurtoj distancat e udhëtimit midis këtyre qendrave dhe do të përforcoj dhe përmirësoj bashkëpunimin ndërkufitar midis tyre;



Rigjenerimi i aksit Fushë-Arrëz – Tropojë, përveç rrjetit rrugor propozohen shtigje biçikletash, bazuar në faktin se kjo rrugë kalon pranë liqenit artificial të Fierzës (Lumi Drin), i cili është një atraksion për turizmin natyror dhe kanotazhin. Fierza mund të jete një pikë shkëmbimi për mjete të ndryshme transporti. Kjo i referohet strategjisë sektoriale për transportin 2008-2013, e zbatuar sipas parimeve të transportit të qëndrueshëm. Optimizimi i kostove, siguria dhe mbrojtja e mjedisit.

1.1.2 Parashikimet që rrjedhin nga plani kombëtar sektorial për zhvillimin e turizmit në alpe

Plani kombëtar për zhvillimin e turizmit në alpe është në fazë përpilimi. Në ambientet e AKPT është bërë tashmë një takim i parë teknik midis grupeve të konsulentëve që po mbëshenin bashkitë që preken nga ky plan, me qëllim bashkërendimin e rezultateve. Bashkia Tropojë përveç integritimit të parashikimeve që do të rrjedhin nga ky plan në dokumentin e PPV, ka si qëllim pjesëmarrjen aktive në procesin e ndërtimit të tyre.

1.2 Përmbledhje e analizës territoriale. Analiza e territorit

1.2.1 Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor and infrastrukturor

Territoret e njësive së qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në pesë sisteme bazë, si më poshtë:

- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujqor (U);
- Sistemi infrastrukturor (IN).

Këto sisteme duhet të organizohen në marrëdhënie mes qendrave të banuara, korridorëve dhe zonave, mbi bazën e të cilave do të detajohet dokumenti i PPV-së. Ndarja në këto sisteme nuk duhet parë vetëm si përcaktime për përdorimin e tokës , por edhe si mundësi për zhvillimin në përputhje me karakteristikat primare të sistemeve.

Objektivat dhe konceptet e kësaj ndarjeje dalin nga përcaktimet në këto dokumente ligjore kryesore:



- LIGJ Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- VKM Nr. 686, date 22.11.2017
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar

1.2.2 Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit natyror

Sistemi natyror i Tropojës karakterizohet nga një sasi e madhe e burimeve mjedisore, te tilla si parqet, rezervat, burimeve ujore, shumëllojshmëri te pasur te biodiversitetit. Rreth 40% e territorit është përfshirë ne zonën e mbrojtur. Shumëllojshmëria e burimeve natyrore te Tropojës përfshijnë: malet, shpellat, kanionet, lumenjtë, liqenet, pyjet dhe kullotat, flora, fauna.

Bashkia e Tropojës ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 1043 km². Ajo përfaqëson një kompleks peizazhesh, të cilat mbartin vlerat dhe karakteristikat përkatëse.


Peizazhi Malor- Në bashkinë e Tropojës mbizotëron peizazhi malor, aty shtrihen sistemi malor më i rëndësishëm i Shqipërisë Alpet Shqiptare, kryesisht Alpet Lindore. Brenda kufijve Alpet kanë gjatësi 64 km dhe gjerësi 60 km. Sipërfaqja e tyre arrin 2020 km². Përfaqëson territorin me mundësi më të pakta jetese për shkak të lartësisë së madhe të relievit, numër të ulët të qendrave të banuara, dendësi e ulët e popullsisë favorizon vetëm zhvillimin e turizmit malor. Në peizazhin malor dallohen dhe kurrizi Toplanë-Bosh-Maja e Hekurave – Mertur. Shtrihet midis luginës së Shalës dhe Valbonës. Kanë formën e një harku të madh me lugësim nga juglindja dhe rrethon luginën Nikaj-Mërturi. Në krahun verilindor dallohen blloku i Majës së Hekurave dhe i Grykëve të Hapura

Peizazhi lumor -përfaqësohet nga lugina e lumenjve Gashit, Valbonës, Drinit, Lumi i Currajt, Lumi i Skatinës, Sylbicës, Bytyçit. Të cilët përfaqësojnë një peizazh jo vetëm me vlera estetike, por dhe ekonomike pasi shërbejnë si burim i ujit të pijshëm (ujërat e Valbonës, Astës), bujqësisë (në fshatin Kasaj ndodhet një rezervuar ujqor artificial me një kapacitet 160,000 m³ që mundëson ujitjen e rreth 400 ha toke bujqësore), dhe zhvillimin e turizmit pasi mbajnë statusin e zonës së mbrojtur (Ujëvarat e Rragamit, Kanioni i Shoshanit), por përfaqësojnë dhe një arter të rëndësishme për zhvillimin e energjetikës dhe si nyje për transportit ujqor siç është liqeni I Fierzës.

Peizazhi Liqenor -përfaqësohet nga liqenet akullnajor si: Liqeni i Ponarëve, liqenet akullnajorë të Sylbicës, liqeni i Dobërdolit, liqeni i Dashit, liqeni i Shkaut, liqenet e Jezercës, liqenet e Qukut dhe të Dunishës të cilët mbartin vlera të rëndësishme për zhvillimin e turizmit, por dhe si bazë të prodhimit të energjisë elektrike siç është liqeni i Fierzës.

Peizazhi urban- përfaqësohet nga qyteti i Bajram Currit, i cili është vendosur në zonën





më të ulët të Bashkisë Tropojë dhe pjesën më të përshtatshme për jetesën. Këtu është përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë Tropojanë.

Tropoja njihet si një nga rrethet që ka numrin më të madh të monumenteve të natyrës. Në fakt komuniteti i zonës ka pak informacion për ta, pasi mungojnë shënjimete apo informacioni në teren i tyre. Pjesa më e madhe e këtyre monumenteve të natyrës ndodhet në zonën e alpeve. Gjendja e tyre është e mirë, sipas specialistëve të zonave të mbrojtura, porse kanë nevojë të mëtejshme për kujdes dhe vëmendje, në identifikimin, pasaportizimin, dhe mbrojtjen e tyre.

Gjithsesi Monumentet e natyrës për Tropojën kanë vlera të shumta, shumica të papërsëritshme dhe të pakthyeshme. Ndër vlerat kryesore të tyre theksojmë: Burim i pazëvendësueshëm informacioni shkencor për shumë shkencë (gjeologji, gjeografi, gjeomorfologji, hidrologji, biologji, etj.) Duke i vizituar këto shërbejnë edhe si burim të ardhurash prej turizmit.

Që një objekti natyror t'i jepet statusi i monumentit të natyrës duhet që ai të plotësojë tre kushte themelore, të pandara nga njeri-tjetri dhe me të njëjtën vlerë: objekti duhet të jete vetëm krijesë e natyrës; të ketë vlera të mëdha shkencore, estetike, kulturore, historike, didaktike, fetare dhe të jete i padëmtuar nga njeriu ose me mundësi rigjeneruese. Monumentet e natyrës se Tropojës janë si me poshtë:

Rrasa e Pecmarrës; Shpella e Haxhisë; Shkëmbi i Forcës; Burimi karstik i Qirecit; Rrasa e Currajt; Liqenet akullnajore të Dobërdolit; Liqenet akullnajore të Sylbicës.; Depozitimet fluvio-glaciale të Shoshanit. Depozitimet fluvio-glaciale të Shëmtinës; Bredhish-ta e Rragamit ose Hormoqi i Valbonës; Shelgu i Rrjetëzuar; Burimi i Qukut të Dunishës; Burimi i Shoshanit. Kanioni karstik i Shtrenjtit; Burimet e Valbonës; Shpella e Akull; Lugina e varur akullnajore e Kukajt; Lugina akullnajore e Motinës; Kanioni i Shoshanit; Bllirët në Markaj; Dushkajat e Qafë Luzhës; Liqeni Ponarëve; Mështekna e Lugut të Zi; Ahishta Gurra e Hasan Gashit; Rrobulli në liqenin e Ponarëve; Arra e Dragobisë; Shpella e Dragobisë;

Në veçanti zonat e mbrojtura të Tropojës mbulojnë sipërfaqet e mëposhtme:

Lumi i Gashit IUCN I: Rezerve rreptësishtë natyrore/rezerve Shkencore me një sipërfaqe prej 3,000ha

Lugina e lumit të Valbonës IUCN II: Park kombëtar me sipërfaqe 8,000 ha

Nikaj Mertur IUCN IV/1: Park natyror rajonal 17,505

Nga pikëpamja mjedisore, pikat me kritike janë menaxhimi i dobët i pyjeve gjë që çon në një humbje progresive të resurseve pyjore, menaxhimi dhe zhvillimi i dobët i parqeve dhe rezervave në zone, degradimi i mjedisit lidhur me praninë e minierave të shumta

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
Sistemit
Natyror



dhe guroreve.

Shfrytëzimi i paplanifikuar i tokës ka çuar si në një fragmentim të hapësirës të lire ashtu dhe në një përdorim të burimeve të parinovueshme natyrore, duke shkaktuar një varfërim të përgjithshëm të cilësisë së mjedisit dhe biodiversitetit.

Menaxhimi i mjedisit dhe sistemit natyror duhet të orientohet jo vetëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e zonës, por edhe për rritjen e saj në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe në shërbim të aktiviteteve njerëzore.

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm. Menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor përballë rritjes së globalizmit. Në të njëjtën kohë i bën aktive dhe kontribuuese në rritjen ekonomike të zonës duke i riaktivizuar si asete nëpërmjet përmirësimit të arritshmërisë së përshtatshme të tyre.

“Zhvillimi i qëndrueshëm” dhe “Rritje e zonave të mbrojtura natyrore, promovimi dhe aksesimi i tyre” janë objektivi dhe politika e zhvillimit të përcaktuar në PPK.

Sistemi natyror zë një sipërfaqe prej 90,174 ha (85.2%) të gjithë territorit të bashkisë Tropojë. I shtrirë pothuajse në të gjithë territorin, më së shumti në veri, përfundim e deri në jug ku kalon lumi Drin. Sistemi natyror përbëhet nga një shumëlloshmëri habitatesh të florës dhe të faunës dhe nga zona strikte natyrore-shkencore. Këto elemente përbëjnë një pasuri me potencial të zhvillimit të turizmit natyror, dhe propozimit të aktiviteteve mjedisore atraktive për zhvillimin e këtij sektori.

Kërcënimet kryesore të mundshme të parashikuara janë fragmentimi dhe zhdukja e habitateve, modifikimi dhe/ose shkatërrimi i habitateve natyrore për shkak të ndërtimit të infrastrukturës, prerjeve të paligjshme, si dhe për shkak të një ndryshimi të mundshëm në prodhimin bujqësor që shkaktohet nga zgjerimi i tokës bujqësore brenda zonës. Prerja selektive e drurëve mund të ndryshojë mjedisin pyjor në mënyrë drastike.

Bimët mjekësore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për banorët e zonave të thella të Bashkisë Tropoje. Por shfrytëzimi i tyre pa kriter ka ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Nga monitorimet e bëra rezultoi se bimët më të rrezikuara janë ato të cilat grumbullohen duke i shkullur me rrënjë. Si sanëza e cila haset në individë tepër të rrallë, salepi, xhërrokulli, Agulicja. Specia të tjera të rrezikuara janë sherbela dëllinja e zezë,

Sipas studimeve dhe kërkimeve të mëparshme mbi diversitetin e florës dhe faunës zona e Alpeve Shqiptare përfshin mbi 1500 lloje të bimëve vaskulare, duke përfshirë rreth 100 lloje të bimëve mjekësore, një numër të lartë të llojeve relikte, endemike dhe sub



-endemike si edhe 70 lloje në rrezik, të rrezikuara kritikisht, dhe lloje të rralla. Flora e territorit të Alpeve Shqiptare përbën 43% të gjithë florës së Shqipërisë. Përveç bimëve me vlera ekonomike si bimët e kullotave, bimët mjekësore dhe aromatike, etj, vlerë të veçantë për florën e kësaj zone kanë dhe llojet endemike, relikte dhe të rralla. Këto bimë kërkojnë faktorë specifik ekologjik dhe zakonisht rriten në mjedise si gropa, kanione, burime dhe majat shkëmbore.

Në lidhje me biomonumentet do të rekomandonim:

Vendosja në një kohë të shkurtër e shenjave dalluese për të gjitha bio monumentet.

Kërkohet një studim më i thelluar për të vlerësuar e rivlerësuar bio-monumentet në të gjithë bashkinë për heqje nga lista e atyre që janë dëmtuar dhe përgatitë dokumentacionin përkatës për të shpallur të tjerë që përmbushin kriteret për përfshirjen e tyre në listën aktuale të biomonumenteve.

Të bëhet sa më parë, përcaktimi i saktë i kufijve në hartë dhe në terren i biomonumenteve që janë grumbuj drurësh apo shkurresh, apo habitate bimore duke i bërë të dukshme me vendosje të shenjave dhe sinjalizimeve përkatëse. Në rastet kur biomonumentet ndodhen në prona private, të bëhen kontrata mirëmbajtje me personat përkatës për mirëmbajtje dhe përkujdesje të vazhdueshme të tyre. Të merren masa për ndalimin e veprimtarive se marrjes inerteve në lumin e Valbonës si dhe rehabilitimin e zonës së dëmtuar.

Të bëhet një punë më e madhe promovuese njohëse për ruajtjen edhe mirëmbajtjen këtyre monumenteve, për rëndësinë që këto pasuri natyrore kanë, si ato biologjike, shkencore, turistike, historike, fetare, didaktike etj.

Brenda territorit të bashkisë gjenden 3 parqe natyrore, ku dy janë të rëndësishme kombëtare, dhe një prej tyre i përcaktuar si park rajonal natyror. Vrella e Shoshanit është një ndër burimet më të mëdha ujore në Ballkan, nga e cila formohet Kanioni me të njëjtin emër që është vlerësuar në cilësinë e monumentit natyror të rrethit. Burimi ndodhet në hyrje të luginës së Valbonës dhe ka kapacitet të mjaftueshëm për furnizimin e gjithë rrethit me ujë të pijshëm.

Zonat e Mbrojtura

Rreth 40% e sipërfaqes së Tropojës, që përfaqësohet nga Alpet Shqiptare dhe në veri të tyre nga zona e Bjeshkëve të Krasniqes, Gashit e Bytyçit, janë pothuaj të pabanuara për të gjithë periudhën e vitit, ato banohen nga popullata e kuotave më të ulëta vetëm në periudhën e verës. Ky territor përfshin tri zona të mbrojtura: Parku Kombëtar i Valbonës, Zona Strikt Natyrore e Lumit të Gashit si dhe Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mërturi. Këto parqe janë potencial natyror jo vetëm i territorit në të cilin bëjnë pjesë por



kanë një rëndësi kombëtare.

Rezerva Natyrore Strikte e Gashit (3000 ha). Gjendet në pellgun ujëmbledhës të lumit të Gashit (27 km), degë e lumit të Valbonës. Respektohet shkalla e parë e mbrojtjes. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 1996/01/15, “Mbi miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit për zbatimin e vlerësimit mjedisor për projektet pyjore”, Lumi i Gashit është shpallur si “Rezervë Strikt Natyrore”, me një sipërfaqe 3000 ha.

Lugina e Lumit të Gashit është e vendosur në verilindje të Alpeve Shqiptare. Rezerva Natyrore mbulohet kryesisht nga pyjet, shkurre dhe bimësi barishtore. Karakteristika kryesore e kësaj Rezerve Natyrore është sasia e madhe e pyjeve përgjatë Luginës së lumit të Gashit dhe mbulesa me habitate me shkurre dhe bar përreth pyjeve.

Në rrjedhën e tij më të sipërme, Lumi i Gashit ka një numër liqenesh akullnajore, siç është Dashi, i cili renditet i treti për nga madhësia dhe zë vendin e parë nga lartësia në të gjitha Alpet. Të gjitha burimet ujore kanë një cilësi të mirë të ujit. Ujërat sipërfaqësore përdoren për furnizim me ujë të pijshëm për komunitetet lokale dhe rajonale, si dhe për ujitje.

Lumi i Gashit konsiderohet gjithashtu si një potencial i mirë tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj. Në pjesën e poshtme të Lumit të Gashit ka gjithashtu aktivitete të peshkimit sportiv.

Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 1996/01/15 “Mbi miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit të vlerësimit mjedisor nga projektet pyjore”, Lugina e Valbonës është shpallur “Parkut Kombëtar”, me një sipërfaqe 8000 ha. Ndodhet 23 km nga qyteti i Bajram Currit dhe është i vetmi Park Natyror Kombëtar i Qarkut Kukës. Ajo është zona malore më e vizituar në Shqipëri. Ajo vizitohet masivisht nga turistë të huaj dhe vendas. Përgjatë luginës së Valbonës janë ndërtuar dhe adaptuar disa hotele dhe shtëpi pritëse për turistët. Në Luginën e Valbonës, hotelëritë dhe shtëpitë pritëse gatujnë dhe shërbejnë gatime tradicionale si maza, flija, mishi i pjekur i qengjit dhe kecit, etj

Parku Kombëtar mbulohet kryesisht nga pyjet e përzier me kullota natyrore dhe male të larta. Habitata më të përhapura të parkut janë pyjet. Ato janë vendosur përgjatë luginës dhe ofrojnë një peizazh të pasur dhe një kombinim të veçantë të ekosistemeve. Kullotat dhe livadhet janë gjithashtu të kudo të pranishme.

Parku Natyror Nikaj-Mërturi që është krijuar se fundmi, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 17,505 ha. Parku jo vetëm që përfaqëson vlerat më të larta të biodiversitetit, për shkak edhe të gjerësisë së konsiderueshme të brezit vertikal në të cilin ai shtrihet, por ai përfaqëson edhe një zonë me tradita e zakone nga më uniket në vend, shumë pak të eksploruara nga vizitorët që vijnë jashtë zonës së Nikaj-Mërturit.



Parku Natyror Nikaj-Mërturi përfaqëson një zonë të veçantë sa i përket sistemeve ekologjike të tij. Ka lloje të një rëndësie kombëtare e ndërkombëtare të florës dhe faunës ujore, të mjediseve të lagëta dhe asaj tokësore. Larmia e bimësisë, altitudes dhe pozicioni gjeografik e bëjnë parkun mjaft të pasur në vlerat natyrore të tij

PNR Nikaj-Mërturi që është shpallur me vendim Nr. 32 datë 13.10.2014 të Këshillit të Qarkut Kukës, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 18,544.6 ha. Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mërturi përfaqëson një pejsazh thujse natyror, të kombinuar me atë rural ku qendrat e banuara dhe tokat bujqësore përbëjnë elementët bashkëjetues të natyralitetit të zonës. Zona është ende e pandikuar nga zhvillimi intensiv i turizmit, bujqësisë dhe arkitekturës. Veçanërisht, arkitektura dhe pejsazhi janë dy elementët kryesorë me të cilët ndeshet çdo vizitor. Përveç disa qendrave të karakterit social (shkolla, ndërtesa të administratës, qendra shëndetësore etj), pjesa tjetër e arkitekturës së zonës përbëhet nga shtëpitë e banimit, të cilat në vetvete përbëjnë dhe arkitekturën tradicionale të zonës. Karakteristikë e përbashkët e shtëpive të banimit janë muret e gjera prej guri të lidhura me gëlqere, brezat prej druri dhe çatitë me tjegulla ose rrasa guri.

Rrethi i Tropojës përfshin brenda tij zonën e Alpeve Lindore, Malësinë e Gjakovës, Pellgun e Tropojës dhe krahinën Nikaj-Mërturi, me specifikat të relievit dhe klimës.

Alpet Lindore: Shtrihen në lindje të luginës së Shalës dhe Lugut të Runicës, në një shtrirje nga veriu në jug deri në 40 km, kurse nga lindja në perëndim 32 km.

Pellgu i Tropojës: Është më i madhi dhe më i bukuri i Alpeve, me një sipërfaqe 254 km². Relievi është i rrafshët deri në kodrinor. Me lartësi 200-800 m. Në këtë pellg jeton shumica e numrit të popullsisë të rajonit.

Malësia e Bytyçit: Përfshin relievin kryesisht kodrinor të Bytyçit deri në pellgun e Tropojës në veriperëndim. Veprimtaria kryesore në këtë Malësi është blegtoria (rritet dhia, delja, derri dhe lopa) dhe shfrytëzimi i pyjeve dhe mineralit të kromit. Krahina e Nikaj Mërturit: ndodhet në juglindje të Alpeve Shqiptare. Qendrat kryesore të banimit janë Lekbibaj, Curraj i Epërm, Curraj i Poshtëm, Gjonpepaj, Qereç-Mulaj, Shëngjergji, Tetaj etj. Veprimtaria kryesore është blegtoria dhe shfrytëzimi i pyjeve.

Si rezultat i relievit të larmishëm, pozitës gjeografike, faktorëve gjeologjikë, formacioneve të tokës, rrjetit hidrologjik dhe kushteve klimatike, Alpet shqiptare shfaqin një larmi të madhe të habitateve natyrore, duke përfshirë:

Pyje dushku dhe me pemë të tjera të ndryshme të larta, Kullota alpine dhe nën alpine, Pamje të shpateve të pjerrëta të maleve karbonatike dhe natyrore, Përrenj që sjellin ujë në lumenjtë dhe zonat përreth, Shpella dhe zona të tjera të ngjashme, Toka me lagështi të lartë, Liqene në lartësi shumë të mëdha (pranë majave të malit) Lumenj dhe përrenj të tjerë etj.



Kjo shumëllojshmëri e madhe e habitateve në zonat e Alpeve Shqiptare së bashku me treguesit e kushteve klimatike mesdhetare malore, kanë “përpunuar” në shekuj një gamë mjaft të lartë të diversitetit të bimësisë natyrore në këtë zonë. Habitati më i përhapur i Alpeve është pylli, i përbërë kryesisht nga pyjet halore dhe gjethegjere, si dhe pylli i ahut. Kullotat që përdoren kryesisht për kullotje dhe livadhe të habitateve, janë lloji i dytë më i madh i habitateve për sa i përket sipërfaqes së zonës që ato mbulojnë.

Lartësia e konsiderueshme nga niveli i detit dhe variacioni i lartë i terrenit malor dhe të kullotave alpine e bëjnë rrethin e Tropojës një hapësirë territoriale të favorshme për rritjen e bimëve medicinale. Në këtë rreth gjenden afërsisht 500 lloje bimësh mjekësore, ku spikat Boronica . Bimë të tjera mjekësore janë: dëllinja e zezë, molla e egër, sherbeia, lule bliri, trumza, çaji i malit, luleshtrydhet (dredhëzat dhe mjedrat), trëndafil i egër, aguliçja, qingla, lule shtogu, salepi, sanëza, lule basani, rrënjët e hithrës, kokrrat e shtogut, rigoni, bar pemza njëmijë gjetkëshe, lule kamomili, thundërmushka, kulumbria, mëllaga, zhumbriçat, shpatorja, ushejza pa kërcell e shumë të tjera.. Bima e boronicës rritet në kullota alpine rreth 1200 – 1800 m mbi nivelin e detit. Çdo vit mblidhen rreth 70 tonë boronicë, 40 tonë dëllinjë e zezë, 30 tonë mollë e egër dhe 20 tonë trëndafil i egër.

Përparësitë

- Burimet natyrore dhe biodiversitetit
- Peizazhet panoramike
- Prezenca e parqeve natyrore, pyjeve, liqeneve dhe lumenjve të njohur
- Turizmi i lidhur me liqenin dhe rrjedhat ujore
- Lidhja me rrjetin rrugor ndërkombëtar (Tropoje -Gjakove)

Dobësitë

- Zona të degraduara mjedisore
- Shfrytëzim i ulet i burimeve ekzistuese
- Bashkëpunim i ulet mes autoriteteve publike dhe operatoreve turistik
- Mungesa e inovacionit dhe integritit mes llojeve të ndryshme të turizmit
- Ndotja urbane

Mundësitë

- Mundësi zhvillimi i turizmit sportiv (sporte ujore – liqen, alpinizëm, etj.)



- Pjesëmarrja ne programet dhe iniciativat e bashkëpunimit ndërkufitar
- Turizmi rural i lidhur me malin
- Turizmi natyror: Shishtaveci si vend qe karakterizohet nga prania e sporteve dimërore dhe i lokalizuar ne mënyre te përshtatshme ne lidhje me flukset ndërkufitare
- Zhvillimi i prodhimit te energjisë hidroelektrike(energji e pastër).

Rreziqet

- Ndotja
- Mungesa e kontrollit mjedisor
- Erozioni dhe shpyllëzimi

Rekomandime për sistemin Natyror

Sistemi natyror përfaqëson mundësinë më të madhe të zhvillimit për bashkinë Tropojë gjithashtu përbën pjesën më të madhe të territorit. Duke marre ne konsideratë brishtësinë e këtij sistemi dhe rëndësinë që kanë elementet e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar bashkia e Tropojës duhet të angazhohet si me burimet e veta njerëzore ashtu me angazhimin e donatorëve dhe aktorëve ndërkombëtar në mënyrë që të ky sistem, nëpërmjet një menaxhimi të kujdesshëm, të ruhet nga rreziqet kryesisht të shkaktuara nga dora e njeriut të cilat çojnë në degradimin e elementeve me vlera të këtij sistemi.


Ndër masat thelbësore që duhen ndërmarrë për mirëmenaxhimin e ketij sistemi janë të lidhura me kontrollin më të efektshëm të aktivitetit minerar, sidomos atij me karriera i cili lë gjurmë të rëndësishme në peizazhin natyror, si dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të lidhura me prodhimin e lëndës së parë për ngrohje. Nxitja e ngritjes së fidanishteve për këtë qëllim si dhe pyllëzimi i kodrave të Bytyçit me variete të cilat i përshtaten cilësisë së këtyre tokave që paraqesin prodhimtari të ulët do të ndihmonte në mbarëvajtjen e aktiviteteve natyrore në këtë sistem.

1.2.3 Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit ujqor

Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në territore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit “Ujëra dhe ligatina” rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria.

Sistemi ujqor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”. Çdo zhvillim në brigjet ujqore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga





legjislacioni i posaçëm dhe kjo rregullore.

Sistemi uxor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit uxor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Sistemi uxor me një sipërfaqe prej 965 ha (0.9% të territorit) përbëhet nga Lumi i Currajve, i Valbonës, i Gashit, i Sylbicës, i Bytyçit dhe i Skatinës. Burimet ujore ndahen në burime ujore për prodhim të energjisë elektrike, burime ujore për vaditje ku kemi 267km kanale ujitëse (një pjesë e mirë e tyre jashtë funksioni për mungesë mirëmbajtjeje) dhe 8 rezervuarë për grumbullim uji për vaditje, si dhe burime ujore për konsum nga popullata. Shumë prej burimeve ujore, përjashtuar ato të lumit Drin, janë pak ose shumë pak të shfrytëzuara deri tani. Ky është një sistem i pasur me potencial zhvillimi të aktiviteteve, ekonomike, energjetike, të peshkimit apo dhe të turizmit. Mungesa e një sistemi mbështetës infrastrukturor dhe politikave mirëmbajtëse kanë sjellë shfrytëzimin jo të plotë të përfitimeve që ofron ky system.

Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në territore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit "Ujëra dhe ligatina" rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria. Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm dhe kjo rregullore. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit uxor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e rezervave ujore dhe për parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit janë objekt i lejeve administrative ose koncesioneve, kur këto janë brenda kuadrit të shërbimeve publike. Është i ndaluar magazinimi i materialeve dhe lëndëve, që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
Sistemit Uxor



në zonat e kërcënuara nga përmytjet.

Menaxhimi shkencor i ujit dhe energjisë ka qenë dhe mbetet një target thelbësor me pasoja të rëndësishme për të sotmen dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Rrethi i Tropojës është e pasur me burime ujore dhe ofron një shumëllojshmëri të biodiversitetit.

Zona e Tropojës karakterizohet nga prania e liqenit të Fierzës që përfaqëson bashkimin e disa përrenjve dhe lumenjve. Lumjete rrezikohen nga ndotja e ujit si rezultat i dekompozimit të mbeturinave me origjinë urbane bujqësore dhe industriale.

Sistemi i ujit që përfshin liqene dhe lumenj është përdorur kryesisht për energji elektrike, bujqësi dhe furnizimin me ujë problemi kryesor i të cilit është i lidhur me ndotjen si pasojë e shkarkimit të ujit të patrajtuar. Monitorimi i analizave të kryera në vitet e fundit në Shqipëri, tregon një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ujit të lumenjve dhe liqeneve. Në mënyrë të vecante, përveç demit të shkaktuar nga shkarkimi i ujerave të zeza të patrajtuara në afersi të qendrave urbane, ujerat me të ndotura janë në afersi të burimeve të ndotjes, si zonat industriale, ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe vendeve të minierave dhe të perpunimit mineral.

Për sasinë e burimeve ujore që ka, territori i Tropojës, ka një potencial të madh nga pikëpamja hidroenergetike si në aspektin e stacioneve të rëndësishme hidroelektrike dhe atyre të vogla.

Rrethi i Tropojës është i pasur me ujëra natyrorë, që janë tërësia e rrjetit hidrografik të rajonit si: përrenj, lumenj, ujëra nëntokësore, burime, liqene, ujëmbledhës artificial. Në rrjetin hidrografik të saj përfshihen shtatë lumenj, ndër të cilat Drini, Valbona, lumi i Gashit, i Tropojës, i Currajt, i Skatinës, i Bytyçit, disa prej të cilave për nga përmasa morfologjike dhe shkalla e ujësisë janë lumenjtë të mëdhenj të vendit tonë (Drini dhe Valbona).

Në rrjetin hidrografik përfshihen edhe dhjetëra liqene përfshi liqenjtë akullnajor dhe ato artificial si Fierza dhe Komani. Gjithashtu ka dhe qindra burime të mëdha dhe të vegjël ujërash nëntokësor karstike. Ujerat që lagin këtë territor karakterizohen nga kthjelltësia.

Këtij rrjeti i bashkëngjitet edhe sistemi i gjerë i kanaleve kulluese e ujitëse.

Lumenjtë: Tropoja laget nga shtatë lumenj, të cilët krijojnë lugina me vlera turistike dhe shkencore. Ata janë: Lumi i Gashit (lugina e të cilit është shpallur Park Kombëtar i kategorisë së parë - Zonë e mbrojtur strikte), Lumi i Valbonës (lugina e të cilit është shpallur Park Natyror Kombëtar), Lumi i Drinit, Lumi i Currajt, Lumi i Skatinës, Lumi i Sylbicës dhe Lumi i Bytyçit Në pellgun e Tropojës rrjedhin gjithashtu disa përrenj kryesor si: përroi i Kasajt, Lugut të Zi, Vitalinës, Degës, Margegajt etj, që shërbejnë si degë



kryesore të lumit Valbona. Ata formojnë lugina dhe kanione që janë ndër më të njohurat dhe më atraktivet në vendin tonë.

Liqenet në rrethin e Tropojës janë të natyrës akullnajore, tektonike dhe artificiale. Ato ndikojnë në klimën e zonës, përhapjen e bimësisë dhe nivelin e zhvillimit të faunës. Liqenet akullnajore, formojnë grupe të veçanta me 10 deri 22 liqene dhe shtrihen në lartësitë 1600-1800 m. Këta liqene janë të tipit të cirqeve dhe ndodhen në lartësitë 1600 m mbi nivelin e detit. Në shumicën e rasteve janë të vendosura në grupe ku ndër grupet kryesore përmendim liqenet e Dobërdolit. Gjithashtu përmendim liqenet e Jezercës, Ponarëve, Sylbicës e të Runicës.

Liqenet akullnajore kanë vlera të mëdha shkencore, ekologjike dhe turistike. Kryesore janë: Liqenet artificiale, të ndërtuara nga diga e hidrocentraleve përkatëse, Fierza dhe Komani, të cilat shfrytëzohen për qëllime hidroenergjetike, për ujtjen e tokave bujqësore, për furnizim me ujë të industrisë, për peshkim.

Liqeni i Fierzës u krijua në 1978 nga ndërtimi i digës së hidrocentralit mbi lumin Drin në Fierzë, pas bashkimit të Drinit të bardhë me Drinin e Zi. Sipërfaqja e tij është 72,5 kilometra katrorë, thellësia maksimale 128 metra. Vëllimi është 2,7 miliardë metra kub ujë. Ujërat janë relativisht të ftohtë, sepse liqeni ushqehet jo vetëm nga lumenjtë, por edhe nga përranj të shumtë malorë të cilët zbrasin poshtë, e që bien në malet e larta rreth e rrotull. Mbi liqen është zhvilluar transporti me anije.

Liqeni i Komanit ka një sipërfaqe prej 12 kilometrash katrorë, gjatësi 34,5 kilometra dhe vetëm 50-60 metra i gjerë, i cili dredhon ngushtë përmes një Kanioni të maleve me shpatë të thepisura shkëmbore me pamje impresionuse. Liqeni është krijuar nga lumenjtë e Drinit dhe Valbonës. Këtu mund të kryhen udhëtime me traget, me anije si dhe me varka peshkimi. Mund të vizitohet shpella karstike e Komanit midis Berishës në krahun jugor dhe Tplanit. Ishulli i Shenjtë i Pëllumbave është një destinacion pelegrinazhi jo vetëm për katolikët por edhe amatorët e natyrës. Udhëtimi me traget në liqenin e Komanit është cilësuar si një nga udhëtimet më të bukura liqenore në botë

Hidrologjia e Alpeve të Shqipërisë ka karakteristika origjinale. Ato dallohen nga zhvillime të larta të rrjetit hidrografik të përfaqësuar nga baseni uJOR i Liqenit të Shkodrës, Drinit, Bunës, Vermoshit, Kirit, Shalës, dhe Lumi të Valbonës. Lumenjtë e zonës derdhen në Detin Adriatik. Lumenjtë përmbajnë një numër të madh kafshësh endemike, kryesisht peshq. Liqenet e larta malore janë kryesisht me origjinë akullnajore dhe nuk përmbajnë shumë specie endemike.

Zona është e pasur me burime të ujit të freskët. Uji përdoret nga komuniteti vendas kryesisht për të pirë, dhe vaditje. Gjithashtu përdoret dhe për prodhim energjie dhe aktivitete rekreative.

Lumi i Valbonës është lumi më i gjatë dhe lumi më i madh në zonë. Ai është ende rela-



tivisht i pacenuar. Burimi i tij shtrihet afër kufirit me Malin e Zi.

Lumi i Valbonës është një nga degët kryesore të Lumit të Drinit. Sipërfaqja ujëmbledhëse e tij shtrihet në pjesën Qendrore dhe Lindore të Alpeve të Shqipërisë. Pellgu ujëmbledhës kufizohet në perëndim me lumenjtë Shalë dhe Curraj, në jug-lindje me përroin e Skatinës dhe në jug me liqenin artificial të hidrocentralit të Komanit. Në veri dhe në lindje ai kufizohet me Malin e Zi dhe Kosovën.

Në zonën e Nikaj-Mërturit gjenden dy lumenj të përhershëm, lumi i Currajt dhe ai i Nikajt. Të dy këta lumenj të vegjël bashkohen në Currajt e poshtëm dhe formojnë lumin kryesor të zonës që është lumi i Nikajt, me një gjatësi rreth 19 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 145 km². Kudo uji është shumë i pastër dhe i pijshëm, me përjashtim të zonave në afërsi të shtëpive. Trupa më e madhe ujore në zonë është liqeni i Komanit. Edhe këtu uji është shumë i pastër, por brigjet e liqenit janë të ndotura nga shishet dhe materiale të tjera të shumta plastike.

Operimi privat i centraleve të vogla të energjisë ka filluar në vitin 1999 me hyrjen në fuqi të ligjit për privatizimin e asetëve shtetërore në sektorin e energjisë, që fillimisht menaxhoheshin tërësisht nga kompania KESH. Raporti komercial mes KESH-it dhe operatoreve privat u stabilizua në vitin 2002 dhe, deri me sot, janë nënshkruar disa marrëveshje të blerjes së energjisë.

Për territorin e Tropojës një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është ai në lidhje me shitjen e energjisë hidroelektrike, një burim kryesor i të ardhurave të qeverisë që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e të ardhurave publike.

Kuadri ligjor përfshi ndër të tjera: 1. Ligji për privatizimin e hidrocentraleve lokale e n. 8527/1999, ndryshuar me ligjin nr. 9479/2006; 2. Ligji për sektorin e energjisë n. 9072/2003; 3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Energjinë Nr 424/2003; 4. Ligji për sigurimin e kushteve të favorshme për ndërtimin e instalimeve të reja për gjenerimin e energjisë n. 8987/2002; 5. Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Modelit Tranzitor

Tregut të Energjisë Elektrike n. 539/2004; 6. Ligji për efikasitetin e energjisë n. 9379/2005.

Për përdorimin e ujit për përdorim të përditshëm, problemet kryesore që ndodhin në përgjithësi në vend, janë konfirmuar edhe për Bashkinë e Tropojës, dhe i referohen:

- Mungesa e infrastrukturës adekuate;
- Mbulimi i shëndetit dhe higjienës në zonat urbane dhe rurale qëndron në vetëm 47.9%;
- Në përfundim të analizës mundet të rëndësim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit Ujor:



Përparësitë

- Prania e një rrjeti te dendur ujqor nëntokësor dhe sipërfaqësor
- Lumenj malor qe ofrojnë energji hidroelektrike dhe janë burim ujitje për bujqësinë
- Bashkimi i rrjedhave te Drinit te zi dhe Drinit te bardhe

Dobësitë

- Ndotje e forte nga derdhjet e patrajuara ne pellgun e Fierzës
- Kontrolli sanitar: për tu përmirësuar dhe shtrire ne te gjithë sistemin
- Vështirësi dhe pengesa ne lidhje me shërbimet e kanalizimeve te ujerave te zeza
- Paqartësi mbi pronësinë e rrjeteve te kanalizimeve te ujerave te zeza
- Verifikimi i ofrimit te shërbimeve ne zonat informate urbane
- Mungesa e infrastrukturës adekuate
- Mbulimi i shëndetit dhe higjienës ne zonat urbane dhe rurale qëndron ne vetëm 47.9%

Mundësitë

- Riorganizim i perpunimit te urave
- Përfshirja e burimeve ujore te përbashkëta ne shoqërinë ekzistuese Kukës sh.a.
- Bashkëpunimi me agjentet fiskal apo subjekte te tjera
- Investime për te përmirësuar mbulimin me shërbime

Rreziqet

- Shfrytëzimi hidroenergjetik I territorit pa impakt ekonomik ne zone
- Rrezikun e përmytjeve gjate periudhave te reshjeve te renda ne dimër / pranvere
- Ka lidhje te shumta informate dhe te paligjshme.

Rekomandime për sistemin Ujqor

Sistemi ujqor është i gjithëpranishëm në territorin e Tropojës dhe si i tillë kërkon angazhim serioz për mirëmenaxhimin e gjithësisë së problemeve që parashtrojnë. Urgjente për këtë territor dhe marrëdhënien e tij me sistemin ujqor mbeten çështjet e ndotjes së



tij. Sfidë e parë për qeverisjen vendore është ndërtimi i sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza të cilat aktualisht derdhen direkt në lumenj duke ndotur ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Problematikë gjithashtu urgjente është ajo e menaxhit të mbetjeve. Mungesa e efektshmërisë në këtë sektor ka efekte direkte në cilësinë e sistemit ujqor.

Tjetër aspekt i rëndësishëm i lidhur me sistemin ujqor është mundësia e këtij sistemi për tu shfrytëzuar për prodhim të energjisë. Bashkia Tropojës duhet të sigurohet që ky aktivitet shumë i rëndësishëm për territorin e Tropojës por edhe me rëndësi kombëtare të zhvillohet nën kontroll të vazhdueshëm në mënyrë që sidomos në periudha të caktuara të mos çenojë vlerat e biodiversitetit të këtij territori.

1.2.4 Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit bujqësor

Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”. Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitetet e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj.

Sistemi bujqësor zë një sipërfaqe prej 7300 ha (12.9%) të gjithë territorit të bashkisë Tropojë. Në këtë sipërfaqe përfshihen jo vetëm tokat bujqësore me të mbjella të përhershme, por edhe livadhet, tokat heterogjene (toka kryesisht të zëna nga bujqësia por edhe me bimësi natyrale), dhe tokat bujqësore pjellore por të papunuara.

Sistemi bujqësor (B) përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Duhet përsëritur që konceptimi i sistemit bujqësor nuk konsiston vetëm në zonimin funksional bazuar në përdorimin e tokës, por në evidentimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm dhe profilizim të zgjuar. Aq më tepër merr rëndësi ky aspekt në kushtet e Bashkisë Tropoje, ku cilësia e ulët e tokës nga njëra anë, dhe kushtet specifike klimatike nga ana tjetër, kërkojnë orientimin e projekteve drejt produkteve karakteristike të zonës.

Zhvillimi dhe ndërtimi në zona bujqësore kryhen sipas dokumenteve të planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm për tokën bujqësore. Çdo dokument i përgjithshëm ose sektorial planifikimi që parashikon edhe ndryshim të kategorisë së përdorimit të tokës nga bujqësi në përdorime të tjera dhe anasjellas shoqërohet, sipas rastit, me aktet përkatëse të ndryshimit sipas legjislacionit të posaçëm. Duhet theksuar se boniteti i kësaj toke




është i cilësisë së dobët dhe me prodhimtari të ulët.

Zona e Tropojës ka potenciale të pashfrytëzuara përse i përket tokës bujqësore të papunuar. Gjithashtu edhe rendimenti në bujqësi dhe blegtori është relativisht i ulët. Potenciali prodhues i Tropojës është të paktën dyfishi i prodhimit të tanishëm. Në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blegtoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermerë dhe të qytetit Bajram Currit. Një pjesë e tyre përdoret për të plotësuar nevojat e banorëve të qytetit të Bajram Currit dhe turizmit në Luginën e Valbonës. Një pjesë e vogël tregtohet jashtë bashkisë (Shqipëri apo Kosovë).

Blegtoria është një sektor prioritar dhe jetik për zhvillimin e zonës rurale dhe ekonomisë në zonën e Tropojës. Ajo nuk ndahet nga zhvillimi i bujqësisë dhe është pjesë integrale e zhvillimit të këtij sektori. Blegtoria luan një rol të rëndësishëm dhe kryesisht mbarëshihet për qumësht dhe mish. Ky sektor i ekonomisë ka një rol të rëndësishëm në ekonominë e rrethit për vetë faktin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së kullotave të shumta natyrore. Hapësira e gjerë e kullotave alpine ofron një kapacitet të mjaftueshëm për zhvillimin e blegtorisë. Prodhimet blegtorale përdoren për konsum familjar dhe një pjesë e tyre shiten në tregun e brendshëm. Në llojet e kafshëve të mbarështuara në shkallë rrethi, vendin kryesor e zënë: gjedhi, të leshtat dhe të dhirtat. Lloje të tjera mjaft të përhapura janë: njëthundrakët, shpendët dhe derrat. Vihet re një rënie e përgjithshme e numrit të krerëve dhe ndër arsyt kryesore janë mungesa e baxhove dhe e tregjeve për tregtimin e produkteve si mishi, qumështi, gjalpi, djathi dhe leshi i bagëtive. Bujqësia paraqet sektorin më potencial për tregti dhe shkëmbim në komunitetet vendore të Tropojës. Pemëtaria, dhe bletaria janë të zhvilluara në zonë. Plantacione gështenjash, boronicat, bimët medicinale përbëjnë produktet lokale tipike që rrisin kërkesën për bashkëpunim më qëllim rritjen e vlerave të prodhimeve bujqësore. Mbledhja dhe tregtimi i gështenjës dhe boronicës përbën një nga burimet kryesore të ardhurave për fermerët në Tropojë. Fermerët në Tropojë nuk kanë kapacitetet për magazinimin, përpunimin dhe parketimin e tyre. Ngritja dhe funksionimi i infrastrukturës magazinuese dhe garo-përpunuese paraqet një nevojë imediatë për rritjen e vlerës së prodhimeve bujqësore.

Sipërfaqet bujqësore janë mjaft të kufizuara dhe të fragmentarizuar. Tokat bujqësore në territorin e bashkisë llogariten të jenë 7.390 ha e cila ndodhet kryesisht në kuotat 250-550 m mbi nivelin e detit në të cilën mbillet dhe prodhohet: misër, grurë, perime dhe foragjere për blegtori. Potencial përbën brezi i kullotave alpine, që shtrihet kryesisht në lartësi mbi 2000 m. Tropoja konsiderohet e pasur gjithashtu me disa lloje drurësh frutore ku vlen për t'u përmendur gështenja, molla, arra, kumbulla, boronica, etj, shumëllojshmëri bimësh aromatike e medicinale prej të cilave më kryesorja është boronica. Pemëtaria (kumbull, mollë, rrush, qershi, etj) kultivohet kryesisht në zonën kodrinore e malore të territorit të bashkisë, e zhvilluar në kuotat 300-600m mbi nivelin e detit, kurse gështenja zhvillohet kryesisht në kuotat 550-850m mbi nivelin e detit. Pylli i gështenjës,





ndodhet në afërsi të Bajram Currit, në pjesën veriore të tij.

Për sa i takon bonitetit, tokat bujqësore të Tropojës klasifikohen në kategorinë VI-te, si mesatare rrethi. Bëjnë përjashtim vetëm tokat e Llugajt, Bujanit dhe të Zogajve. Disa toka të fshatrave Lekbibaj (Brise dhe Salce) janë të kategorisë së IX-te. Theksojmë se boniteti është kryer 30 vite më parë, dhe toka ka nevojë për një rivlerësim të ri. Bujqësia është sektori kyç i zhvillimit ekonomik në rrethin e Tropojës. Rezultojnë të regjistruara 4800 ferma që ushtrojnë aktivitetet bujqësor dhe blegtoral në shkallë rrethi. Sipërfaqja mesatare e tokave të punuara është 0.9 ha/familje, ndërsa sipërfaqja në aspektin individual rezulton 0.25 ha/frymë. Tokat bujqësore kategorizohen në 77% të kafenjta, 22% të murrme dhe rreth 0.6% livadhore alpine. Sipërfaqen më të madhe të tokës së punueshme e zënë arat (rreth 50%). Kulturat kryesore bujqësore që mbillen në këto toka janë: misri, gruri, perimet, foragjeret dhe patatet. Nga prodhimi i tyre, banorët e Tropojës sigurojnë rreth 39% të ardhurave. Vendin kryesor në këtë nën sektor e zënë respektivisht: Njësitë administrative Tropojë, Margegaj, Bujan dhe Llugaj, të cilat favorizohen dhe nga afërsia gjeografike e ndërveprimi më intensiv me Bajram Currit, në cilësinë e qendrës së rrethit. Peshën më të madhe e zënë drithërat (rreth 75%), ndërsa perimet kanë një rol më inferior. Pavarësisht nga kushtet e favorshme, vihet re një rënie e sipërfaqes së mbjellë për të gjitha kulturat bujqësore, duke përjashtuar foragjeret. Kjo lidhet me largimin e familjeve nga fshati në qytet, migrimin e jashtëm, uljen e kapaciteteve ujitëse, mungesën e mekanizimit të shumë faktorëve të tjerë. Kjo ulje është shoqëruar me rritjen e kulturave livadhore polifite shumëvjeçare, si nevojë e sigurimit të bazës ushqimore për blegtorinë

Fakti më i rëndësishëm rreth pemëtarisë është se Tropoja ka masivin më të madh të gështenjave, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Ballkan. Ky masiv shtrihet në 2,000 hektarë dhe numëron më shumë se 190,000 rrënjë, ku dallohen njësitë administrative e Bujanit, Lekbibaj, Tropojës dhe Margegajt. Ky rreth gjithashtu ka si karakteristikë kumbullën tropojane, aroret e shumta, mollët e shumëllojshme (gjyle, starkinge etj.) dhe vreshtat e tij. Sipas të dhënave rezulton që vetëm gjatë vitit 2016 janë gjeneruar më shumë se 4 milionë € të ardhura nga shitja e gështenjave. Vendet kryesore të eksportimit të saj janë Gjermania, Austria dhe Turqia

Tropoja konsiderohet e pasur gjithashtu me disa lloje drurësh frutore ku vlen për t'u përmendur molla, arra, kumbulla, boronica, etj, shumëllojshmëri bimësh aromatike e medicinale prej të cilave më kryesorja është boronica.

Zona e Tropojës ka potenciale të pashfrytëzuara si përsa i përket tokës bujqësore të papunuar. Potenciali prodhues i këtyre zonave është të paktën dyfishi i prodhimit të tanishëm. Ka tokë pjellore dhe e përshtatshme për pemëtari dhe vreshtari. Ka një traditë të mirë në zhvillimin e frutikuturës (gështenja, kumbulla, molla, etj.). Kërkohej vëmendje në rritje e qeverisë qendrore dhe agjencive të zhvillimit dhe donatorëve ndaj zonave

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
Sistemit
Bujqësor



malore. Po kështu edhe projektet e Bashkëpunimi ndërkuftar dhe rajonal duhet të fokusohen në projekte konkrete ndihmëse të banoreve të këtyre zonave.

Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të turizmit malor, është e nevojshme që struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore të orientohet drejt plotësimit të nevojave të turizmit malor.

Mbledhja dhe tregtimi i gështenjës është një nga burimet kryesore të ardhurave për ekonominë lokale. Në këtë kontekst, mund të rritet pesha specifike e tokës së mbjellë me arrere (arrë, lajthi dhe gështenje). Gështenja ka një prodhim mesatar prej 10.5 kg/rrenjë rreth 2500 ton në vit, prodhim i cili zë 70% të prodhimit të gjithë frutave të rrethit. Shtrihet në të gjithë rrethin në të 8 njësitë administrative. Ndarja në kashnjete të vogla (siç i quajmë vendasit) për çdo familje. Janë rreth 3000 familje ose 28000 banorë përfitues të drejtpërdrejtë. Kërkesat për këtë frut janë shumë të mëdha nga tregu vendas dhe tregjet evropiane.

Zhvillimi i brand-it të "Gështenjës së Tropojës" do të ishte një hap i rëndësishëm. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në sigurimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë dhe rritjen e të ardhurave nga shitja e produkteve. Mbledhja dhe tregtimi i gështenjës është një nga burimet kryesore të ardhurave për ekonominë lokale.

Formalizmi i pronësisë mbi masivet e gështenjës do të ndikonte pozitivisht në mbledhjen dhe tregtimin e gështenjës si nga burimet kryesore të ardhurave për ekonominë lokale. Duhet theksuar se tregtimi i gështenjës bëhet kryesisht si frut i sapo mbledhur/papërpunuar dhe shumë pak i përpunuar. Ai eksportohet jashtë vendit, kryesisht në Gjermani, Austri dhe Turqi. Tropoja nuk ka kapacitetet për përpunimin e gështenjës. Sot ka vetëm një Qendër të vogël e cila bën standardizimin dhe ambalazhimin e frutit të gështenjës. Për mungesë financimi, kjo Qendër nuk ka mundësi të përmirësojë teknologjinë për të bërë përpunimin industrial agro-ushqimor të frutit të gështenjës prandaj duhet të mbështetet me grante. Projekti për përpunimin e gështenjës është i përgatitur. Nga prodhimi i këtij viti u siguruan rreth 2500 ton ose rreth 4 milion euro të ardhura për fermerët

Vitet e fundit ka një tendencë për mbarështimin e bletarisë. Mbarështimi i bletarisë po shikohet si një aktivitet me mjaft perspektive nga ana e banoreve të rajonit, ku shumëlojshmëria e bimëve mjaltëse, pakësimi i përdorimit të pesticideve ka bërë që ky aktivitet të vijë në rritje nga viti në vit, fatmirësisht, ndryshe nga tendenca botërore që në zgjojeve të bletëve po pëson një rënie drastike nga viti në vit nga efekti i ndryshimeve klimatike, valëve të antenave celulare, përdorimit të lartë të pesticideve në bujqësi etj. Është i njohur mjalti i gështenjës në Tropojë për shkak të masivit më të madh në Ballkan të gështenjës. Është i njohur në mbarë vendin mjalti i Zogajve (Bytyçit) dhe i gështenjës (Krasniqe). Sasia e prodhimit vetëm nga Tropoja është rreth 61 ton mjaltë në vit. Në rrethin e Tropojës janë rreth 7000 zgjoje bletësh me një prodhim rreth 80 ton



ne vit. Mjalti është cilësor, por rendimenti i tij është relativisht i ulët, rreth 9 kg/zgjuja. Për zhvillimin e bletarisë, ka pasur edhe interes dhe subvencione nga shteti. Meqenëse mjalti është i një cilësie të mirë, veçanërisht mjalti i gështenjës, kërkohet shumë dhe shitet në tregun lokal, por edhe jashtë rrethit, por sasia e prodhuar është e kufizuar në krahasim me nevojat e tregut.

Relievi i ndërthurur mes lëndinave e pyjeve dhe natyra në përgjithësi e karakterizuar nga ajri i pastër krijojnë kushte të favorshme për rritjen e bletëve

Lidhja e bujqësisë me blegtorinë është e pandalshme, prandaj dhe sipërfaqja me e madhe e tokës mbillet me foragjere për ushqim për bagëtitë. Karakteristike është që pjesa fushore merret me shume mbarështimin e gjedhit, ndërsa pjesa malore ne zonën ku ka kullota alpine me shume merren me mbarështimin e deleve ndërsa pjesa e zonës se pyjeve te larta dhe te ulte me shume me dhinë. Blegtoria është e shtrire ne te gjithë zonën, me dominim me te madh te kafshëve te imta (dele, dhi). Por përqendrimi me i madh i saj është ne zonat e Margegajt dhe Tropojës vjetër.

Zona e Margegajt është pjese e rëndeshe e ekonomisë se zonës pasi siguron një pjese te konsiderueshme te ardhurave qe sigurohen nga mishi, ndërsa produktet e nënproduktet e tjera përdoren kryesisht për përdorim familjar dhe nuk tregtohen ne treg. Dhente përdoren kryesisht për prodhim mishi, kryesisht për tregun lokal ne Tropoje, kurse qumështi dhe leshi për përdorim familjar, shume pak tregtohet ose aspak. Raca me përhapur ne zone është tipi i deles “Bardhoke”.

Prodhimi blegtoral nuk është ne rendimente te larta kjo për shume arsye, por me kryesorja është qe tregu i produkteve blegtorale është i vogël dhe racat e mbarështuara nuk janë te shquara për prodhimtari te larte. Prodhimi i qumështit është me i larte, por rendimenti dhe përfitimi nuk është shume i lart. Përpunimi i prodhimeve blegtorale, kryesisht i qumështit është ne formën tradicionale dhe behet nga çdo familje , ku merren kosi, gjalpi, gjiza dhe djathi, kryesisht për nevojat familjare dhe pak për treg.

Për më tepër sistemi ekzistues i vaditjes nuk plotëson nevojat e fermerëve, ku sistemi vaditës mbulon vetëm 29 % të sipërfaqes së mbjelle potenciale të për shkak të mungesës së investimeve në përmirësimin dhe mirëmbajtjen që rrjedhin si pasojë e tranzicionit, fakt që përball Bashkinë Tropojë me nevoja konkrete në përmirësimin e sistemit vaditës. Përsa i përket aftësisë ujitëse, sistemi ekzistues i ujitjes në bujqësi nuk mbulon nevojat e fermerëve për vaditjen e tokave bujqësore. Për vitin 2016 është mundësuar ujitja e 29% e sipërfaqes së mbjellë ose 42 % e sipërfaqes potenciale. Sipërfaqja potenciale që duhet të ujitet është jo me pak se 70% e totalit të fondit tokës.

Ne takimet me komunitetet është paraqitur si një nga kërkesat kryesore dhe me urgjente ndërhyrja për rikonstruksionin e kanaleve ekzistuese vaditëse. Bujqësia ne Tropojë është e lidhur ngushtë me funksionimin e dy veprave kryesore vaditëse: Kanali Krasniqes dhe



Kanali i Gashit. Aktualisht kanali Gashit nuk funksionon për rrjedhoje janë rreth 1000 hektarë toke bujqësore që kane mbetur pa u vaditur. Fermerët e ngrenë si parësor ndërhyrjen ne sistemin e vaditjes. Mos mbjelljen e kulturave bujqësore dhe migrimin e te rinjve ata e lidhin me mos funksionimin e këtyre veprave te vaditjes.

Konkretisht janë kërkuar këto ndërhyrje te veprat vaditëse: Ne zonën e Lekbibaj: Ndërtim i kanaleve ujitëse ne fshatrat: Gjonpepaj, Peraj, Lekbibaj, Shëngjergj e Curraj. Ndërtimi i kanalit te ujit zi , me gjatësi 8 km, sipas banoreve te zonës, zgjidh problemet e fermerëve ne këtë zone. Ne njësinë administrative te Fierzës, dëmtimi dhe mosfunksionimi i rezervuarit te Tplanit, ka lënë pa vaditje 400 hektarë toke bujqësore. Ne zonën e Bujanit kërkohet vënia ne funksion te plote e kanalit te fisit (Krasniqes) me te gjitha degëzimet. Ne zonën e Tropojës se vjetër, fermerët kërkojnë te rivitalizojne kanaline vaditës te Gashit , i cili mbulon me shume se 1000 hektarë. Kërkesa te tjera kane për rikonstrukcionin e këtyre kanaleve vaditëse : Kanali i Gashit 25 km (është projekti) Kanali i Myhejanit 5.8 km; Kanali rezervuari Kasaj – Vicidol – Sylaj – Mejdani (projekti është ne M.Bujqesise); Kanali Vicidol –Sylaj 4.2km; Ura Aste-Kojel Rrafsh 1.9 km; Kanali Aste –Kojel shpat 2.9km; Kanali vaditës Treleze Kasaj 1.8 km; Kanali Shumice –Boshnjak 1.8km; Kanali Shumice – Bucin 1.4 km; Kanali Kuçanes 2 km; Kanali Papaj 1.5 km; Kanali Begaj I poshtëm 3 km; Kanalet vaditëse Shumice 2 km.

Peshkimi përbën një potencial mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Zonës. Liqeni i Fierzës, përbën një mundësi të madhe për kultivimin e peshkimit me rreth 5000 ha sipërfaqe ujore (pra mbi 70%) duke e kthyer peshkimin në Liqenin e Fierzës, në një veprimtari të rëndësishme ekonomike për gjithë zonën. Ujërat janë tipike për kultivimin natyror të popullatave peshkore që në këtë zonë marrin një zhvillim vërtetë të dukshëm. Sot në Fierzë rriten rreth 13 lloje peshqish përfshirë edhe rritjen e midhjeve të vogla të ujërave të ëmbla.

Nga Liqeni është marrë deri në 5 mijë tonë peshk në vit, por prodhimi ka pësuar rënie në dhjetëvjeçarët e fundit për shkak të mos shtimit, por edhe për arsye të peshkimit të pa kontrolluar, shpesh dhe me mjete shfarosëse si dhe ndotja e liqenit. Po kështu mungojnë edhe kushtet për rritjen e ruajtjen e peshkut. Megjithatë, problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës. ambientit përreth, si dhe shfrytëzimin e terrenit për plazh dhe aktivitete ujore.

Marrja e masave për të përmirësuar kushtet aktuale të liqenit e rritur peshkimin, nëpërmjet pastrimit i Liqenit të Fierzës dhe zonës përreth tij, sistemit të bregut te Liqenit dhe përshtatjes së tij në një Pikë Turistike , si dhe peshkëzimit artificial si të Liqenit te Fierzës dhe ujëmbledhësve të Bashkisë Tropojë ka qenë dhe mbetën si prioritete për zhvillimin e këtij



Përparësitë

- Klima e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë;
- Kosto e lirë e krahut të punës;
- Tregu potencial është i konsiderueshëm pasi imazhi i produkteve bujqësore dhe blegtorale është mjaft pozitiv;
- Tradita historike familjare në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë dhe eksperiencat e përfutur në vite përben një bazë të rëndësishme për sektorin;
- Akses për tregun ndërrajonal dhe vendet fqinje.
- Tokë pjellore dhe e përshtatshme për pemëtarë dhe vreshtarë.
- Burime ujore për të mbuluar nevojat e bujqësisë për ujë.
- Zhvillimi i frutikulturës (gështenja, kumbulla, molla, etj.).
- Kultivimi i bimëve të arave me destinacion blegtorinë.
- Bimë mjekësore dhe aromatike të shumëllojshme.
- Traditë dhe kushte natyrore - kullota të bollshme në bjeshkë--për zhvillimin e blegtorisë.
- Ka kushte të favorshme për mbarëshkrimin e llojeve të ndryshme të blegtorisë (dhëntë e dhitë, gjedhë për mish, bletari, etj.).
- Bujqësia faktor nxitës për zhvillimin e turizmit veror dhe dimëror.
- Bimët medicinale dhe eterovajore ndodhen me shumicë në rrethin Tropoje.
- Ekzistenca e disa prodhimeve bujqësore të cilat dallohen për cilësinë e tyre;
- Interesi në rritje për prodhimet vendase dhe prodhimet bio;
- Çmimet konkurruese të produkteve bujqësore të zonës së Tropojës krahasuar me zonat e tjera të vendit;
- Potencialët e mëdha në prodhimin e bimëve aromatike medicinale

Dobësitë

- Madhësia e vogël e fermave;
- Niveli i ulët i mekanikës dhe teknologjisë bujqësore;
- Kapacitetet vaditëse;



- Pronësia dhe regjistrimi i tokës;
- Përdorimi i kufizuar i farave të zgjedhura që ndikojnë në rritjen e rendimentit e prodhimit;
- Kostoja e lartë e shpenzimeve të punimit tokës dhe plehrave komike.;
- Mungesa e pikave të grumbullimit me qëllim sigurimin e kushteve optimale të ruajtjes së produkteve bujqësore;
- siguria ushqimore e ofrimi i standardeve të duhura për konsumatorin
- Mungesa e dokumentacionit për pronësisë e tokës
- Aftësi ujitëse të pamjaftueshme,
- Kanale ujitëse jashtë funksionit
- Parcelizimi i tokave ne ngastra të vogla
- Mekanizimi bujqësor i pamjaftueshëm.
- Burime financiare të pamjaftueshme.
- Kreditë e buta mungojnë për fermerët.
- Sipërfaqe e vogël e pronës për fermer.
- Mungesa e qendrave të përpunimit të fruta perimeve.
- Mungesa e përpunimit të qumështit dhe mishit (baxho, thetore, punishte përpunimi mishi, etj.).
- Mungesa e impianteve të përpunimit të bimëve mjekësore.
- Mungesa e kryerjes së shërbimeve në kulturën e gështenjës.
- Burime njerëzore të pamjaftueshme dhe të pakualifikuara për bujqësi dhe blegtori.
- Mungesa e depove frigoriferike.
- Mungesa e tregjeve për tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale të zonës.
- Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme bujqësore, mungesa e teknologjive të reja bujqësore dhe teknikave të reja;
- Problemet me pronën dhe fragmentimi i saj;

- Mungese e kontrollit dhe e informimit ne përdorimin e pesticideve dhe helmeve;
- Mungesa e konsorceve rajonale dhe strukturave te tjera private apo qeveritare për te rritur aksesin ne treg nëpërmjet, markave, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, promocionit qe produktet bujqësore te kenë markën dhe linjën e tyre te tregu;
- Efiçencë e ulet e prodhimit për efekt te fragmentarizimit te larte te tokës bujqësore ne ngastra te vogla dhe mungesa e kultures se bashkepunimit mes fermereve ne forme Kooperative;
- Mungesa e pikave te grumbullimit te prodhimeve bujqësore veshtirson aksesin ne treg te prodhimit dhe gjeneron stoke dhe humbje te prodhimit;
- Kostoja e larte e prodhimit dhe rendimenti i ulet i prodhimit gjeneron norm atë vogla fitimi,
- Investime te vogla ne bujqesi;
- Mungesa e aksesit për te përfituar nga programet dhe skemat qeveritare;
- Mungesa e shkolles profesionale me profil bujqësor, numri i ulet i specialisteve keshillues te bujqësisë për fermer, mungesa e aftesise ne përdorimin e inovacioneve teknike dhe teknologjike nga fermeret;
- Mungesa e promovimit te produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Mundësitë

- Kerkesa e tregut për produkte BIO dhe te cerifikuara;
- Bujqesia është sektor me prioritet për qeverine;
- Mundesi për zhvillimin e agrobizneseve nëpërmjet zhvillimit te agroturizmit;
- Skema e subvencionit nga ministria e Bujqësisë, dhe e donatoreve te huaj;
- Përdorimi i farave te zgjedhura qe rrisin produktivitetin e prodhimeve bujqësore;
- Interes ne rritje për eksportin e bimëve medicinale dhe aromatike.
- Peshkëzimit artificial si te Liqenit te Fierzës dhe ujëmbledhësve te Tropojës ka qene dhe mbeten si prioritet te për zhvillimin e këtij sektori ne menyre te qëndrueshme dhe

Rreziqet

- Mungesa e aftesise për te bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermereve;



- Mungesa e studimeve dhe orientimeve te fermerëve për te kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive ne bujqësinë intensive dhe te integruar;
- Fatkeqësitë natyrore, sëmundjet dhe viruset e kulturave dhe mungesa e programeve dhe mjeteve te përshtatshme për parandalimin e tyre;
- Mungesa e politikave afatgjate ne mbështetjen e sektorit te Bujqësisë;
- Kostoja e larte e shpenzimeve te transportit;
- Niveli i ulet i eksporteve si pasoje e përdorimit pa kriter te pesticideve;
- Siguria ushqimore; Konkurrenca rajonale nga importet

Rekomandime për sistemin Bujqësor

Thelbësore në sistemin bujqësor është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve, dhe bashkia Tropojë duhet të japë kontribut në këtë nxitje edhe duke vënë në dispozicion të grupimeve të fermerëve pasuritë që disponon. Sistemi bujqësor në bashkinë Tropojë duhet të orientohet drejt një modeli të bujqësisë organike. Për shkak të mos shfrytëzimit të këtij sistemi për bujqësi ekstensive, përshtatja e prodhimitarisë bujqësore në territorin e bashkisë Tropojë me kushtet për bujqësinë organike do të ishte i menjëhershëm. Përveç kësaj boniteti i ulët i tokave bujqësore në këtë territor është i përshtatshëm për prodhimtari cilësore në shkallë të vogël.

1.2.5 Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit urban

Sistemi urban

Nga pikepamja e zhvillimit urban, si shpjegohet ne seksionin e analizës dhe vlerësimit te territorit, Bashkia e Tropojës duket se ka ndjekur gjate 25 viteve te fundit një trend qe ka çuar ne shpopullimin, sidomos nga zonat rurale drejt zonave qendrore por edhe, pjesërisht, nga Tropoja drejt Tiranës dhe Durrësit. Faktorët përcaktues te kësaj dukurie janë kryesisht te lidhura me kushtet e këqija te punës ne bujqesi, produktiviteti i ulet i sektorit dhe cilësia e dobët e aksesit ne shërbime te tilla si rruge, kanalizime, shkolla, ujesjellesa. Bashkia e Tropojës është konsideruar si një nga me te varfrat ne vend (2016) dhe densitet te ulet te popullsisë ne disa zona rurale gjë qe pengon investimet ne infrastrukture dhe shërbime, ne favor te një zhvillimi te monocentrik. Ne qytetin e B.Currit jeton rreth 34% te popullsisë se përgjithshme te qytetit dhe zonat me dendësi te ulet janë ato te Lekbibajt dhe Bytyçit.

Qyteti i Bajram.Currit është qendra administrative, ekonomike dhe sociale rreth te cilës



sillet i tere rrethi Tropojës. Qendrat e tjera te një fare rëndësie nga pika dimensionale dhe ekonomike janë Tropoja Vjetër, Fierza, Bytyçi, por qyteti i Bajram Currit është konsideruar si i vetmi treg i rendesishem ne te cilin realizohen shkëmbimet kryesore. Roli primar i Tropojës është dhëne edhe nga ndërveprimi fqinj me Kosovën dhe qytetet e Gjakovës dhe Prizrenit.

Si rezultat i reformës administrative, bashkia e Tropojës është e përbëre nga 7 Njësi.

Nga informacionet e marra nga Censusi i vitit 2011 rezulton se mbi 80 % e banesave janë ndërtuar para vitit 1991. Kjo na lejon të perceptojmë nevojat që kanë banorët dhe Bashkia e Tropojës për të përmirësuar kushtet e banimit dhe kualitetin e jetesës

Raporti i banesave bosh dhe i banesave të pazëna përbëjnë indikatorët kryesor në shfrytëzimin efikas të banesave ekzistuese.


Në Bashkinë e Tropojës pjesa e banesave bosh është 21.2%, vlerë e cila i afrohet mesatares kombëtare. Nëse fokusohemi në shkallë njësie administrative, vërehet se njësitë Bytyç, Fierzë dhe Lekbibaj regjistrojnë respektivisht vlerat 43%, 39% dhe 31%, çka tregon qartë një mos shfrytëzimin efikas të ndërtesave për banim.

Census 2011 reflekton gjithashtu banesat e pazëna, çfarë do të thotë: banesat boshe dhe shtëpitë sekondare. Ku vërehet se janë njësitë Lekbibaj, Fierzë dhe Bytyç të cilat regjistrojnë vlerat më të larta të banesave të pazëna. Territori i bashkisë Tropojë ka një ndryshim të theksuar të dhënash, bazuar ne burimin e informacionit. Nëse do të bazohemi tek Censusi i vitit 2001, Tropoja ka një popullsi prej 20,491 banorë .Nëse bazohemi tek regjistri i gjendjes civile, që disponon Bashkia e Tropojës, me njësitë administrative, numri popullsisë së regjistruar është 28200.

Sipas të dhënave që jep bashkia, 75% e popullsisë jeton në zonat rurale. Dendësia mesatare e popullsisë është 20 banorë për km². Përsa i takon sipërfaqes se territorit, bashkia e Tropojës ka një nga territoret me të mëdha ne shkalle vendi Ndonëse kanë një territor relativisht të madh, komunitat e Tropojës kanë një popullsi të vogël. Popullsia mesatare për njësi vendore është 2536 banorë, shumë e ulët krahasuar jo vetëm me mesataren kombëtare (8016 banorë) por edhe me atë të Qarkut të Kukësit (3159 banorë). Në qytet banon pak me shumë se 25% e popullsisë. Njësitë e Administrative sikurse janë Margegaj, Bujan dhe Tropojë kanë dendësi më të lartë të popullsisë (rreth 33 banorë/km²) se ato më periferike Bytyç dhe Lekbibaj (nën 28 banorë/km²). Njësitë më të vogla administrative nga pikëpamja e popullsisë janë komunitat Lekbibaj dhe Bytyç përkatësisht 1207 dhe 1563 banorë. Sipërfaqja relativisht e madhe, territori malor, dhe dendësia e vogël e popullsisë kanë bërë që banorët e komunave të largëta të kenë problem me shërbimet.

Tropoja ka një popullsi relativisht të re në moshë. Sipas Censurit të vitit 2011, rreth 25% e popullsisë është nga mosha 0-14 vjeç dhe rreth 63% e popullsisë nga mosha 14-65 vjeç.





Lëvizjen më të madhe të popullsisë e ka zona e Lekbibajt, kjo për shkak të kushteve natyrore dhe mungesës së shërbimeve për banorët. Shumica e fshatrave të kësaj njësie nuk kanë akses me rrugën e makinës, si dhe kanë sipërfaqen më të vogël të tokës bujqësore për frymë. Në këto kushte, menjëherë pas viteve 1990 popullsia e kësaj zone ka lëvizur në mënyrë masive për kushte më të mira në zonën e Tiranës, Lezhës dhe Durrësit.

Nëse shohim lëvizjet e popullsisë sipas Censurit 1989 - 2011, njësitë Administrative që regjistrojnë nivelin më të lartë të lëvizjes së popullsisë, janë njësitë administrative Lekbibaj me një lëvizje prej -78%, njësitë administrative Bytyç me një lëvizje prej -66%, njësitë administrative Llugaj me një lëvizje prej -63%, njësitë administrative Fierzë me një lëvizje prej 60%. Të gjitha njësitë administrative bashkisë Tropojë kanë një lëvizje të popullsisë tejet të lartë në krahasim me mesataren kombëtare që është 12%..

Të pastrehët

Numri i të pastrehëve në Bashkinë Tropojë është 150 familje. Nder vite edhe pse kërkesat e qytetareve kanë qenë të shumta si të pastrehe nuk ka pasur përfitues të programeve sociale për banesë. Vetëm në vitin 2011 ka pasur 10 përfitues banesë me kosto të ulët (kredi e lehtësuar). Kjo procedurë është ndjekur nga Enti Kombëtar i Banësive.

Bashkia ka paraqitur kërkesën pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban për bonus strehimi për 89 familje përfituese sipas V.K.Bashkiak, Nr.64, dt.21.07.2016 ku vetëm 21 kanë qenë familje përfituese pasi të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme për të mbuluar pjesën e mbetur të qirasë sipas VKM nr.1093 dt.28.12.2015 "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit", si dhe udhëzimin Nr. 23 dt.30.12.2008, "Për përmbajtjen e bonusit të strehimi".

Bashkia nuk disponon banesa sociale për të pastrehe por janë bërë kërkesa Ministrisë së Zhvillimit Urban për investime për banesa sociale duke vënë në dispozicion sipërfaqe trualli 1075 m² dhe sipërfaqe gjurme e objektit të rënë 352m².

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
Sistemit Urban

Gjithashtu ekziston edhe objekti "ish-hoteli i punëtorëve" me një sipërfaqe gjurme 290m², në të cilin po të ndërhyhet për rikonstruksionin dhe adaptimin e ndërtesës mund të strehohen 20 familje të pastreha dhe në nevojë (godinë katër katërshe). Në fakt, për këtë objekt janë marrë kontakte nga bashkia edhe me fondacionin "Albania Austria Partnerschaft Marianne Graf & Team" për bashkëpunim e ndihmë financiare për rikonstruksionin dhe adaptimin e këtij objekti.

Objekte të tjera që disponon bashkia janë dhe dy godinat "ish-Komitetit e Vjetra" të cilat ndodhen në një gjendje të amortizuar por në qoftë se do të kishim mundësi investimi nga Ministritë përkatëse ose donatorë të ndryshëm apo dhe biznesmen të fuqishëm vendas, pasi buxheti i Bashkisë është shumë i vogël, mund të kthehen në banesa so-



ciale, dhe do të strehoheshin rreth 25 familje të pastreha.

Problem tjetër për sa i përket banesave është edhe privatizimi i banesave dhe objekteve të ndërmarrjeve shtetërore ne banesa private , këto objekte janë prone e njësive Vendore që nuk i kane kaluar Entit Kombëtar të Banesave sipas ligjeve dhe afateve ne fuqi, edhe pse ne to banojnë qytetare të pastrehe nder vite dhe kërkojmë kthimin e këtyre objekteve ne banesa private.

Gjendja ne tërësi e familjeve ne nevoje është mjaft shqetësuese dhe shume e vështire pasi mundësitë financiare nuk janë të mjaftueshme për një jete me kushte me minimale të jetesës.

Numri i familjeve që trajtohen me ndihme ekonomike ne qytetin B.Curri është 428, Njësia Administrative Fierze 185, Njësia Administrative Lekbibaj278, Njësia Administrative Margegaj 301, Njësia Administrative Llugaj 227, Njësia Administrative Bujan 241, Njësia Administrative Bytyç 261, Njësia Administrative Tropojë (fshat) 497, gjithsej nga Bashkia Tropojë trajtohen si familje ne nevoje 2418 familje.

Numri i banesave sociale është aktualisht 62 apartamente, ndërkohe qe kërkeša e familjeve pa shtëpi dhe qe kane nevoje për programet sociale te strehimit është 706. Nga këto te dhëna është e dukshme nevoja për investime ne fushën e strehimit social për grupet e ekspozuara.

Nga pikepamja e shërbimeve shëndetësore ne qytetin e B.Currit është një spital qe plotëson shërbimet shëndetësore baze te popullatës.

Ne vitet e fundit është rritur disponueshmeria e Qendrave shendetesore ne zonat rurale, me qellim ofrimin e shërbimeve baze dhe te aksesueshme për popullsinë rurale. Çdo Njësi Administrative ka një qendër shendetesore. Megjithatë trajnimi i stafit ende nuk është adekuat dhe pajisje dhe furnizimet duhet te përmirësohen.

Arsimi

Përsa i përket arsimit, i gjithë territori i rrethit është i mbuluar me kopshte për fëmijë dhe shkolla 9-vjeçare dhe të mesme. Sidoqoftë, për shkak të sipërfaqes së madhe dhe dendësisë së ulët të popullsisë së njësive administrative, ka një numër të madh kopshtesh dhe shkollash 9-vjeçare për një numër të vogël fëmijësh dhe nxënësish. Për shembull, në se në qytetin Bajram Curri ka 4 kopshte për 296 fëmijë (ose mesatarisht 78 fëmijë për kopsht) dhe 3 shkolla 9-vjeçare për 1066 nxënës (ose mesatarisht 355 nxënës për shkollë), komuna si Lekbibaj kanë vetëm një kopsht për 15 fëmijë dhe 8 shkolla për 202 nxënës (ose mesatarisht 15 nxënës për shkollë). Shkolla e mesme e qytetit Bajram Curri ju shërben edhe komunave ngjitur bashkisë, si Bujan dhe Margegaj apo atyre të me popullsi të vogël si Lekbibaj. Komunitat e tjera kanë shkolla të mesme, por që janë të vogla (kanë



një numër të vogël nxënësish dhe mësuesish—mesatarisht 5 mësues për 50—70 nxënës për rrjedhojë ushtrojnë aktivitetin në një objekt me shkollat 9 vjeçare.

Në Bashkinë Tropojë regjistrohen 77 objekte shkollore, ku : 25 objekte Parashkollore (kopshte) ; 20 objekte ofrojnë arsim të ciklit të ulët ; 25 objekte ofrojnë arsim 9-vjeçare ; 6 objekte ofrojnë arsim 9-vjeçar dhe të mesëm; 1 objekt ofron arsim të mesëm.

Për vitin 2015-2016, në këto objekte janë të regjistruar 4532 nxënës, të cilët monitorohen nga 433 mësues/edukator, nga të cilët 619 nxënës janë të regjistruar në Kopshte, 2844 nxënës janë të regjistruar në ciklin 9 Vjeçar, 1069 nxënës janë regjistruar në ciklin e m I gjithë territori i bashkisë mbulohet nga shërbimi arsimor, 9 vjeçar dhe ai i mesëm. Fshatrat e zonës kufitare, për shkak të largimit të popullsisë kanë klasa të bashkuara, për shkak të numrit të ulët të nxënësve. Të gjitha njësitë administrative kanë në qendrat e tyre shkolle të mesme. Në njësinë administrative të Bytyçit janë dy shkolla të mesme (Pac, dhe Zogaj) ndërsa nuk ka shkolle të mesme Njësia administrative e Margegajt për shkak të afërsisë prej 2 km që ka me qytetin. Në territorin e Bashkisë Tropojë ka 45 institucione arsimore të ciklit të ulët dhe 9 vjeçar. Frekuentimi në shkollat e ciklit të ulët është shumë i dobët, ku shkolla fillore më e frekuentuar ka vetëm 22 nxënës dhe shkolla fillore më pak e frekuentuar ka vetëm 4 nxënës.

Frekuentimi i ulët vërehet dhe në shkollat 9-vjeçare, ku në 8 objekte regjistrohen më pak se 30 nxënës.

Në territorin e Bashkisë Tropojë regjistrohen 7 objekte që ofrojnë arsimin e mesëm, të cilat kanë një shpërndarje territoriale që përqendrohet në zona më të urbanizuara. Vlen të theksohet se njësitë si Bujan, Margegaj nuk kanë në qendrat e tyre objekte të arsimit të mesëm.

Shëndetësia

Spektori shëndetësor i territorit të Tropojës disponon 33 ambulanca dhe 8 qendra shëndetësore (pra një në çdo njësi administrative), si dhe një spital në qytetin e Bajram Currit, me një kapacitet prej rreth 100 shtretërish, me një efektiv mjekësor prej 13 mjekësh dhe 133 infermiere.

Të gjitha Qendrat shëndetësore mbulohen me mjekte të familjes dhe ambulancat ofrojnë shërbime primare, duke pozicionuar spitalin e Bajram Currit si qendër kryesore të shërbimeve të specializuara shëndetësore. Megjithatë shërbimet kryesore si pediatria, kirurgjia, obstetri etj ofrohen në spitalin e Bajram Currit, vlen të theksohet se ka një numër të pa mjaftueshëm të personelit shëndetësor dhe të pajisjeve bashkëkohore. Një pjesë të shërbimeve banoret e kësaj zone e marrin në spitalin e Gjakovës.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen e gjerë të territorit të bashkisë Tropojë, mungesën e personelit mjekësor, aksesit të disa zonave të banuara për shkak të infrastrukturës



rrugore dhe të klimës, vërehet se sistemi shëndetësor në Bashkinë e Tropojës është në pamundësi të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe në kohë.

Projeksioni demografik i popullsisë për vitin 2031

Sfondi demografik në Tropojë pritet të transformohet në të ardhmen. Nga moshimi i brezave që i përkasin gjeneratës që është ne moshe pune, numri i vdekjeve do të rritet me më pak se gjysma, ndërsa numri i lindjeve do të ulët kur brezat e lindur në vitet 2000 do të hyjnë në moshën e lindjes së fëmijëve. Numri vjetor i vdekjeve pritet të jete më i lartë sesa numri i lindjeve në vitin 2031. Megjithatë, nëse brezat e rinj vazhdojnë të emigrojnë dhe të ulin më shumë lindshmërinë e tyre, Tropoja do të pësojë një rënie natyrore të popullsisë nga fillimi i viteve 2020.

Sipas skenarëve të ndryshme të rritjes së popullsisë, numri i banorëve do të variojë ndërmjet një humbje prej 14% dhe një rritje të lehtë prej 4% përkundrejt vitit 2011. Edhe nëse popullsia në moshë pune do të stabilizohet gjatë dhjete viteve të ardhshëm, ajo pritet të ulët rreth 11% deri në vitin 2031. Në mungesë të migrimit ndërkombëtar, popullsia në moshë pune do të rritej edhe pse pak.

Rënia e rritjes natyrore të popullsisë do të mund të kompensohet vetëm pjesërisht nga humbje të vogla demografike, rrjedhojë e migrimit ndërkombëtar në të ardhmen. Lindshmëria e ulët dhe emigrimi i vazhdueshëm (sa do që më i ulët) në të ardhmen do të ishin shkaqet kryesore të ndryshimit të strukturës mohore të popullsisë së Shqipërisë. Numri i fëmijëve do të vazhdojë të bjerë dhe numri i të moshuarve do të rritet deri në vitin 2031. Kjo do të çojë drejt arritjes së plakjes së avancuar të popullsisë, me më shumë varësi të moshuarve në krahasim me fëmijët.

Ne rast se marrim në konsideratë parashikimet për një periudhë 50 vjeçare, natyrisht që dhe projeksionet kane një koeficient besueshmërie me të ulët por sidoqoftë mundet të na shërbejnë për të pasur një ide mbi të ardhmen bazuar në hipoteza të caktuara demografike.

Nga të dhënat e Censurit 2011 popullsia rezidente në territorin e Bashkisë Tropojë është 20,517 banorë, për një sipërfaqe prej 1,043 km². Siç vihet re, popullsia rezidente përqendrohet kryesisht në njësinë administrative Bajram Curri dhe në njësinë Tropojë e Vjetër.

Duke theksuar se më shumë se 1/4 e popullsisë rezidente ndodhet në njësinë administrative të Bajram Currit, e cila regjistron një densitet prej 1,749 banorë/km² dhe duke parë më nga afër densitetin e popullsisë së njësive të tjera vëmë re se popullsia është e pozicionuar në përafërsi të kësaj njësie, duke i dhënë Bajram Currit funksionin e një qendre të rëndësishme të Bashkisë Tropojë.



Nga të dhënat e Gjendjes Civile Tropojë, del qartë se tendenca demografike janë negative për 10 vitet e fundit, siç shihet dhe përshkrimin e mëposhtëm

Nisur nga të dhënat e gjendjes civile, tendenca demografike të dekadës të fundit, dhe duke neglizhuar faktorët ekzogjen të mundshëm, atëherë mund të përdorim metodat e regresionit linear, metoda gjeometrike dhe ajo aritmetike, për të projektuar popullsinë e regjistruar në Bashkinë Tropojë për 15 vitet e ardhshme.

Bazuar në të dhënat e Strategjisë së zhvillimit vendor të Tropojës të përgatitur nga IP3, si dhe duke u nisur nga llogaritja e popullsisë me metodën e regresionit linear të korigjuar, regresionit aritmetik dhe gjeometrik, dalim në përfundimin që popullsia e pritshme në Bashkinë Tropojë për vitin 2031 mesatarisht do të jete 23,421 banorë

Projeksioni vlerëson që popullsia e regjistruar në gjendjen civile në Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë do të ketë një tendencë në rënie nga 2016 në 2031:

Bashkia e Tropojë, pritet të njohë një rënie prej 4,824 njerëz për 15 vitet në vijim, gjë që shfaq qartë nevojat e bashkisë për të ndërmarre politika sociale dhe ekonomike, për të reduktuar eksodin demografik të territorit të saj, ku tendenca migratore theksohen nga të dhënat e Censurit 2011.

Ketë parashikim bën strategjia territoriale e Bashkisë Tropojë, por duhet të theksojmë se nga vizitat në terren dhe takimet me komunitetet vendore vërehet fenomeni i rikthimit të shume banoreve që kanë lëvizur me parë brenda ose jashtë Shqipërisë për të ndërtuar shtëpi në fshatrat e tyre në Tropojë. Për më tepër kostoja për të lëvizur vendbanimin tashme është e shtrenjtë dhe e papërballueshme për banoret ekzistues. Janë me dhjetëra familje tropojanë që pavarësisht që jetojnë në Tiranë, Durrës, apo në vendet e tjera të botës, janë rikthyer dhe kanë ndërtuar banesat e tyre në vendlindje. Ky trend po shtohet çdo vit, dhe interesimi i të rinjve, të cilët jetojnë jashtë por që sjellin të ardhura në Tropojë përbën një bindje se Tropoja nuk do të braktiset, e për më tepër, ka nevojë për një rishikim të Planeve ndërtimore ekzistuese

Në përfundim të analizës mundet të rëndësim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit urban:

Sistemi urban përbëhet nga bashkimi i territoreve urbane të kufizuara nga vija e gjelbër "Territori urban" është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor. Objektivat nga PPK: Rritje inteligjente. Politikat: Zhvillim policentrik, densifikimi dhe gjithëpërfshirje

Sistemi urban zë një sipërfaqe prej 855 ha (0.8%) të gjithë territorit në bashkinë e Tropojës.

Për të zbutur pabarazinë e krijuar, Sistemi Urban sipas Planit Kombëtar propozon:



- Zhvillim Policentrik hapësinor dhe një marrëdhënie të re Urbane - Rurale
- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara duke promovuar densifikimi në vend të shpërhapjes urbane;
- Akses më i mirë në një infrastrukturë multimodal e cila është jo vetëm më efektive por edhe miqësore ndaj ambientit;
- Funksione mikse dhe komplementare;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në veçanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;
- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.

“Territori urban” është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor. “Rritja inteligjente” dhe “Zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithë përfshirja” janë objektiva dhe politika e përcaktuar për këto sisteme në PPK.

Tendenca e zhvillimit urban në Bashkinë e Tropojës në 25 vitet e fundit është karakterizuar nga 2 tipare kryesore:

- Migrimi drejt rajonit qendror urban (kryesisht në aksin Tiranë-Durrës), ose jashtë territorit të Republikës;
- Shpërhapja urbane në dëm të tokës bujqësore dhe tokës së lirë natyrore

Të dy këta faktorë kanë sjellë si pasojë uljen e ndjeshme të popullsisë në disa fshatra dhe gjendjen gati statike të popullsisë në qytetin Bajram Curri. Në disa zona ka një dendësi mjaft të ulët të popullsisë, gjë që vështirëson efikasitetin e investimeve në infrastrukturë dhe shërbime për këto pjesë të territorit të bashkisë.

Kjo tendencë rezulton në një zhvillim monocentrik të rajonit, me tipare të theksuara të pabarazisë ekonomike dhe sociale. Mungesa e infrastrukturës cilësore, rrugë, kanalizime, shkolla dhe kopshte, kanë bërë që pjesa më e madhe e popullsisë që braktisi fshatin e lindjes për një jetë më të mirë të mos e gjejë atë.

Nga njëra anë një pjesë e territorit karakterizohet nga një depopullim i lartë, mungesë e forcës punëtore, mungesë shërbimesh, kurse nga ana tjetër në qytet kemi përqendrim të popullsisë, por pa infrastrukturën e nevojshme sociale e inxhinierike.



Informaliteti, shpërhapja urbane, stoku i banesave që në shumicën e rasteve nuk plotësojnë kushtet minimale për ndriçim dhe ajrim, ndërtimi masiv në ish zona bujqësore apo natyrore, dhe përsëri mungesa e strehimit për një kategori të popullatës janë tiparet dominuese që karakterizojnë zhvillimin urban të 25 viteve të fundit.

Plani Kombëtar prezanton: 6 rajone ekonomike parësore; 9 qendra primare,; 10 qendra te specializuar; 42 qendra lokale.

Rajoni Tropojë – Gjakove është tashmë pjesë e Planit Kombëtar si Rajon Ndërkufitar mes Shqipërisë dhe Kosovës. Duke u nisur nga plani kombëtar, PPV-ja duhet të përcaktojë:

Qendrat primare, në zonat e banuara me popullsi të stabilizuar dhe shërbime bazike të karakterit infrastrukturor, si elementë të hierarkisë lokale. Këto qendra do të mund të intensifikojnë infrastrukturën e shërbimeve primare si arsimit dhe transporti, të përshtatshme për të mbuluar kërkesat e qendrave administrative më të vogla, në rrezen e shërbimit prej 45 min. kohë udhëtimi. Investimet në infrastrukturë do të bëhen me qëllim rritjen e aksesit te popullsisë së zonave përreth drejt qendrave primare.

Qendrat e specializuara, që do të zhvillohen në përputhje me potencialet e tyre dhe karakteristikat specifike të karakterit ekonomik, llojit të aktivitetit bujqësor-blegtoral më të zhvilluar apo tipareve të spikatura natyrore që promovojnë një tip të caktuar turizmi, për tu kthyer në zona tërheqëse për të jetuar e punuar dhe për të tërhequr investime e profesionistë të specializuar. Për t'u veçuar në Bashkinë Tropoje janë burimet e shumta minerare dhe përfitimi që do të kish zona nga përpunimi në vend i këtyre pasurive. Orientimi i qendrave të specializuara drejt kësaj lloji industrie (pa lënë pas dore format e tjera të mundshme) do të ishte me interes të madh ekonomik dhe strategjik.


Përparësitë

- Pozicion i favorshëm gjeografik, mundësi për shfrytëzimin e fondeve te BE-se për bashkëpunimin ndërkufitar
- Tropoja sipas politikave kombëtare është qendra sekondare e aglomerateve rajonale, qe nënkupton avantazhe nga prania e zyrave dhe shërbimeve publike.

Dobësitë

- Ekspansion i paplanifikuar i qendrave urbane me mungese hapësirash publike dhe cilësie urbane
- Eficence e ulët në ofrimin e shërbimeve
- Infrastruktura arsimore me cilësi të ulët
- Cilësi e ulët shërbimesh në zonat rurale





- Zhvillim monocentrik
- Mungese banesash sociale për grupet vunerabel

Mundësitë

- Bashkëpunim ekonomik dhe social ne nivel rajonal dhe ndërkuftar
- Zona industriale për tu rikuperuar dhe rikualifikuar
- Sistemet e fortifikimit për tu kualifikuar si pika identifikuese

Rreziqet

- Fenomeni i migrimit nga këto zona drejt Tiranës dhe Durrësit
- Tendenca e te rinjve për te braktisur zonën
- Varfëria - Rajoni i Tropojës është nder me te varfërit në Shqipëri

Rekomandime për sistemin Urban

Me rëndësi shihet konsolidimi i hapësirës urbane në vitet e ardhshme për të patur kontroll mbi shtimin e sipërfaqes së ndërtuar si në lidhje me popullsinë dhe sipërfaqet e pashfrytëzuara (për shembull, shfrytëzimin e strukturave ekzistuese për strehim e shërbime në vend që të ndërtohen të reja), edhe në drejtim të ruajtjes së tokave bujqësore (raporti ndërtim/ pronë). Kërkohet ruajtja dhe perforcimin i karakterit të zonës si ne raportin sipërfaqe e lirë/ sipërfaqe e ndërtuar dhe në aspektin arkitektonik të tij. Veç kësaj, shihet e arsyeshme rehabilitimi, perforcimi dhe shtimi i hapësirave publike, si një element i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së jetesës së banorëve. Pikë tjetër thelbësore është krijimi i kushteve më të punësimit, shërbimit dhe jetesës për banorët vendas, me qëllim uljen e migrimit si brenda dhe jashtë vendit. Kjo do të arrihej përmes politikave dhe shërbimeve sociale për banorët apo edhe familjet e pastreha, rritjen e aksesueshmërisë ndaj shërbimeve ekzistuese dhe hapjen e fronteve të reja ekonomike dhe punësimi, duke rritur dhe interesin për të qëndruar. Një ndër mënyrat për realizimin do të ishte krijimi i zonës urbane policentrike në territor.

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
Sistemit
Infrastrukturor



1.2.6 Përcaktimi i territorit në bazë të sistemit infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar, objektivi kryesor është integrimi hapësinor, rrit-

je e aksesueshmërisë së vendit dhe shpërndarje të balancuar të flukseve. Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë kombëtar, rrjetje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Me qëllim realizimin e integritit hapësinor të vendit dhe të shpërndarjes së balancuar të flukseve brenda territorit të tij, aplikimi i korridoreve të planifikuara nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar qëndron në themel të Sistemit Infrastruktural të PPV-së së Bashkisë Tropojë. Ky plan duhet më tej, të parashikojë korridoret prioritar për lidhjen e qendrave prioritar të territorit të bashkisë në një rrjet të integruar multimodal.

Sistemi infrastrukturor i Bashkisë Tropojë ka një gjatësi prej 525 km. Në nivel bashkie vihet re kryesisht prezenca e rrugëve sezonale, të rrugëve urbane kryesore e dytësore kryesisht në qendrën e qytetit Bajram Curri, Fierzë dhe Tropojë e Vjetër, ndërkohë në fshatrat veriore e perëndimore aksesit është i ulët, ku dominojnë rrugët e paasfaltuara

Pjese e sistemit infrastrukturor janë: Rrjetet rrugore te nivelit kombëtar, rajonale dhe lokale; Linjat hekurudhore; Porte e aeroporte; Rrjetet teknologjike qe përfshijnë: linjat e energjisë, tubacionet e gazit, ujësjellës, kanalizime

Sistemi Infrastrukturor i Tropojës përfshin rrjetet rrugore te nivelit kombëtar, rajonale dhe lokale. Qyteti i B.Currit shërben si pike lidhëse mes Shqipërisë dhe Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Në këtë zonë kalon rruga B.Curri – Qafe Morine qe lidh Shqipërinë me Gjakovën (Kosovën). Në këtë zonë ndodhet pika kufitare e Qafe Prushit për ngarkesa dhe mjete.

Cilësia e infrastrukturës rrugore është përmirësuar ndjeshëm, dhe të gjithë Qendrat e njësive administrative janë të asfaltuara. Një pjese e konsideruar e fshatrave kanë rrugë të pashtruar. Për të përshkuar rrugën nga Njësia Administrative deri në B.Curri duhen mesatarisht rreth 30 minuta. Ndërsa Njësia Bytyç dhe Lekbibaj lidhen me qytetin përkatësisht për 40 – 50 minuta.

Në bashkinë e Tropojës, përdorimi i transportit publik nga qytetaret për lëvizje ndërmjet zonave të ndryshme është tepër minimal. Pjesa më e madhe e shërbimeve të transportit ofrohet nga sektori privat nëpërmjet shërbimit të furgonave dhe shërbimit taksi. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e komunave bën që aksesit ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Në gjithë zonën mungojnë stacionet e udhëtareve, ç'ka bën që lëvizja e automjeteve dhe pikat e ndalimit të pasagjereve të vendosen pa një plan të caktuar të pikave të transportit urban e nderurban.

Transporti i udhëtareve nga komunat drejt B.Currit behet në mënyrë jo të rregullt. Edhe pse Transporti nga qyteti në komunat e afërta është i shpeshtë pothuaj çdo orë, nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetareve nga komunat drejt Tropojës.

Infrastruktura rrugore në rrethin Tropojë përgjithësisht është e mirë. Qyteti i Bajram



Currit është i lidhur me rrugë automobilistike me qendrat e njësia administrativeve si dhe shume nga fshatrat e rrethit të Tropojës si Markaj, Lekbibaj, Shipshan, Pac, Zogaj, Valbone, Berishë, Kepenek. Bajram Curri është gjithashtu i lidhur me rrugë automobilistike me Krumën (Has).

Aksesi për në Bashkinë Tropoje

Tropoja lidhet me sistemin kombëtar të rrugëve nëpërmjet rrugëve kombëtare Bajram Curri – Qafë Morinë, Bajram Curri - Fierzë dhe Bajram Curri - Krumë.

Rruga nacionale Bajram Curri – Qafë Morinë (rruga nacionale 22) lidh Tropojën me autostradën “Ibrahim Rugova” (Kosovë) dhe “Rrugën e Kombit” (Shqipëri). Nëpërmjet kësaj rrugë, distanca nga Bajram Curri në Tiranë është rreth 258 km. Komunikimi nëpërmjet kësaj rrugë është më i lehtë nga pikëpamja e cilësisë së udhëtimit. Por, kalimi nëpër dy pika kufitare—Qafë Morinë (Tropojë) dhe Morin (Kukes) rrit kohën e udhëtimit dhe, në rastin e transportit të mallrave, paraqet vështirësi lidhur me procedurat doganore

Rruga nacionale Bajram Curri – Fierzë është pjesë përbërëse e rrugës nacionale Bajram Curri – Tiranë. Deri para pavarësisë së Kosovës, dhe sidomos pas ndërtimit të “Rrugës së Kombit” dhe autostradës “Ibrahim Rugova”, rruga nacionale Bajram Curri-Tiranë nëpërmjet Fierzës ka qenë rruga kryesore e komunikimit të Tropojës me Tiranën dhe aeroportin “Nënë Tereza” dhe portin e Durrësit. Fillimisht kjo rrugë kalonte nga Qafa e Malit për në Tiranë nëpërmjet Pukës dhe Vaut të Dejës ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë, ose Rubikut, Fushë-Arrzit, Rubikut dhe Milotit ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë dhe është përkatësisht rreth 275 dhe 260 km e gjatë. Si rruga që kalon nga Puka edhe ajo që kalon nga Rubiku, në pjesën më të madhe (deri ku bashkohet me rrugën nacionale Tiranë – Shkodër) është rrugë malore, që lejon shpejtësi mesatare rreth 40 km/orë, me kosto relativisht të lartë për transportin e udhëtarëve, por sidomos të mallrave, dhe e vështirë në dimër kur ka borë.

Pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, një alternativë e rrugës për Tiranë kombinonte transportin rrugor dhe ujqor nëpërmjet Liqenit të Fierzës duke ndjekur itinerarin Fierze-Koman-Vau Dejës ku bashkohet me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë.

Për arsye të koston së lartë të transportit, kjo rrugë sot përdoret në masë të vogël. Sidoqoftë, kjo rrugë është shumë panoromike dhe mund të jete me shumë efektivitet në shërbim të zhvillimit të turizmit. Gjendja e rrugës nga Komani deri Vaun e Dejës nuk është e mire. Kjo rrugë ka nevojë për ndërhyrje dhe rikonstruksion të plotë duke u riveshur me asfalt.

Rruga nacionale Bajram Curri – Krumë (rruga nacionale 23) lidh Tropojën me Kukësin dhe nga aty me Tiranën. Gjatësia e kësaj rrugë është 75 km. Rruga është e shtruar me



asfalt (vitin e kaluar ka përfunduar rikonstrukcioni i rrugës Kukës – Krumë. Një alternativë për banorët e Bytyçit për tu lidhur me Kukësin dhe Kosovën është edhe nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Prushit. Kjo rrugë është malore që lejon shpejtësi të vogël (30-40 km/orë) dhe e vështirë në dimër kur ka borë. Kjo rrugë përdoret kryesisht nga banorët e njësia administrative Bytyç që kufizohen me Hasin.

Transporti brenda Tropojës

Në qendër të zonës është Bashkia Bajram Curri që është tregu kryesor, qendra më e rëndësishme administrative dhe vendi ku ofrohen shumica e shërbimeve. Të gjithë njësia administrative konvergojnë në Bajram Curri. Intensiteti i ndërveprimit është më i lartë midis qendrës—Bajram Currit—dhe fshatrave të NJQV-ve më afër saj që njëkohësisht janë edhe fshatrat më të mëdhenj.

Aksesi në rrugët nacionale. Qendrat e njësia administrativeve lidhen me rrugën nacionale Bajram Curri – Qafë Morinë. Rrugë tjetër që lidh Bajram Currin me qendrën e Rajonit e Kukësit është Rruga B.Curri- Krume –Kukes.

Aksesi në rrugët rajonale. Shumica e fshatrave kanë akses në rrugët rajonale dhe prej këtu në rrugët nacionale.

Aksesi në rrugët e njësive administrative lokale. Në përgjithësi, fshatrat brenda territorit të NJQV-ve dhe lagjet brenda fshatrave janë të lidhura me njëra tjetrën. Këto rrugë janë pjesërisht të asfaltuara dhe një pjesë e tyre të pa-asfaltuara.

Nga takimet me banoret e zonave të njësive administrative lidhja e fshatrave që nuk kanë rrugë është parësore. Kërkesa të tilla u shtruan nga drejtuesit e fshatrave Lekbibaj dhe konkretisht në këto rrugë:

- Sistemim dhe asfaltim i rrugës Lekbibaj –Lugu i ndermanjave 14 km
- Rehabilitimi i rrugës Lekbibaj –Tetaj –Qaf Kolçit
- Rehabilitimi i rrugës Ura e Mserrit –Palc –Salce 8 km
- Rehabilitimi i rrugës Kthesa e Bushatit –Gjon Pepaj (stakaj) 5 km
- Rehabilitimi i rrugës Hidrocentrali -Curraj 3.7 km
- Rehabilitimi i rrugës Markaj- Kodër Rrucaj 5 km
- Rehabilitimi i rrugës Fushe Fierzë –Shëngjergj 2.7 km
- Rehabilitimi i rrugës Kthesa e Zades -Kotec 3.2 km
- Ndërtimi i rrugës për në Curraj te Epërm 14 km



- Ndërtimi i rrugës nga Salca për ne Brise 5 km
- Rehabilitimi i rrugës qendër Lekbibaj –Gjonpepaj 2.5 km
- Ndërtimi i rrugës për Betosh me gjatësi 5 km

Ne Njësinë administrative te Fierzës, ndërtimi i rrugës se Tplanit dhe asfaltimi i saj është imediat. Rruga e Breg Lumit është e rrezikshme dhe kërkon ndërhyrje

Në njësinë administrative te Tropojës vjetor kërkohet përmirësimi i Infrastrukturës Rrugore ne këto drejtime

- Tropoje- Muhejan- Gosturan (Aksi Tropoje –Muhejan ekziston projekti) 3.5 km
- Kernaje –Kovac 2.5 km
- Bucaj- Papaj –Padesh 9km është projekti
- Boshnjake –Tafaj- Treshnjeve
- Qafe Morine-Gegaj
- Qafe Morine –Kamenice
- Asfalt –Viçidol 1km
- Pific-Kamen –Lugu I Tropojës 7.7 km (Profic- Kamen është projekti)
- Asfalt-Kasaj 2.1 km
- Asfalt- Mejdan 2.1 km
- Ura e Astes-Kojel Shpat 1.2 km është projekti
- Ura e Balishtes- Shumice –Asfalt 3.1 km
- Asfalt –Iberhasaj 3.1 km
- Boshnjake –Koldet

Për njësinë administrative te Bujanit ndërtimi i Rrugës Rosujë –Gri – Lekurtaj –Selimaj qe ekziston si projekt me vlere 1.2 milion dollarë krijon premisa për zhvillimin ekonomik dhe turistik te zonës.

Për njësinë administrative te Margegajve është domosdoshmëri ndërtimi i rrugës Çeremit me gjatësi 8 km. Lidhja e kësaj rrugë me Vranicen e Malit te zi është kërkesë perspektive për zhvillimin e turizmit.



Për njësinë administrative te Llugajve kërkohet ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Luzhë.

Për njësinë administrative te Bytyçit kërkohet te ndërtohen dhe asfaltohen rrugët që lidhin Kamin me Qafe Prushin, vazhdimi i asfaltimit të rrugës drejt fshatit Berishe, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Pac – Zherke – Vlad.

Gjendja e rrugëve rajonale është në përgjithësi e mirë. Ato janë të shtruara me asfalt. Pjesa më e madhe janë të shtruara me zhavorr, por të kalueshme. Të pa-aksesueshme ose të aksesueshme me vështirësi janë rrugët që lidhin fshatrat Degë dhe Bredashnicë. Rrugëtimi paraqet vështirësi në dimër sidomos në rrugët që lidhin fshatrat malorë, të largët nga qendra e zonës funksionale.

Në zonën e Tropojës janë gjithsej 538 km rrugë nga të cilat 164 km janë rrugë të asfaltuara. Problem mbetet mirëmbajtja pasi NJQV-të që janë përgjegjëse për këtë shërbim kanë buxhete të kufizuara për këtë qëllim.

Rruga nacionale Bajram Curri-Qafë Morinë, e cila nëpërmjet Kosovës kalon në Kukës, përgjithësisht lidh Tropojën me Tiranën por edhe me Prishtinën dhe qytetet e tjera në Kosovë.

Qyteti i Bajram Currit lidhet me qytetin e Gjakovës, 37 km largësi, nëpërmjet një rrugë automobilistike të asfaltuar e cila kalon nga Bajram Curri–Tropojë e Vjetër–Qafë Morinë–Gjakovë. Nga Bajram Curri për në Gjakovë dhe anasjelltas udhëtojnë mesatarisht çdo ditë rreth 5-6 furgonë. Gjithashtu, rreth 15 furgonë udhëtojnë çdo ditë për transportimin e mallrave.

Përdorimi i makinave për qëllime transporti është rritur me 37% krahasuar me 2006. Sipas Censurit të 2011, ka 36 makina/1000 banorë. Në vitin 2013, numri i automjeteve private u rrit në 306 krahasuar me 256 që ishte një vit më parë.

Gjendja e mirë e rrugëve ka ndikuar në shkurtimin e kohës që ju duhet banorëve të fshatrave për ardhur në Bajram Curri. Për të përshkuar rrugën nga njësinë administrative deri në Bajram Curri si qendër administrative duhet mesatarisht rreth 30 minuta. Sidoqoftë, ka fshatra që janë larg qendrës dhe ju duhet një kohë relativisht e gjatë për të ardhur në qendër. Për shembull, banorëve të njësinë administrative Lekbibaj ju duhet më shumë se 65 minuta për të shkuar në Bajram Curri.

Karakterit malor i zonës e bën të vështirë transportin rrugor, sidomos për zonat e largëta nga qendra dhe në dimër. Me gjithë përmirësimin në infrastrukturën rrugore, rrjeti rrugor nuk ndodhet në gjendje të kënaqshme.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është instalimi i linjave urbane për transportin e nxënësve të shkollave si nevojë e përqendrimit të shërbimeve të ofruara nga bashkia në zona me



specifike. Shpërngulja dhe shpërndarja e popullsisë gjatë viteve të fundit ka bërë eliminimin e shkollave në fshatra si mungesë e nxënësve dhe përqendrimin e tyre në zona me densitet të lartë urban si pjesë e përqendrimit të shërbimeve. Përqendrimi i shërbimeve arsimore në Njësitë Administrative krijon nevojën për krijimin e një transporti urban që do të transportojë nxënësit nga shtëpitë e tyre në fshatra drejt shkollës dhe anasjelltas. Është e rëndësishme që mjetet e transportit urban dhe atyre të arsimit të jenë të sigurte, mjedisor, të lehtë identifikueshëm dhe me vende parkimi të specifikuar.

Shërbimi i Ujësjetës-Kanalizime (Rrjeti i ujit të pijshëm)

Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Megjithatë, furnizimit me ujë të pijshëm i banesave nuk është në nivelin e kënaqshëm. Vetëm qyteti i Bajram Currit e ka të mbuluar në një masë të kënaqshme furnizimin me ujë në banesë të banorëve (91%). Njësia administrative e Margegaj ka një përqindje relativisht të lartë të furnizimit me ujë në banesë (72 %). Përqindjen më të ulët të furnizimit me ujë në banesë e ka Lekbibaj me 33 %. Cilësia e shërbimit është e pakënaqshme. Edhe në qytet, orët e furnizimit me ujë janë të pakta (9 orë në ditë). Sistemi i furnizimit me ujë nuk funksionon për të gjithë lagjet.

Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Problemi i ujit të pijshëm qëndron në tubacionet dhe sigurimin e pastërtisë së tij deri në çemat e familjeve. Për këtë janë përcaktuar një sërë ndërhyrjesh si: rritja e investimeve për përmasimin e cilësisë së ujit; rehabilitimin i rritjeve të kanalizimeve nëpërmjet menaxhimit të mirë të shërbimeve; rregullimi i tarifave; matja e saktë e konsumit të ujit; zvogëlimi i lidhjeve të paligjshme dhe nxitja e pagesave; kalimi i pronësisë së infrastrukturës së ujësjetës dhe kanalizimeve nga qeveria qendrore në atë lokale (të bashkisë) etj. Aktualisht është bërë lidhja me ujësjetësin e Qarkut të Dunishës, i cili ka përfunduar në dy lagje të qytetit kanë furnizuar 24 orë më ujë të pijshëm. Rreth 90% e familjeve të qytetit kanë sistem uji brenda familjes, 8% e kanë sistemin e ujit jashtë shtëpisë dhe vetëm 2% furnizohet me ujë depozitë. Problemi kryesor për një pjesë të qytetit të Bajram Currit mbetet amortizimi i tubacioneve për shkak të së cilës ka pasur raste dhe të përzierjes së tyre me ujërat e zeza.

Sa i takon njësive administrative, fshatrat e ish komunës Llugaj furnizohen nga një burim me ngritje mekanike. Banoret kërkojnë që të vazhdojë projekti i nisur një vit më parë për mbulimin e zonës me ujë të pijshëm nga uji i Valbonës.

Për zonën e Lekbibajve kërkohej ndërtim i ujësjetës për fshatrat Peraj dhe Gjonpepaj si dhe rehabilitim i ujësjetës Lekbibaj, Shëngjergj, Tetaj, Salce, Curraj i poshtëm.

Për njësinë administrative të Fierzës pritet që ujësjetësi i Valbonës të mbulojë sistemin e ujit të pijshëm për fshatrat Degaj dhe Tplanin. Për zonën e Tropojës së vjetër ekziston



një projekt për ujësjellës i cili mund të furnizoje gjithë fshatrat.

Për njësinë administrative të Bujanit tre fshatra kane furnizim me ujë 24 ore (Markaj, Dojan, Bujan). Fshatrat Rosujë, Lekurtaj, Selimaj, nuk kane projekte për ujë të pijshëm

Për njësinë administrative Bytyç, kane ujesjellesa fshatrat: Paci, Prushi, Kepeneku, Rodogoshi. Nuk kane ujesjellesa: fshatrat Leniq, Vlad, Visoce, Zherke

Tek njësia administrative Margegaj të gjithë fshatrat kane ujesjellesa. Vetëm fshati Dragobi është pa ujësjellës.

Kanalizimet (Rrjeti i ujerave të zeza)

Territori i zonave urbane të bashkisë nuk mbulohet me rrjet të kanalizimeve të ujerave të zeza. Kanalizimet e ujerave të zeza janë prezent vetëm në Bajram Curri dhe pjesërisht në Njësinë Administrative të Margegajt dhe Fierzës. Në Margegaj është ndërtuar kolektori kryesor i shkarkimit të ujerave të zeza për fshatin Margegaj. Nuk ka kanalizime të ujerave të zeza për fshatrat e tjerë. Ujërat e zeza derdhen në përrenj dhe lumenj. Kolektori i qytetit për ujërat nga reshjet nuk është përfunduar. Projektet në fushën e kanalizimeve kanë qenë të pakta, mund të përmendim KUZ Dushaj dhe Bajram Curri të financuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Kanalizimet e ujerave të zeza të qytetit Bajram Curri janë ndërtuar vetëm për ujërat e zeza, nuk janë të përziera. Në përgjithësi në këtë qytet nuk ka kanalizime për ujërat e shiut, me përjashtim të disa rrugëve që janë ndërtuar kohët e fundit të cilat kanë tubacione që grumbullojnë ujërat e shiut të vetë rrugës dhe zonës në afërsi të saj. Këto kanalizime janë zhvilluar në drejtim perpendikular me rrugët kryesore të qytetit. Kjo ka sjelle si rezultat që në rrugët më të gjëra dhe kryesore të qytetit të mos ketë kanalizime, sepse siç e thamë më sipër kolektorët kryesore shtrihen në atë mënyrë që kalojnë mes për mes zonave të ndërtimit. Kjo ka ardhur për shkak se ndërtimi i objekteve në pjesën më të madhe ka filluar nga lart poshtë dhe me ndërtimin e zonave të reja kolektorët kryesore nuk kanë kaluar në trase më të përshtatshme, por janë lënë sipas gjendjes ekzistuese, duke mbetur në mes të ndërtimeve.

Tani ka dalë në pah problemi i funksionimit të rrjetit të kanalizimeve sepse prurjet janë rritur shumë në krahasim me ato të parashikuara fillimisht. Kjo për faktin e rritjes së dendësisë së ndërtimeve të reja që janë lidhur me rrjetin e kanalizimeve nga të dy krahët e tij gjithashtu dhe si rezultat i shumë ndërtimeve private të cilat shkarkojnë në rrjet dhe ujërat e shiut të oborreve të tyre. Meqenëse rrjeti ka kaluar përmes zonave të banimit, si rezultat ndërtimet e shumta që janë bërë e kanë dëmtuar atë në dy drejtime. Disa ndërtime janë vendosur mbi kanalizime ose shumë afër tyre, duke sjellë dëmtime dhe pamundësi për mirëmbajtjeje. Në përgjithësi lidhjet e shkarkimeve të këtyre ndërtimeve me kanalizimet ekzistuese janë bërë jo sipas kushteve teknike, gjë që i ka dëmtuar



kanalizimet ekzistuese. Mos mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve ka ardhur si rezultat i shumë faktorëve.

Gjykojmë se furnizimi me ujë të pijshëm në çdo banesë në fshatra e kërkon paralelisht hartimin e një projekti të tillë për të gjithë fshatrat e zonës.

Energjia Elektrike

Furnizimi me energji elektrike dhe sistemi i ngrohjes thuajse është një problem i zgjidhur në qytetin e Bajram Currit. Në përgjithësi nuk ka ndërprerje të saj, duke përjashtuar rastet e remonteve, defekteve gjatë stinës së dimrit. Problemi kryesor në furnizimin me energji elektrike mbetet amortizimi i shtyllave të tensionit transformatorëve, kablllove, izolatorëve etj. Këto bëhen shpesh dhe burim i mungesës së energjisë elektrike.

Nga takimet me komunitetet vendore në zona, rezultoi se fshatrat e Njësisë Administrative Llugaj dhe Lekbibaj kanë probleme me furnizimin me energji elektrike dhe ndërhyrjen për riparimin e rrjetit të energjisë elektrike e kanë vendosur parësore.

Për sistemin e ngrohjes përdoren më shumë burimet drusore si dhe gazi dhe kondicionerët. Në qytetin e Bajram Currit rreth 95% e popullsisë ka sistem ngrohje individuale.

Burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike të vendit është ajo hidroelektrike, por duke qenë që pritet zgjatja e sezonit të thatësisë, me periudhat e thatësisë ekstreme, do të duhet të kërkojnë burime të reja të energjisë.

Tropoja ka brenda territorit të vet veprën më të madhe hidroenergjetike, atë të Hidrocentralit të Fierzës, e cila është nënshtruar rivitalizimit të plotë vitin e fundit, duke e kthyer këtë vepër një atraksion interesant për vizitorët dhe turistët.

Pritet që në shkallë vendi kontributi me energjinë e hidrocentraleve dhe me energjinë termike do të përjetojë një ndryshim të rëndësishëm: në vitin 1990, 94% e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet, dhe vetëm 6% nga termocentrali, ndërsa në vitin 2025 pritet që hidrocentralet të kontribuojnë për 47.68% dhe ato termoelektrike për 52.32% të totalit.

Specialistët e OSSHE-se rekomandojnë një ndërhyrje totale në rrjetin elektrik dhe sigurimin e Kabinave elektrike në të gjithë zonën.

Telekomunikacioni

Sektori i telekomit në Tropojë është i zotëruar nga kompania e Alb-Telekomit. Alb telekomit ofron shërbime të telefonisë fikse, dhe të internetit. Në kuadër të saj funksionin edhe operatori i telefonisë është Eage1 i cili ofron shërbimet e telefonisë mobile.



Operatorë të tjerë të telefonisë celulare që ofrojnë edhe shërbime të telefonisë celulare janë Vodafon, Plus, Telekom të cilat ofrojnë edhe shërbime Interneti etj.

Shërbimi i telefonisë fikse është i vendosur kryesisht ne qytetin e Bajram Currit. Njësitë Administrative mbulohen me shërbim celular nga të gjithë kompanitë që operojnë ne Shqipëri.

Kompanitë celulare kane vendosur përforcues dhe mbulojnë 85 % të zonës. Zona me probleme për mbulimin me shërbim celular ka qenë deri para 3 vitesh, porse këto vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm. Bëjnë përjashtim disa zona të veçanta të Alpeve dhe Luginës se Valbonës. Kompanitë e këtyre shërbimeve ofrojnë oferta me çmime të favorshme për periudha të caktuara.

Në takimet me komunitetet është ngritur si problem mos Efiçencë e disa ambulancave, mungesa e pajisjeve, si dhe nevoja për të ndërtuar disa ambulanca ne fshatra sikurse janë: Riparimi i të gjithë ambulancave ne njësinë administrative Lekbibaj, Riparim i Njësisë Shëndetësore Tropojë, Ndërtimi i Ambulancave të fshatrave: Shkëlzen, Myhejan, Kojel, Kucane, Kasaj, Papaj

Në njësinë administrative Bujan, Qendra shëndetësore ne Dojan është tek një ndërtese e vjetër Fshatrat Rosujë e Gjonaj janë pa ambulance, ne fshatin Bujan , ambulanca është Brenda shkollës, ne fshatin Markaj ambulance është Brenda ambienteve të shkollës. Ne Njësinë administrative të Llugajve kërkohet të ndërtohet një ambulance ne fshatin Luzhë dhe ne fshatin Rreze Mali.

Në njësinë administrative Margegaj kërkohet të ndërtohet një ambulance ne Çerem dhe një ambulance ne Valbone, si dhe të rikonstruktohet objekti i Njësisë shëndetësore.

Në njësinë administrative Bytyç, nuk kane objekte për ambulance fshatrat Berishe, Kepenek, Zherke, Zogaj, Kam, Leniç. Qendra Shëndetësore Pac ndonëse është me e largëta e rrethit, nuk ka një ambulance (makine)

Përparësitë

- Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm
- Burimet e shumta të ujit të pijshëm që ka Tropoja
- Uji i pastër dhe cilësor
- Furnizimi me ujë të pijshëm që bëhet pjesërisht për shumicën e Njësisve Vendore (Bashkia Bajram Curri dhe Njësitë administrative Margegaj, Bujan, Llugaj dhe Tropojë)
- Burimi i furnizimit nga ujësjellësi i Valbonës.



- Është në funksionim linja kryesore, ndërsa rrjeti i brendshëm për komunën Margegaj dhe në qytet është ndërtuar pjesërisht. Në komunën Llugaj ka filluar projekti por ka mbetur për fonde.

- Njësitë administrative Bytyç, Fierzë dhe Lekbibaj kanë burime ujore të mjaftueshme.

- Shërbimi i pastrimit

- Vendgrumbullimi i mbetjeve ekziston

- Infrastruktura rrugore për grumbullimin e mbetjeve nga qendrat e njësive administrative është funksionale

- Tre lagjet e qytetit Bajram Currit janë pjesërisht të rregulluara.

- Në komuna nuk ka kënde lojërash, gjelbërim dhe vende çlodhje.

- Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm

- Ka vendburime ujore

- Ka vullnet për bashkëpunim ndërvendor

Dobësitë

- Çeshtja kyçe kritike është qasja e dobët në brendësi: rrugët në zonat rurale nuk janë të shtruara dhe shpesh bëhen të pakalueshme, sidomos në dimër

- Akses i varfër në ujin e pijshëm

- Rrjeti infrastrukturor i ujësjellësit i dëmtuar

- Lidhjet e paligjshme

- Administrimi i mbetjeve joefektiv

- Mungese e trajtim-largimit të shkarkimeve

- Mungese parkimesh

- Mungese e nyjeve të transportit

- Përdorim joefektiv i burimeve energjetike

- Furnizimi me ujë të pijshëm për komunitetin është i pamjaftueshëm (në qytet 2-3 herë në ditë me nga 1 orë, ndërsa në komuna 1 herë nga 1 orë, çdo familje ka de-pozitë si në fshat dhe qytet)



- Shkollat nuk kanë ujë të pijshëm.
- Në Njësitë administrative Fierzë dhe Llugaj ujësjellësi funksionon me pompë ngritje që kërkon shumë energji elektrike (që bën që kosto të jete e lartë).
- Ujësjellësi i Bashkisë së Bajram Currit është jo funksional (menaxhim i dobët, mungojnë matësit në masën 60%).
- Mungojnë mjetet financiare për ujësjellësin në Njësitë administrative Bytyç dhe Fierzë.
- Burimi aktual nuk është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë në periudhën e verës.
- Niveli i arkëtimeve për furnizimin me ujë është problem i madh.
- Ndërmarrja e ujësjellësit me aksione të përbashkëta me bashkinë nuk rezulton efektive.
- Në brendësi të lagjeve të qytetit nuk ka kosha të vegjël.
- Mungon përpunimi i mbeturinave.
- Në zonat rurale mungojnë vendgrumbullimet dhe koshat.
- Nuk bëhet klasifikimi i mbetjeve për shkak të mungesës së koshave.
- Mungon transporti i mbeturinave me mjete shkarkuese.
- Mungojnë kanalet e ujerave të zeza dhe gropat septike në komuna.
- Ujërat e zeza derdhen në lumenj.
- Kolektori i qytetit për ujërat nga reshjet nuk është përfunduar për shkak të mungesës së fondeve.
- Bashkia ka si vend grumbullimi një gropë natyrale.

Kufizime

- Fshatrat e brendshëm te pa aksesueshme, me rruge shpesh te pakalueshme
- Transporti publik me Tiranën i dobët
- Shërbimi: Furnizimi me ujë të pijshëm
- Ka mungesë investimesh
- Niveli i ulët ekonomik



Rekomandime për sistemin Infrastrukturor

Shihet si thelbësore përmirësimi dhe shtimi i infrastrukturës ekzistuese, ku përfshihen rrejtë rrugor, rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm, rrjeti i kanalizimeve dhe i menaxhimit të mbetjeve. Duhet t'i jepet rëndësi lidhjes së sistemit të furnizimit me ujë më burimet e shumta natyrore. Po ashtu, rekomandohet krijimi i një rrjeti të përcaktuar qartë për menaxhimin, trajtimin, kompostimin dhe riciklimin e mbetjeve. Veç rekomandimeve të mësipërme vihet theksi edhe në trajtimin e ujrave të zeza përmes ligatinave të ndërtuara, gropave septike të centralizuara dhe gjysmë të centralizuara si dhe krijimi i një rrjeti të përbashkët mes Bajram Currit dhe Margegajt për ngritjen e një impianti të trajtimit të ujrave. Së fundmi, sugjerohet përmirësimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike, duke shfrytëzuar dhe futur në lojë afërsinë me hidrocentralet dhe marrëdhëniet me shtetet fqinjë. Këto synojnë në rritjen e cilësisë së jetesës dhe menaxhimin më të mirë të resurseve dhe problematikave të territorit.

1.3 Analiza metabolike e territorit

Me kuptimin e territorit si një trup i vetëm i bërë nga pjesë të pandashme dhe të ndërlidhura, analiza metabolike ri-përpunon të dhënat e mbledhura në pjesën e parë të analizës dhe prodhon një seri hartash narrative të përdorura si bazë për zhvillimin e strategjisë territoriale. Analiza metabolike ka parë kështu territorin nga 4 pika vështrimi: mbetjet e ngurta, uji, energjia dhe furnizimi me ushqim.

Rrjedha e mbetjeve

Rrjedha e mbetjeve tregon llojet e ndryshme të mbetjeve të pranishme brenda territorit të bashkisë, duke përshkruar të gjithë ciklin e tyre, nga prodhimi i tij në mbledhjen dhe depozitim të tij. Në Tropojë në vitin 2016 janë prodhuar 3000 ton mbeturinat urbane, kryesisht të prodhuara në Bajram Curri, 3500 ton inerte që vijnë nga sektori i ndërtimit dhe nxjerrjes së materialeve dhe 0.3 ton si mbetje spitalore. Mbetjet që vijnë nga përpunimi industrial nuk janë veçanërisht të rëndësishme në territorin e Tropojës pasi sektori industrial nuk ka qenë në gjendje të zhvillohet fuqishëm vitet e fundit. Analiza tregon se i gjithë zinxhiri i menaxhimit të mbeturinave është i thyer qysh në fillim të tij. Në të vërtetë të gjitha mbeturinat urbane grumbullohen vetëm në qendrat kryesore, ndërsa mbeturinat e prodhuara nga fshatrat rurale, industria e ndërtimit dhe inertet në përgjithësi, janë të shpërndara në mënyrë të paligjshme në territor në një sërë vendgrumbullimesh të paligjshëm, shumë prej të cilave janë të pranishme në shtratin e lumenjve dhe përrenjve. Kjo, së bashku me keqmenaxhimin e fushës së vetme tokësore të pranishme në territor, paraqet një rrezik serioz për mjedisin që përbën një ndër asetet kryesore të këtij territori.



Rrjedha e energjisë

Tropoja ka një prej hidrocentraleve më të mëdhenj në Evropë, me prodhim vjetor prej 1330 GWh. Por megjithatë, shumë zona rurale ende sot kanë mungesë të energjisë elektrike, me infrastrukturën elektrike që daton para 90-ve. Edhe pse vitet e fundit po vazhdojnë ndërtimet e hidrocentraleve të reja, infrastruktura lokale është ende e papërshtatshme dhe e dëmtuar. Në këtë drejtim nevojiten më shumë përpjekje.

Rrjedha e ushqimit

Zonat bujqësore janë mjaft të kufizuara dhe të fragmentuara. Ato vlerësohen të jenë rreth 7,390 ha, në të cilat mbillet dhe prodhohet: misri, gruri, zarzavatet dhe ushqimi për bagëtinë. Ky prodhim mbulon plotësisht kërkesën e brendshme, një nevojë e zhvilluar posaçërisht për pozicionin e largët të bashkisë, pothuajse e izoluar nga pjesa tjetër e Shqipërisë.

Me rëndësi të veçantë janë kullotat alpine për varietetet e tyre të bimëve medicinale, mbi të cilat veçohet boronica dhe lloje të tjera të pemëve frutore, të tilla si gështenja, mollët, arra dhe kumbulla. Bashkia ka masivin më të madh të gështenjës në Ballkan, i barabartë me 2600 ha që përfaqëson pasuri të mëdha për ekonominë e zonës.

Rrjedha e ujit

Prania e bollshme e ujit në rajon garanton për të gjithë banorët e saj një akses të drejtpërdrejtë me burimet ujore, si për përdorim shtëpiak edhe për prodhim. Për fat të keq ky akses nuk është i rregulluar gjithmonë ose, në shumicën e rasteve, ka mungesë të një infrastrukture të plotë. Në shumë zona malore burimi i vetëm i ujit të pijshëm është i përbërë nga shumë burime të përhapura në territor, ndërsa për zonat e urbanizuara rrjeti aktual nuk plotëson kërkesat e të gjithë popullsisë.

Rrjeti i kanalizimit është i kufizuar në qytetin e Bajram Currit dhe mbulon pjesërisht qendrat e Tropojës dhe Fierzës. Por, pavarësisht kësaj, ky rrjet nuk është i lidhur me ndonjë impiant trajtimi, duke sjellë dëme serioze mjedisore, pasi derdhet direkt në lumin e Valbonës, gjë që e bën gjithë rrjetin të padobishëm.



1.4 Rekomandime për problematikat e identifikuara

Bazuar në analizën e mësipërme dhe vizitat në terren, territori I bashkisë Tropojë në përgjithësi e vuan izolimin nga pjesa tjetër e Shqipërisë dhe aksesin në akset kombëtare, por ka një ndërveprim shumë të mirë me fqinjët përtej kufirit. Ky lloj ndërveprimi duhet të shfrytëzohet në mënyrën më të mirë të mundshme jo vetëm ana ekonomike por edhe nga ajo sociale e kulturore. Territori I bashkisë ka potenciale dhe burime të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të popullatës së zonës.

Përsa i përket burimeve ujore, cilësia e ujit të këtyre burimeve është mjaft e mirë për pirje dhe pjesa me e madhe janë burime të përhershme çarjesh-kontakti (formacioni nga ku buron uji). Kryesisht burimet ndodhen në kuota të larta dhe dërgimi i ujit mund të bëhet me vetërrjedhje duke shmangur ngritjet mekanike dhe duke ulur kostot e energjisë. Topografia e zonës mundëson ndërtimin e një rrjeti kanalizimesh të studiuar në atë mënyrë që të përfshijë një sipërfaqe sa më të madhe zonash të banuara dhe ujrat e ndotur të dërgohen me rrjedhje të lirë në një Impiant Trajtimi Ujrash të Ndotur.

Një nga pikat më të forta të bashkisë është sistemi natyror i cili zë pjesën më të madhe të territorit. Kjo zonë mbart vlerat më të veçanta natyrore e pejsazhistike të gjithë territorit shqiptar, relief të mahnitshëm malor, monumente të shumta natyre, nëntokë të pasur, etj. Pasuria e gjelbër e Tropojës fillon nga brezi i kullotave alpine, në drurët frutorë e deri të shumë-llojshmëria e bimëve medicinale e aromatike.

Ekzistenca e 3 parqeve natyrore, përfshirë këtu dhe zona strikte, bën që një pjesë e konsiderueshme e territorit do të përfitojë një zhvillim të qëndrueshëm në sajë të planeve dhe rregullave të menaxhimit të këtyre zonave. Ndërkohë vlen për tu theksuar cilësia e ajrit dhe tokës, elemente këto që do të përdoren si potenciale në vizionin e bashkisë.

Pavarësisht aksesit të dobët, I cili mbi të gjitha do të sillte lehtësira në ndërveprimet ekonomike, territori është I prekshëm dhe I përshkueshëm me anë të shtigjeve turistike malore, itinerare ujore përgjatë një prej luginave më të bukura, asaj të lumit Drin. Kësi lloj aktivitetesh I kanë dhënë jetë shumë-llojshmërisë së turizmit në këtë zonë, e cila dita-ditës bëhet edhe më e preferuar nga vendasit dhe mbarë bota.

Problematikat e evidentuara dhe rekomandimet për zbutjen e impaktit

Aksesueshmëria e dobët do të kërkonte projekte dhe investime të mëdha, për shkak të pozitës gjeografike dhe relievit të thyer malor që ka territori I bashkisë. Korridorin Adriatik-Alpe mbetet një nga akset më prioritar, jo vetëm për Tropojën por për të gjithë rajonin verior të Shqipërisë. Kjo rrugë e cila do të ofronte kushte dhe standarde bashkohore, shpejtësi më të lartë udhëtimi dhe eliminimin e kalimit në pika kufitare, do ta bënte Tropojën më lehtë të aksesueshme dhe me konkurruese në tregjet ekonomike.



Rekomandime të tjera përsa i përket infrastrukturës:

- Ndërtimi i rrugës që lidh Tropojën me Malin e Zi nëpërmjet aksit Dragobi-Kika-Cerem-Qafe Vranice- Piramida 25 – Plavë dhe Guci, kjo rrugë do të kishte efekt pozitiv për Tropojën si nga ana ekonomike ashtu edhe për turizmin.

- Lidhja me rrugë e të gjitha qendrave të banuara me Bajram Currin dhe me njëra tjetrën.
- Ndërtimi i sheshit të trageteve dhe terminalit në Fierze.

Ndërkohë, për shërbimin e Ujësjellës-Kanalizime të Bashkisë Tropojë, gjendja financiare e Ndërmarrjes nuk mundëson një mirëmbajtje të mjaftueshme të rrjeteve inxhinierike. Monitorimi periodik I rrjetit do mundësonte një evidentim dhe një ndarje më të saktë të problematikave sipas prioriteteve. Humbjet teknike dhe ekonomike ndikojnë negativisht në ofrimin e shërbimeve duke ndëshkuar kështu abonentët e rregullt që janë më të shumtë në numër në krahasim me ata që bëjnë shkelje. Impakti ndaj mjedisit me përdorimin e gropave septike të ndërtuara jo konform kushteve teknike, ndonëse nuk vërehet haptazi për momentin do reflektohet më vonë në kohë.

Rritja e faturimeve nga shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve do përmirësonte situatën financiare të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizime Tropojë rrjedhimisht duke lehtësuar dhe menaxhimin e problematikave të mirëmbajtjes dhe monitorimit të rrjeteve inxhinierike. Ulja e humbjeve në rrjet dhe pajisja me ujëmatës e përqindjes më të madhe të popullatës do ndikonte në përmirësimin e shërbimit dhe ndërgjegjësimin e abonentëve ndaj shpërdorimit të ujit. Monitorimi konstant I strukturave të ujësjellësit si kaptazhet, depot e ujit, stacionet e pompimit, linjat e dërgimit do e lehtësonte mjaftueshëm në parandalimin e problematikave dhe përmirësimin e shërbimeve.

Shumë e rëndësishme është dhe ruajtja e burimeve duke bërë rrethime të zonave ku ato ndodhen për të shmangur ndotje nga faktorë të ndryshëm.

Derdhja e ujrave të zeza në mjedis, ka sjellë një ndotje në nivele mjaft të larta të ujrave sipërfaqësore, nëntokësore, tokës, biodiversitetit, ajrit etj, duke cënuar cilësinë e jetës së vendasve dhe ndotjen e mjedisit. Fondet dhe investimet e thjeshta të bashkisë duhet menjëherë të përqendrohen në ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve në zonat ku nuk bëhet fare trajtimi i ujrave të zeza, prioritar duhet të jenë zonat turistike, ose në mungesë të fondeve mund të përdoren metoda shumë të thjeshta për filtrimin e këtyre ujrave si përdorimi i kallameve, zhavorrit dhe rërës.

Prerja masive e pyjeve, gjuetia e paligjshme e disa specieve të mbrojtura, kullotja e pakontrolluar, zjarret e qëllimshëm, veprimtaria njerëzore dhe industriale etj, janë fenomene që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme diversitetin e llojeve në territorin e Tropojës



Një rendësi e madhe duhet ti kushtohet shkallës së ruajtjes ose mbrojtjes së habitateve dhe të biodiversitetit dhe gjithashtu forcimit të sistemit të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura. Prerja e paligjshme e pyjeve duhet të monitorohet me kujdes dhe të behët zëvendësimi i shpejtë i sipërfaqeve pyjore të prera.

Tropoja paraqitet një zonë mjaft e favorizuar kundrejt procesit të erozionit pasi ajo shtrihet në një rrafshinë në rrëzë të Malësisë së Alpeve që pozicionohet në kufi të një zone me rrezik të lartë shkëputjeje aktive, e cila është e vazhdueshme në drejtimin jug-perëndim-verilindje.

Nevojiten të merren disa masa me qëllim uljen e këtij rreziku potencial. Këto masa mund të jenë: ndalim i prerjes masive të bimësisë në sipërfaqet pyjore si dhe pyllëzim sa më i shpejtë të sipërfaqeve të zhveshura nga bimësia. Masë tjetër mund të jetë eliminimi ose moslejimi i ndërhyrjeve mekanike në afërsi të shtratit të lumenjve. Gjithashtu ndër-marrja e një sërë masash të karakterit inxhinjrik, hidroteknik me qëllim menaxhimin dhe mirëmbajtjen e baseneve ujore si dhe shtretërve të lumenjve, si dhe ndërtimin e pritave malore dhe gardheve me qëllim uljen e rrezikut potencial.

- Hartimi i planeve të menaxhimit të burimeve natyrore dhe humane në favor të zhvillimit socio-ekonomi-mjedisor të zonës
- Përmirësimi i menaxhimit të furnizimit me ujë (rritjen e mbulimit me furnizim dhe rritjen e orëve të furnizimit me ujë të banoreve; furnizimin me ujë të fshatrave të pambuluara; Kryerja e një studimi fizibiliteti për sistemin e ujit të pijshëm dhe KUZ për gjithë territorin e zonës dhe zhvillimi i një plani për menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve.
- Menaxhimi efektiv i mbetjeve është i rëndësishëm për jetesën e qytetarëve si dhe për zhvillimin e turizmit.
- Të shihet mundësia e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.
- Të rriten përpjekjet për ndërgjegjësimin e komunitetit për të kontribuar në mbrojtjen e ambientit.
- Menaxhimi i mbetjeve të orientohet drejt një menaxhimi të përbashkët si një mundësi e kostove financiare më të ultë.
- Vendosja e taksave të pastrimit për familje, bizneseve dhe institucioneve në mënyrë që të mbulojnë kostot. Kontraktimi shërbimit të pastrimit tek kompani të specializuara private, bazuar në një proces kompetitiv, duke përcaktuar njëkohësisht standarde të qarta të pasqyruara në kontrata që mundësojnë monitorimin me rigorozitet të menaxhimit të mbetjeve nga njësitë vendore.
- Avokimi dhe Lobimi për lehtësimin e lëvizjes së lire, sidomos të mallrave,



në kufirin midis Shqipërisë dhe Kosovës do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e transportit dhe për pasojë zhvillimin ekonomik në dy anët e kufirit.

- Përmirësim i infrastrukturës rrugore që lidh fshatrat e largët me zonat urbane të Tropojës. Kjo do të ndikonte në lehtësimin e daljes në treg të këtyre fshatrave, zhvillimin ekonomik të tyre, rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe mbajtjen e popullimit të këtyre zonave.

- Është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura rrugore në zonat potenciale turistike si Çeremi, Curraj Epërm, Liqeni i Ponarëve, Vargmali i Bjeshkëve, si kusht për zhvillimin e turizmit malor. Të shfrytëzohet potenciali prodhues i zonës i cili është të paktën dyfishi i prodhimit aktual (toka bujqësore e papunuar & rendimentet e ultë). Prodhimet bujqësore dhe blegtorale të kenë destinacion tregun turistik dhe turistin vendas e të huaj

- Të mbështeten përpjekjet për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Të kryhen shërbime në kulturën e gështenjës për të luftuar sëmundjet .

- Të konsiderohen bimët medicinale si një mundësi për gjenerimin e të ardhurave dhe të investohet në njësitë e përpunimit dhe kultivimit të tyre.

- Të dyfishohet numri i koshereve dhe rritja e prodhimit të mjaltit .Duke pasur parasysh rëndësinë në rritje të turizmit malor, është e nevojshme që struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore të orientohet drejt plotësimit të nevojave të turizmit malor.

- Zgjidhja e problemit të pronësisë mbi masivet e gështenjës do të ndikonte pozitivisht në menaxhimin e tyre dhe rritjen e prodhimit

- Mbështetja e fermerëve (nëpërmjet kreditimit me kushte lehtësuese për shembull) për të rritur përdorimin e mekanikës bujqësore do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e prodhimit dhe të ardhurave të fermerëve. Gjithashtu e rëndësishme është nxitja e kooperimit midis fermerëve. Mbështetja e familjeve bujqësore për shtimin e të dhirtave, pasi kullotat natyrore janë të përshtatshme dhe kanë kapacitet mbajtës trefish më shumë se sa aktuali.

- Të aplikohen metodat bashkëkohore nga bletarët për sigurimin e rritjen e rendimentit të mjaltit. Përdorimi efektiv i subvencioneve nga shteti është gjithashtu i rëndësishëm.

- Të nxiten brezi i ri që të punojë në bujqësi dhe blegtori përmes arsimimit të tyre në këtë profil dhe dhënies se donacioneve për krijimin e fermave. Është e nevojshme të inkurajohet organizimi i fermerëve në shoqata.

- Aplikimi me efektivitet i skemave të mbështetjes financiare për fermerët është



e rëndësishme për rritjen e prodhimit bujqësor.

- Përcaktimi i destinacioneve të ekzistuese dhe atyre të reja turistike në Parkun e Malësisë së Gjakovës. Të hartohet një kalendar i përbashkët i ngjarjeve/aktivitete me qëllim tregun turistik. Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi dhe asaj turistike në veçanti (sinjalistika, akomodim, shërbime)Të rritet niveli dhe cilësia e shërbimeve përmes rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjëseve(trajnimeve, kurseve 1-3 mujore).
- Të rritet prania e ushqimeve cilësore lokale tradicionale bujqësore dhe blegtorale. Të investohet për arritjen e standardeve të produkteve blegtorale dhe bujqësore përmes ngritjes së njësive të përpunimit, magazinimit dhe paketimit, me qëllim rritjen e besimit të vizitorëve ndaj këtyre produkteve.
- Të promovohen jo vetëm një formë të lëvizjes turistike, por të gjitha llojet e mundshme që mund të zhvillohen duke u nisur tashme nga katër elementë kyç:Përvojat turistike (“gjëra për të parë dhe për t’u bërë nga turisti”);
- Motivët për të vizituar rajonin, të cilat duhet të jenë joshëse sidomos për tregjet jashtë tij; Interpretimi dhe prezantimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit; dhe Ofrimi i një serie njësish akomoduese të pranueshme nga tregu.
- Të ndërmerren masa për shfrytëzimin me efektivitet të interesit për të investuar në turizëm si dhe të interesit të emigrantëve për tu kthyer në vendin e tyre.
- Të ruhet tendenca për ndërtime dhe arrendim sipas traditës që përben një avantazh të turizmit malor në zonat turistike, duke mënjanuar betonizimin. Të ruhen Gatimet tradicionale si një ofertë e rëndësishme për tërheqjen apo rikthyer turistët përsëri në park
- Funksionimi i vazhdueshëm i zyrave të info-turizmit në të gjithë territorin. Të shihet mundësia e ngritjes së këtyre zyrave edhe në vende të tjera (B. Curr, Has) dhe të përmirësohet informacioni turistik.
- Sigurimi i kreditimit të sektorit në kushte favorizuese është i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Hartimi i një plani të menaxhimit dhe zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal do të ishte një ndihmese e rëndësishme për financimin e projekteve të ndryshme dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.





2 VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE





2.1 Tropoja dhe territoret e bashkive fqinje

Bazuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, tre janë tipet e rajoneve kryesore përcaktuara:

- Rajone ndërkufitare
- Rajone ekonomike kombëtare
- Rajone kombëtare të specializuara

Rajonet Ndërkufitare

Ndarja në Rajonet ndërkufitare burojnë nga politikat e kohezionit të Komisionit Evropian dhe asistencën që jepet në kuadër të instrumentit të asistencës së Bashkimit Evropian IPA-. Ndër katër programet e bashkëpunimit ndërkufitar ku merr pjesë Shqipëria, Bashkia e Tropojës përfshihet në zonat përfituese të programit të IPA CBC Shqipëri- Kosovë dhe Shqipëri-Mali Zi.

Rajoni Tropoje-Gjakove ka patur dhe ka lidhje të forta historike dhe tregtare. Bashkëpunimi nder-rajonar mes tyre është një indikator i mirë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij rajoni. Potencial për zhvillimin e këtij rajoni është zhvillimi turistik dhe kulturor, shkëmbimi tregtar në produktet bujqësore komplementare.

Rajonet Ekonomike Kombëtare

Në bazë të parashikimeve të PPK si Rajon Ekonomik Kombëtar aktualisht performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por PPK në bazë të zhvillimeve të pritshme deri në 2030 koncepton fuqizimin dhe ngritjen edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndësi kombëtare.

Rajonet kombëtare të specializuara


Bashkia Tropoje përfshihet tek Porta e Veriut e përbërë nga Rajoni Shkodër - Lezhë dhe Rajoni Kukës – Has – Tropojë

Profili kryesor i zhvillimit në bazë të PPK koncepton fuqizimin dhe ngritjen edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndësi kombëtare.

Ndër zhvillimet strategjike kryesore që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe prekin Bashkinë Tropojë mund të përmendim:

- Zhvillimi i portit të peshkimit dhe portit turistik të Shëngjinit si pjesë e lidhjeve të reja





- Qendër selicndare
- Qendër lokale e specializuar
- Qendër lokale
- Fshat

- Linjë Autobusuale ndërbashkësie
- Linjë Autobusuale ndërbashkësie të propozuara
- Qendër Intermediale
- Stacione Autobusuale
- Stacione Autobusuale të propozuara
- Linjë Autobusuale bashkësie
- Linjë Autobusuale bashkësie të propozuara
- Qendër Intermediale dytësore
- Stacione Autobusuale
- Stacione Autobusuale të propozuara
- Linjë tregëtoresh
- Linjë tregëtoresh të propozuara
- Shërbim tregëtoresh
- Shërbim tregëtoresh të propozuara
- Hëlpporte të propozuara

- Llojëvill kryesor
- Pika primare grumbullimi
- Pika sekundare grumbullimi
- Rrjetorë tregëtoresh / komerciale
- Rrjetorë dytësore / banorë
- Tregëtor
- Tregëtor lokal
- Tregëtor
- Qendër në ndihmë të bujqësisë
- Shërbim bujqësor
- Mbledhës gjëshinjash
- Mbledhës blimesh mjekësore
- Rrjetorë
- Vendlinje Linjë 1
- Tërfaqe

- Tokë bujqësore me kategori boniteti IX
- Tokë bujqësore me kategori boniteti VIII
- Tokë bujqësore me kategori boniteti VII
- Tokë bujqësore me kategori boniteti VI
- Tokë bujqësore me kategori boniteti V
- Zonë e pemëve të gëzhgimjave
- Zonë pemësh frutëse
- Biorandë
- Qendër dytësore
- Qendër lokale e specializuar



funkcionale me bashkinë Lezhë dhe qendrat lokale përreth, por edhe atraksion i Bashkisë Tropojë dhe Kosovës.

- Akses për ne rajonin turistik malor verior të Alpeve Shqiptare, projekt ndërkuftar ndërmjet tre shteteve Shqipëri, Mal i Zi dhe Kosovë; Majat e Ballkanit
- Zhvillimi i projektit për “Transport Ujor Liqenor” në liqenet artificiale Koman Fierzë

por jo vetëm, vlerësuar si parku energjetik me i madh i vendit me vlera të larta peizazhistike natyrore.

- Fasha kombëtare Energjetike liqeni i Vaut të Dejës, Fierzës, Komanit
- Zona të pasura minerare për nxjerrjen dhe përpunimin e kromit dhe të bakrit

2.2 Vizioni dhe strategjia e zhvillimit territorial për bashkinë e Tropojës

Vendosur në Shqipërinë Veri-Lindore, Tropoja është një nga rajonet më pak të njohura të vendit. Territori i saj malor mbetet gjerësisht i panjohur për shumicën e shqiptarëve, por ka fituar vëmendjen e turistëve të huaj, veçanërisht hiker-ve evropianë që e vizitojnë rajonin për të shijuar kushtet e saj natyrore të paprekura dhe shtigjet alpine. Vendndodhja e largët, në brendësi të pozitës gjeografike kombëtare, dhe vështirësia për t’u arritur janë dy nga faktorët që në të njëjtën kohë përfaqësojnë një problem dhe një aset.

Ndërkohë që nga njëra anë rajoni i Tropojës ka humbur një pjesë të madhe të popullsisë së tij aktive, e cila është vendosur në qytete më të mëdha të Shqipërisë ose jashtë vendit, ka vështirësi në shpërndarjen e prodhimeve lokale me vlerë dhe është e vështirë të arrihet nga vizitorët dhe udhëtarët, nga ana tjetër, ajo mbetet ndoshta i vetmi rajon në vend që nuk është prekur nga urbanizimi i pakontrolluar, ndërtimet e paligjshme dhe dëmtimi i resurseve të peizazhit që ka përfshirë pjesën tjetër të Shqipërisë që nga vitet 90’.

Mundësia për të krijuar vizionin e ardhshëm për Tropojën është një mundësi unike për të ngritur strategji, veprime dhe projekte konkrete që e bëjnë Tropojën një rajon unik, ku zhvillimi i ardhshëm socio-ekonomik bazohet në ndërlidhjen e kujdesshme midis përmirësimit, mbrojtjes dhe përdorimit të resurseve të tij territoriale. Vizioni për të ardhmen e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe në kuptuarit se shfrytëzimi i tyre nevojitet të bëhet në përfitim të ekonomisë dhe popullsisë vendase, pa çënuar vlefshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhmen. Ky program do të zbatohet në hapa dhe faza nëpërmjet veprimeve dhe projekteve strategjike të kujdesshme që do të kontribuojnë në arritjen afat-gjatë të këtyre rezultateve.

(në faqen
paraardhëse)
Tropojë: Harta
e strategjisë
territoriale





Hapësirë
publike në
Bajram Curri



Veprimet dhe projektet strategjike lidhen me tri fusha kryesore:


1. Zhvillimi urban i Bajram Currit dhe qendrave rurale

Në kontrast me bukurinë e peizazhit, si qendrat urbane, si Bajram Curri, ashtu edhe qendrat rurale vujanë nga një mungesë e mirëmbajtjes bazike dhe shumica e rrugëve dytësore janë të pashtruara. Kjo situatë shkakton shumë probleme, si mungesë të sistemit të kullimit të ujërave dhe, mbi të gjitha, e bën të prekshme mungesën e një sfere publike dinjitoze. Kështu, prioritet i është dhënë rehabilitimit të hapësirave publike nëpërmjet ndërhyrjeve të përcaktuara që mund të përmirësojnë në mënyrë strategjike hapësirën midis shtëpive në të gjitha qendrat urbane të Tropojës. Shumica e qendrave urbane të Tropojës dhe veçanërisht Bajram Curri karakterizohen nga një topografi me pjerrësi, e cila ka potencialin për të krijuar skena teatrale. Hapësirat e reja publike të qytetit janë përfytyruar si zona të shtruara që, duke ndjekur topografinë, krijojnë sekuenca tarracash dhe shkallësh të realizuara me punime tulle të ekspozuara. Në këtë mënyrë, hapësirat e reja publike prezantojnë një ndjenjë qetësie dhe pushimi në të cilat zhvillohen si aktivitetet ashtu edhe takime apo soditje. Kjo qasje është testuar në Bajram Curri, ku shumica e rrugëve dytësore të qytetit janë të pashtruara dhe, edhe pse të përdorura, janë në gjendje braktisjeje. Janë përzgjedhur tre sitestrategjike ku këto hapësira të reja publike janë lehtësisht të realizueshme me kosto të ulta dhe rezultate efektive të mundshme.

Në lidhje me qendrat e tjera më të vogla urbane, hapësirat kryesore urbane, normalisht ndodhur pranë shërbimeve publike si administrata publike, ambulanca dhe zyra postare, janë të shtruara rishtazi. Në këtë mënyrë, çdo qendër urbane shenjohehet nga një vend i caktuar takimi dhe i jetës qytetare. Megjithëse secila nga këto ndërhyrje është e ndryshme, përsëritja e motiveve si shkallët dhe tarracat dhe konsistenca e materialeve, si punimet me tullë të ekspozuar, i bëjnë ato pika referimi të dallueshme dhe, si të tilla, gurë kilometrikë të transformimit urban të rajonit të Tropojës.

Falë turizmit potencial, Tropoja zhvillon një pritje të përshtatshme hotelerie dhe bëhet qendra rajonale për strehimin e turistëve. Siç është shpjeguar më sipër, ky vizion bazohet në idenë e turizmit të lehtë (soft-tourism), i cili parandalon urbanizimin agresiv të territorit. Ende ka nevojë urgjente për hotele dhe shërbime të tjera turistike të vendosura në pika strategjike. Një nga këto pika është qyteti i Bajram Currit, i cili mund të pranojë një koncentrim shërbimesh turistike, duke parandaluar kështu përhapjen e këtyre strukturave në territor dhe në peizazhet më të çmuara. Këto struktura bëhen strumbulli i zgjerimit të qytetit drejt verilindjes. Nga Bajram Curri, turistët lehtësisht do të jenë në gjendje të arrijnë pikat e nisjes së ekskursioneve falë një sistemi të gjerë të lëvizshmërisë publike dhe të përfitojnë, gjatë ekskursioneve alpine (hiking), nga shërbimet në shkallë të vogël dhe më të thjeshta.





Pelzazh
bujqësor në
Tropojë të
Vjetër



2. Përforcimi i Bujqësisë dhe Blegtorisë

Bujqësia dhe blegtoria janë dy format kryesore të prodhimit në territorin e Tropojës dhe kontribuojnë, së bashku me zhvillimin urban të qendrave urbane të rajonit, në rritjen e potencialit turistik të territorit. Si bujqësia, ashtu edhe blegtoria (veçanërisht lopët, delet dhe dhitë) janë tashmë të pranishme, veçanërisht në malësitë lindore të rajonit të Tropojës, por gjatë dekadave të fundit kanë vuajtur nga braktisja e infrastrukturave të rëndësishme, si sistemet e vaditjes dhe kullimit, mungesa e përpunimit të ushqimit, shërbimeve të depozitimit dhe shpërndarjes, kushtet e përgjithshme të mjerueshme të infrastrukturës së komunikimit dhe së fundi nga procesi i ndarjes së pronësisë së tokës. Shumë banorë, në vitet e fundit, kanë braktisur të korrat dhe bagëtitë, edhe për shkak të nivelit të ulët të të ardhurave që ka qenë në gjendje të prodhojë bujqësia.

Megjithëse malësitë e Tropojës janë rajoni kryesor për veprimtaritë bujqësore, është e rëndësishme të përmendet se të korrat alpine luajnë gjithmonë e më shumë një rol të rëndësishëm brenda ekonomisë bujqësore, si për kushtet e virgjëra të tokës (perfekte për të korrat bio) dhe për të korra të cilësisë së lartë që janë karakteristike për klimën alpine, si gështenjat dhe boronicat. Për të arritur këto qëllime janë zhvilluar projekte që synojnë të rehabilitojnë infrastrukturat bujqësore të braktisura dhe të lehtësojnë bashkëpunimin midis fermerëve që mund të përdorin së bashku shërbimet e reja, të përmirësojnë vlerën e të korrave vendase duke plotësuar zinxhirin e prodhimit, nga kultivimi dhe korrja, deri te përpunimi dhe shitja; duke i bërë prodhimet vendase të disponueshme dhe të njohura për vizitorët dhe pjesë të eksperiencës së tyre në Tropojë. Prodhimet vendase duhet të bëhen krenaria e Tropojës, të shërbehen në restorantet vendase dhe të shiten në dyqanet vendase. Shumë nga të korrat dhe bagëtitë e pranishme nuk janë shfrytëzuar ende, pavarësisht potencialit të tyre. Nëpërmjet pak projekteve të përzgjedhura, veprimtaritë bujqësore mund të bëhen sërish një përbërës ekonomik jetësor në ekonominë e Tropojës. Investimi në bujqësi është veçanërisht i rëndësishëm, pasi këto veprimtari janë veçanësisht të përputhshme me mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë dhe komunitetit vendas, me zhvillimin dhe përforcimin e tyre. Investimi në bujqësi dhe duke e bërë këtë të qëndrueshme nga ana ekonomike përputhet me mundësinë e kthimit të popullsisë së Tropojës, e kujdesit për territorin e saj dhe me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e aseteve kulturore të vendit.





Pikë vrotimi
në Curraj të
Epërm



3. Zhvillimi i Turizmit të Lehtë (Soft-Tourism)

Zona e Tropojës ka një peizazh me bukuri të pakrahasueshme, një bukuri që rrezaton nga kontrasti i fortë midis tre peizazheve: Alpeve, luginave dhe malësive. Vizioni ynë forcon këtë kompozim duke u përpjekur të përmirësojë jo vetëm bukurinë e secilit prej këtyre peizazheve, por edhe bashkëjetesën e tyre si park territorial. Për të arritur këtë qëllim është e rëndësishme të ruhen shtigjet e shumta historike që ende përshkojnë territorin e Tropojës. Falë krijimit të rrugëve të reja, komunitetet vendase i përdorin gjithmonë e më pak këto shtigje historike. Në të njëjtën kohë ato janë bërë shumë popullore midis një komuniteti ndërkombëtar hiker-ash, të cilët e vlerësojnë natyrën gjerësisht të pakorruptuar të luginave dhe vargjeve malore të Tropojës. Kjo do të thotë se shtigjet e hikingkanë nevojë për kujdes, mirëmbajtje dhe përmirësim nëpërmjet shërbimeve të veçanta si pika informacioni, platforma, stola, sinjalistikë për itineraret dhe vende të pajisura për fushim (kamping). Të gjithë këta elementë nuk duhet të jenë pushtues dhe duhet të vendosen me kujdes brenda peizazhit. Në këtë mënyrë, shtigjet historike bëhen një rrjet që të lejon të vizitosh territorin e Tropojës, ndërkohë që ruan bukurinë e saj natyrore. Disa nga ndërtesat historike, të cilat tani janë pak ose aspak të përdorura, janë përshtatur si struktura të përhapura hoteliere me një minimum shërbimesh, si ujë të rrjedhshëm dhe vende fjetjeje. Si të tilla, këto struktura përdoren si pied-a-terre të lehta për shijimin e peizazhit. Këtë qasje ne e përkufizojmë si soft-tourism, që është një turizëm jo i përbërë nga shërbime në shkallë të madhe, si resorte, por një fomë më e lirë turizmi, i cili do të tërhiqte vizitorë të interesuar dhe të respektueshëm ndaj kulturës së vendit.

Ne besojmë se kjo mënyrë e të kuptuarit të turizmit nuk është vetëm një mundësi ekonomike, por përfaqëson edhe një mundësi për të ruajtur sistematikisht peizazhin natyror të Tropojës. Për të testuar këtë qasje, dy shtigje historike, që ne besojmë mund të shërbejnë si prototipe për konsolidimin e mëtejshëm të shtigjeve të tjera në territor, janë përzgjedhur si raste studimore. Përgjatë këtyre shtigjeve është ndërtuar një segment me shërbime të lehta si pika informacioni dhe vendsoditjeje. Këto sillen si gurë kilometrikë, duke i lejuar vizitorët të arrijnë lehtësisht majat me pamje qetësuese drejt peizazhit.

2.2.1 Objektivat strategjike

Veprimet dhe projektet strategjike janë organizuar në bazë të tetë objektivave kryesore:

O1 - Mbrojtja e Mjedisit

OIS1 Ruajtja (konservimi) e Biodiversitetit



Mbrojtja e natyrës së egër (flora dhe fauna vendase)

Shtimi i ekosistemeve prodhuese

Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i infrastrukturës së sistemit të mbrojtjes nga zjarri

Rritja e ndërgjegjësimit publik

OIS2 Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura dhe Rrjetit Ekologjik (Natura 2000)

Planet e menaxhimit për Zonat e Mbrojtura

Zbatimi i “Natura 2000”

Ristrukturimi dhe forcimi i strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura

OIS3 Ndikimi i ndryshimeve klimaterike

Ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi biodiversitetin dhe ekosistemet

Ndikimi i ndryshimit klimatik në pasuritë hidrologjike

OIS4 Ndërhyrje rigjeneruese në zonat mjedisore të prekura

Parandalimi i erozionit

Masa parandaluese mjedisore për industrinë minerare

Rehabilitimi i ish-zonave të hedhjeve

O2 Ruajtja e vlerave kulturore

O2S1 Mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të kulturës dhe vendbanimeve fshatare

Restaurim i monumenteve historike

Nxitja e fushatave hetuese arkeologjike

Restaurim i vendbanimeve historike

O2S1 Ruajtja dhe pasurimi i trashëgimisë shpirtërore



Nxitja (mbështjettja) e folklorit (programe për vallen dhe këngët)

Festime dhe Përkujtime

O3 Zhvillimi i Turizmit

O3S1 Promovimi i Territorit

Promovimi në faqe interneti

Krijimi i pikave të informimit për turistët

Reklamimi i prodhimeve autoktone në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare (programe)

Nxitja e veprimtarive ndërkombëtare dhe ngjarjeve që synojnë promovimin e vlerave natyrore dhe të trashëgimisë së rajonit (të paktën 2 veprimtari)

Pajisja e rrugëve, shtigjeve, vendeve të interesit me sinjalistikë (për parqet, trashëgiminë kulturore dhe natyrore etj.)

O3S2 Përmirësimi i rrugëve turistike dhe arritshmërisë në vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë

Pajisja e hyrjes së parkut me struktura shërbimi (zona të parkimit, tabela informuese, kujdes shëndetësor, kabinë rojtarësh, burim uji, stola, tavolina dhe kioskë)

Krijimi i vendeve të pajisura për shtigjet natyrore dhe vlerat e trashëgimisë natyrore dhe historike (parkime, tabela informuese, kabina rojtarësh etj.)

Rikonstruimi i shtigjeve kryesore historike të ecjes duke përforcuar itineraret turistike rajonale dhe ndërkufitare

Pajisja e shtigjeve me shërbimet e nevojshme dhe infrastrukturat e vogla plotësuese (vende soditjeje, çlodhjeje, etj.)

Hartëzimi i të gjitha shtigjeve dhe rrugëve kryesore turistike (projekte)

Garantimi i arritshmërisë në monumentet natyrore dhe historike (projekte rrugësh)

O3S3 Zhvillimi i strukturave turistike



Zgjerimi i llojeve të strehimit turistik sipas prirjeve të ndryshme të territorit (kamp, bujtina, hotele luksi, hotele standarte) në Lekbibaj

Ripërdorimi i ndërtesave tradicionale si infrastrukturë mikpritjeje (stanet në bjeshkë, shtëpitë tradicionale, etj.)

Përmirësimi i ofertës turistike (turizëm dimëror, turizëm sportiv, ish-qendrat e skive, parashutizmi, etj.)

O3S4 Përmirësimi i shërbimeve turistike

Mbështetja e formimit profesional të operatorëve privatë (programe)

Krijimi i qendrave për edukimin dhe trajnimin në profesionet e turizmit (projekt)

O4 Fuqizimi i bujqësisë dhe blegtorisë

O4S1 Përmirësimi i mjedisit bujqësor

Shtimi i tokës bujqësore dhe bagëtive

Rehabilitimi i sistemit të vaditjes dhe kullimit

Promovimi i ripërdorimit të tarracave

Implementimi i akuakulturës

O4S2 Mbështetja e fermave organike

Mbështetja e përdorimit të metodave të krijimit të fermave organike

Implementimi i metodave të krijimit të fermave organike

O4S3 Mbështetja e prodhuesve të vegjël dhe fermave

Shtimi i llojshmërisë së prodhimit të përgjithshëm blegtoral/bujqësor

Mbështetja e fermerëve vendas (taksë)

Investim në strukturat fizike të fermave



Asistencë teknike dhe përmirësim i shërbimeve këshilluese

Nxjtja e realizimit të qendrave për përpunimin e ushqimit

O4S4 Promovimi i bashkëpunimit

Shtimi i bashkëpunimit midis fermerëve dhe operatorëve të vegjël

Mbështetje për themelimin e grupeve të prodhuesve

Promovimi i bashkëpunimit publik-privat

O4S5 Promovimi i tregtimit të prodhimeve ushqimore vendase

Zgjerimi i veprimtarive ekonomike të fermerëve

Krijimi i tregjeve lokale

O4S6 Sigurimi i certifikimit të prodhimeve vendase

Promovimi i skemave të cilësisë për prodhimet bujqësore dhe ushqimet

Krijimi i brandit të Tropojës

O4S7 Promovimi i formimit profesional

Promovimi i përgatitjes profesionale

Promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit

O5 Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme

O5S1 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

Përmirësimi i lidhjeve midis qendrave kryesore (projekte)

Përmirësimi i lidhjeve midis qendrave kryesore dhe fshatrave (projekte)



O5S2 Përmirësimi i transportit ujor

Ngritja e linjës së tragetit në Kukës (aeroporti i Kukësit - Kukës - Fierzë)

Ngritja e ndalesave (stacioneve) të tragetit (projekte)

O5S3 Përforcimi i lëvizshmërisë së përbashkët

Krijimi i shoqatave të transportit të përbashkët (për formalizimin e transportit të përbashkët, që të jepet mundësia e nënkontraktimit të shërbimit dhe rregullimit të itinerareve të transportit, orëve dhe çmimeve)

Ndërtimi i stacioneve intermodale (stacione kryesore)

Sigurimi i transportit të përbashkët në të gjithë territorin (itinerare dhe qëndrime autobusi)

Rinovimi dhe përmirësimi i transportit të përbashkët ekzistues.

O5S3 Përforcimi i lëvizshmërisë së lehtë

Përmirësimi i lëvizshmërisë së lehtë në fshatrat rurale (projekte, lidhje mes fshatrave)

Përmirësimi i rrugëve çiklistike (projekte)

O6 Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale

O6S1 Garantimi i arritshmërisë së hapësirave publike

Sigurimi i pranisë së hapësirave publike në zonat e urbanizuara (projekte për hapësirat publike, ripërdorim dhe të reja)

Rehabilitimi i hapësirave publike në blloqet urbane (projekte)

Sigurimi i hapësirave publike për rrugët kryesore urbane

Krijimi i rrugëve për këmbësorë (projekte)

O6S2 Përmirësimi i shërbimeve të përbashkëta



Promovimi i arsimit (projekte, shkolla)

Përmirësimi i shërbimit shëndetësor

Promovimi i shoqërisë kulturore dhe civile (projekte, qendra kulturore dhe projekt për muzeun ekzistues)

Zgjerim dhe përmirësim i varrezave (projekte)

O6S3 Përbushja e nevojave për strehim dhe përmirësimi i ofertës aktuale për strehim

Përmirësimi i ofertës për strehim social

Akses i përmirësuar në strehimet sociale për grupet “vulnerabël”

Rinovimi i stokut të banesave ekzistuese

O6S4 Dendësimi dhe konsolidimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

Dendësimi dhe rikualifikimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

Rikualifikimi i ish-zonave industriale dhe ushtarake

O7 Përditësimi dhe krijimi i infrastrukturës bazë urbane

O7S1 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore lokale

Përmirësimi i rrugëve urbane ekzistuese

Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese me ndërhyrje me ndikim të ulët në mjedis (sistemi gjeo-grid)

O7S2 Përmirësimi i rrjetit të shërbimit ujësjellës

Përmirësimi i rrjetit kryesor të furnizimit me ujë të pijshëm

Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë

Promovimi i mekanizmave të grumbullimit të ujërave atmosferike



O7S3 Ngritja e një sistemi kanalizimesh funksional për të gjithë territorin

Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit kryesor të ujërave të zeza

Planifikimi dhe ndërtimi i një impianti të centralizuar të trajtimit të ujërave të zeza

Planifikimi dhe ndërtimi i sistemeve gjysmë të centralizuara për vendbanimet e largëta

Promovim i trajtimit shtëpiak të ujërave të zeza për banesat e izoluara

O7S4 Ngritja e një sistemi funksional për grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave për të gjithë territorin

Parandalimi i prodhimit të mbetjeve

Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve

Nxitja e ndarjes së mbetjeve në origjinë

Promovimi i kompostimit të mbetjeve organike

Promovimi i ekonomisë së riciklimmit të mbetjeve (qendrave)

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit

O7S5 Përmirësimi i rrjetit të telekomunikimit

Zgjerimi i rrjetit të komunikimit në qendrat kryesore

Sigurimi i aksesit të rrjetit të komunikimit në zonat rurale

O7S6 Përmirësimi i efektshmërisë energjitike

Fuqizimi i rrjetit ekzistuese të shpërndarjes së energjisë elektrike

Nxitja e prodhimit alternativ të energjisë

O8 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar

O8S1 Mbrojtja e biodiversitetit



Mbrojtja e llojeve (specieve) dhe habitateve – përtej kufijve kombëtarë

Sigurimi i vazhdimësisë së procesit të evolucionit natyror përtej kufijve shtetërorë (p.sh. korridoret e migrimit të kafshëve të egra)

Zvogëlimi i kërcënimeve aktuale

Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështje mjedisore

O8S2 Mbështetja e zhvillimit socioekonomik

Nismat e bashkëpunimit në nivel institucional

Vlerësimi dhe shtimi i kapaciteteve të partnerëve të ndryshëm vendas për bashkëpunim ndërkufitar

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

Zhvillimi i një modeli zonimi të harmonizuar dhe të përputhshëm në konsultim me të gjitha vendet e përfshira

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në rajon

Zhvillimi i aplikimeve të përbashkëta për fonde në IPA (Instrument for Pre-Accession Assistance/Instrumenti për Ndihmën Para-Aderuese)

2.2.2 Programet strategjike (përshkrimi i detajuar i programeve për zbatimin e objektivave strategjike)

Programet strategjike të O1- Mbrojtja e mjedisit

O1S1 Ruajtja (konservimi) e Biodiversitetit

Zona që mbulon Bashkia Tropojë karakterizohet nga kontraste të mëdha të relievit, luginave dhe kreshtave alpine përreth. Edhe pse kjo zonë ka një reliev të thyer dhe të lartë ajo nuk është e paarritshme. Rrjeti i dendur i luginave, grykave dhe qafave lehtëson kalimin përmes saj deri në pjesët më të largëta.

Zona përbën një rajon unik natyror me bukuri të rrallë dhe vlerë ekologjike, dhe streha e burimeve të lumenjve kryesore. Ato përbëjnë një mjedis kryesor ekologjik, ekonomik, kulturor, argëtues dhe dinamik. Si rezultat i relievit të larmishëm, pozitës gjeografike, faktorëve gjeologjikë, formacioneve të tokës, rrjetit hidrologjik dhe kushteve klimatike, zona që mbulon Bashkia Tropojë shfaq një larmi të madhe të habitateve natyrore. Një



rezervë strikte natyrore dhe një park kombëtar dhe një rajonal, si dhe një numër monumentesh natyrore janë të vendosura në rajon. Nga një pikëpamje socio-ekonomike zona ka potencial për zbatimin e aktiviteteve ekonomike të suksesshme. Ekzistojnë mundësi për zhvillimin e këtij rajoni dhe në veçanti, për integrimin dhe bashkëpunimin ndërkuftar.

Habitati më i përhapur në zonë është pylli, i përbërë kryesisht nga pyjet halore dhe gjethegjere, si dhe pylli i ahut. Kullotat që përdoren kryesisht për kullotje dhe livadhe të habitateve, janë lloji i dytë më i madh i habitateve për sa i përket sipërfaqes së zonës që ato mbulojnë. Bujqësia zë kryesisht ato toka që janë vendosur në afërsi të fshatrave më të populluara. Zona shkëmbore, zona të dëmtuara nga erozioni, si dhe zona të djegura janë gjithashtu të pranishme, së bashku me trupat ujorë.

Dokumenti i Politikave Strategjike Për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB) ka si objektiv të përgjithshëm kontribimin në nivel kombëtar për arritjen e objektivave të 2020 në ndalimin e humbjeve të biodiversitetit dhe degradimin e shërbimeve të ekosistemit.

Në këtë kuadër, në strategji janë identifikuar katër veprime prioritare, të cilat duhen realizuar.

Mbrojtja e natyrës së egër (flora dhe fauna vendase)

Qëllimi i mbrojtjes është të sigurojë trashëgimin e pasurisë natyrore tek brezat e ardhshëm dhe të njohë rëndësinë e kësaj faune për speciet e tjera, përfshirë atë njerëzore. Mbrojtja e faunës dhe florës së egër është një praktikë gjithnjë e më e rëndësishme për shkak të efekteve që qëniet njerëzore kanë mbi të. Kjo mbrojtje synon të ndalojë humbjen e biodiversitetit duke marrë në konsideratë principe ekologjike si kapacitet mbajtësi, shqetësimet dhe vazhdimësia (ripërtëritja ciklike) dhe kushte mjedisore si gjeografia, pedologjia dhe hidrologji, duke barazpeshuar nevojat e faunës dhe florës me ato të qenieve njerëzore. Me rëndësi për sa më sipër është ruajtja dhe përmirësimi i habitateve dhe së fundmi ka një tendencë rritjeje të ndërhyrjeve të rikthimit në gjendjen origjinale natyrore. Teknikat për këto praktika mund të përfshijnë ripyllëzim, kontrollin e insekteve, nitrifikim dhe denitrifikim, ujitje, cungim dhe rrethim me gardhShkatërrimi dhe fragmentimi i habitateve, i lidhur me kërcënime të tjera si ndotja e ajrit, dëmtuesit, herbicidet, sëmunjdet, zjarret mund të vlerësohen si faktori kryesor i humbjes së biodiversitetit dhe uljes së numrit të llojeve autoktone.

Në Shqipëri mbrojtja e jetës së egër rregullohet sipas dispozitave të ligjit për ruajtjen e habitateve natyrore të faunës dhe florës së egër. Mbrojtja e llojeve realizohet nëpërmjet dispozitave të veçanta të ligjit të biodiversitetit dhe ligjit për mbrojtjen e faunës së egër. Ligji i biodiversitetit përmban edhe dispozita për llojet invazive dhe masat mbrojtëse për ruajtjen e llojeve. Ligji për mbrojtjen e faunës së egër parashikon mbrojtjen e habitateve



të rëndësishme për shpendët në përgjithësi dhe shpendët migratore në veçanti.

Menaxhimi dhe ruajtja e llojeve të faunës së egër, mund të ofrojë mundësi të shkëlqyera për zhvillimin rural dhe përdorimin e qëndrueshëm të kafshëve të egra, kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në ekonominë lokale dhe kombëtare.

Për të eliminuar dhe më pas për të parandaluar zhdukjen e llojeve dhe shfrytëzimin e tepërt të specieve natyrore me interes ekonomik për shkak të menaxhimit të paqëndrueshëm të burimeve natyrore, inkurajohet përgatitja e planeve të veprimit për ruajtjen e specieve të cilat janë me interes të lartë biologjik.

Plani i veprimit për llojet përfshin një inventarizim të informacionit biologjik, një vlerësim mbi gjendjen e ruajtjes, si dhe objektivat e ruajtjes për speciet indikatorë, si dhe afatet e zbatimit të këtij plani.

Përsa i përket ruajtjes duhen të përfshihet monitorimi i popullatave të gjallesave, eksplorimi i vendeve të përshtatshme, zhvendosja dhe krjimi i kushteve të përshtatshme për riprodhimin e tyre. Konsulta me ekspertë përkatës/ organizata për masat e ruajtjes së llojeve të propozuara duhet të organizohet para zbatimit të zhvendosjes.

Në kuadër të zbatimit të veprimit prioritar për mbrojtjen e jetës së egër, në strategji parashikohen programet/projektet si më poshtë:

- programe mbrojtje për speciet e rrezikuara
- vlerësim i rezervave/burimeve për speciet pyjore dhe përcaktimi i pyjeve për ruajtje in-situ të larmisë gjenetike(studim)
- identifikim/vlerësim i specieve në rrezik(studim)
- monitorim i specieve në rrezik(në nivel ndërkombëtar) në bashkinë Tropojë(studim)
- programe kërkimi mbi folrën dhe faunën
- studim vlerësimi i “birdwatching” për qëllim shkencor dhe turistik
- fushatë eksplorimi për shpellat
- hartëzim dhe krijimi i bazës së të dhënave për habitatet natyrore
- studim mbi habitatet dhe speciet ujore

Shtimi i ekosistemeve prodhuese

Qëllimi për përmirësimin e ekosistemeve prodhuese është i trefishtë:



- të paturit një efekt pozitiv mbi biodiversitetin(që shkon përtej ndalimit të efekteve ose vetëm arritjes së një rezultati neutral)
- të adresojë kompensimin dhe kerkesat e zbutjes në shkallë ekosistemi
- Për të nxitur partneritete inovative dhe bashkëpunuese për të krijimin e aksioneve ruajtëse në të tërë rajonin

Ekosistemet produktive specifike të zonës përbëhen nga pyjet dhe kullotat. Per vetë specifikat produktive dhe të llojit të menaxhimit, veçohen ekosistemi i gështenjës dhe administrimi i pyjeve komunalë/bashkiakë.

Ekosistemi i gështenjës së Tropojës, përmban homogjenitetin gjenetik më të lartë në Europë. Funkzioni kryesor i ekosistemit të gështenjës është prodhimi i frutave dhe i lëndës drusore. Funkcionet dytësore janë prodhimi i gjetheve, luleve, lëvoreve që kanë përdorime të gjera në farmaci, në industrinë e trajtimit të lëkurëve, industrinë kimike të ngjyrimit, në kozmetikë, në bletari dhe për ushqim blegtorie.

Funksione të tjera përfshijnë:

- *Funksioni Hidrologjik:* Bimësia e ekosistemit të gështenjës, mbron tokën nga erozioni, ul shpejtësinë dhe forcën e lëvizjes së ujit në tokë dhe nuk lejon një avullimit të lartë, duke favorizuar një absorbim të drejtpërdrejtë nga bimësia. Pylli i gështenjave gjithashtu përthith zhurmat, kufizon dëmet e shkaktuara nga smogu, si dhe rregullon lëvizjen e ujrave nëntokësore dhe burimeve.
- *Funksioni klimatik:* Masivet e pyjeve të gështenjave ndikojnë në sasinë e reshjeve, ndikojnë zvogëlimin avullimit të tokës, në normalizimin e temperaturave, erërave etj.
- *Funksioni i Mbrojtjes* konsiston në krijimin e brezave mbrojtës pranë qendrave të banuara dhe tokave bujqësore për pengimin e erërave të fuqishme dhe mbrojtja nga dëmet e tyre, reshjet e fuqishme, orteqet, etj.
- *Funksioni estetik dhe i peisazhit:* Druri i gështenjës është konsideruar si një pjesë e pazëvendësueshme e peizazhit, një e mirë publike të çmohen dhe mbrohen edhe për turizëm. Plantacione e krijuara dhe pyjet natyrore paraqesin një interes për vizitorët e pyjeve, pasi ofrojnë larmi të pejsazheve natyrore , si dhe një ajr të paster dhe të pasur me oksigjen.
- *Funksioni biologjik:* Në pemën e gështenjës dhe në tokën rreth saj jetojnë mil-iarda qenie të gjalla, kafshëve të ndryshme , shpend të egëra dhe mikroorganizma me rëndësi për bimët dhe tokën, siç janë insektet, krimbat, brejtësit, etj.

Përsa i përket pyjeve komunalë/bashkiakë, transferimi i pronësisë mbi pyjet e kullo-



tat komunale në Shqipëri drejt komunave/bashkive ndryshoi rregullat dhe fokusin e manaxhimit të tyre. Masat e reja të përcaktuara në legjislacionin e pyjeve ju dhanë më shumë autoritet dhe përgjegjësi Njësite të Qeverisjes Vendore (NJQV). Kontrolli i mëparshëm i centralizuar i shtetit rezultoi në humbjen e përdorimit tradicional prej familjeve lokale, të cilat e kanë patur tradicionalisht në pronësi tokën pyjore. Për më tepër, përgjegjësitë e paqarta dhe/ose të mbivendosura ndaj përdoruesve të pyjeve dhe kullotave çuan në konflikte dhe praktika të paqëndrueshme të menaxhimit të pyjeve nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor dhe NJQV-të.

Në strategji, kjo çështje adresohet duke propozuar programin e ngritjes dhe funksionimit të duhur të agjencisë së menaxhimit të pyjeve bashkiakë.

Në kuadër të zbatimit të veprimit prioritar për forcimin e ekosistemeve produktive, në strategji parashikohen programet/projektet si më poshtë:

- Plani i menaxhimit të kullotave
- Plani i menaxhimit të gështenjës
- Vlerësimi ekonomik i përdorimit të qëndrueshëm të habitatit të gështenjës
- vlerësim dhe masa parandaluese kundër sëmundjeve të gështenjës
- studim realizueshmërie dhe plan aksionesh për zgjerimin e habitatit të gështenjës
- Projekt ripyllëzimi me qëllim mbrojtjen dhe zgjerimin e habitatit të gështenjave në Bujan
- Krijimi i agjencisë bashkiake të menaxhimit të pyjeve
- Rregullimi i aktivitetit të mbledhjes së barnave dhe mbrojtja nga mbi kullotja dhe dëmtimi i ekosistemit

Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i infrastrukturës së sistemit të mbrojtjes nga zjarri

Zjarret konsiderohen si kërcënimi kryesor për vlerat natyrore të zonës dhe shkallën e natyralitetit të saj. Në disa zona ata kanë lënë gjurmët e tyre shkatërruese, duke djegur pyjet dhe rritur dukshëm nivelin e erozionit të shpateve malorë. Një faktor tjetër që ndikon në këtë fenomen është fakti se terreni mbërrihet me vështirësi nga njerëzit, dhe thuhet se është i pambërritshëm për makinat. Gjithashtu burimet njerëzore në zonë janë të kufizuara; dhe në raste të rënies së zjarrit, ndikimin më të madh në shuarjen e tij e ka terreni më shumë se banorët. Ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë negativisht në këtë drejtim.



Për të përballuar këtë kërcënim të vazhdueshëm është e rëndësishme të organizohen sisteme efikase të parandalimit dhe shuarjes së zjarrit në pyje.

Shuarja e zjarreve shpesh kërkon pjesëmarrjen e shumë zjarrfikësve dhe në raste të veçanta popullsia vendase bëhet pjesë shuarjes së zjarreve. Megjithatë është e nevojshme që personeli i zjarrfikësve të jetë i specializuar dhe të ketë njohuri të mira mbi shuarjen e zjarreve, të ketë pajisjet e duhura dhe formimin specifik për përdorimin e tyre, të jetë i organizuar në struktura operative dhe të zhvillojë një strategjitë për shuarjen e zjarreve e cila duhet të jetë e përshtatshme për tipet e territorit. Shuarja e zjarreve në pyje kërkon pajisje të specifike për tipin e zjarrit, fazën e zhvillimit të tij dhe kushtet mjedisore

Strategjia parashikon aktivitetet si më poshtë:

- Përmirësim të shërbimit ekzistues zjarrfikës (vënia në dispozicion e mjeteve të reja, përmirësimi i ndërtesës)
- Pajisje me sisteme të përshtatshme të mbrojtjes nga zjarri dhe formimin specifik
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për kontributin e përbashkët midis komuniteteve dhe shërbimit zjarrfikës.

Rritja e ndërgjegjësimit publik

Në kuadër të zbatimit të Konventës së Diversitetit Biologjik, një ndër masat e ndërmarra dhe që i shërben objektivit të rritjes së sipërfaqes dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura, është edhe informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut, duke përfshirë edhe forcimin e organizatave të shoqërisë civile.

Ruajtja e biodiversitetit varet nga bashkëpunimi i një shumëllojshmërie të gjerë të njerëzve dhe organizatave, veprimet e të cilëve ndikojnë në një farë mënyre në biodiversitet. Këto përfshijnë pronarët e tokës, vizitorët e zonave të mbrojtura, agjencitë qeveritare dhe organizatat jo-qeveritare (OJQ), bizneset dhe industrinë, shkencëtarët dhe grupet me bazë komunitare. Arritja ka të bëjë me bashkëpunimin dhe kultivimin e ndjenjës së përgjegjësisë për mjedisin, kërkon përdorimin strategjik të komunikimit, edukimit, ndërgjegjësimit publik dhe pjesëmarrjen e tij. Komunikimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi publik janë instrumente të rëndësishme për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.

Ndërgjegjësimi i publikut për vlerën ekonomike të ekosistemeve dhe biodiversitetit dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të kësaj vlere ekonomike me kujdestarët e biodiversitetit janë stimujt kryesorë për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij.



Një mënyrë shumë efektive për të ruajtur dhe për të mbrojtur biodiversitetin dhe për të krijuar vetëdije dhe mirëkuptim për biodiversitetin është edukimi në lidhje me biodiversitetin dhe rëndësinë e tij për mbijetesën dhe ekzistencën e njeriut. Arsimi gjithashtu, mund të çojë në ndryshime në modelet e sjelljes, mund të sigurojë aftësitë dhe njohuritë në lidhje me biodiversitetin dhe ruajtjen dhe mund të frymëzojë një ndjenjë të llogaridhënies, përgjegjësisë në administrimin e tokës dhe sistemet e saj biologjike.

Masat për të nxitur ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë e biodiversitetit, luajnë një rol kyç në ruajtjen e biodiversitetit, sepse njerëzit janë zakonisht të rezervuar për të ruajtur diçka që ata nuk e njohin apo nuk ju intereson.

Gama e alternativave për të ndihmuar bërjen e natyrës dhe biodiversitetit pjesë të qytetarëve është i madh, që nga përdorimi i elementeve didaktikë (diagramet, tabelat, fotografitë), me sistemet tradicionale të komunikimit (media publike, ekspozita tematike, tryeza të rrumbullakëta, shtypi lokal, TV dhe programet e radios, etj) deri te përdorimi i teknologjive moderne dhe mediave sociale.

Aktivitetet të organizuara nga institucionet arsimore dhe muzeumet, institucionet kërkimore, agjencitë qeveritare dhe mediat duhet të mbështeten, sepse ata luajnë një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimin të publikut dhe komunikimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit lokal dhe global.

Biodiversiteti është një nga themelet e të dy aspekteve: një mjedis i qëndrueshëm, por edhe një ekonomi e qëndrueshme, pasi aktivitetet e të gjitha kompanive mund të kenë një ndikim në biodiversitet, qoftë në mënyrë direkte apo dhe indirekte. Ndikimi (direkt ose indirekt) mbi biodiversitetin mund të vijë nga sektorë të ndryshëm. Prandaj, të gjithë këto sektorë që kanë një ndikim të konsiderueshëm dhe që duhet të përfshijnë aspektet e biodiversitetit në praktikën e tyre, duhet të jenë grup i synuar për aktivitete ndërgjegjësuese.

Ndërgjegjësimi i publikut dhe edukimi për biodiversitetin duhet të ketë si prioritet ngritjen e vetëdijes publike si dhe përpilimin e një fushate të veçantë ndërgjegjësuese për biodiversitetin, e cila duhet të sjellë ndryshimin e qëndrimeve që lidhen me shumëllojshmërinë biologjike.

Në këtë drejtim, në këtë strategji parashikohet ngritja e Institucionit “Tropoja – oazi i Alpeve”, si dhe realizimi i programeve të ndryshme publike si Dita e Lumit (me aktivitete të përkatese siç janë pastrimi i lumit, ekskursione, etj.)



OIS2 Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura dhe Rrjetit Ekologjik (Natura 2000)

Zonat e Mbrojtura janë sipërfaqe me vlera të veçanta të peizazhit, formacione të rralja biologjike, gjeomorfologjike dhe pasuri të biodiversitetit. Ato kanë vlera natyrore, kulturore, historike, arkeologjike të trashëgimisë rajonale e ndërkombëtare të cilave iu jepet një status i veçantë për mbrojtjen e tyre. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të sistemit ndërkombëtar dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me të.

Sipas legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, për secilën zonë hartohet plani përkatës i menaxhimit, i cili përcakton objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur, mekanizmat e zbatimit dhe kontrollit, aktivitetet e lejuara brenda zones, burimet financiare për menaxhim, etj

Një nga detyrimet bazë të procesit të përafrimit të Shqipërisë me standartet e kërkuara Europiane për mjedisin dhe mbrojtjen e natyrës e biodiversitetit është dhe krijimi i rrjetit të Natura2000.

Në këtë kuadër, në strategji janë identifikuar tre veprime prioritare, të cilat duhen realizuar.

Planet e menaxhimit për Zonat e Mbrojtura

Në territorin e Bashkisë Tropojë gjendet një park kombëtar, një park natyror rajonal dhe një rezervë strikte natyrore:

- Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës i shpallur në vitin 1996, me një sipërfaqe 8,000 ha;
- Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur i shpallur me vendim Nr. 32 datë 13.10.2014 të Këshillit të Qarkut Kukës, me shtrirje 18,544 ha; dhe
- Rezerva Strikte Natyrore e Lumit të Gashit, i shpallur në vitin 1996, që mbulon një sipërfaqe prej 3,000 ha.

Gjithashtu, Drejtoria e Biodiversitetit pranë Ministrisë së Mjedisit ka përgatitur një plan për vënien në zbatim të një Parku të madh Kombëtar në Alpet Shqiptare, i cili do të mbulojë një sipërfaqe masive prej 36,571.6 hektarë dhe do të përfshijë zonat aktuale të Rezervë Strikt Natyror të "Lumit të Gashit, Parqet Kombëtare të "Thethit" dhe "Luginës së Valbonës".

Ky Plan Menaxhimi kërkon të mbulojë shumë faktorë dhe çështje specifike për secilën



zonë të mbrojtur veçmas ndërsa nxit një qasje të integruar që mund të përdoret për të arritur qëllimet e menaxhimit të Parkut të ardhshëm Kombëtar të Alpeve shqiptare. Ai synon të gjejë zgjidhje që shfrytëzojnë optimalisht të gjitha burimet, përmbushin nevojat e komunitetit dhe biznesit dhe mbrojnë, përmirësojnë dhe rrisin perceptimin e cilësive të veçanta të Parqeve të ardhshme Kombëtare të Alpeve shqiptare.

Në këtë kuadër, kjo strategji parashikon si aktivitete kryesore finalizimin e planit të menaxhimit të Parkut të Alpeve dhe integrimin e planeve specifike të menaxhimit për secilën zonë të mbrojtur, në planin e menaxhimit të Parkut të Alpeve. Aktivitet tjetër i parashikuar është dhe plani i menaxhimit të rrjetit ekologjik për zonën e Tropojës.

Zbatimi i "Natura 2000"

Natura2000 është një sistem që ka të bëjë me vendosjen e një rrjeti të zonave me interes për ruajtjen e habitateve dhe specieve (në vendin tone, më thjesht quhen zonat e mbrojtura). Një ndër veprimet që parashikon kjo strategji në këtë drejtim është përfshirja e politikave mjedisore të BE-së në legjislacionin përkatës shqiptar.

Rrjeti Natura2000 në Shqipëri do të jetë mbrojtës dhe garantues i zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri për zonat e mbrojtura. Fillimi i procesit për rrjetin Natura2000 do të kërkojë një përqasje të ndryshme për ruajtjen e habitateve dhe specieve. Kjo do të lidhet edhe me rritjen e numrit të punonjësve dhe kualifikimin e tyre. Do të jetë një prioritet afatgjatë edhe kërkesa për zbatimin e ligjit, kontrollin dhe ndalimin e aktiveve të paligjshme.


Në kuadër të procesit të Natura2000 në Shqipëri, vëmendje e veçantë i kushtohet zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese të zonave të mbrojtura, që do të jetë baza për të ardhmen e Natura2000 në vend.

Mbrojtja e habitatit në Shqipëri kryhet përmes dispozitave të ligjit për zonat e mbrojtura, në bazë të të cilit është vendosur rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura që do të shërbejnë për të identifikuar dhe për të krijuar rrjetin ekologjik NATURA 2000.

Aktiviteti i parashikuar nga kjo strategji në këtë kuadër është hartimi i hartës së detajuar të habitateve ekzistuese sipas Natura 2000 në Bashkinë Tropojë dhe përditësimi periodik i kësaj harte.

Institucionet shtetërore që lidhen me mjedisin kanë detyrimin të përcaktojnë politika të qarta në mbështetje të këtij procesi si edhe të lehtësojnë punën që bëhet nga aktorë të ndryshëm në drejtim të vendosjes së rrjetit Natura2000.





Ristrukturimi dhe forcimi i strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura

Shqipëria tashmë ka identifikuar një rrjet të gjerë e gjithëpërfshirës të zonave të mbrojtura, të shpërndarë në të gjitha rajonet e vendit, ç'ka duhet të ofrojë një bazë solide për krijimin e një rrjeti ekologjik kombëtar. Megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë përsa i përket krijimit të lidhjeve potenciale midis zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ndërmarrjes së masave të përshtatshme për menaxhimin dhe ruajtjen e natyrës.

Në Draft Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur Alpet Shqiptare janë identifikuar objektivat specifike afatgjata për menaxhimin e kësaj zone. Këto objektiva fokusohen në ruajtjen, argëtimin, kërkimin shkencor dhe edukim, dhe në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit në zonën e mbrojtur. Këto janë projektuar për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit unik, dhe për të ruajtur proceset kryesore ekologjike të zonës së mbrojtur, duke lejuar aktivitetet e duhura rekreative. Objektivat promovojnë rritjen e të kuptuarit për zonën e mbrojtur dhe gjithashtu synojnë të krijojnë kujdestarinë e komunitetit. Gjithashtu, ato kontribuojnë në qëndrueshmërinë afatgjatë ekologjike të burimeve të zonës.

Parësore është krijimi dhe forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të administratave për secilën ZM, sipas dispozitave ligjore të ligjit “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar. Është e domosdoshme që të krijohen administrata të dedikuara për menaxhimin e zonave të mbrojtura, të përmirësohen aftësitë për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të përdoren procedura të përshtatshme operative, për të cilat, plani i menaxhimit është hapi më i rëndësishëm.

Analiza SWOT për zonat e mbrojtura në Bashkinë Tropojëka theksuar potencialet të zonës, ka identifikuar çështjet që duhet të përmirësohen ose shmangen në menaxhimin e ardhshëm, ka përcaktuar nga këndvështrimi ekologjik dhe social-ekonomik kërcënimet në zonë si dhe mundësitë e zhvillimit në të ardhmen.

Një ndër problemet dhe mangësitë e evidentuara është fakti që menaxherët e zonave të mbrojtura dhe aktorët e tjerë kryesorë shpesh nuk kanë njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e mjaftueshme dhe mjetet për tu përgjigjur efektivisht sfidave që dalin nga ndryshimet globale. Ngritja e kapaciteteve është elementi kryesor në adresimin e këtyre problemeve dhe ajo është e nevojshme në nivele të ndryshme duke përfshirë agjencitë e menaxhimit të zonave të mbrojtura, menaxherët e zonave të mbrojtura dhe aktorët kryesorë. Aftësitë dhe kompetencat që kërkohen sot janë më të specializuara dhe më të gjera se në të kaluarën duke përfshirë një mori metodash dhe modelesh të reja. Aktiviteti i parashikuar nga kjo strategji në këtë kuadër është:

- Ndërtimi i qendrës së informimit dhe menaxhimit për parkun e Alpeve në Peraj i cili do të shoqërohet nga veprimtaritë e:
- Mbështetje për formin dhe pajisje

(në faqen
paraardhëse)
Harta për
menaxhimin
e zonave të
mbrojtura



- Krijimi i një sistemi inventari
- Prgatitja dhe krijimi i programeve të monitorimit

OIS3 Ndikimi i ndryshimeve klimaterike

Ndryshimet klimatike janë dhe do të jenë arsyet e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri. Ndryshimi i klimës mund të shkaktojë zhdukjen e llojeve të rrezikuara si dhe një ndikim të madh në mjedis. Ndryshimet në modelet e vegjetacionit, humbja e burimeve biologjike, rritja e papritur e llojeve të huaja dhe ndryshimet në burimet e peshkut, janë disa nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballet globi. Përveç kësaj, ndryshimi i klimës e rrit ndikimin e specieve të huaja invazive.

Klima në zonë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë shekullit të kaluar, me temperaturat vazhdimisht në rritje. Kjo e ka bërë zonën mjaft të brishtë ndaj ndryshimeve në ciklin hidrologjik dhe në uljen e lartësisë së mbuluar nga bora, të cilat tashmë janë duke ndodhur. Ndryshimet e klimës globale rrezikojnë ndryshimin në mënyrë drastike të sistemit alpin hidrologjik. Ndryshimet e parashikuara në reshjet e shiut dhe të panoramave të mbulimit me dëborë do të sjellin ndryshime të mëtejshme të regjimeve klimatike tradicionale, duke çuar në më shumë thatësi në verë, më shumë përmbytje dhe rrëshqitje të tokës në dimër, dhe ndryshueshmëri klimatike ndërvjetore më të lartë. Mungesat e parashikuara të ujit dhe ngjarjet më të shpeshta ekstreme, të kombinuara me rritjen e kërkesës për ujë (për shembull, për ujitjen në bujqësi apo për nevoja të fluksit turistik) mund të shoqërohen me ndikime serioze negative tek shërbimet e ekosistemit, të tilla si ato të sigurimit të ujit të pijshëm. Në këtë kuadër, në strategji janë identifikuar dy veprime prioritare, të cilat duhen realizuar.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike mbi biodiversitetin dhe ekosistemet

Ndryshimet klimatike pritet të kenë efektet e tyre në zonë, përmes prezencës së ngjarjeve ekstreme të klimës të tilla si; breshër në sezonin e vegjetacionit, ngrica dhe dëborë jashtë sezonit, furtuna me reshje intensive, temperatura të larta e valë të nxehti etj. Efektet më negative të pritshme janë dëmtimet e kulturave bujqësore nga ngricat e vonshme, dëborat dhe breshëri në periudhën e vegjetacionit, thatësira e tejzgjatuar e verës, gjë që dëmton kulturat bujqësore dhe rrit rrezikun e zjarreve.

Shumë specie bimore malore mund të përballen me zhdukjen e tyre nëse nuk janë në gjendje për t'u përshtatur duke u zhvendosur drejt veriut apo në lartësi më të mëdha. Në të vërtetë, flora dhe fauna duhet të përshtaten me kushtet e ndryshuara klimatike, në mënyrë që të sjellin ndryshimet përkatëse në strukturën e ekosistemit. Specie të reja



mund të shfaqen dhe zhvillohen ndërsa specie të tjera natyrore mund të zhduken

Për të parandaluar, ose kufizuar dëme të rënda për mjedisin, shoqërinë dhe zhvillimin social-ekonomik të zonës, kjo strategji parashikon një sërë aktivitete që lidhen me hartimin e strategjive të përshtatjes për sistemet e prekura. Këto aktivitete përfshijnë:

- Kryerjen e studimeve mbi zgjedhjen dhe menaxhimin e llojeve indikatorë për ndryshimet klimatike
- Vlerësimin e shëndetit dhe vitalitetit të pyjeve
- Përzgjedhjen dhe monitorimin e insekteve pyjore, treguese për ndryshimet klimatike
- Monitorimin afatgjatë të ndryshimeve në ekosistemet pyjore
- Parashikimin e ndryshimeve të ardhshme, në shpërndarjen dhe shumëllojshmërinë e llojeve, të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike
- Mbështetjen për përmirësimin e menaxhimit sistematik të llojeve të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike
- Zhvillimin e varieteteve të reja, të përshtatshme për ndryshimet klimatike.

Ndikimi i ndryshimit klimatik në pasuritë hidrologjike

Territori i bashkisë së Tropojës shtrihet në basenin e Lumit Drin nga i cili përshkohet. Ky basen mbulon një sipërfaqe prej 19000 Km² që shtrihet në territorin e Shqipërisë, Ish republikës Jugosllave të Maqedonisë, Greqisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Regjimi hidrologjik i lumit Drin është fortësisht i ndikuar nga aktivitetet njerëzore. Vetëm në territorin Shqipëtar përgjatë këtij lumi janë ndërtuar tre hidrocentralet më të mëdhenj të territorit shqipëtar. Kërcënimi kryesor i shkaktuar nga hidrocentralet është i lidhur me hapjen e portave shkarkuese gjatë periudhave të rreshjeve të forta, të cilat për shkak të ndryshimeve klimatike janë gjithnjë e më të shpeshta e të paparashikueshme. Kjo e bën nevojën e menaxhimit të vazhdueshëm të lumit dhe bashkëveprimin e aktorëve të interesuar nga ky menaxhim (bashkia Tropojë, Ministria e Energjitikës, Ministria e Mjedisit) ekstremisht të rëndësishme.

Presioni i ujit të shkarkuar nga portat modifikon shtratin e lumit duke spostuar sedimentet dhe shton aktivitetin eroziv.

Krijimi i pritave përgjatë përrrenjve lejon mbajtjen e sedimenteve dhe garanton një rrjedhje më të mirë të lumit dhe minimizon koston e mirëmbajtjes së lumit. Sedimentet e mbajtura mund të përdoren si material për ndërtim. Kjo do të sjellë shmangien e mbi shfrytëzimit të lumit për nxjerrje materiali.



Për të zbutur impaktin e ndryshimeve klimatike mbi pasuritë hidrogeologjike duhet të krijohen sisteme të buta të mbajtjes/grumbullimit të ujërave të shiut. Ky sistem do të ulë shpejtësinë e rrjedhjes së ujit dhe do të krijojë mundësinë e shfrytëzimit të ujit për bujqësinë. Krijimi i hapësirave për ujin dhe sedimentet në zona përmytjesh të kontrolluara është thelbësor në rast reziku përmytjesh. Brezat e rezervuar të lumit mund të shfrytëzohen për këtë funksion dhe të kombinohen me infrastruktura të lehta për kohën e lirë dhe me të mbjella rezultuese ndaj ujit.

Strategjia propozon katër veprime kryesore:

- Krijimi i pritave përgjatë përrenjve
- Sisteme të buta të mbajtjes/grumbullimit të ujërave të shiut

OIS4 Ndërrhyrje rigjeneruese në zonat mjedisore të prekura

Një nga çështjet prioritare lidhur me mbrojtjen e mjedisit në bashkinë e Tropojës është përballja me çënimet që aktiviteti i erozionit, minierave dhe vendet joformale të depozitimit të mbetjeve shkaktojnë në mjedis.

Në këtë kuadër, në strategji janë identifikuar tre veprime prioritare, të cilat duhen realizuar.

Parandalimi i erozionit

Fenomeni i erozionit lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, veçanërisht në pjesën më malore të zonës. Edhe ky përbën një kërcënim për biodiversitetin. Cilësitë e ekosistemeve ujore mund të ndryshohen ndjeshëm kur materialet e shkatëruara nga erozioni shpëlahen nga ujërat, dhe habitatet në përgjithësi mund të ndikohen fizikisht nga erozioni që vjen nga zonat e sipërme. Prerja e paligjshme e drurëve dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpate të larta, shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit që së bashku me erozionin që ndodh natyrshëm, ndikon ndjeshëm tek habitatet. Nëse ndodh kjo, duhen shumë vite që një pyll të rigjenerohet në një mjedis të tillë të ashpër. Erozioni artificial çon në shkatërrimin dhe fragmentimin e habitateve, zhdukjen e specieve, modifikimin e bimëve dhe komuniteteve të kafshëve vendase, dhe së fundi, në ndryshimin e përhershëm të ekosistemit. Duke qenë se prej vitesh nuk janë marrë masa për reduktimin e efekteve të tij, ai kërcënon aktualisht tokat bujqësore, qendrat e banuara dhe infrastrukturën e zonës (kanalet e ujit, rrugët, ujësjellësit etj).

Një sfidë prioritare për territorin e bashkisë së Tropojës është ndalimi i fenomenit të erozionit, territori i bashkisë së Tropojës klasifikohet si territor me nivel të lartë poten-



cial dhe aktual të erozionit. Ky fenomen në vitet e fundit ka patur një trend në rritje. Ndalimi i erozionit është jetësor për këtë territor dhe mund të arrihet nëpërmjet nëpërmjet ndërhyrjeve të mëposhtme:

- Ripyllëzim i zonave “tokave të reja” dhe brezareve të cënuara me kultura auto-ktone të përshtshme për konservimin e tokës Ripyllëzim i të zonave të cënuara përgjatë lumenjve e përrenjëve
- Program për rehabilitimin e zonave të prekura nga rrëshqitjet e dheut nëpërmjet ripyllëzimit dhe strukturave pritëse

Masa parandaluese mjedisore për industrinë minerare

Peizathi natyror i territorit është pasuria kryesore e bashkisë së Tropojës. Për shkat të mungesës së mirë menaxhimit kjo pasuri gjëndet nën një presion shumë të madh kryesisht me shfrytëzimin e burimeve natyrore. Kryesisht në territorin e njësisë administrative Bytyç ka një numër të madh minierash dhe karriera disa prej të cilave të braktisura. Cënimi i mjedisit nga aktiviteti i minierave përfshin erozionin, formimin e “sinkhole”, humbje të biodiversitetit dhe ndotje të tokës, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqeve ujore nga kimikate të proceseve të aktiviteteve të minierave. Përkrah cënimit të mjedisit ndotja nga mbetjet e minierave është një kërcënim serioz për shëndetin e banorëve.

Kjo strategji përballlet përballlet me këtë problem duke bashkërenduar dekontaminimin e këtyre zonave me rehabilitimin peizayhistik të tyre.

Më hollësisht, strategjia parashikon:

- Programe për zhvillimin e metodave të rehabilitimit për zonat e minierave të braktisura dhe për administrimin mjedisor të aktiviteteve minerare
- Rehabilitimin e zonave të minierave të braktisura nëpërmjet ripyllëzimit me kultura të përshtashme për prodhimin e biomasës

Rehabilitimi i ish-zonave të hedhjeve

Një tjetër kategori e cënimeve në mjedis është e lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Zonat e grumbullimit të mbetjeve kanë pasoja serioze si në mjedis ashtu edhe në cilësinë e jetës. Ndotja e këtyre zonave prek si tokën ashtu edhe ujërat. Ujërat e shirave që rrjedhin nëpërmjet këtyre zonave duke u përzierë me substancat që ndodhen aty formojnë një substancë të quajtur “leachate”. Kjo përbën një cënim serioz për ujërat nëntokësore nëse nuk menaxhohet siç duhet. Zonat e grumbullimit të mbetjeve gjithashtu shtojnë rrezikun e përmbetjeve pasi mbetjet e ndryshme mund të bëhen pengesë për rrjedhjen normale të ujërave. Zjarret në këto zona kanë një impakt direkt në mjedis. Prania e një zone të pa



kontrolluar të depozitimit të mbetjeve mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore për banorët në rrethina.

Përpara reformës territoriale ish komunat në territorin e bashkisë Tropojë menaxhonin mbetjet e territorit të komunës. Ky menaxhim bëhej kryesisht duke grumbulluar mbetjet në zona të caktuara. Tashmë këto zona nuk janë më në përdorim dhe nuk është bërë asnjë ndërhyrje rimëkëmbëse në to.

Strategjia parashikon ndërhyrje rehabilituese të cilat duke marrë parasysh burimet e kufizuara ekonomike të bashkisë do të bazohen rimëkëmbje natyrore të këtyre zonave nëpërmjet “phytoremediation” duke krijuar edhe mundësinë e prodhimit të biomasës për qëllime ngrohje.

- Program për zhvillimin e mënyrave për rehabilitimin e ish zonave të depozitimit të mbetjeve
- Projekte për rehabilitimin e ish zonave të grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet phytoremediation



Programet strategjike të O2- Ruajtja e vlerave kulturore

O2S1 Mbrojtja dhe rehabilitimi i monumenteve të kulturës dhe vendbanimeve fshatare

Kjo strategji synon zhvillimin e politikave dhe rregullave të qarta të mbrojtjes për monumentet dhe trashëgiminë kulturore në territorin e bashkisë, përmes rehabilitimit të elementëve më të rëndësishëm që janë pjesë e kësaj trashëgimie. Strategjia përmban gjithashtu veprimtari për ruajtjen e bansave historike rurale dhe fshatrave që gjenden në zona rurale, veçanërisht në pjesët malore në veri. Ky program strategjik do përqëndrohet në tre veprimtari kryesore:

Restaurim i monumenteve historike

Veprimtaritë zhvillohen për mbrojtjen dhe rehabilitimin e ndërtesave historike që gjenden në territor, shpesh në kushte shumë të neglizhuara, dhe për të mbështetur transformimet e tyre në objekte publike dhe kolektive si galeri, biblioteka ose qendra kulturore.

Nxitja e fushatave hetuese arkeologjike

Në territor gjenden zona arkeologjike që nuk kanë qënë subjekt i gërmimeve arkeologjike. Këto zona, prej potencialit të madh që kanë, do të adresohen nga programe specifike vëzhgimi.

Restaurim i vendbanimeve historike

Veprimtaria do të ketë për qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e vendbanimeve historike rurale, veçanërisht ato që nuk janë braktisur ende krejt dhe ato që karakterizohen nga prania e shtëpive historike rurale.

O2S2 Ruajtja dhe pasurimi i trashëgimisë shpirtërore

Në rajonin e Tropojës, trashëgimia kulturore nuk limitohet vetëm në elementët fizikë të gjendur në territor, por është një koncept më i gjerë që përfshin shekuj të tërë të traditave të zonës. Tropoja, si gjithë Shqipëria, ka në fakt një traditë të pasur muzike e vallëzimesi sidomos në folklor. Strategjia synon të promovojë këto dhe aspekte të tjera kulturore në





përpyktjen për të ruajtur traditën e zonës.

Ky program përqëndrohet në dy veprimtari kryesore:

Nxitja (mbështetja) e folklorit (programe për vallen dhe këngët)

Kjo veprimtari promovon ruajtjen dhe shpërndarjen e valleve dhe këngëve tradicionale duke krijuar hapësira shfaqjesh të dedikuara për kostumet dhe instrumentet (si p.sh. lahuta, çiftelia, sharkia dhe daullet) dhe përmes mbështetjes së veprimtarive brenda dhe jashtë vendit.

Festime dhe Përkujtime

Bashkia do të mbështesë gjithashtu dhe përkujtime të ngjarjeve dhe figurave të rëndësishme që kanë karakterizuar historinë e zonës dhe të kombit.

Programet strategjike të O3- Promovimi i turizmit

O3SI Promovimi i territorit

Për të rritur tërheqjen e Bashkisë Tropojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, është thelbësore që të promovohet rajoni dhe pasuritë natyrore në mënyrë strategjike përmes një rrjeti të qartë komunikimi. Promovimi i territorit duhet të bëhet në një mënyrë profesionale dhe të menduar mirë, duke iu drejtuar kryesisht jo vetëm atyre që do të vlerësojnë burimet territoriale të vendit, por dhe ata, prania e të cilëve do të përfaqëson një vlerë të shtuar në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të territorit në drejtimet e hartuara në këtë plan. Për këto arsye, promovimi i territorit duhet të bëhet në një mënyrë të kujdesshme, nëpërmjet veprimeve të shumta. Këto janë:

-Promovimi i territorit në web dhe përmes mediave të tjera

Interneti është sigurisht mjeti më i fuqishëm i komunikimit për arritshmërinë dhe promovimin e territorit. Megjithatë, ky aktivitet promovues duhet të bëhet në mënyrë të koordinuar dhe të organizuar, nën udhëheqjen e bashkisë. Një faqe interneti duhet të paraqesë në mënyrë të qartë për vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë rrugët kryesore turistike, momentet tërheqëse, aktivitetet, informacionet mbi florën dhe faunën, gastronominë dhe produktet tradicionale, por gjithashtu të përmbajnë informacione mbi hotelet dhe bujtinat, duke përfshirë këtu kontaktet dhe përshtypjet e vizitorëve të mëparshëm.

Promovimi i territorit duhet të bëhet edhe duke mbështetur hartimin e një udhëzuesi zyrtar për territorin, që do të printohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe do të shpërndahet

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
monumenteve
te kulturës



në libraritë e specifike. Përveç udhëzuesit, duhet të krijohet një hartë zyrtare e territorit, në përputhje me hartën e alpinistëve që gjenden në shumicën e vendeve malore evropiane.

Paralelisht me këtë punë, territori i Tropojës duhet të jetë i pranishëm në guida specifike dhe në website.

-Promovimi i prodhimeve vendase në tregje brenda dhe jashtë Shqipërisë

Ndërsa pjesëmarrja në panairë kombëtare ose ndërkombëtare do të vendoset nga prodhuesit e vegjël ose nga kooperativa prodhuesish, veprimi synon organizimin e një panairi për bimët mjekësore lokale në Tropojë. Ky lloj organizimi shpejt mund të bëhet një tërheqje rajonale e fuqishme mjaftueshëm të mbështesë ekonominë vendase.

Organizimi i eventeve dhe aktiviteteve ndërkombëtare synon të promovojë pasuritë kulturore dhe natyrore të rajonit.

Ky veprim ka të bëjë me organizimin e eventeve dhe aktiviteteve ndërkombëtare si një mjet që mund të kontribuojë në promovimin e pasurive kulturore dhe natyrore të rajonit. Brenda këtij qëllimi, është e rëndësishme që ngjarje të tilla të jenë në përputhje me synimet e territorit dhe janë të dobishme për të arritur qëllimin e parashikuar për këtë territor. Në këtë drejtim, organizimi i një maratone qielli ndërkombëtare ndërshtetërore / alpine në Luginën e Valbonës shihet si një mjet strategjik për të nxitur turizmin e butë dimëror dhe për të tërhequr flukse të shumta në rajon.

Përfshirja e pikave turistike të informacionit dhe pajisja e rrugëve, shtigjeve e vendeve me interes të veçantë me sinjalizimet përkatëse.

Në një shkallë shumë më të vogël, është e rëndësishme që pikat e informacionit të jenë të pranishme në vende strategjike në territor dhe që shenjat të vendosen në mënyrë që të identifikohen lehtë të gjitha vendet e rëndësishme me interes. Pikat informative parashikohen si struktura të thjeshta, që përmbajnë një hartë të rajonit dhe pak informacione strategjike.

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
strategjisë së
turizmit

O3S2 Përmirësimi i rrugëve turistike dhe arritshmërisë në vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë

Ndërkohë arritshmëria në rajonin e Tropojës diskutohet kryesisht në aspektin e infrastrukturës së rrugëve dhe lëvizshmërisë publike, është me rëndësi thelbësore përmirësimi i rrugëve turistike dhe aksesit (i këmbësorëve) për në pasuritë natyrore dhe kulturore të pranishme në territorin e rajonit. Ky objektivi strategjik ka të bëjë me përmirësimin e shtigjeve të këmbësorëve dhe rrugëve malore - duke rritur dukshmërinë, sigurinë dhe



pajisjen e këtyre rrugëve me shërbime shumë të thjeshta dhe themelore, të cilat do t'i bënin ato lehtësisht të përdorshme nga vizitorët, udhëtarët dhe komuniteti vendas.

-Pajisja e hyrjeve të parqeve me struktura shërbimi

Kjo veprimtari ka të bëjë me pajisjen e hyrjeve në parqet natyrore me struktura të vogla shërbimi që përfshijnë pika informacioni, tualete, kiska, etj.

-Zbatimi i zonave të pajisura përgjatë shtigjeve dhe zonave të monumenteve natyrore e historike

Kjo veprimtari ka të bëjë me pajisjen e plotë të zonave përgjatë shtigjeve të ecjes dhe në afërsi të zonave të monumenteve historike. Këtu i referohemi pikave të informacionit, tualeteve, vendeve të pushimit, kioskave, zonave të mbrojtura, etj.

-Rehabilitimi i shtigjeve kryesore historike/ të ecjes

Rajoni I tropojës është I pasur me shtigje të ecjes dhe shtigje historike. Këto, dalëngadalë janë braktisur dhe nuk janë mirëmbajtur, duke rezultuar në shtigje që në shumë raste nuk duken ose nuk kuptohen më. Duke parë potencialin e rajonit për t'u bërë një destinacion për alpinizëm dhe ecje në natyrë, është thelbësore të nisë një fushatë për rehabilitimin me synim përmirësimin e kushteve dhe dukshmërisë së shtigjeve historike të ecjes.

-Pajisja e shtigjeve më zona shërbimi dhe infrastrukturë të vogël

Duke plotësuar më tej rehabilitimin e shtigjeve historike, ky veprim katë bëjë me pajisjen e shtigjeve të përzgjedhur me zona shërbimi dhe infrastrukturë të vogël si stola, burime, pika vrojtimi dhe strehë për raste urgjence.

-Hartëzimi I gjithë shtigjeve dhe itinerareve kryesore turistike

Hartëzimi I gjithë shtigjeve dhe itinerareve kryesore turistike është mjaft I rëndësishëm dhe duhet si bazë për krijimin e një harte të re për territorin. Ky veprim do të mbështetet mbi nismat e shumta që janë ndërmarrë deri tani në këtë drejtim dhe, me ndihmën e popullsisë vendase, do të krijojë një hartë të përditësuar dhe të kuptueshme për gjithë shtigjet e pranishme në rajon.

O3S3 Zhvillimi i strukturave turistike

Ky objektivi strategjik ka të bëjë me zhvillimin e strukturave turistike si për akomodimin dhe për pushimin. Objektivi arrihet përmes zbatimit të tre veprimeve të ndryshme:



-Diversifikimi I tipologjisë së akomodimit për turistë, bazuar në tendencat e ndryshme të territorit

Aktualisht, oferta e akomodimit në bashkinë e Tropojës është e kufizuar në strehë dhe bujtina në zonat malore, dhe disa hotele në Bajram Curri. Ky veprim përmban projekte që synojnë diversifikimin e tipologjisë së strehimit turistik, sipas tendencave të ndryshme të territorit. Ndërsa në Bajram Curri duhet të zhvillohet një sektor i ri hotelierie, llojet e tjera të akomodimit duhet të sigurohen në pjesë të ndryshme të territorit siç është zona e kampingut në Curraj të Epërm ose në zona të mbrojtura, ndërsa strukturat e vjetra ushtarake si ajo në Lekbibaj mund të kthehen në një stacion të madh turistik (pika informacioni, akomodim, shërmime, rekreacion, etj.

-Ripërdorimi i ndërtesave tradicionale për akomodim turistik

Në përputhje me veprimin e sipërpërmendur, ndërtesat tradicionale, veçanërisht ato si stanet apo shtëpitë historike duhet të konvertohen në struktura për strehim turistik. Ky veprim përmban disa projekte pilot për rehabilitimin e strukturave të vjetra që do të shërbenin gjithashtu si rregullore për këtë proces të rehabilitimit.

-Përmirësimi i ofertës turistike

Ndërsa peizazhi natyror, shtigjet, lumenjtë dhe luginat në vetvete ofrojnë tërheqjen më të madhe në rajon, oferta turistike duhet të zgjerohet më tej duke dhënë mundësinë e shërbimeve për parashutizëm, ski në natyrë në zonën e Valbonës, lundrim, rafting dhe çiklizëm.

O3S4 Përmirësimi i shërbimeve turistike

Ndërkohë që infrastruktura e turizmit duhet të zbatohet në vazhdim, është po ashtu e rëndësishme të përmirësohen shërbimet turistike dhe kapaciteti vendas në këtë sektor të ri ekonomik. Operatorët privatë duhet të trajnohen në mënyrë profesionale. Qëllimi strategjik do të arrihet nga:

-Promovimi i formimit të operatorëve privatë

Ky veprim ka të bëjë me zbatimin e programit që synon zbatimin e agroturizmit dhe aktivitetit pritës në shtëpitë rurale dhe në organizmin e trajnimit lidhur me aktivitetet ekzistuese të hotelierisë që prekin tema si gjuha Angleze, menaxhimi, etj.

-Krijimi i shkollave dhe qendrave për trajnimin për turizëm

Ky veprim lidhet me zbatimin e shkollave profesionale të turizmit në Bajram Curri.



Programet strategjike të O4- Fuqizimi i bujqësisë dhe blegtorisë

O4S1 Përmirësimi i mjedisit bujqësor

Ky program strategjik i referohet drejtpërdrejt Masës 7 dhe 9 të SNZHRB-së.

Përmirësimi i mjedisit bujqësor është hapi i parë themelor për ta bërë bujqësinë ekonominë e parë të Tropojës. Njëzetë e pesë vite dinamikash të forta shpopulluese, së bashku me mungesën e mirëmbajtjes dhe investimeve, kanë çuar drejt përkeqësimit të shpejtë të infrastrukturave bujqësore. Sot, 41% e tokës bujqësore është plotësisht e papërdorur. Ndërhyrja në këtë drejtim do të mbështes rimëkëmbjen, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve që varen nga bujqësia dhe pylltaria, duke i trajtuar ato si sfida të ndryshimit klimatik. Më në veçanti, përmirësimi i rezervave pyjore nëpërmjet pyllëzimit të tokës do të jetë një masë për të kundërshtuar erozionin, humbjen e pyjeve të dëmtuara nga zjarri, mbrojtjen e burimeve ujore dhe përmirësimin e biodiversitetit.

Ne kemi evidentuar katër ndërhyrje prioritare:

Shtimi i tokës bujqësore dhe bagëtive

Kjo politikë do të zgjeroj tokën e punueshme, duke favorizuar rehabilitimin dhe zgjerimin e plantacioneve të pemëve frutore tradicionale (kumbulla, arra, gështenja) dhe bimëve aromatike dhe mjekësore. Ndërhyrja do të drejtoj edhe mbështetjen për shtimin e numrit të bagëtive (veçanërisht dhive), për të rikthyer biodiversitetin dhe për të ndihmuar prodhuesit e vegjël, të cilët nuk kanë fuqi ekonomike, për të përkrahur dhe zgjeruar veprimtarinë e tyre.

Rehabilitimi i sistemit të vaditjes dhe kullimit

Në Tropojë, vetëm 50% e tokës së punueshme mbështetet nga një sistem vaditjeje dhe pothuajse gjysma e tij nuk është funksional për shkak të gjendjes së përgjithshme të braktisjes së rezervuareve, kanaleve të vaditjes dhe pajisjeve rregullatore të lidhura me to, kanaleve të kullimit dhe pompave. Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit është themelor për të siguruar burimet e vaditjes, kullim të mirë dhe zgjerim të tokës bujqësore. Rehabilitimi i përgjithshëm i sistemit të vaditjes është çelësi për të kundërvepruar ndaj nevojave të paplotësuara për ujë për vaditje, të cilat pritet të rriten, për shkak të rritjes së temperaturave dhe pakësimit të reshjeve sipas parashikimeve (Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë në KKKBNK/Konvetën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, 2016).

Gjithashtu, do të jepet mbështetje edhe për modernizimin e sistemeve të vaditjes nëpërmjet teknikave më efektive. Fermerët do të përkahen të blejnë pajisje për vaditje



me spërkatje, duke evituar vaditjen tradicionale dhe më pak efikase me vërshim uji. Me teknika më efikase pakësohen humbjet e ujit dhe përmirësohet funksionimi i rrjetit të vaditjes.

Promovimi i ripërdorimit të tarracave

Promovimi i ripërdorimit të tarracave kodrinore lidhet me stimulimin e kultivimit të kulturave me cilësi të lartë si vreshtat dhe pemët frutore në njësi toke me madhësi mesatare minimale 10 ha. Kjo ka përfitimin e dyfishtë të themelimit të një ekonomie me vlerë dhe produktive ndërkohë që mbron tokën nga erozioni, rikthen dhe e bën prodhuese një pjesë të madhe të tokës në territor. Si kooperative ashtu edhe privatët janë të inkurajuar për të marrë pjesë në këtë ndërhyrje. Për sipërfaqe minimale të kërkuar prej 10 ha, ferma që merret me bujqësinë në tarraca (qoftë private apo kooperativë) lejohet të ngrejë objekte për strehimin e makinerive dhe pajisjeve shtesë, nëse janë të përfshira. Çdo strukturë e re mund të ndërtohet vetëm në përputhje me rregullat përkatëse të ndërtimit, treguesit dhe parimet ndërtimore për tarracat dhe që sigurojnë një karakter të përkohshëm të ndërtesave dhe sipërfaqeve të mbuluara.

Implementimi i akuakulturës

Ndërhyrja parashikon promovimin e peshkimit dhe fermave të peshkut, nëpërmjet programeve të ripopullimit të lumenjve apo të fermave në rezervuare, pellgje apo sipërfaqe të tjera ujore artificiale. Ndërhyrja gjithashtu merr në konsideratë krijimin e një kooperative të fermerëve të peshkut. Akuakultura organike është një sektor në zhvillim, me kërkesë në rritje, që ndihmon rikthimin e kapitalit natyror, njëkohësisht duke rritur të ardhurat e prodhuesve.

04S2 Mbështetja e fermave organike

Ky program strategjik i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Masës 6 të SNZHRB-së (Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor) dhe Ligjit Nr.9199, datë 26.2.2004.

Territori i Tropojës, kryesisht kodrinor dhe malor, i karakterizuar nga terreni i pjerrët dhe sipërfaqe horizontale, i ekspozuar ndaj erozionit dhe mungesës së infrastrukturës, nëse nga njëra anë ka qenë pengues për zhvillimin intensiv dhe të mekanizuar të prodhimit bujqësor, sot është kthyer, për të njëjtat arsye, mjedisi i përkryer për të zhvilluar prodhime bujqësore organike. Objektivi i kësaj strategjie është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore nëpërmjet implementimit të metodave të prodhimit bujqësor që janë në përputhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit,



peizazhit, pasurive natyrore, tokës dhe shumëllojshmërisë gjenetike. Fermat organike kanë treguar se janë një treg dinamik dhe në zhvillim, duke rritur nivelin e cilësisë së mjedisit dhe duke i shtuar vlerë prodhimit përfundimtar. Ky program strategjik do të përqendrohet në dy veprime kryesore:

Mbështetja e përdorimit të metodave të krijimit të fermave organike

Fermerëve apo grupeve të fermerëve, të cilët vullnetarisht janë duke u përpjekur të rikthehen në praktikat dhe metodat malore të bazuara në krijimin e fermave organike si përcaktohet nga ligji kombëtar, do t'u mundësohen skema themeluese që sigurojnë mbështetje për përdorimin e metodave të prodhimit organik. Pagesat do të kryhen me bazë vjetore dhe përfituesit do të kompensohen plotësisht apo pjesërisht për kostot shtesë dhe humbjen e të ardhurave për shkak të angazhimit për këtë qëllim. Ky veprim do të promovojë certifikimin në grup, në mënyrë që të pakësojë shpenzimet e certifikimit organik të fermerëve.

Implementimi i metodave të krijimit të fermave organike

Përgatitja dhe ngritja e një projekti pilot për mjedisin bujqësor, i cili përqendrohet në një numër të kufizuar zonash pilot me probleme të veçanta për mjedisin, në mënyrë që të fitohet eksperiencë për implementimin e masave të bujqësisë në mjedisin BE-së. Mbështetja e planeve për kulturave veçanta dhe bagëtitë; veprimet parashikojnë një vlerësim të kulturave bujqësore dhe bagëtitë më të rëndësishme në rajon dhe praktikave më të mira të fermave organike që mund të ngrihen për të përmirësuar prodhimin dhe për të maksimizuar të ardhurat e fermës.

04S3 Mbështetja e prodhuesve të vegjël dhe fermave

Ky program strategjik i referohet drejtpërdrejt Masave 1,10,12 dhe 13 të SNZHRB-së. Objektivi i këtij programi strategjik është të përmirësojë pamjen e përgjithshme të pronave bujqësore për prodhimin parësor të prodhimeve bujqësore, duke ndihmuar fermerët të adoptojnë standardet e BE-së në sigurinë e ushqimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve, duke përfshirë edhe ato që lidhen me fermat organike. Strategjia do të promovojë gjithashtu programe për të përmirësuar performancën e përgjithshme të fermerëve, duke asistuar implementimin dhe duke monitoruar programet e IPARD II dhe zhvillimin e mëtejshëm të masave të programit. Pronat e vogla janë shumë më tepër intensive në punë se sa në kapital, kështu që duke i mbështetur ato dhe zinxhirin e furnizimit të ushqimit mund të rrisim ndjeshëm nivelin e punësimit, duke rritur nivelin e veprimtarisë ekonomike dhe duke ruajtur ekzistuesen. Strategjia synon të zhvillojë edhe shumëfunktionalitetin e fermave, në kuptimin e diversifikimit të burimeve të të

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
strategjisë për
bujqësinë



ardhurave. Përveç fondeve direkte, do të paraqiten skema lehtësuese dhe përfituese për të mbështetur prodhuesit e vegjël.

Ky program strategjik do të përqendrohet në tri veprime kryesore:

Shtimi i llojshmërisë së prodhimit të përgjithshëm blegtoral/bujqësor(Masa 10)

Në këtë drejtim mund të ndiqen programe të ndryshëm, së pari përfshirja e prodhimit shtesë apo alternativ të barërave mjekësore ose erëzave, bimëve zbukuruese, kërpudhave, kërmijëve, bletarisë, akuakulturës ose prodhimit bujqësor të produkteve të veçanta për biokarbutet, etj.

Mbështetja e fermerëve vendas (taksë) (Propozimi ynë)

Konsiston në uljen e taksës minimale për të gjitha pronat e fermerëve që aktualisht kultivojnë 90% të tokës së tyre bujqësore. Veprimi përfshin lehtësimin e taksave të rritura për fermerët e pajisur me ndërtime bujqësore për makineri të vogla përpunimi. Veprimi parashikon edhe leje ndërtimi për ata fermerë (privat apo kooperativa) që kanë në plan të ngrejë shërbime bujqësore për përpunimin e prodhimeve që janë të aksesueshme edhe nga fermerët e tjerë për një periudhë minimale prej 10 vitesh. Shërbimet e sipërpërmendura bujqësore mund të ndërtohen vetëm në zona të identifikuar si të përshtatshme (për shkak të lidhjes së afërt me rrjetin rrugor apo duke siguruar një shpërndarje të ekuilibruar të ndërtimeve bujqësore në territor, dhe jo në kontrast me praninë e kooperativave publike-private) dhe në përputhje me rregullat përkatëse të ndërtimit, treguesit dhe parimet e ndërtimit të identifikuar për shërbimet kolektive bujqësore.

Investim në strukturat fizike të fermave (Masa 1)

Investimet do të drejtohen drejt fermës (si përcaktohet nga legjislacioni kombëtar dhe të cilat janë të përfshira në regjistrin kombëtar të fermave apo dokumentave të tjera që lidhen me të) për ndërtimin dhe përmirësimin e pajisjeve të fermës, blerjen e makinerive të reja si koleksion dhe shërbime frigoriferike për qumshtin, shërbime të transformimit dhe paketimit, shërbimet e kompostimit, duke përfshirë edhe programet kompjuterike. Kjo strategji për zhvillimin dhe shtimin e investimit në modernizimin e makinerive rurale do të mbështesë edhe shpërndarjen e teknologjisë me emetim të ulët të karbonit dhe makineri me bazë energjie të rinovueshme. Ndërhyrje tjetër do të jetë programi për implementimin e serrave, mbështetje për prodhimin e kribave, kompostimin e plehut të kafshëve dhe mbetjeve vegjetale. Duke mbështetur fermerët (veçanërisht ata që merren me blegtori) me infrastruktura në shkallë të vogël për kompostim mund të plotësohet kërkesa e fermerëve për këta fertilizues organik. Në veçanti, ndërhyrja do të favorizoj sektorët e konsideruar si zona prioritare për zhvillimin e prodhimeve cilësore për tregjet vendas dhe të eksportit, si fruta dhe perime, bimë aromatike dhe mjekësore,



fruta të thata, sektorët mishit dhe bulmetit, me preferencë për prodhimet e dhive, mjalt.

Asistencë teknike dhe përmirësim i shërbimeve këshilluese (Masa 12 dhe 13)

Forcimi i shërbimeve këshilluese për fermerët dhe pronarët e pyjeve, duke ndihmuar kështu përmirësimin e performancës së përgjithshme të fermerëve dhe bizneseve rurale. Do të mundësohet këshillimi në çdo aspekt të menaxhimit të biznesit, krijimit të formave organike dhe metodave të tjera të qëndrueshme, teknikave të kompozimit, menaxhimit të tokës, cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve, standardeve të BE-së për mbrojtjen e ushqimit, etj. Zhvillimi i asistencës teknike duhet të jetë në qendër të këtyre veprimeve, për të mbështetur fermerët dhe për të ndërtuar kapital social dhe rrjete nëpërmjet pjesëmarrjes në workshope. Në mënyrë që kjo të garantohet në nivele maksimale, duhet të jenë të detyrueshme pjesëmarrjet e fermerëve në workshope dhe trajnime për të hyrë në programet e mbështetjes. Përfitues të tjerë do të jenë institucionet që sigurojnë këshilla për fermerët dhe bizneset e vogla apo mikrobizneset, si shërbimet e këshillimit publik, organizimi i industrisë apo asistencë për implementimin dhe monitorimin e programeve të IPARD II.

Nxitja e realizimit të qendrave për përpunimin e ushqimit

Promovimi i krijimit të qendrave për përpunimin e ushqimit.

04S4 Promovimi i bashkëpunimit

Ky program strategjik i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Masave 2 dhe 5 të SN-ZHRB-së dhe Ligjit Nr.38/2012 për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.

Objektivi i këtij programi strategjik është të rrisë integrimin e vlerave në zinxhirin e furnizimit dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis aktorëve individualë, përfshirë bashkëpunimin horizontal. Një tjetër objektivi i rëndësishëm do të jetë zhvillimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së sektorit agro-ushqim, duke inkurajuar krijimin e grupeve të prodhuesve dhe shoqatave të kooperativave bujqësore, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë dhe prodhimin duke planifikuar e përpunuar, tregtimin e sasive të mëdha dhe përmirësimin e aftësive negociuese. Themelet për zhvillimin e praktikave të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit midis aktorëve privatë do të jenë në mbështetje të sektorit publik. Ky program strategjik do të përqendrohet në tri veprime kryesore:

Shtimi i bashkëpunimit midis fermerëve dhe operatorëve të vegjël (Masa 5)

Investimet janë parashikuar për zhvillimin e prodhimeve, praktikave, proceseve dhe te-



knologjive të reja në bujqësi dhe industrinë ushqimore, për bashkëpunimin midis operatorëve të vegjël duke organizuar procese punetë përbashkët apo duke ndarë përdorimin e shërbimeve dhe rezervave. Do të promovohet bashkëpunimi horizontal dhe vertikal midis palëve të interesuara në zinxhirin e furnizimit, për krijimin e platformave logjistike për të promovuar zinxhirë të shkurtër furnizimi dhe tregjet vendase. Zhvillimi i sistemit të ushqimeve vendase dhe zinxhirëve të shkurtër të furnizimit janë konceptuar si tregues cilësie (ushqime slow, etj.) për t'u ofruar turistëve cilësinë më të mirë të ushqimeve vendase dhe për të promovuar konkurrencën vendase (vaktet më të mira, prodhimet më të mira, restorantet më të mira, etj.) si një mënyrë për të përmirësuar njohjen (dijen) dhe ofertën e pronarëve të restoranteve vendase. Veprimtari të tjera të implementuara në këtë ndërhyrje do të lidhen me studime të fizibilitetit, planet e biznesit dhe strategjitë e zhvillimit lokal.

Mbështetje për themelimin e grupeve të prodhuesve(Masa 2)

Do të sigurohet asistencë për të lehtësuar krijimin dhe veprimin e grupeve të prodhuesve në sektorin bujqësor për të përshtatur prodhimin me kërkesat e përshkruara nga ligji, për të promovuar njësitë e tregtimit të prodhimeve, përfshirë përgatitjen për shitje, përqendrimin e shitjeve dhe furnizimin e blerësve me shumicë; përshtatjen e prodhuesve me standardet përkatëse të BE-së;vendosjen e rregullave të përbashkëta për informacionin e prodhimit, me vëmendje të veçantë në grumbullimin dhe vlefshmërinë e produktit; sigurimine standardizimit efektiv në të gjitha fazat e tregtimit dhe shpërndarjes së produkteve në zinxhirin ushqimor. Përqendrimi i vlerësimit në kooperativat e inovacionit dhe kërkimit të diversifikimit të produkteve, duke zhvilluar produkte jo tradicionale (kozmetike, mjekësore, etj.). Ndërtimi i rrjeteve të fermave në mënyrë që të zhvillohen strategji të certifikimit kolektiv, së bashku me organet e certifikimit mund të pakësojnë shpenzimet e certifikimit. Kooperativat që blejnë produkte organike dhe që rrisin vetë produkte organike për tregun rajonal apo ndërkombëtar mund të jenë një mënyrë e mirë për të mbështetur fermat organike në rajon.

Promovimi i bashkëpunimit publik-privat

Ky veprim do të promovoj bashkëpunimin midis subjekteve private nga një pjesëmarrje aktive e publikut. Eksperiencia e fundit në Tropojë ka treguar dobësinë (financiare dhe menaxheriale) të investorëve privatë në krijimin dhe vënien në funksion të veprimtarive të mëdha private në fushën e bujqësisë. Është e dukshme që sektorët privatë nuk mund të jenë zhvillues të qëndrueshëm pa mbështetjen konkrete nga sektorët publikë. Sektorët publikë duhet të ndërhyjnë si garantues, duke asistuar dhe mbështetur nismat private në këtë periudhë tranzitore, nga një model i centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë. Bashkia mund të ndërhyjë nëpërmjet strategjive të ndryshme, duke mbuluar prodhime apo veprimtari të veçanta. Ky veprim do të prezantoj modele të ndryshme të



bashkëveprimit publik:

- *Koncesioni (lëshimi) i tokës publike.* Bashkia mund t'u japë kooperativave bujqësore private menaxhimin e tokës bujqësore publike me koncesion. Toka do u caktohet me një çmim simbolik prej 1 euro për një periudhë prej nëntë vitesh, e rinovueshme, menaxhimi i një parcele toke publike dhe do të marrë një ndihmë financiare prej 10,000 euro për ngritjen dhe fillimin e kompanisë. Ky model, nga njëra anë do të mbështes formimin e kooperativave dhe nga ana tjetër do të shndërroj toka publike të papërdorura në toka prodhuese. (Modeli Italian)
- *Promovimi i formimit të kooperativave socialiste.* Këto kooperativa janë shoqata të finalizuara në formimin dhe integrimin në tregun e punës të punëtorëve të disavantazuar (të rinj të papunësuar, grupet minoritare, etj.). Një kooperativë sociale, si e tillë jo si një sipërmarrje për përfitim, organizon rezervat e veta për të ndjekur qëllime sociale dhe për të përmbushur nevojat kolektive. Këto kooperativa mund të sigurojnë shërbime për prodhuesit e vegjël dhe fermerët e pavarur, duke mundësuar punë të mekanizuar dhe forma të tjera asistence (krasitje, vjelje e frutave, etj.). Bashkia mund të promovojë ose të veprojë drejtpërdrejt në formimin e këtyre kooperativave. Për më tepër, mund të nënkontrakttojë këto shërbime të kooperativave, si mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes apo pastrimin e pyjeve dhe lumenjve (ky model mund të aplikohet edhe në sektorë të tjerë ekonomikë).
- *Ngritja e kooperativave ndihmëse.* Një kooperativë ndihmëse është një kompani në të cilën një pjesë e kapitalit është nën zotërimin e një organi publik. Investitorët privat mund të marrin pjesë në kooperativën bujqësore duke mundësuar tokën bujqësore, ose strukturat fizike të nevojshme për funksionimin e kooperativës (ato mund të jenë edhe në tokë publike). Me themelimin e këtij tipi kooperative, bashkia mund të mbështesë grupet private të fermerëve, të përmirësojë standardin e cilësisë së ushqimeve duke kontrolluar produktet brenda zinxhirit të përpunimit të prodhimit, në përputhje me standardet e BE-së për prodhimin. Ky model mund të aplikohet edhe aty ku ka grupe pronarësh tokash të cilët nuk i kanë legalizuar ende pronat e tyre dhe që japin me qira apo lejojnë njerëz të tjerë të punojnë në këto toka. Duke themeluar një kooperativë, bashkia mund të mbështesë këta punëtorë për të punuar dhe mirëmbajtur këto toka, mund të kontrollojë prodhimin përfundimtar, të certifikojë prodhimet që në burim, mund të mbështesë përpunimin dhe tregtimin. Shembuj të kooperativave ndihmëse janë: qendra e dehidratimit të frutave, thertoret, grumbulluesit e gështenjave, bulmetoret, kooperativat e frutave, kooperativat e fermave, vreshtat dhe paketimi i produkteve përfundimtare.
- *Realizimi i qendrave për mbështetjen e bujqësisë.* Bashkëpunimi nuk mund të marrë gjithmonë formën e një kompanie të strukturuar. Si ka ndodhur shpesh në shumë fshatra, prodhuesit lokalë janë shumë të vegjël për të arritur prodhim për tregun vendas, ose shumë të përhapur për të ndarë veprimtaritë gjatë procesit të prodhimit, duke i



orientuar fermat e tyre kryesisht drejt të qenit vet-qëndrueshme (self-sustainable). Edhe pse shtigjet turistike, shpesh, i ndihmojnë disa prej këtyre prodhuesve të vegjël të krijojnë të ardhura shtesë nga prodhimi i tyre, kjo bëhet e pamundur për ata që janë larg nga këto shtigje. Qendrat për mbështetje të bujqësisë janë struktura që do të ndihmojnë organizimin dhe promovimin e prodhimit në zonat rurale. Vendosur në pozicion strategjik, kjo strukturë do të përmbushë funksione të ndryshme bazuar në madhësinë dhe veprimtaritë e pranishme në zonat e propozuara, duke kaluar nga funksione shumë të vogla si hapësira për formim profesional, në funksione më të mëdha. Funksionet e pritura janë (jo ekskluzivisht): qendër informacioni për prodhuesit e vegjël, qendra të formimit profesional, qendër veterinarë, pikë shitje, pro loco (shoqata vendase për promovimin dhe zhvillimin e territorit) dhe magazina. Këto struktura mund të kombinohen dhe integrohen me kooperativa sociale dhe ndihmëse.

- Vendndodhje të mundshme për këto qendra janë Tropoja, Vividoli, Shumica, Babina, Bucaj, Myhejani, Kernaja-Shkëlzeni, Gegaj, Kocanaj-Margegaj, Dragobi, Lekurtaj, Markaj, Dojan-Bllata, Gria-Bujan, Jah Salihi, Llugaj, Lluza, Vlad, Pac, Zogaj, Berisha, Dega, T'plan, Dushaj, Salca, Gjonpapaj, Curraj-Shëngjergji, Valbona dhe Bajram Curri.

04S5 Promovimi i tregimit të prodhimeve ushqimore vendase

Ky program strategjik i referohet drejtpërdrejt Masës 10 të SNZHRB-së.

Objektivi i kësaj strategjie është të mbështesë zhvillimin rural duke promovuar shitjen e prodhimeve vendase. Nëpërmjet ngritjes së tregjeve dhe veprimtarive plotësuese të fermave, strategjia synon të krijojë mundësi të reja punësimi dhe të ruaj vendet ekzistuese të punës në sektorin bujqësor. Ajo parashikon zhvillimin e veprimtarive të reja të biznesit, duke rritur kështu nivelin e veprimtarive ekonomike dhe të përmbysë tendencën aktuale të shpopullimit në zonat rurale. Gjithashtu, të gjithë fermerët, prodhuesit dhe palët e interesuara të përfshira në zinxhirin e furnizimit të ushqimit, duhet të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në procesin e vendim-marrjes në zinxhirin e furnizimit të ushqimit. Është shumë i rëndësishëm zhvillimi i veprimtarive ndërmjetëse, si transformimi dhe shpërndarja, por fermerët duhet të kenë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit të ushqimit në mënyrë që të bëhet një ndarje e drejtë e vlerës së shtuar të prodhimit përfundimtar. Kjo është e rëndësishme për të evituar nivele të larta të përqendrimit që mund të dëmtojnë interesat e fermerëve.

Ky program strategjik do të përqendrohet në dy veprime kryesore:

Zgjerimi i veprimtarive ekonomike të fermerëve (Masa 10)



Promovimi i fillimit të veprimtarive të tjera ekonomike që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë bujqësore, si përpunimi dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në hyrje të fermave, agroturizmi, ferma dhe veprimtaritë e lidhura me to (kalërimi, peshkimi, gjuetia), ashtu si edhe prodhimi i energjisë së rikthyeshme, etj.

Krijimi i tregjeve lokale

Rajoni i Tropojës nuk ka një qendër për shpërndarjen e prodhimeve vendase dhe shumica e prodhimeve i drejtohen tregut të Gjakovës. Kjo tendencë duhet ndryshuar, duke parashikuar krijimin e një tregu të fortë rajonal, në mënyrë që të rriten të ardhurat nga prodhimet vendase dhe të evitohet zhvlerësimi i mëtejshëm i tyre. Në këtë kontekst, vendosja e certifikimit rajonal do të luaj një rol kyç. Qendrat kryesore rurale dhe urbane do të jenë pikat kryesore të shpërndarjes, Bajram Curri do të jetë tregu kryesor për prodhimet e rajonit të alpeve dhe do të jetë pikë referimi për tregun e eksportit. Qendrat kryesore të Tropojës, Llugajt dhe Bytyçit do të kenë tregjet e tyre lokale për të përforsuar dhe promovuar prodhimin e tyre. Këto njësi lokale, në fakt, përveç se kanë fatin të kenëtokat bujqësore të rajonit, janë të vendosura në pozicione strategjike, në kufij me Kosovën dhe përgjatë aksit kryesor për në Kukës. Përmirësimet në transportin rrugor dhe rritja e sektorit të turizmit përfaqësojnë mundësi të mëdha për të krijuar pika të shpërndarjes në vend. Pika të vogla shpërndarjeje, veçanërisht për konsumin vendas, do të realizohen në Fierzë, Bujan dhe Valbonë.

04S6 Sigurimi i certifikimit të prodhimeve vendase

Ky program strategjik i referohet drejtpërdrejt Masës 4 të SNZHRB-së.

Objekti i kësaj strategjie është të zhvillojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e industrisë agro-ushqimore nëpërmjet integritit të skemave cilësore në zinxhirin ushqimor dhe skemave të certifikimit rajonal për të promovuar kështu prodhimin vendas.

Ky program strategjik do të përqendrohet në dy veprime kryesore:

Promovimi i skemave të cilësisë për prodhimet bujqësore dhe ushqimet (Masa 4)

Struktura aktuale e sektorit bujqësor të fermave të vogla dhe të fragmentarizuara e pengon arritjen e konkurrencës nëpërmjet prodhimit në sasi të mëdha. Kështu, veprimet në mbështetje të cilësisë janë themelore për këtë rajon. Promovimi i prodhimeve cilësore do të rrisë perceptimin e cilësisë në të gjitha nivelet e zinxhirit të vlerave, duke u shtrirë nga fermeri deri te përpunuesi dhe te konsumatori. Qëllimi i këtij veprimi është të mbështesë; programe cilësie për prodhimet bujqësore dhe artikujt ushqimorë; programe cilësie për prodhime bujqësore dhe ushqimore të njohura nga legjislacioni kombëtar dhe



i BE-së; programe cilësie që mbulojnë prodhimet biologjike, prodhime të kategorizuara me origjinë të mbrojtur (EOM), tregues të mbrojtur gjeografik (TMG) dhe prodhime tradicionale vendase.

Krijimi i brandit të Tropojës

Kjo është thelbësore për trashëgimin dhe zgjerimin, veçanërisht në tregun ndërkombëtar, e sektorit bujqësor në këtë rajon dhe rajoni i Tropojës do të certifikoj prodhimet e saj me një brand të dallueshëm dhe të besueshëm. Veçanërisht prodhimet me orientim organik dhe cilësor do të certifikohen si “Tropoja Organike” ose “Tropoja e Cilësisë” për të promovuar prodhimin e ushqimit dhe emrin e rajonit, duke ipërdorur këto brande në çdo veprimtari të promovimit turistik që lidhen me të. Ky certifikim mund të aplikohet si kushtëzues për fermerët në mënyrë që të adoptojnë fermën organike. Ky program strategjik i referohet drejtpërdrejt Masave 11 dhe 12 të SNZHRB-së.

Objekti i kësaj strategjie është të kontribuojë në formimin profesional të ekspertizës së re dhe në përmirësimin e aftësive profesionale të atyre që janë tashmë të përfshirë në bujqësi, ushqim dhe pylltari, ashtu si edhe aktorëve të tjerë ekonomik në zona rurale.

Ky program strategjik do të përqendrohet në dy verpime kryesore:

Promovimi i përgatitjes profesionale (Masa 11 dhe 12)

Do të mundësohet mbështetje për organizimin e kurseve të trajnimit dhe për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrësve. Veprimi do t’u drejtohet në veçanti organizatave profesionale dhe/ose ekstraprofesionale (organet e trajnimit) që kanë mundësi dhe janë përgjegjëse për shpërndarjen e kurseve të trajnimit. Së bashku me programet e formimit profesional, një shkollë e specializuar për bujqësinë do të siguroj trajnimin e figurave të ardhshme profesionale dhe promovimin e kërkimit në sektorin bujqësor.

Promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit

Ky veprim do të mbështes formimin e fermave edukative për të promovuar ndërgjegjësimin e nxënësve dhe gjeneratës së re për mjedisin natyror dhe bujqësor. Këto struktura janë laboratore natyrore dhe vende për pedagogji aktive, në plotësim të programeve të shkollave që mund të përdoren nga mësuesit për punën e tyre. Gjithashtu, do të përfaqësoj mundësi për një udhëtim nëpër fshat, ku fëmijët mund të mësojnë origjinën e ushqimeve dhe të kuptojnë lidhjen midis prodhimeve bujqësore dhe ushqimeve, duke rivlerësuar funksionin social të fermerëve. Fermat Edukative do të adresojnë edhe sektorin turistik. Këto ferma, të mirëpajisura, do të kryejnë trajnimin e atyre që janë të interesuar të mësojnë më shumë rreth botës rurale në shkolla të veçanta dhe grupe të organizuara.



Programet strategjike të O5- Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme

O5S1 Përmirësimi i kushteve të rrugës dhe transportit

Pavarësisht se plani e vë theksin në transportin publik dhe atë tëbutë, ai përmban gjithashtu një strategji që synon përmirësimin e kushteve të rrugës. Kjo strategji përqipet jo vetëm të përmirësoje efektshmërinë dhe sigurinë e transportit rrugor me një përmirësim të përgjithshëm të infrastrukturës rrugore në zona të ndjeshme (me semaforë, trotuare, vija të bardha), por gjithashtu dhe kryesisht një rrugën si hapësirë të rëndësishme publike në territorin e bashkisë - sidomos aty ku rruga ka treguar që është shtylla ku mbështetet zhvillimi urban. Veprimtari specifike brenda kësaj strategjie merren me lidhjet mes qendrave kryesore dhe lidhjet mes qendrave kryesore dhe fshatrave

O5S3 Përforsimi i transportit kolektiv

Promovimi i shoqatave për aktorët e transportit kolektiv (kjo ndihmon në procesin e formalizimit të aktorëve që veprojnë në mënyrë informale, dhe në organizimin e itinerareve, orareve dhe çmimeve)

- Krijimi i kushteve për zhvillimin e transportit intermodal (p.sh. terminalet me bend parkim makinash dhe biçikletash)
- Ndërtimi i stacioneve lehtësisht të dallueshme
- Nxitja e rinovimit të mjeteve të transportit tëkolektiv

O5S4 Përforsimi i lëvizshmërisë së lehtë

Kjo strategji kujdeset për zhvillimin e një rrjeti lëvizjeje tëbutë si për këmbësorët edhe për çiklistët. Pavarësisht se numri i makinave është në rritje, ka ende një pjesë të madhe të popullsisë që lëiz me mjete të transportit kolektiv dhe në këmbë. Kjo strategji e sheh këtë gjendje si një problem - sidomos kur transporti kolektiv nuk është i shpërndarë dhe i efektshëm sa duhet - por gjithashtu e sheh edhe si një potencial duke qënë që me pak veprimtari strategjike niveli i arritshmërisë dhe mundësitë e lëvizjesh mund të rriten ndjeshëm. Kjo strategji përfshin veprimtari që merren me përmirësimin e lëvizshmërisë së butë në fshatrat rurale dhe përmirësimin e rrugëve çiklistike.



Programet strategjike të O6- Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale

O6S1 Garantimi i arritshmërisë së hapësirave publike

Rehabilitimi i qendrave urbane (si të mëdhatë dhe ruralet e vogla) do të përqëndrohet veçanërisht në përmirësimin e kushteve të hapësirave publike. Hapësirat publike janë në fakt thelbësore për organizimin social të komunitetit dhe për bashkëveprime ndër-personale në veprimtaritë e vogla të përditshme, si për shembull ato të lagjeve. Duhet të sigurohet prania dhe arritshmëria e këtyre hapësirave për të gjithë banorët e në të gjitha nivelet.

Ky program strategjik do të përqëndrohet në katër veprimtari kryesore:

Sigurimi i pranisë së hapësirave publike në zonat e urbanizuara (projekte për hapësirat publike, ripërdorim dhe të reja)

Veprimtaria parashikon rehabilitimin e shesheve ekzistuese dhe realizimin e atyre të rinj në të gjitha qendrat kryesore të bashkisë. Përmes këtij veprimi secila njësi vendore do të ketë të paktën njëhapësirë publike (të hapur), duke përforcuar kështu strukturën e qendrave të tyre dhe duke i bërë lehtësisht të njohshme.

Rehabilitimi i hapësirave publike në blloqet urbane (projekte)

Veprimtaria përmban projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të hapësirave mes ndërtesave të banimit të periudhës socialiste. Shumë prej këtyre hapësirave sot janë të papërdorura dhe në kushte të mjera, një rezultat direkt i procesit të privatizimit të këtyre ndërtesave, dikur publike, që ndodhi në vend pas vitit 1991. Një proces që duke u fokusuar vetëm në rishpërndarjen e pronësisë së apartamenteve ka krijuar kështu një hapësirë të re, “të mbetur”, shumë shpejt të lënë pas dore si prej pronarëve privatë edhe prej autoritetit publik. Proceset ekzistuese të rikualifikimit janë përqëndruar në rifunksionalizimin kryesisht si vende parkimi, duke “tjetërsuar” kështu një hapësirë dikur të menduar si pjesë integrale e banesave. Përmes rikualifikimit të tyre fizik, këto hapësira do të inkurajojnë banorët për rikuperimin dhe ripërvetësimin e tyre.

Sigurimi i hapësirave publike për rrugët kryesore urbane

Veprimtaria parashikon ndërtimin e hapësirave të reja publike përgjatë rrugëve kryesore urbane dhe rurale. Përgjatë këtyre hapësirave të reja lineare do të identifikohen vende për ndërhyrje ‘molekulare’ me synim krijimin e formave të reja të hapësirës publike (si kopshte, patio publike, sheshe, etc). Kjo hapësirë do lidhë funksionet kryesore pub-



like me njëra-tjetrën dhe do të sigurojë hapësirat e duhura publike për zonat urbane të banimit.

Krijimi i rrugëve për këmbësorë (projekte)

Kjo veprimtari ka për qëllim rikuperimin e disa rrugëve qendrore në zonat urbane/ të banimit, përmes kthimit totalisht ose kryesisht në zona këmbësore. Më shumë se shtim i hapësirave të reja publike, vetë rrugët kthehen në hapësira publike.

O6S2 Përmirësimi i shërbimeve të përbashkëta

Kjo strategji synon përmirësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe kolektive si në vendbanimet urbane dhe në ato rurale që gjenden në territorin e bashkisë. Pas vizitave dhe takimeve të shumta publike me qytetarët, strategjia fokusohet veçanërisht në përmirësimin e shërbimeve për arsim, sporte, aktivitete sociale e kulturore, shëndetësisë dhe administratës. Në mënyrë më të detajuar, ky program strategjik përqëndrohet në pesë veprimtari kryesore:

Promovimi i arsimit (projekte, shkolla)

Kjo veprimtari përqëndrohet në rehabilitimin e shkollave ekzistuese dhe ndërtimin e shkollave dhe kopshteve të reja ku shihet e nevojshme. Do të mbështesë gjithashtu rehabilitimin e oborreve ekzistuese të shkollave në një shesh lojërash funksional për aktivitete sportive të përdorshme si nga nxënësit dhe nga komuniteti lokal jashtë orëve të zakonshme mësimi.


Përmirësimi i shërbimit shëndetësor

Veprimtaria parashikon ndërhyrje në sektorin shëndetsor duke plotësuar mangësitë e strukturave shëndetësore dhe duke rehabilituar ato ekzistuese.

Promovimi i shoqërisë kulturore dhe civile (projekte, qendra kulturore dhe projekt për muzeun ekzistues)

Veprimtaria promovon ndërtimin e qendrave shpërndarë, kulturore dhe shoqërore, të menduara si struktura të thjeshta shumë-funksionale për aktivitete kulturore p.sh. biblioteka, salla takimesh dhe konferencash, hapësira për kinema dhe salla të përdorura për qëllime administrative (njësi administrative lokale, zyrë poste) duke zbatuar idenë e “one stop station”.





Zgjerim dhe përmirësim i varrezave (projekte)

Ndërhyrjet e parashikuara nga kjo veprimtari do të përmirësojnë kushtet e varrezave ekzistuese në bashki dhe do të përcaktojë zona të reja veçanërisht për ato në zona urbane. Lloji dominant i sistemit të varrimit do të mbahet duke prezantuar forma të reja të varrezave familiare dhe në veçanti duke rritur praninë e pemëve për të përcaktuar perimetrin e tyre.

O6S3 Përbushja e nevojave për strehim dhe përmirësimi i ofertës aktuale për strehim

Kjo strategji ka për qëllim përbushjen e nevojave për strehim në territorin e bashkisë dhe përmirësimin fizik të kushteve të banesave ekzistuese. Ajo përmban veprimtari dhe projekte të shumta si në format e ndërhyrjeve konkrete edhe në formën e linjave të veprimit që dhet të zbatohen si nga autoritetet publike edhe nga aktorët privatë. Ky program strategjik përqëndrohet në tre veprimtari kryesore:

Përmirësimi i ofertës për strehim social

Përmirësimi i kapaciteteve të Bashkisë për të ofruar njësi të banesave sociale, duke siguruar ndërtimin e banesave të reja me kosto të ulët dhe dke përmirësuar banesat sociale me qira për të akomoduar kërksat akoma të papërbushura të njerëzve në nevojë, duke marrë parasysh gjithashtu edhe ata qytetarë që për momentin nuk i përmbuhin kushtet për tu konsideruar për banesa sociale si dhe komunitetet e marginalizuara.

Akses i përmirësuar në strehimet sociale për grupet "vulnerabël"

Përmirësimi i aksesueshmërisë në banesa sociale për grupet e rrezikuara si njerëzit me kufizime, jetimët, të moshuarit, minoritetet etnike, dhe mbi të gjitha, programet për integrimin në punë, promovimin e autonomisë ekonomike të këtyre grupeve që sot për sot mbështeten nësubvencionet për strehim.

Rinovimi i stokut të banesave ekzistuese

Riparimi i stokut ekzistues të banesave të ndërtuara para viteve '90, me ndërhyrje për të përmirësuar efektshmërinë energjitike. Riparimet e fasadve, çatime me izolim termik dhe përdorimi i kasave të izoluar të dritareve mund të përdoret për të pakësuar urat termike dhe për të rritur ruajtjen termike të një ndërtese. Veprimtari të tjera do të ndiqen për transformimet e ndërtesave të braktisura, programin për shpërndarjen e granteve të vogla për përmirësimin e banesave që nuk përmbushin standartet e sigurisë dhe shëndetsisë, ndërhyrjen në banesa që kanë mangësi si ujë i pijshëm, kushte higjieno-sanitare,

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
mobilitetit



WC, lavamanë e dushë, dhe lidhjen e vendbanimeve me rrugët, ujësjellësin dhe kanalizimet.

O6S4 Dendësimi dhe konsolidimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

Regjenerimi i zonave urbane nërënimështë strategjia fillestare para se të parashikohen zgjerimet e zonave urbane në pjesë të reja të territorit. Kjo jo vetëm për një përdorim efektshëm të zonave me infrastrukturë ekzistuese, por edhe për të recuperuar pjesë të territorit tashmë të kompromentuar. Në fakt, në territor ka shumë struktura të braktisura të lidhura drejtpërdrejtë me aktivitetet prodhuese të ngritura nga regjimi komunist. Këto struktura, duke i shtuar shumë ndërtesa të braktisura banimi e bujqësie në zonat rurale, duket se janë një problem serioz i rajonit.

Dendësimi dhe rikualifikimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

Zhvillimi i politikave të reja për të promovuar densifikimin dhe konsolidimin e qytetit ekzistues, veçanërisht zonat e urbanizuara. Zhvillimi i këtyre zonave, veç përmirësimit të blloqeve të banimit, do të plotësojë gjithë banorët me shërbime më të mira infrastrukture (kanalizime, ujë të pijshëm, etc.).

Rikualifikimi i ish-zonave industriale dhe ushtarake

Veprimtaria ka për qëllim të ripërvetësojë zona të vjetra ushtarake, struktura industriale dhe venbanime/ ndërtesa banimi, këto të fundit të realizuara për të përballuar forcën punëtore në hidrocentrale apo në sektorin e minierave. Do të prezantohen nxitje ndaj pronarëve privatë për zhvillimin e këtyre zonave, ndërkohë që zonat publike do të konvertohen përmes Parteritetit Publik-Privat.


Programet strategjike të O7- Përditësimi dhe krijimi i infrastrukturës bazë urbane

(në faqen paraardhëse)
Harta e strategjisë për konsolidimin e qendrave urbane

O7S1 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore lokale

Ndërsa problemet e infrastrukturës rrugore të lidhuara me çështjen e arritshmërisë së këtij territori janë trajtuar më sipër (Objektivi Strategjik OS5), ky Objektivi Strategjik ka për qëllim përmirësimin e kushteve të rrugëve lokale, kryesisht të atyre që ndodhen në brendësi të qendrave të banuara. Megjithëse rehabilitimi i këtyre rrugëve në një vështrim të parë mund të mos duket një veprim strategjik si ai i rrugëve lidhëse midis qendrave, nga ky plan konsiderohet thelbësor për përmirësimin e jetës publike në këto qendra të banuara ku shpesh rruga është e vjetër hapësirë publike në këto qendra.





Përmirësimi i rrugëve urbane ekzistuese

Ky veprim ka si qëllim përmirësimin e rrugëve ekzistuese në brendësi të qendrave të banuara nëpërmjet shtrimit dhe pajisjes me trotuarë. Një ndërhyrje shëmbullore është ajo e propozuar për rrugën që lidh kullën e Mic Sokolit me banesën e Sali Manit dhe kullën e Binak Alias(Pajtimit).

Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese

Ky veprim ka si qëllim përmirësimin e rrugëve rurale ekzistuese nëpërmjet ndërhyrjeve me ndikim të ulët në mjedis.

O7S2 Përmirësimi i rrjetit të shërbimit ujësjellës

Kjo strategji ka si qëllim përmirësimin sasior dhe cilësor të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në të gjithë territorin. Janë identifikuar 3 aksione prioritare për këtë strategji:

Përmirësimi i rrjetit kryesor të furnizimit me ujë të pijshëm

Rrjeti kryesor ka nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe përmirësime të sistemit të kontrollit për ti bërë ballë humbjeve. Sistemet e kontrollit të automatizuara janë një instrument i cili do të ndihmonte në një administrim më të mirë të këtij shërbimi duke vënë në dukje zonat ku ka humbje. Përmirësimet e sistemit duhet të marrin në konsideratë edhe nevojën për përballuar kushtete ashpra klimatike të këtij territori. Përmirësimi kushteve të kësaj infrastrukture ka për qëllim të garantojë një shërbim të vazhdueshëm të furnizimit me ujë për të gjithë territorin duke minimizuar humbjet.


Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë

(në faqen paraardhëse)
Harta e strategjisë për infrastrukturën rrugore

Thelbësor për këtë është zbatimi i projektit të burimit “Perlinat e bardha”. Ky rrjet i ri do të garantojë mbulimin me shërbim për një pjesë të gjerë të këtij territori. Nevoja e zgjerimit të rrjetit ka të bëjë gjithashtu edhe me sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm për vendbanimet më të largëta ku mungon lidhja me një rrjet dhe ku aktualisht uji i pijshëm merret nga përrenjt në afërsi. Në territorin e Bashkisë Tropojë ka një numër të mjaftueshëm burimesh të cilët janë në gjendje të garantojnë zgjerimin e rrjetit. Vënia në shfrytëzim e tyre falë pozicionit gjeografik dhe prurjeve mesatare kërkon investime të përmbajtura si për realizimin ashtu edhe për mirëmbajtjen.

Promovimi i mekanizmave të grumbullimit të ujërave atmosferike





Kjo strategji parashikon prezantimin e skemave nxitëse të mekanizmave të mbledhjes dhe depozitimit të ujërave të shiut dhe ripërdorimi i tyre (për ujitje, shkarkime etj.). Këto mekanizma janë thelbësore për përmirësimin e përdorimit të burimeve natyrore vendore.

O7S3 Ngritja e një sistemi kanalizimesh funksional për të gjithë territorin

Në shumicën e rasteve ujërat e zeza në bashkinë Tropojë shkarkohen pa asnjë trajtim në lumenj apo përrenj duke çenuar për shkak të ndotjes cilësinë mjedisore të tyre por edhe të tokave përreth e si pasojë të produkteve që këto toka japin. Trajtimi i ujërave të zeza në këtë territor është një çështje urgjente. Ky trajtim duhet të jetë në përputhje me Strategjinë kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017 dhe me direktivat që rrjedhinng BE. Janë identifikuar 4 veprime prioritare për këtë strategji

Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit kryesor të ujërave të zeza

Kanalet e dëmtuara dhe që lejojnë rrjedhje të ujërava duhet të rehabilitohen. Këto kanale krahas ndotjes që shkaktojnë në tokon ku rrjedhin, kur ndodhen në afërsi të rrjetit të ujësjellësit rrezikojnë ndotjen e ujit të pijshëm duke rrezikuar të çënojnë shëndetin për një numër të konsiderueshm banorësh. Kanalet e ujërave të zeza duhet të kenë mbikqyrje dhe mirëmbajtje të vazhdueshme.

Planifikimi dhe ndërtimi i një impianti të centralizuar të trajtimit të ujërave të zeza


Zgjerimi i zonës së shërbyer mund të bëhet duke bashkuar rrjetin e njësisë administrative Margegaj me atë të Bajram Currit. Ky bashkim do të sillte rritjen e numrit të banorëve të shërbyer nga një sistem qendror i cili do të përfundojë me një impiant trajtimi të këtyre ujërave. Ujërat e trajtuara do jenë të një cilësie të tillë që të mundësojë përdorimin e tyre për vaditje. Mbetjet e tjera pas një trajtimi të mëtejshëm do mund të përdoren gjithashtu në bujqësi.

Planifikimi dhe ndërtimi i sistemeve gjysmë të centralizuara për vendbanimet e largëta

Janë disa vendbanimet të cilat nuk janë të shërbyera nga sistemi i kanalizimeve dhe nuk bëjnë asnjë trajtim të ujërave të zeza. Në këto vendbanime është e nevojshme të ndërtohen sisteme gjysëm të centralizuar ose sisteme të kombinuara në vend-i centralizuar për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave. Secili sistem duhet të jetë i përbërë nga një pajisje për trajtimin primar dhe një ligatinë e ndërtuar për trajtimin dytësor. Kjo ndërhyrje është urgjente në Tropojë ku rrjeti ekzistues i ujërave të zeza shkarkon në lumë pa asnjë

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
strategjisë
për rrjetin
ujësjellës





trajtim. Gjithashtu urgjente është pajisja me ligatina të ndërtuara për trajtimin dytësor në Firzë dhe Zonë B ku janë të ndërtuara rishtas gropat septike të përbashkëta.

Promovim i trajtimit shtëpiak të ujërave të zeza për banesat e izoluar

Për një administrim të plotë të ujërave të zeza bashkia Tropojë do të vendosë rregulla që detyrojnë krijimin e gropave septike sipas standraveve për ato banesa që nuk janë të lidhura me asnjë rrjet. Këto rregulla duhet të nxisin edhe instalimin e pajisjeve të decentralizuara për trajtim dytësor.

O7S4 Ngritja e një sistemi funksional për grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave për të gjithë territorin

Ky program i mbështetet në draft strategjinë ndërsektoriale të mjedisit 2015-2020 dhe në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Bashkia e Tropojës gjendet në Zonën e mbetjeve 5 për të cilën ende nuk është përpiluar plani i menaxhimit të mbetjeve. Për këtë bashki riorganizimi i menaxhimit të mbetjeve dhe shtrirja e këtij shërbimi në tërësinë e territorit është prioritar. Mangësitë në këtë shërbim kanë efekte negative shumë dimensionale. Nga një anë këto efekte çënojnë shëndetin e banorëve dhe cilësinë e jetës dhe nga ana tjetër kanë një efekt negativ edhe në zhvillimin ekonomik të këtij territori që ka turizmin gjenerator kryesor të rimëkëmbjes ekonomike.

Janë identifikuar 6 veprime prioritare për këtë strategji :

Parandalimi i prodhimit të mbetjeve


Një menaxhim i mirë i mbetjeve kërkon që këto të parandalohen dhe reduktohen që në burim, sa më shumë të jetë e mundur. Për këtë qëllim është e nevojshme ndërmarrja e fushatave informuese dhe të rritjes së ndjeshmërisë mbi këtë çështje. Këto fushata janë të nevojshme pasi me rritjen numrit të vizitorëve në këtë territor rritet edhe rreziku i një shtimi të shpejtë të sasisë së mbetjeve të prodhuara.

Përmirësimi i organizimit të grumbullimit të mbetjeve

Ky veprim ka si qëllim përmirësimin e organizimit të mbledhjes së mbetjeve nëpërmjet ndërtimit të sistemi të shpërndarë grumbullimi dhe ndarje dhe nëpërmjet përmirësimit të efektshmërisë së transportit të tyre. Mbetet i nevojshëm edhe një studim specifik për organizimin kohor dhe të trajektoreve të udhëtimeve për mbledhjen e mbetjeve.

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
menaxhimit të
kanalizimeve





Nxitja e ndarjes së mbetjeve në origjinë

Bazuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia do të nxisë ndarjen e mbetjeve në origjinë sipas sistemit të grumbullimit me tre kosha (1. Riciklimet e thata; 2. Riciklimet e lëngëshme; 3. Mbetjet e tjera). Për të arritur rezultatet e pritura do të organizohen fushata informimi. Arritja e rezultateve në ndarjen e mbetjeve në origjinë do të përshpejtonte zhvillimin e ekonomive në fushën e riciklimit dhe do të zvogëlonte kapacitetin dhe si pasojë investimin e nevojshëm për “landfill”.

Promovimi i kompostimit të mbetjeve organike

Praktika e përdorjes së mbetjeve ushqimore për plehërim është gjerësisht e përdorur në zonat rurale. Në këto zona më shumë se 60% e mbetjeve kanë natyrë organike. Këto mbetje nëpërmjet kompostimit mund të rifuten në përdorim duke përmirësuar cilësinë e tokës dhe të produkteve të saj pa përdorur fertilizues kimik. Nxitja e kompostimit do të bëhet duke organizuar programe trainimi dhe mbështetje në blerjen e koshave të përshtatshëm për kompostimin shtëpiak.

Promovimi i ekonomisë së riciklimin të mbetjeve (qendrave)

Organizimi i mbledhjes së mbetjeve sipas sistemit të grumbullimit me tre kosha është hapi i parë për nxitjen e ekonomisë së riciklimit. Kjo ekonomi ka potencialin të ulë shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve. Mbetjet mund të grumbullohen në stacionet e transferimit pranë qendrave bujqësore ku do të bëhet kompostimi i mbetjeve organike dhe përgatitja për tu transportuar në Bajram Curri ku pranë landfillit do të bëhet përpunimi i materialeve të riciklueshme dhe propojsja e atyre të pa riciklueshme.

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit

Ky veprim ka për qëllim organizimin e strukturave për vënien në zbatim të rregullores nr. 1, datë 30.03.2007. e cila synon të disiplinojë procesin e administrimit të mbetjeve të fushës së ndërtimit, duke vendosur rregulla e kërkesa konkrete për të gjitha subjektet që operojnë në sferën e ndërtimit e të trajtimit të mbetjeve që gjenerohen prej tij. Krahas zbatimit të Neni 10 për garancinë financiare që parashikon në pikën 1 “Përpara lëshimit të lejes së ndërtimit ose të shembjes për një strukturë që prodhon mbetje ndërtimi, të cilat duhet të depozitohen në një venddepozitim kërkuesi duhet të depozitojë një shumë në para pranë pushtetit vendor në sasinë që do të përcaktohet nga këshilli i qeverisjes vendore për çdo ton mbetje të parashikuar nga ndërtimi dhe/ose shembja/prishja, e cila nuk do të jetë më e vogël se 5% e vlerës së strukturës” bashkia Tropojë ka ambicien të arrijë një administrim të efektshëm nga pikëpamja ekologjike të këtyre mbetjeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet nxitjes së krijimit të një cikli për ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit. Nëpërmjet këtij cikli do të bëhet e mundur jo vetëm rritja e sasisë së mbetjeve

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
menaxhimit të
mbetjeve



të menaxhuara dhe si rrjedhojë konsum i kufizuar i territorit për qëllime depozitimi të këtyre mbetjeve por edhe përmirësimi i efektshmërisë ekonomike në sajë të rritjes së sasisë dhe cilësisë së materialeve të ricikluara. Kjo sjell dy përfitime, zëvendësimin e nevojës për materil primar të virgjër dhe si rrjedhojë zvogëlimin e nevojës për gurore dhe uljen e cmimit të këtyre materialeve duke shtuar konkurrueshmërinë në treg.

O7S5 Përmirësimi i rrjetit të telekomunikimit

Zgjerimi i rrjetit të komunikimit në qendrat kryesore

Përdorimi i telekomunikimit, në veçanti internetit në bashkinë e Tropojës, sipas INSTAT rezulton të jetë shumë i ulët. Kjo kufizon mundësitë për zhvillim të këtij territori. Kjo strategji ka për qëllim të përballet me kërkesën në rritje për infrastrukturë dhe shërbime telekomunikimi që është ngushtësisht e lidhur me mundësinë për të aksesuar shërbime të ndryshme elektronike të nivelit kombëtar dhe për të shtuar mundësitë e promovimit të vlerave të territorit.

Zgjerimi i rrjetit të telekomunikimit në qendrat kryesore

Ky veprim synon zgjerimin e rrjetit të telekomunikimit në qendrat kryesore duke filluar nga ato që janë të lidhura me aktivitetet turistike.

Sigurimi i aksesit të rrjetit të komunikimit në zonat rurale

Ky veprim synon ndërtimin e qendrave të hyrjes në internet në zonat rurale.

O7S6 Përmirësimi i efektshmërisë energjitike

Fuqizimi i rrjetit ekzistuese të shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike në territorin e bashkisë Tropojëka një kapilaritet të mirë. Kjo është e lidhur edhe me faktin që në këtë territor gjendet një nga hidrocentralet kryesore të vendit, ai i Fierzës dhe disa hidrocentrale më të vogla të shpërndara në territor. Edhe pse me këto kushte të favorshme mungesa e energjisë dhe tensioni i ulët është një konstante në vendbanimet e largëta. Për këtë arsye strategjia parashikon:

Përforcimin e rrjetit të shpërndarjes

Rreti i shpërndarjes së energjisë do të përforcohet duke nëpërmjet përmirësimeve në



stacionet e transformimit dhe kabinat elektrike si dhe krijimit të infrastrukturës nën-tokësorë të shpërndarjes së energjisë.

Nxitja e prodhimit alternativ të energjisë

Në territorin e Bashkisë Tropojë do të nxitet prodhimi alternativ i energjisë. Prodhimi i enrgjisë nëpërmjet shfrytëzimit të erës, diellit dhe biomasës është një mënyrë e efektshme për ulur varësinë nga rrjeti i centralizuar dhe sidomos në rastin e vendbanimeve të përkohëshme (bjeshkët) është mënyra që më pak çënon mjedisin natyror.

Programet strategjike të O8- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar

O8S1 Mbrojtja e biodiversitetit

Zona ndërkufitare e Bashkisë së Tropojës përfshin një zonë me peizazh unik dhe është një nga rajonet më të rëndësishëm për mbrojtjen e biodiversitetit në Ballkan dhe në gjithë Evropën.

Vlerat natyrore të kësaj zonë përfshijnë llojshmërinë e habitateve alpine dhe sub-alpine, livadheve dhe kullotave alpine me vegjetacion të pasur dhe komplekse të mëdha pyjore. Rajoni është shtylla kryesore për një numër të madh llojesh (speciësh) të faunës, të cilat përfshijnë lloje të rrezikuara, me rëndësi të përgjithshme Evropiane. Këto vlera unike duhet të merren në konsideratë gjatë vendimmarrjes për këtë rajon dhe mbrojtjes së thesareve natyrore për gjeneratat e ardhshme. Përveç vlerave natyrore dhe peizazhstike, zona përfshin edhe site të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Një nga kërcënimet kryesore ndaj habitateve dhe popullatave të llojeve (specieve), dhe një nga shkaqet kryesore të rënies së biodiversitetit biologjik, është fragmentimi dhe izolimi i habitateve dhe efekti që kjo mund të ketë në qëndrueshmërinë e popullatave të llojeve. Statusi i favorshëm i mbrojtjes së specieve të ndryshme dhe habitateve natyrore varet nga madhësia e zonave të mbrojtura. Migrimi, shpërndarja dhe shkëmbimi gjenetik i specieve të egra varet nga ekzistenca e korridoreve ekologjike që lidhin zona të mbrojtura të veçanta të kategorive të ndryshme të mbrojtjes të projektuara në nivel kombëtar. Vazhdimësia dhe lidhja e habitateve në zonat kufitare kërkon lidhje ndërkufitare dhe korridore ekologjike të cilat lidhin rrjetet e zonave të mbrojtura të vendeve fqinje.

Zona ndërkufitare e Bashkisë së Tropojës formon korridorin ekologjik natyror duke lidhur gjithë rajonin, por aktualisht nuk është siguruar ende integriteti dhe vazhdimësia e habitateve që shtrihen përtej kufijve shtetërorë apo korridoreve që lejojnë migrimin e specieve të faunës. Megjithatë, pritet që nismat e fundit qeveritare, në të gjitha anët e kufirit shtetëror, mund ta ndryshojnë situatën aktuale dhe të mundësojnë fuqizimin e



lidhjes dhe vazhdimësisë ekologjike të rrjetit të zonave të mbrojtura në këtë rajon. Janë evidentuar katër veprime prioritare për t'u ndërmarrë:

Mbrojtja e llojeve (specieve) dhe habitateve – përtej kufijve kombëtarë

Një nga arsyt kryesore për krijimin e një zone të mbrojtur ndërkufitare është lehtësimi i mbrojtjes dhe përdorimi i qëndrueshëm i vlerave të saj natyrore dhe peizazhistike në shkallë eko-rajonale, perceptuar si një njësi natyrore koherente. Harmonizimi dhe koordinimi i praktikave të menaxhimit të natyrës dhe peizazhit në secilën anë të kufirit, në vend të menaxhimit të vlerave natyrore dhe paizazhistike të zonave të mbrojtura të ndryshme e më të vogla në një mënyrë konfliktuale dhe jo të përputhshme, është një nga “vlerat e shtuara” më të mëdha për krijimin e një zone të mbrojtur ndërkufitare.

Sipas Direktivës së Këshillit 92/43/EEC të datës 21 Maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe faunës së egër e florës, prania e tipeve të habitateve natyrore të listuar në Aneksin I dhe habitateve të llojeve të listuara në Aneksin II të Direktivës është kriteri për përcaktimin e zonave të veçanta për mbrojtje të cilat përbëjnë rrjetin Natyra 2000.

Prandaj, identifikimi i prioriteteve për bashkëpunimin ndërkufitar për mbrojtjen e biodiversitetit në rajon duhet të marrë në konsideratë Direktivën e Këshillit 92/43/EEC të datës 21 Maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës së egër dhe florës (“Direktiva e Habitave”), e cila do të mund të përgatisë zonat e mbrojtura të këtij rajoni për ngritjen e ardhshme të konceptit të Natyra 2000.

Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi duhet të bashkëpunojnë për themelimin dhe menaxhimin e rezervave natyrore ndërkufitare dhe duhet të harmonizojnë objektivat e menaxhimit dhe masat e aplikuar.

Duhet theksuar gjithashtu se, deri tani, nuk ka bazë të dhënash apo harta të përditësuara apo të përbashkëta të shpërndarjes së habitateve dhe specieve për të gjithë rajonin ndërkufitar. Prandaj, përditësimi, zhvillimi, harmonizimi dhe mirëmbajtja e të dhënave që lidhen me biodiversitetin dhe zhvillimi i të dhënave të përbashkëta për zonat e mbrojtura ndërkufitare, në konsultim dhe bashkëpunim midis vendeve të përfshira, duket se është detyra më urgjente.

Kjo do të kërkojë grumbullimin dhe përmbledhjen e të dhënave shkencore, inventare kombëtare dhe harta që kanë të bëjnë me tipet e habitateve natyrore dhe gjysmë-natyrore të rralla ose të rrezikuara, si edhe bashkësitë dhe speciet bimore, përfshirë florën endemike dhe speciet e faunës.

Përsa i përket rregullimit të transportit ndërkufitar të mbeturinave, theksohet se sistemi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e këtij transporti duhet të jetë i rregulluar, njëlloj si në vendet anëtare të BE-së. Duhet ngritur në nivel kombëtar mbikëqyrja dhe sistemi i



kontrollit për të siguruar nivelin e lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, dhe për të siguruar zbatimin e parimeve për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara si në Direktivat e BE-së dhe Rregulloren e 1013/2006/EC për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme.

Sigurimi i vazhdimësisë së procesit të evolucionit natyror përtej kufijve shtetërorë (p.sh. korridoret e migrimit të kafshëve të egra)

Në kuadër të praktikave menaxheriale të harmonizuara dhe të koordinuara në një zonë të mbrojtur ndërkufitare, duhet të rritet mbrojtja e habitateve natyrore të ndodhura përtej ose pranë kufirit shtetëror, migrimi i specieve përtej kufijve shtetërorë duhet të bëhet i lirë, duhet të sigurohet vazhdimësia e proceseve të evolucionit natyror përtej kufijve shtetërorë dhe duhet të identifikohen dhe të kontrollohen bashkarisht kërcënimet e përbashkëta ndaj natyrës dhe rreziqet mjedisore ndërkufitare.

Si rezultat i bashkëveprimit ndërkufitar duhen përkufizuar zonat e rëndësishme për biodiversitetin biologjik dhe peizazhistik, veçanërisht ato që janë të përfshira në tipet e habitateve natyrore dhe gjysmë-natyrore të rrezikuara si edhe ato të përcaktuara si shtylla kryesore, korridore lidhëse prioritare dhe shtigje migruese të specieve migruese të rrezikuara, dhe duhen vlerësuar kërcënimet ndaj funksioneve të tyre ekologjike. Duhet të krijohen lidhje ndërkufitare dhe korridore ekologjike që lidhin rrjetet e zonave të mbrojtura midis vendeve fqinje.

Duke marrë parasysh sa më sipër – identifikimi i prioriteteve për ruajtjen e biodiversitetit në zonat ndërkufitare duhet të kombinojë tri qasje metodologjike:

- Identifikimi i habitateve dhe llojeve të listuara tashmë në Aneksin përkatës të Direktivës së Këshillit, Shtojca II e Konventës së Bernës ose Listat e Kuqe kombëtare dhe të IUCN-së;
- Identifikimi i llojeve target (ndoshta edhe i habitateve) të rëndësishë së veçantë për ruajtjen e biodiversitetit në rajon (p.sh. speciet endemike dhe relike vendase), të cilat nuk janë përfshirë ende në listën e njohur ndërkombëtarisht;
- Përqendrimi në habitatet dhe llojet që ndodhen në zonat kufitare, mbrojtja e të cilave do të përfitonte shumë nga shtimi i bashkëpunimit ndërkufitar në këtë rajon të veçantë.

Zvogëlimi i kërcënimeve aktuale

Një nga kërcënimet kryesore për habitatet dhe popullatat e specieve, dhe një nga shkaqet kryesore për rënien e llojshmërisë biologjike në Evropë, është copëzimi dhe izolimi i habitateve dhe ndikimi që kjo mund të ketë në qëndrueshmërinë e popullatave



të specieve. Copëzimi është ndarja e trakteve të vazhduara të ekosistemit, duke krijuar pengesa për migrimin dhe shpërndarjen e organizmave dhe duke pakësuar madhësinë e zonave homogjene. Ai mund të shkaktohet nga veprimtaritë njerëzore (p.sh. infrastruktura rrugore) ose nga proceset natyrore.

Ndikimi negativ i copëzimit të habitateve mund të pakësohet duke krijuar rrjete ekologjike: copëzimi i habitateve mund të luftohet duke krijuar zona buffer, për të mbrojtur zonat natyrore që kanë mbijetuar, dhe duke lidhur këto zona bërthamë me gurë kilometrikë dhe korridore, të cilët i lejojnë speciet të migrojnë dhe të shpërndahen.

Partnerët e bashkëpunimit ndërkuftar duhet të identifikojnë habitatet, bashkësitë bimore, speciet, peizazhet dhe vlera të tjera, mbrojtja e të cilave do të përfitonte shumë nga shtimi i bashkëpunimit ndërkuftar në këtë zonë të veçantë. Pasi të jetë rënë dakord për këto objektiva, identifikimi dhe vlerësimi i përbashkët i kërcënimeve aktuale dhe i veprimtarive të mundshme të përbashkëta, me objektivin për të pakësuar dhe/ose kontrolluar kërcënime të tilla, do të lejoj identifikimin e prioriteteve të përbashkëta për bashkëpunimin ndërkuftar për ruajtjen e biodiversitetit në këtë rajon.

Për sa i përket habitateve pyjore, mbetjet e fundit të pyjeve të lashta me pisha endemike dhe relike Ballkanase/Maqedonase (*Pinus peuce*) dhe me pisha Boshnjake (*Pinus heldreichii* ssp. *leucodermis*), si edhe pyjet me panjë Heldreich (*Acer heldreichii*, specie endemike relike tretësore), kërkojnë vëmendje të veçantë, dhe përpjekje të përbashkëta për ruajtje, nga partnerët e përfshirë në bashkëpunimin ndërkuftar për mbrojtjen e biodiversitetit në këtë rajon. Analiza e habitateve të shënjestruar duhet të marrë në konsideratë edhe ato të listuara në Konventën e Bernës, p.sh. pyjet e ahut (41.1), pyjet me pisha të larta Mesdhetare (42.7), formacionet bregore me shelgje (44.1) dhe galeritë bregore Boreo-alpine.

Zona ndërkuftare, me presion njerëzor pothuaj të papërfillshëm në zonat e gjera, të largëta dhe të paarritshme malore, është ende një fortesë për speciet e ndryshme të kërcënuara të faunës, të cilat janë të një rëndësie të përbashkët evropiane, veçanërisht ato që kërkojnë ekosisteme të mëdha pyjore të pashqetësuara, përfshirë gjitarët e mëdhenj si ariu bojë kafe, ujku, rrëqebulli dhe dhia e egër, të listuar në Aneksin II të Direktivës së Këshillit 92/43 EEC të datës 21 Maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës së egër dhe florës. Të gjitha këto lloje të rëndësishme të faunës, të cilat kanë mbijetuar në këtë rajon dhe kanë shtyllat e tyre në habitatet përtej kufijve shtetërorë, kështu do të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi ndërkuftar mbi mbrojtjen e tyre në zonën ndërkuftare në shkallë të madhe të propozuar për mbrojtje.

Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështje mjedisore

Niveli i ulët i ndërgjegjësimit ekologjik të popullsisë vendase bashkohet me kapacitetet e pamjaftueshme të autoriteteve bashkiake vendase për të adresuar kërcënimet e identi-



fikuara. Nuk është bërë shumë deri më tani me objektivin për të zvogëluar apo kontrolluar kërcënimet e ndryshme mjedisore të viteve të fundit.

Të gjitha përpjekjet për ruajtje do të kërkojnë edhe lëshimin e fushatave të ndërgjegjësimit të zërit publik (në nivel fshati dhe mundësisht edhe rajoni), gjë që do të kërkoj zhvillimin e materialeve informative dhe promovuese duke synuar audiencë dhe grupe profesionale të ndryshme.

Kështu, duhet të ndërmerret një fushatë ndërgjegjësimit publik, që përfshin organizata vendase joqeveritare, dhe shtimi të konsultimeve me komunitetet vendase, me objektivin për të shtuar mbështetjen publike për të themeluar bashkëpunimin ndërkufitar dhe për të gjetur kompromisin midis kërkesave për ruajtje dhe nevojave për zhvillim të komuniteteve vendase dhe palëve të interesuara.

Fushata e ndërgjegjësimit publik mundësisht duhet të përqendrohet në përfitimet e mundshme të parqeve kombëtare dhe/ose përcaktimin e zonave ndërkufitare të mbrojtura për zhvillimin ekonomik vendas. Për shembull, emërtimi 'park kombëtar, pjesë e një zonë ndërkufitare tripalëshe me vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe argëtuese' dhe 'një nga zonat e mbrojtura me të mëdha në Evropë' mund të rrisë tërheqjen turistike të rajonit dhe të promovojë shërbimet e tij turistike, të rrisë njohjen e rajonit jashtë vendit dhe të ndihmojë në pakësimin e efekteve të mundshme të pafavorshme.

Organizimi i programeve verore, programeve të ndërgjegjësimit mjedisor dhe shkëmbimet rinore janë aktivitete të ndryshme që mund të zbatohen në të tre vendet në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit publik mjedisor.

O8S2 Mbështetja e zhvillimit socioekonomik

Modeli i përdorimit të tokës dhe zhvillimit ekonomik është shumë i ngjashëm në secilën anë të kufirit shtetëror në zonën ndërkufitare të Bashkisë së Tropojës. Banorët e këtij rajoni malor mund të përshkruhen më mirë si një popullsi dominuese rurale, me të ardhura të ulta dhe të ndikuar seriozisht nga papunësia strukturore. Mundësitë zyrtare të punësimit në zonë (të përhershme dhe të përkohshme) janë të parëndësishme krahasuar me numrin e popullsisë dhe janë të kufizuara në mësimdhënien në shkollat vendase, shërbimet civile në zyrat vendase ose ndonjëherë edhe në shërbimet turistike (p.sh. restorante apo shërbimet e pakta turistike). Kështu, aktualisht, niveli i papunësisë është shumë i lartë.

Sektorët kryesorë të ekonomisë vendase janë bujqësia dhe pylltaria, ndërkohë që përdorimet më të rëndësishme tradicionale të tokës dhe rezervave natyrore, me rëndësi të madhe për jetesën dhe plotësimin e nevojave ekonomike të banorëve vendas, përfshijnë mbarështimin e deleve dhe kullotjen në livadhet dhe kullotat malore, kositjen e barërave të thatë, administrimin e fermave dhe të kafshëve (dele, lopë dhe dhi), prodhimin e frutave të freskëta dhe perimeve, bletërritjen dhe mbledhjen e bimëve mjekësore dhe



boronicave.

Vlera e shtuar dhe përfitimet e mundshme për të gjitha vendet e përfshira, që vijnë nga krijimi i zonës së mbrojtur ndërkufitare, kanë të bëjnë me faktin se bashkëpunimi ndërkufitar tripalësh në këtë rajon do të lehtësojë shumë:

- Arritjen e objektivave të mbrojtjes së natyrës së tyre dhe ruajtjes së biodiversitetit;
- Pakësimin e kërcënimeve të pranishme ndaj mjedisit dhe natyrës në rajonin e ndarë;
- Promovimin dhe zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe rajonal;
- Vendosjen e një mekanizmi bashkëpunimi afatgjatë që i shërben palëve të interesuara vendase.

Janë evidentuar gjashtë veprime prioritare për t'u ndërmarrë:

Nismat e bashkëpunimit në nivel institucional

Suksesi, në bashkëpunimet ndërkufitare, kërkon marrëveshje formale dhe informale bashkëpunimi. Marrëveshjet formale mundësojnë qasje komplekse ndërdisiplinore ndaj ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, janë ligjërish të imponueshme, mund të parashkruajnë periudhën e marrëveshjes duke kërkuar ri-angazhim ose ri-bisedim, mund të përfshijnë administrata dhe agjenci qeveritare, të rrisin fuqizimin e administratave dhe stafit të zonave të mbrojtura, janë më pak të ndikuara nga ndryshimet e personelit, sigurojnë raportim të rregullt dhe vlerësim të progresit të bashkëpunimit, sigurojnë vazhdimësi të bashkëpunimit, mund të sigurojnë fondet e duhura nga buxheti qendror, p.sh. takime, udhëtime dhe komunikim, staf, veprimtari të përbashkëta dhe kërkim, si edhe të inkurajojnë marrëveshje në nivel lokal. Gjithashtu, marrëveshjet formale janë të pazëvendësueshme si bazë ligjore për të marrë mbështetje zyrtare institucionale dhe financiare, ashtu si edhe për njohjen e një Zone të Mbrojtur Ndërkufitare nga organizatat ndërkombëtare.

Mbajtja e kontakteve direkte personale të punës midis partnerëve të ndryshëm do të ishte thelbësore për zhvillimin e bashkëpunimit të ardhshëm ndërkufitar.

Administrata e krijuar rishtazi e zonës së mbrojtur mund të kërkojë ndërtesa operative dhe me kapacitet profesional/teknik, të cilat mund të përfshinin disa trajnime të përbashkëta, vizita studimore ose të organizonin seminare tematikë të përbashkët, duke mbledhur ekspertë dhe menaxherë nga të gjitha vendet e përfshira.



Nismat e bashkëpunimit duhet të përqendrohen në veprimtaritë e mëposhtme:

- Vendosja e bashkëpunimit me administratën e Zonave të Mbrojtura (ZM) ndërkufitare në Kosovë dhe Mal të Zi;
- Përgatitja e Memorandumit të Mirëkuptimit për ZM dhe mbrojtjen e kafshëve të egra;
- Shkëmbimi i vizitave periodike në zonat e mbrojtura ndërkufitare në Kosovë dhe Mal të Zi.

Në të ardhmen, duhet të drejtohen më shumë konsultime formale, edhe më intensive, mbi prioritetet e mundshme midis partnerëve kyç të bashkëpunimit ndërkufitar, në veçanti Ministrinë përkatëse, administratat e zonave të mbrojtura dhe bashkitë lokale.

Sipas këtij skenari, vazhdimësia dhe lidhja ekologjike e peizazheve dhe habitateve do të përmirësoheshin ndjeshëm krahasuar me situatën aktuale dhe do të siguronin mundësi për bashkëpunim tripalësh, harmonizim të qasjes dhe praktikave të menaxhimit dhe ndërmarrje të projekteve dhe masave në fusha të përbashkëta, për ruajtjen e biodiversitetit në zonat kufitare midis administratave të parqeve kombëtare në tre vendet (Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi).

Nismat e bashkëpunimit në nivel institucional (qendror dhe rajonal) mund të nxisinin gjerësisht qëndrimet pozitive të bashkive lokale kundrejt zhvillimit të bashkëpunimeve ndërkufitare.

Vlerësimi dhe shtimi i kapaciteteve të partnerëve të ndryshëm vendas për bashkëpunim ndërkufitar

Bashkëpunimi ndërkufitar do të lehtësohej shumë duke vendosur dhe përcaktuar një 'organ koordinimi' të veçantë, të përbashkët, për bashkëpunimin ndërkufitar, si një forum zyrtar për konsultimet midis të gjitha vendeve të përfshira.

Një organ i tillë koordinimi duhet të ketë qartësisht të përcaktuar kompetencat, detyrat, rregullat e procedurimit duke lejuar vendim-marrje të drejtë dhe të ekuilibruar midis të gjithë partnerëve, modalitete operacionale dhe buxhet të përshtatshëm operacional për të financuar takimet dhe punën. Një organ i ngjashëm koordinimi u themelua në kuadër të projektit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Shqipërisë, në lidhje me mbrojtjen e Liqenit të Shkodrës, bazuar në Memorandumin për Mirëkuptim midis Ministrive përgjegjëse nga të dy vendet, miratuar më vonë nga qeveritë përkatëse.

Kapacitete të ndryshme institucionale, operacionale dhe teknike (p.sh. pabarazi në numrin e stafit, në shkallën e profesionalizmit dhe ekspertizës) midis partnerëve mund të shkaktojnë pengesa të ndryshme për të zhvilluar bashkëpunimin ndërkufitar dhe të



rezultojnë në nevojë për asistencë të përbashkët dhe mbështetje në implementimin e objektivave të menaxhimit për të cilat është rënë dakord.

Prandaj, kapacitetet e partnerëve të ndryshëm lokalë për bashkëpunimin ndërkufitar duhet të vlerësohen dhe të rriten, në mënyrë që të:

- Grumbullohen rezervat e mundshme aktualisht dhe të përmirësohen aftësitë profesionale dhe ekspertiza e zotëruar nga anëtarët e stafeve të institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme;
- Mundësohen rezervat e nevojshme për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar, në terma të mjediseve (zyra, biblioteka, salla konferencash dhe mbledhjesh), të personelit (stafi profesional dhe administrativ), të pajisjeve (p.sh. kompjutera, kamera, automjete ose pajisje shkencore dhe profesionale).

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

Pasuritë e jashtëzakonshme natyrore dhe peizazhistike të 'Alpeve Shqiptare' ende nuk perceptohen si një faktor i mundshëm zhvillimi dhe kyç për atraksonit turistik të këtij rajoni, kryesisht falë infrastrukturës së pazhvilluar turistike dhe rrugore.

Infrastruktura e transportit në rajon, në përgjithësi, nuk është e zhvilluar mirë dhe konsiderohet të jetë e pamjaftueshme në secilën anë të kufirit shtetëror. Gjithashtu, zona të largëta rurale në afërsi të kufirit, të cilat janë të lidhura me ultësirat nëpërmjet rrugëve të ngushta (dhe zakonisht të pashtuara) lokale malore, janë të arritshme më vështirësi, ndërkohë që situata në dimër është edhe më e rëndë, kur rrugët lokale malore bllokohen nga dëbora. Rrjeti ekzistues rrugor dhe ai që kalon kufirin u shërbejnë qytetarëve të vendeve fqinje, falë zhvillimit të pakët të tyre.

Rrjeti rrugor i pazhvilluar, shpesh i bllokuar nga dëbora gjatë dimrit, si edhe mungesa e sinjalistikës në shtigjet turistike për hiking pengon vizitat intensive të zonës.

Pabarazia në zhvillimin e rrjetit rrugor në anë të ndryshme të vargut malor rezulton në distanca relativisht të gjata (të paktën për kushtet lokale) midis zyrave qendrore të ardhshme të autoriteteve, që pritet të bëhen partnerë të bashkëpunimit ndërkufitar në rajon.

Prandaj, vendosja e lidhjeve rrugore nëpër malet përgjatë kufirit shtetëror konsiderohet një veprim kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Zhvillimi i një modeli zonimi të harmonizuar dhe të përputhshëm në konsultim me të gjitha vendet e përfshira

Shumica e zonave të mbrojtura si edhe rezervat e biosferës të UNESCO-s zbatojnë modele zonimi që përmbushin objektivin e mbrojtjes së natyrës dhe peizazhit dhe ato të



zhvillimit të qëndrueshëm. Vlerat më të rëndësishme natyrore dhe peizazhiste janë ruajtur në “zonat bërthamë” rreptësisht të mbrojtura, ku ndërhyrjet njerëzore dhe ndikimi në proceset natyrore janë të kufizuara. Zona të tilla bërthamë zakonisht janë të rrethuara dhe të lidhura me zona (“zona buffer”) që qëndrojnë nën regjim mbrojtës pjesor, duke lejuar menaxhim që synon p.sh. përmirësimin e gjendjes aktuale të ekosistemit dhe/ose hatitave, dhe ndalimin e presioneve të jashtme negative mbi “zonën bërthamë”. Gjithashtu, në rastin e rezervave të biosferës, një “zonë tranzit bashkëpunimi” është krijuar jashtë zonës së mbrojtur ligjërisht me qëllimin harmonizimin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të afërta me mbrojtje të natyrës në dy zonat e brendshme.

Në rastin e një zone të mbrojtur ndërkufitare – zona të mbrojtura të veçanta, që lidhen me njëra-tjetrën në mënyrë direkte përgjatë kufirit shtetëror, duhet të projektohen në një mënyrë që të lejojnë zonim funksional të harmonizuar, të përputhshëm dhe plotësues. Mundësisht, të gjitha vendet e përfshira duhet të zbatojnë model zonimi funksional të njëjtë ose të përputhshëm, që do të thotë se çdo zonë funksionale në njërin anë të kufirit shtetëror duhet të ketë zonën e saj ekuivalente përtej kufirit shtetëror. Zonat funksionale duhet të përcaktohen saktësisht me anë të përdorimit të instrumentave GIS (Geographic Information System) dhe të paktën zonat bërthamë duhet të sinjalizohen në terren.

Gjithashtu, zonat bërthamë në secilën anë të kufirit shtetëror duhet të përfshijnë të gjitha zonat dhe habitatet e rëndësishme për të mbajtur llojshmërinë biologjike dhe peizazhiste të rajonit (p.sh. habitatet natyrore target, korridoret lidhëse prioritare në zonat kufitare, shtyllat kryesore dhe shtigjet migruese të kafshëve target).

‘Plotësueshmëria ndërkufitare’ e nevojshme për modelin e zonimit në një zonë të mbrojtur ndërkufitare nënkupton se zonimi, në secilën anë të kufirit shtetëror, duhet të mundësojë koherencën ekologjike të zonave kufitare dhe të garantojë status mbrojtjeje të ngjashëm për zonat e ndodhura në të dy anët e kufirit shtetëror, me objektivin për të parandaluar situatën kur p.sh. një rezervë natyrore e përcaktuar në njërin anë të kufirit shtetëror është në afërsi të drejtpërdrejtë me zona të shfrytëzuara intensivisht ose të zhvilluara përtej kufirit.

Gjithashtu, duhet të theksohet se zona ndërkufitare është shumë e rëndësishme për mbrojtjen e biodiversitetit, por njëkohësisht ka edhe potencial të lartë reagimi, i cili mund të rezultojë në konflikte të mundshme lidhur me përdorimin e tokës, përveç rastit kur zonimi hapësinor i zonës bazohet në inventarin e rezervave dhe aksesit i vizitorëve është i harmonizuar me kërkesat e ruajtjes.

Një projektim i tillë i harmonizuar hapësinor dhe zonim i brendshëm funksional i zonës së mbrojtur ndërkufitare të propozuar duhet të marrë në konsideratë siç duhet:

- çështjet e pronësisë së tokës;
- rrjetin ekzistues të vendbanimeve dhe prioritetet e zhvillimit të bashkive në të



dy anët e kufirit shtetëror;

- kërkesat për mbrojtjen e zonave të afërta përtej kufirit shtetëror;
- shtigjet e korridoreve ekologjike lidhëse prioritare ndërkufitare (p.sh. korridoret e migrimit të kafshëve të egra) në zonat kufitare.

Plani i Përgjithshëm Vendor (brenda kontekstit ndërkufitar) do të marrë në konsideratë siç duhet si kërkesat për mbrojtjen e biodiversitetit, ashtu edhe kushtet lokale, p.sh. përdorimin aktual të tokës, i cili duhet të rezultojë në një zonim funksional të ekuilibruar dhe shkencërisht të shëndetshëm e të justifikuar të zonave të mbrojtura përtej kufirit, duke marrë në konsideratë funksionet e zhvillimit ekonomik të këtyre zonave.

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në rajon

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në zonë mund të jetë mundësia më premtuese e zhvillimit për ekonominë lokale, burim të ardhurash me rëndësi në rritje duke siguruar mundësi punësimi për banorët vendas dhe një faktor që mund të pakësojë apo të pengojë tendencën aktuale alarmuese të shpopullimit rural dhe të pengojë migrimin e të rinjve nëpër qytete. Zhvillimi i turizmit, njëkohësisht mund të rezultojë në kërkesë në rritje për prodhimet ushqimore dhe artizanale tradicionale vendase.

Janë parashikuar programe/projekte të ndryshme që do të ndihmojnë arritjen e zhvillimit të sektorit të turizmit në Bashkinë e Tropojës. Këto përfshijnë:

- Programe për bashkëpunim të ngushtë të ofertuesve të shërbimeve turistike;
- Vendosja e emërimit 'zonë e mbrojtur ndërkufitare me vlera të jashtëzakonshme natyrore';
- Qartësimi i regjimeve kufitare dhe statusit të kalimit të kufirit në male, me objektivin për të lehtësuar krijimin e shtigjeve ndërkufitare turistike për hiking;
- Promovimi dhe marketimi i prodhimeve vendase bujqësore (p.sh. ushqimet organike) dhe artizanale;
- Mbajtja e programeve për shtigjet ndërkufitare për hiking.

Për faktin se atraksionet kryesore turistike të këtij rajonui (brenda kontekstit ndërkufitar) janë vlerat e jashtëzakonshme peizazhstike dhe natyrore, zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në rajon do të kërkojë bashkëpunim të ngushtë të ofertuesve të shërbimeve turistike me autoritetet e zonave të mbrojtura në rajon, p.sh. mbi zhvillimin e shtigjeve të përbashkëta turistike për hiking dhe rrjetin e qendrave të bashkëpunimit për vizitorët në zonat e mbrojtura. Prandaj, e ardhmja dhe qëndrueshmëria e biznesit turistik, në të gjithë rajonin, është gjerësisht e varur nga bashkëpunimi i autoriteteve të mbrojtjes



së natyrës me autoritetet e bashkisë lokale dhe sektorit të turizmit, për mirëmbajtjen, ruajtjen dhe, nëse nevojitet, edhe për rikthimin e pasurive natyrore, si burimi kryesor i tërheqjes turistike të rajonit.

Emërtimi 'zonë e mbrojtur ndërkufitare me vlera të jashtëzakonshme natyrore' mund të sigurojë 'pikën unike të shitjes' për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm me bazë natyrën, mund të rrisë tërheqjen turistike të rajonit, të lehtësojë njohjen e rajonit dhe tregtimin e prodhimeve turistike rajonale jashtë vendit dhe të ndihmojë në pakësimin e efekteve të mundshme jo të favorshme.

Zhvillimi i prodhimeve të përbashkëta turistike dhe paketa që përfshijnë vizita dhe vep-
rimtari të ndryshme turistike në rajone të ndryshme, në secilën anë të kufijve shtetërorë,
duhet të bazohet në strategjinë e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, të zhvilluar dhe
implementuar për rajonin, i cili duhet të përfshijë ofertuesit e shërbimeve turistike nga
bashki të ndryshme të vendeve fqinje, duke mundësuar kështu një ndarje më të barabartë
të përfitimeve dhe të ardhurave nga turizmi për banorët e pjesëve të ndryshme të zonës,
duke rezultuar mundësisht në një zhvillim më të harmonizuar dhe të përputhshëm të
shërbimeve dhe ndërtimeve ndihmëse në të gjithë rajonin ndërkufitar. Promovimi dhe
tregtimi i prodhimeve bujqësore dhe artizanale vendase mund të organizohet bashkar-
isht gjatë eventeve dhe takimeve tradicionale lokale ndërkufitare.

Zhvillimi dhe publikimi i materialeve të përbashkëta promovuese dhe një hartë e përbashkët për vizitorët është e domosdoshme, duke marrë në konsideratë se hartat turis-
tike apo ato për alpinizëm, aktualisht, është veshtirë të jenë në dispozicion madje edhe
për disa zona më të vogla të të gjithë rajonit ndërkufitar.

Zhvillimi i aplikimeve të përbashkëta për fonde në IPA (Instrument for Pre-Accession Assistance/Instrumenti për Ndihmën Para-Aderuese)

Mbledhja e fondeve është një instrument i shkëlqyer për mundësimin e implementimit të shumë veprimtarive të lidhura me zonat ndërkufitare. Ne kemi marrë në konsideratë mundësinë e zhvillimit të aplikimit të përbashkët për fonde në IPA, në lidhje me veprimtaritë që do të ndërmerren në zonat e mbrojtura ndërkufitare, përfshirë:

- Krijimin e zonave të reja të mbrojtura;
- Zhvillimin e planeve të menaxhimit për zonat e reja të mbrojtura;
- Masat për ruajtjen e biodiversitetit;
- Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Megjithatë, duhet të theksohet se partnerët lokalë, në të dyja anët e kufirit, kanë eks-
periençë të kufizuar në mbledhjen e fondeve të përbashkëta, ndërkohë që me shumë



mundësi projektet e ardhshëm të ndërtimit të kapaciteteve, trajnimet dhe shkëmbimet për personelin e zonave të mbrojtura dhe bashkive lokale do të jenë të varura nga asistenca të disponueshme financiare të jashtme. Kështu, zhvillimi i aplikimeve për fonde do të paraprihet dhe shoqërohet, nëse do të jetë e nevojshme, me trajnime dhe ndërtim kapacitetesh të stafit menaxhues dhe operativ të zonave të mbrojtura ndërkufitare.

2.3 Sistemet territoriale

2.3.1 Konvertimi nga një sistem në tjetrin

Në faqet në vijim, paraqiten në formën e tabelave treguesit e monitorimit, me anë të të cilëve paraqiten ndryshimet e parashikuara, sipas përmasave, midis pesë sistemeve. Përveç shtrirjes së secilit prej sistemeve, tabelat paraqesin detajet e ndryshimeve që strategjitë specifike do të kenë elementet përbërës të sistemeve. Treguesit janë një mjet për personelin e bashkisë, teknikët dhe agjensitë kombëtare për të vlerësuar dhe vëzhguar zbatimin e sakt të strategjive të planit, ato organizojnë informacionin në mënyrë që të qartësojë relatat midis ndikimit të projektit dhe rezultateve, dhe ndihmon në zbardhjen e problemeve që mund të bëhen pengesë për arritjen e objektivave të projektit.

Treguesit e përdorur për vlerësimin e e planit janë “treguesit e vëzhgimit të efektshmërisë” të World Bank. Ata janë përlllogaritur mbi dimensionet e parashikuara dhe të paraqitura në hartat strategjike. Përqindjet janë përlllogaritur duke ndërthurur të dhëna të ndryshme, për secilin rast janë dhënë qartësime specifike në tabela.



TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
<p>Sipërfaqe e përgjithshme (km²) Sipërfaqja e përgjithshme është sipërfaqja totale e rajonit, përfshirë sipërfaqet ujore të prapatakës. <i>Tregues i bankës botrore</i></p>	1,057.3 km ²	1,057.3 km ²	
<p>Sipërfaqe toke (km²) Sipërfaqe toke është sipërfaqja totale e rajonit, me përjashtim të sipërfaqeve ujore të prapatakës, ujërave territorial dhe zonave ekonomike ekskluzive. <i>Tregues i bankës botrore</i></p>	1,044.8 km ²	1,053.6 km ²	Sipërfaqja totale e tokës nuk përfshin trupat ujor të prapatakës siç janë lumenjtë kryesorë dhe lumenjtë. Ndryshimet nga viti në vit mund të jenë të rezultatit të përditësimit apo rishikimit të të dhënave më shumë se sa ndryshimeve.
<p>Dendësia e popullsisë (p/km²) Dendësia e popullsisë është numri i popullsisë në mes të vitit pjestuar sipërfaqe toke në km² <i>Tregues i bankës botrore</i></p>	26.3 p/km ²	st. 29.7 p/km ²	
<p>Popullsia (2011-31) Popullsia totale bazohet tek përcaktimi "de facto" i popullsisë, që numëron të tërë banorët pa marrë parasysh gjendjen ligjore ose shtetësinë. <i>Tregues i bankës botrore</i></p>	27,682 p	st. 31,281 p	Numri i popullsisë së pritëshme në 2031 bazohet në një skenar ku fenomeni i emigrimit është ndalur dhe tendenca e uljes së rritje natyrore të popullsisë barazpeshohet nga rritja e tendencës së rikthimit të popullsisë së emigruar.
<p>Rritja e popullsisë (%) Rritja vjetore e popullsisë është shkalla eksponenciale e rritjes së popullsisë së mesit të vitit, nga viti t-1 në vitin t, e shprehur në %. <i>Tregues i bankës botrore</i></p>	2007-2017 -10%	st. 13.3%	Shkalla e rritjes së popullsisë totale është llogaritur duke u bazuar në një skenar ku fenomeni i emigrimit është ndalur dhe tendenca e uljes së rritje natyrore të popullsisë barazpeshohet nga rritja e tendencës së rikthimit të popullsisë së emigruar.



TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
URBAN	0.78% <i>Tot:</i> 8.2 km ² <i>Industrial:</i> 0.8 km ² <i>Banim:</i> 6.3 km ²	0.69% <i>Tot:</i> 7.3 km ² <i>Industrial:</i> 0.8 km ² <i>Banim:</i> 5.1 km ²	
Popullsia urbane (%) Popullsia urbane i referohet banorëve të zonave urbane sipas përcaktimeve të zyrave kombëtare të statistikave. <i>Tregues i bankës botrore UNECE</i>	29%	st. 34%	Përkufizimi i rekomanduar bazohet në konceptin e "lokalitetit". Një lokalitet është përcaktuar si një grupim i caktuar i popullsisë, që është, zona e përcaktuar nga popullsia që jeton në lagje ose ndërtesa të afërta, ku ndërtesa të afërta janë ndërtesa që: a) formojnë një zonë të ndërtuar të vazhdueshme me formim të qartë të rrjetit rrugor; ose b) edhe pse jo pjesë e një zone të tillë ato përbëjnë një grup ndërtesash të cilat njihen me një emërtim unik; ose c) edhe pse nuk përbushin kushtet e mësipërme përbëjnë një grup ndërtesash me largësi më të vogël se 200m.
Lidhje me shërbimet (% banesa) Përqindje banesash të cilat brenda njësisë së banueshme kanë të lidhur a) ujë të pijshëm; b) rrjetin e ujrave të zeza; c) elekticitet; dhe d) telefon <i>Tregues UNHabitat</i>	22%	st. 57%	<i>Shtim i banesave sociale</i> Zhvillim i politikave të reja për densifikimin dhe konsolidimin e qytetit ekzistues në mënyrë që të gjithë banorët zonave të shërbehen me infrastrukturën parësore (kanalizime, ujësjellës, etj.);
Banasa në zona të rrezikuara (%) Proporcion i njësisve të banimit të ndërtuara në zona të rrezikuara (për 100 njësi banimi). Edhe pse disa banesa mund të jenë ndërtuar me materiale të klasifikuara si rezistues, banorët mund të mos gëzojnë siguri të përshtatshme nëse gjenden në zona të rrezikshme. <i>Tregues UNHabitat</i>	1% nga 8,303 njësi	0% nga 11,251 njësi	<i>Parandalimi i erozionit</i> Fenomeni i erozionit lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, veçanërisht në pjesën më malore të zonës. Ky përbën një kërcënim jo vetëm për biodiversitetin por edhe për banorët e vendosur pranë këtyre zonave. Cilësitë e ekosistemeve ujore mund të ndryshohen ndjeshëm kur materialet e shkaktuara nga erozioni shpëlahen nga ujërat, dhe habitatet në përgjithësi mund të ndikohen fizikisht nga erozioni që vjen nga zonat e sipërme. Prerja e paligjshme e drurëve dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpatë të larta, shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit që së bashku me erozionin që ndodh natyrisht, ndikon ndjeshëm tek habitatet.



TREGUESIT E SISTEMIT	2017	2032	PËRSHKRIMI
NATYRE	88.8% <i>Tot:</i> 939.5 km ²	88.4% <i>Tot:</i> 935.6km ²	st. km ² që transformohen në infrastrukturë kompensohen nga rimëkëmbja e zonave të braktisura
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Përmirësimi i gjendjes së strukturës

Përshkrimi i projektit:

Përkujtimorja e dëshmorëve në Bajram Curri përmban varre të disa prej personaliteteve më të rëndësishme të historisë shqiptare si Bajram Curri dhe Mic Sokoli. Ajo përbëhet nga një sërë shkallësh, tarracash dhe kopshtesh që ndjekin pjerrësinë e terrenit. Pavarësisht se përfaqëson një element të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore dhe historike për vendin, sot është në një gjendje shumë të degraduar dhe ka nevojë për ndërhyrje urgjente restaurimi. Në vitet e fundit ka pasur ndërhyrje të rralla nga organizata vendore dhe të huaja. Projekti ka për qëllim restaurimin e strukturave ekzistuese, rehabilitimin e kopshteve të tarracuara dhe mbrojtjen e varreve të dëshmorëve.





Faqe web për informacione mbi territorin




03.1 Krijimi i një faqeje interneti me shtigjet kryesore, veprimtaritë turistike, informacione, udhërrëfyesit, hotelet dhe bujtinat, kontaktet.

Emri i Projektit:	Krijimi i një faqeje interneti me rrugët kryesore, tërheqjet, veprimtaritë turistike, informacion për florën dhe faunën, gastronominë dhe prodhimet tradicionale, udhërrëfyesit, hotelet dhe bujtinat, kontaktet... (projekt)
Vendndodhja:	Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Sipërmarrje private
Fazat:	1) 2018-2020 2) 2021-2022
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Faqja e internetit

Përshkrimi i projektit:

Territori i Tropojës po bëhet një tërheqje e rëndësishme turistike për vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë. Interneti është sigurisht mjeti më i fuqishëm i komunikimit për të promovuar këtë territor dhe për ta bërë atë të dukshme në mbarë botën. Faqja e rrjetit "Turizmi-tropoja" do të ofrojë një udhëzues gjithëpërfshirës dhe të organizuar mirë për rrugët kryesore turistike, atraksionet, aktivitetet, informacionin mbi florën dhe faunën, gastronominë dhe produktet tradicionale, si dhe do të përmbajë informacion mbi hotelet dhe shtëpitë pritëse, duke përfshirë kontaktet dhe recensionet. Faqja e internetit do të promovohet dhe koordinohet nga bashkia, mbështetur nga autoritetet kombëtare dhe organizatat e specializuara vendore dhe të huaja. Faqja e internetit do të përfshijë materiale dixhitale, imazhe dhe një hartë zyrtare turistike të Tropojës që mund të konsultohet në gjuhë të ndryshme dhe formate digjitale.





Shtegu
Valbonë-Theth



03.2 Pajisja e shtigjeve Valbone - Theth me shërbimet e nevojshme dhe infrastrukturat e vogla plotësuese (vende soditjeje, çlodhjeje..etj.)


Emri i Projektit:	Pajisja e shtigjeve Valbone - Theth me shërbimet e nevojshme dhe infrastrukturat e vogla plotësuese (vende soditjeje, çlodhjeje..etj.)
Vendndodhja:	Valbonë, Bashkia Tropojë
Përmasa:	11.2 km
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	FShZh dhe Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Shtigjet historike janë bërë shumë të populllore midis një bashkësie ndërkombëtare Alpinistësh, të cilët vlerësojnë natyrën kryesisht të pakorruptuar të luginave dhe maleve të Tropojës. Në mënyrë që të nxitet turizmi i butë në rajon është e rëndësishme të ruhen dhe rehabilitohen shtigjet e shumta historike që ende kalojnë territorin. Kjo do të thotë që shtigjet për "hiking" duhet të mirëmbahen dhe

përmirësohen nëpërmjet strukturave ndihmëse specifike si pikat informative, vend-soditjet, stolat, tabelat informative dhe vendet e pajisura për kampe. Të gjitha këto elemente nuk duhet të jenë invazive dhe duhet të integrohen me kujdes brenda peizazhit. Në këtë mënyrë shtigjet historike bëhen një rrjet që mundëson të vizituarit të territorit të Tropojës duke ruajtur vlerat e tij natyrore. Shtegu Valbonë-Theth është më njohuri dhe i përdoturi në Tropojë dhe për këtë arsye do të jetë shtegu i parë ku të ndërhyhet. Kjo do të përfaqësojë një mundësi shëmbullore për të zhvilluar një qasje që mund të riprodhohet lehtësisht në shtigje të tjera kryesore ose të reja në rajon.





Tjetërsimi i një ish-kazerme ushtarake

03.3 Tjetërsimi i një ish kazerme ushtarake në Lekbibaj në qendër turistike


Emri i Projektit:	Tjetërsimi i një ish kazerme ushtarake në Lekbibaj në qendër turistike
Vendndodhja:	Lekbibaj, Bashkia Tropojë
Përmasa:	780 sqm
Kosto e ndërhyrjes:	21 060 000 ALL/156000 Euro
Burimet financiare:	PPP, Bashkia Tropojë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Ne besojmë se zhvillimi i turizmit në rajon nuk është vetëm një mundësi ekonomike, por gjithashtu duhet të përfaqësojë mundësinë për të ruajtur sistematikisht peizazhin natyror të rajonit. Tropoja duhet të zhvillojë një model të përshtatshme hoteliere, me tipologji të larmishme sipas ambicieve të ndryshme të territorit.

Një shembull praktik i kësaj strategjie është zhvillimi i dy strukturave turistike në Lekbibaj në një zonë ish ushtarake. Njëra nga strukturat, një hotel, do të zhvillohet më afër qendrës së njësive vendore, ndërkohë që një “ndalesë për turistët” në pjesën e poshtme të zonës, do të drejtohet turistëve dhe “hiker”-ave të Parkut Nikajt Merturi (zona është e vendosur në hyrje të parkut). Zhvillimi i një strukture të tillë do të ketë një ndikim të madh për zonën, në veçanti për parkun e Nikaj Merturit dhe promovimin e turizmit të butë.





Tjetërsim i
pjeshëm i
staneve



03.4 Tjetërsimi i pjesshëm i staneve ekzistues për mikëpritje turistësh (projekt pilot - të zgjidhet çështja e infrastrukturës bazë, strukturë modulare..)

Emri i Projektit: Tjetërsimi i pjesshëm i staneve ekzistues për mikëpritje turistësh (projekt pilot - të zgjidhet çështja e infrastrukturës bazë, strukturë modulare..)

Vendndodhja: Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: Sipërmarrje private, Donatorë

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -


Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Struktura

Përshkrimi i projektit:

Stanet tradicionale të kullotave alpine të Tropojës (bjeshkët) përfaqësojnë një burim të rëndësishëm ekonomik për shumë fermerë lokalë dhe mund të jenë një tërheqje interesante turistike për ata vizitorë që duan të zbulojnë pjesë të pandotura dhe të paeksploruara të territorit. Projekti ka të bëjë me ripërdorimin dhe kthimin e pjesshëm të këtyre strukturave në strehim të përkohshëm për turistët dhe banorët lokalë. Ky projekt do të zbatohet sipas kufizimeve dhe dispozitave të rregullores kombëtare për zonat e mbrojtura të Alpeve Shqiptare, duke marrë parasysh aspektet tradicionale, tipologjitë, materialet dhe respektin e peizazhit. Ndërhyrja propozon ndërtimin e një stehimi të përkohshëm prej druri mbi muret ekzistuese dhe qelizat e vogla modulare për "infrastrukturën" bazë siç janë një kuzhina, vatra, tualeti dhe hapësirat e magazinimit. Këto module mund të përshtaten për përdorime dhe dimension të ndryshëm të strukturave.





Rifunksionimi
i tarracës së
Babinës



04.1 Projekt për rifunksionimin e tarracës në Babin me pemë frutore

Emri i Projektit:	Projekt për rifunksionimin e tarracës në Babin me pemë frutore
Vendndodhja:	Babin, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	PPP, Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Sasi e prodhuar

Përshkrimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim nxitjen e sistemit agro-pyjor në fusha të pakultivuara dhe tarraca të braktisura në Babinë. Ai ka të bëjë me diversifikimin e kultivimeve nëpërmjet mbjelljeve të alternuara të kulturave të ulëta dhe pemëve frutore. Sistemi agro-pyjor do të kontribuojë përmirësimin e produktivitetit të tokës duke e stabilizuar atë dhe duke siguruar një kullim cilësor. Kjo gjithashtu do të kontribuojë në krijimin e një mjedis të larmishëm bujqësor dhe ekosistem kompleks. Projekti propozon katër modele alternative që do të aplikohen sipas llojit specifik të plantacioneve dhe morfologjisë së fushave.





Toka bujqësore



04.2 Zbatimi i strategjisë për bujqësinë organike (Bio-rajoni)

Emri i Projektit:	Zbatimi i strategjisë për bujqësinë organike (Bio-rajoni)
Vendndodhja:	Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	PPP, Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Sasi e prodhuar

Përshkrimi i projektit:

Territori i Tropojës është kryesisht kodrinor dhe malor. Karakterizohet nga terreni i pjerrët dhe sipërfaqe horizontale dhe është i ekspozuar ndaj erozionit. Ky kusht ka qenë një pengesë për zhvillimin e një prodhimtarie bujqësor intensive dhe të mekanizuar dhe në të njëjtën kohë paraqet mjedisin e përsosur ku të zhvillohet prodhimtaria e bujqësisë organik. Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes zbatimit të metodave të prodhimit bujqësor që janë në përputhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, peizazhit, burimet natyrore, tokës dhe diversitetit gjenetik. Bujqësia organike ka treguar të jetë një treg në rritje dinamike, duke rritur nivelin e cilësisë së mjedisit dhe duke shtuar vlerën e produktit përfundimtar.





Pika për
grumbullimin
e produkteve
ushqimore



04.3 Pika për grumbullim dhe përpunim të produkteve ushqimore (gështenja, bimë mjekësore, thertore, baxho) Vlad, Tropoja, Bajram Curri

Emri i Projektit: Pika për grumbullim dhe përpunim të produkteve ushqimore (gështenja, bimë mjekësore, thertore, baxho) Vlad, Tropoja, Bajram Curri

Vendndodhja: Bashkia Tropojë

Përmasa:

Kosto e ndërhyrjes:

Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare:

PPP, Donatorë

Fazat:

1) 2018-2020

Përgjegjësia:

Bashkia Tropojë

Burimet njerzore:

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Sasi e prodhuar

Përshkrimi i projektit:

Gështenja janë një produkt shumë i rëndësishëm i këtij territori. Të ardhurat e krijuara prej tyre janë një ndihmë me peshë për një numër të madh familjesh. Gështenja e grumbulluara aktualisht përpunohen me teknika tradicionale dhe shiten në mënyrë të pa organizuar tek mbledhësit që vijnë në Bajram Curri për t'i blerë ato. Në Bajram Curri është bërë një investim i parë privat për të ndërtuar një pikë grumbullimi për gështenjat. Aktualisht ky investim ka ndalur për shkak të mungesës së buxhetit. Përfundimi i kësaj pike grumbullimi është shumë i rëndësishëm për ekonominë lokale dhe modele shoqërisht duhet t'i propozohen investitorit kryesor për të gjetur një strategji për të mbështetur investimin e tij. Përveç kësia, duke marrë parasysh dimensionet e ekosistemit të gështenjave një tjetër pikë grumbullimi do të duhet të ndërtohet në Bujan. Ndërtimi i një strukture për mbledhjen, përpunimin dhe tregtimin e gështenjave mund të sjellin disa përfitime. Këto përfitime mund të jenë nga krijimi i një shoqate të mbledhësve të gështenjave që sjell një menaxhim më të mirë të këtij ekosistemi, tek krijimi i një marke tregtare dhe menaxhimi i çmimit të shitjes.





Qendër për mbështetjen e bujqësisë



04.4 Qendër në Ndhimë të Bujqësisë dhe Qendër Shpërndarje në Valbonë

Emri i Projektit:	Qendër në Ndhimë të Bujqësisë dhe Qendër Shpërndarje në Valbonë
Vendndodhja:	Valbonë, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Bashkia Tropojë, Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Fshati i Valbonës është hyrja në parkun kombëtar dhe porta e rrugëve të rëndësishme turistike dhe të ecjes. Ajo është e vendosur në një pozitë shumë strategjike për të promovuar territorin tek vizitorët. Projekti propozon ndërtimin e një pike të shpërndarjes për shitjen e produkteve ushqimore lokale, duke përfshirë bagëtinë, produktet e baxhove, mjaltin etj. Kjo qendër do të ndihmojë fermerët e vegjël lokal që të shesin produktin e tyre. Këto qendra gjithashtu kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për fermerët duke përfshirë qendrën për mbështetje bujqësore, qendrat e formimit, qendrën veterinare, pikën e shitjes, etj.





Treg rajonal në
Bajram Curri



04.5 Krijimi injë tregu rajonal në Bajram Curri

Emri i Projektit:	Krijimi injë tregu rajonal në Bajram Curri
Vendndodhja:	Bajram Curri, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Bashkia Tropojë, Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Në rajonin e Tropojës mungojnë qendrat për shpërndarjen e produkteve vendore dhe shumica e prodhimeve i referohen drejtpërdrejt tregut të Giakovës. Kjo tendencë duhet të përmbysset nëpërmjet krijimit të një tregu të fortë rajonal, me qëllim rritjen e të ardhurave nga prodhimet vendore dhe shmangien e zhvlerësimit të mëtejshëm të tyre. Në këtë kontekst, krijimi i një certifikimi rajonal do të luajë gjithashtu një rol kyç. Bajram Curri do të jetë tregu kryesor për prodhimet e rajonit të alpeve dhe do të jetë pikë referimi për tregun e eksportit. Tregu i Bajram Currit do të funksionojë si qendër për certifikimin rajonal që do të garantojë cilësinë dhe prejardhjen e produkteve ushqimore. Ai gjithashtu do të përcaktojë standardet për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare për tregun e BE dhe do të kontribuojë në promovimin e produkteve biologjike, produkteve me emërtim të origjinës së mbrojtur (EOM), treguesve të mbrojtjes gjeografike (PGI) dhe produkteve tradicionale vendase.





Shkollë
bujqësore në
Llugaj



04.6 Krijimi i një shkolle bujqësore në Llugaj

Emri i Projektit:	Krijimi i një shkolle bujqësore në Llugaj
Vendndodhja:	Llugaj, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Ministria e arsimit, Donatorë
Fazat:	3) 2022-2026
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Ky projekt ka të bëjë me ndërtimin e një shkolle profesionale të specializuar për bujqësinë në Llugaj. Shkolla do të vendoset në një pozicion strategjik dhe të lidhur mirë për të tërhequr studentë të rinj nga i gjithë rajoni. Do t'u drejtohet studentëve që synojnë të mbështesin dhe të fitojnë përvojë në sektorin bujqësor. Kjo shkollë do të ofrojë aftësi profesionale dhe do të sigurojë trajnimin e figurave të ardhshme profesionale, duke promovuar hulumtimet në sektorin e bujqësisë. Kurset e trajnimit do të përfshijnë gjithashtu programet e partneritetit me kooperativat lokale ose ndërmarrjet ku nxënësit do të përfitojnë nga mundësia e ndërveprimit me komunitetin e fermerëve lokal, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e njohurive të tyre përmes praktikës.





Stacion intermodal për tragete në Fierzë




05.1 Stacioni intermodal trageti në Fierzë dhe zgjatimi i linjës Fierzë-Koman deri në qendër të Fierzës

Emri i Projektit:	Stacioni intermodal trageti në Fierzë dhe zgjatimi i linjës Fierzë-Koman deri në qendër të Fierzës
Vendndodhja:	Fierzë, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	FSHZH
Fazat:	3) 2023-2027
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Terminali

Përshkrimi i projektit:

Qëllimi i projektit është përmirësimi i linjës ekzistuese të trageve që lidh Fierzën me Komanin dhe zhvendosjen e stacionit në qendër të Fierzës. Linja e trageve ka nevojë për përmirësime të rëndësishme në mënyrë që të ofrojë një shërbim më të mirë për popullatën dhe turistët, duke shtuar ndalesa të reja përgjatë lumit (për këmbësorë dhe udhëtarët) në fshatrat Markaj dhe Salcë. Si një pikë intermodale e rëndësishme për territorin, ndalesa e trageve në qendër të Fierzës duhet të restaurohet dhe transformohet në një hapësirë publike multifunksionale. Këto shërbime do të siguronin një përvojë unike në qasjen në peizazhin e rajonit dhe sinergjitë ndërmjet anijeve dhe autobusëve duhet të zhvillohen në mënyrë progresive.





05.2 Mbështetja e shoqatave të transportit kolektiv (për formalizimin, nënkontraktimin e shërbimit dhe rregullimin e itinerareve , orareve dhe çmimeve)

Emri i Projektit: Mbështetja e shoqatave të transportit kolektiv (për formalizimin e transportit kolektiv, për të dhënë mundësinë e nënkontraktimit të shërbimit dhe për të rregulluar itineraret e transportit, oraret dhe çmimet)

Vendndodhja: Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: Bashkia Tropojë, Ministria e infrastrukturës

Fazat: -

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Antarë

Përshkrimi i projektit:

Si një lloj projekti rinovimi, mbështetja e shoqatave të transportit kolektiv është i nevojshëm për të formalizuar këtë transportin, për të siguruar mundësinë e nënkontraktimit të shërbimit dhe për të rregulluar trajtat, oraret dhe çmimet e transportit. Situata aktuale nuk ofron ndonjë mundësi për të planifikuar një udhëtim ose organizimin e grupeve që lëvizin me anë të transportit publik. Veprimet e para mund të jenë identifikimi i rrugëve dhe përkufizimi i orareve dhe më pas krijimi i një identiteti të qartë për linjat e autobusëve. Ky lloj projekti do të përfshijë fusha të ndryshme të punës si inxhinierë të transportit, “gesigner” grafik etj.

(në faqen
paraardhëse)
Harta e
mobilitetit





Stacion Intermodal në Bajram Curri




05.3 Ndërtimi i stacionit intermodal në Bajram Curri

Emri i Projektit:	Ndërtimi i stacionit intermodal në Bajram Curri
Vendndodhja:	Bashkia Tropojë
Përmasa:	1100 sqm
Kosto e ndërhyrjes:	2 700 000 ALL
Burimet financiare:	FSHZH, Ministria e infrastrukturës
Fazat:	2) 2021-2022
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Stacioni

Përshkrimi i projektit:

Megjithëse infrastrukturat kryesore të rajonit po përballen me një proces përmirësimi në vitet e fundit, qasja përmes transportit publik në Tropojë ende duhet të përcaktohet dhe të përmirësohet. Një nga ndërhyrjet kryesore strategjike është sigurisht një stacion cilësor intermodal në Bajram Curri (ku ende mungon një platformë shërbimesh për transportin publik) me qëllim përmirësimin e qasjes nga qendrat kryesore të vendit dhe nga shtetet fqinje si Kosova dhe Mali i Zi përmes transportit publik. Stacioni do të jetë pika kryesore e shkëmbimit të mjeteve të transportit dhe do të ofrojë mundësi për të eksploruar territorin përmes mënyrave të ndryshme të transportit. Stacioni intermodal është vendosur në anën e pasme të Qendrës Kulturore të Bajram Currit, në anën jugore të qendrës së qytetit, ku arrihet duke përshkuar unazën e re të qytetit.





Sheshi i ri
qendror në
Bajram Curri



06.1a Realizimi i një sheshi/hapësire të re në Bajram Curri

Emri i Projektit: Realizimi i një sheshi/hapësire të ri në Bajram Curri

Vendndodhja: Bajram Curri, Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: PPP

Fazat: 2) 2021-2022

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Hapësira publike

Përshkrimi i projektit:

Kjo seri e ndërhyrjeve synon të fillojë një proces të restaurimit të hapësirave publike siç janë sheshet, oborret dhe kopshtet në rrethe të ndryshme të qendrave dhe fshatrave kryesore. Duhet të sigurohet prania e këtyre hapësirave, si dhe qasja për të gjithë qytetarët. Propozimet përqëndrohen në pikat strategjike në lagje që në njëfarë mënyre mund të riaktivizojnë aktivitetet sociale: zona të reja të shtruara, zona të gjelbra dhe mobilje të hapura do të jenë elementët fillestarë të këtyre ndërhyrjeve shumë të thjeshta. Këto hapësira do të krijojnë qendra për funksionet kryesore publike dhe do të sigurojnë zonave të banuara / urbane shërbimin e duhur me hapësira publike. Këto modele të para do të punojnë si prototip për ndërhyrjet e ardhshme në qendra.





Hapësirë e
re publike në
Tropojë



06.1b Realizimi i një sheshi/hapësire të re në Tropojë

Emri i Projektit: Realizimi i një sheshi/hapësire të ri në Tropojë

Vendndodhja: Tropojë, Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: AZHR, Ministria e infrastrukturës

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Hapësira të sistemuara

Përshkrimi i projektit:

Kjo seri e ndërhyrjeve synon të fillojë një proces të restaurimit të hapësirave publike siç janë sheshet, oborret dhe kopshtet në rrethe të ndryshme të qendrave dhe fshatrave kryesore. Duhet të sigurohet prania e këtyre hapësirave, si dhe qasja për të gjithë qytetarët. Propozimet përqëndrohen në pikat strategjike në lagje që në njëfarë mënyre mund të riaktivizojnë aktivitetet sociale: zona të reja të shtruara, zona të gjelbra dhe mobilje të hapura do të jenë elementët fillestarë të këtyre ndërhyrjeve shumë të thjeshta. Këto hapësira do të krijojnë qendra për funksionet kryesore publike dhe do tu sigurojnë zonave të banuara / urbane shërbimin e duhur me hapësira publike. Këto modele të para do të punojnë si prototip për ndërhyrjet e ardhshme në qendra.





Hapësirë e re
publike në Pac

06.1c Realizimi i një sheshi/hapësire të re në Pac

Emri i Projektit: Realizimi i një sheshi/hapësire të ri në Pac

Vendndodhja: Pac, Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: AZHR, Ministria e infrastrukturës

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -


Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Hapësira të sistemuara

Përshkrimi i projektit:

Kjo seri e ndërhyrjeve synon të fillojë një proces të restaurimit të hapësirave publike siç janë sheshet, oborret dhe kopshtet në rrethe të ndryshme të qendrave dhe fshatrave kryesore. Duhet të sigurohet prania e këtyre hapësirave, si dhe qasja për të gjithë qytetarët. Propozimet përqëndrohen në pikat strategjike në lagje që në njëfarë mënyre mund të riaktivizojnë aktivitetet sociale: zona të reja të shtruara, zona të gjelbra dhe mobilje të hapura do të jenë elementët fillestarë të këtyre ndërhyrjeve shumë të thjeshta. Këto hapësira do të krijojnë qendra për funksionet kryesore publike dhe do tu sigurojnë zonave të banuara / urbane shërbimin e duhur me hapësira publike. Këto modele të para do të punojnë si prototip për ndërhyrjet e ardhshme në qendra.





Rehabilitimi
i hapësirave
publike në
Bajram Curri

06.2 Rehabilitimi i hapësirave publike në lagjen Partizani

Emri i Projektit:	Rehabilitimi i hapësirave publike në lagjen Partizani
Vendndodhja:	Bajram Curri, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	33 700 000.00 ALL
Burimet financiare:	PPP
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Hapësira të sistemuara

Përshkrimi i projektit:

Rehabilitimi i qendrave urbane (të mëdha dhe të vogla) përqendrohet në veçanti në përmirësimin e kushteve të hapësirës së hapur dhe publike. Hapësirat publike janë thelbësore për organizimin social të komunitetit dhe vendndodhjen primare të shkëmbimeve personale, siç janë ato që ndodhin në shkallën e lagjes. Duhet të sigurohet prania e këtyre hapësirave si dhe arritshmëria nga të gjithë qytetarët. Për të siguruar praninë e hapësirave publike në të gjitha zonat e urbanizuara ne propozojmë ndërtimin e hapësirës së re publike lineare përgjatë rrugëve kryesore urbane dhe rurale. Së bashku me këtë hapësirë të re publike lineare, do të identifikohen vende për ndërhyrje “molekulare” që lidhen me zbatimin e formave të reja të hapësirës publike (si kopshte, patio publike dhe sheshe etj.). Kjo hapësirë do të lidhë mes tyre funksionin kryesor publik dhe do t’u ofrojë zonave të banuara / urbane lidhjen e duhur me hapësirën publike. Ndërtimi i saj do të ofrojë gjithashtu mundësinë e ndërtimit të një boshti kryesore infrastrukture (ujërave të zeza, etj.) Për të gjitha qendrat urbane.





Rikonstruksioni
i oborrit të
shkollës në
Jaho Salihi



06.3 Rikonstruksioni i oborrit të shkollës në Jaho Salihi

Emri i Projektit: Rikonstruksioni i oborrit të shkollës në Jaho Salihi

Vendndodhja: Bashkia Tropojë

Përmasa: 250 sqm

Kosto e ndërhyrjes: 5 062 500.00 ALL

Burimet financiare: Bashkia Tropojë, Donatorë

Fazat: 4) 2029-2032

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Struktura

Përshkrimi i projektit:

Megjithëse shkollat fillore janë të shpërndara mirë në territor, shumica e tyre kanë nevojë për një proces restaurimi, sidomos hapësira e lira ku fëmijët janë të lirë të luajnë dhe të bëjnë sport. Një proces i parë rinovimi dhe racionalizimi i shkollave ka filluar tashmë, por duke u fokusuar në ndërhyrjet e ndërtesave. Fushat e sportit dhe zonat e gjelbra në shkollën në Jaho Salihi dhe në qendrat e tjera urbane të Tropojës prezantojnë një mungesë të theksuar mirëmbajtjeje; një ndërhyrje e vogël do t'i lejonte nxënësit të përdorin përsëri këtë hapësirë të shkollës.





Rinovimi i muzeut të Bajram Currit



06.4 Rinovimi i ndërtesës së muzeut të Bajram Currit

Emri i Projektit: Rinovimi i ndërtesës së muzeut të Bajram Currit

Vendndodhja: Bajram Curri, Bashkia Tropojë

Përmasa: 600 sqm

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: Bashkia Tropojë, Donatorë

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -


Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -

Treguesit e monitorimit të zbatimit: Struktura

Përshkrimi i projektit:

Muzeu i Bajram Currit ka një rol të rëndësishëm në procesin e transformimit të qytetit. Si edhe qyteti do të bëhet pika fillestare e eksplorimit të turistëve të rajonit. Muzeu i Bajram Currit do të mbajë ekspozita përhershme dhe të përkohshme për të gjithë territorin. Hapësirat e muzeut janë në gjendje të mirë, por kanë nevojë për një program të përcaktuar të ekspozitave dhe ngjarjeve, dhe një ristrukturim të ekspozitorëve të re të lidhur ngushtë me karakterin e rajonit të Tropojës.





06.5 Përmirësimi i varrezave në Margegaj

Emri i Projektit: Përmirësimi i varrezave në Margegaj

Vendndodhja: Margegaj, Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: 67 500 000 ALL

Burimet financiare: Bashkia Tropojë, Donatorë

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore: -


Treguesit e monitorimit të zbatimit: Struktura

Përshkrimi i projektit:

Varrezat e Margegajt, si raste të tjera të ngjashme, kanë nevojë për ndërhyrje të rëndësishme strukturore, për të përcaktuar një kufi dhe për të përmirësuar qasjen në varreza. Tipologjia dominuese e varrezave ekzistuese duhet të ruhet, duke futur forma të reja të varrimit sipas ligjit vendas dhe duke përhapur praninë e drunjve (qeparis), sidomos për të kufizuar perimetrin e varrezës dhe për të përcaktuar shtigjet për të lëvizur nëpër të. Kjo ndërhyrje mund të jetë një prototip për ndërhyrjet e ardhshme në varrezat në rajon.

Përmirësimi i varrezave në Margegaj





Projekt për
strehim social



06.6 Rikualifikimi i ndërtesës ekzistuese me shtimin e një kati për t’u përdorur për strehim social

Emri i Projektit:	Rikualifikimi i ndërtesës ekzistuese me shtimin e një kati për t’u përdorur për strehim social
Vendndodhja:	Bajram Curri, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t’u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Bashkia Tropojë, Donatorë
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Nevoja për strehim social në bashki dhe përmirësimi i ofertës aktuale të strehimit social janë dy pika të rëndësishme të trajtuara në PPV të Tropojës. Një nga strategjitë më efikase, që mund të realizohet në afatin e shkurtër, është ndërtimi i një kati shtesë për ndërtesat ekzistuese si një “papafingo” për programin e strehimit social. Kjo politikë do të lejojë bashkinë të përballë nevojat për strehim social ndërsa pronarët privatë do të përfitojnë falas përmirësimin e kushteve energjitike por edhe estetike të ndërtesës.





Hoteli i punëtorëve



06.7 Rikualifikimi i “Hotelit të punëtorëve” rrugën Sulejman Vokshi

Emri i Projektit:	Rikualifikimi i “Hotelit të punëtorëve” në rrugën Sulejman Vokshi
Vendndodhja:	Bajram Curri, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t’u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	EKB, Donatorë
Fazat:	3) 2023-2027
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Struktura

Përshkrimi i projektit:

Nevoja dhe përmirësimi i ofertës aktuale të strehimit social janë dy pika të rëndësishme të trajtuara në PPV të Tropojës. Me qëllim të përgjigjet nevojës për banim social në Bajram Curri, ky projekt pilot synon ri-rikualifikimin e ndërtesave publike të braktisura, si “hoteli i punëtorëve” ose ndërtimi i strukturës së re të strehimit social në parcelat publike në qytet. Politikat kombëtare dhe donatorët mund të ndihmojnë bashkinë në këtë proces transformimi në një moment historik në të cilin Shqipëria është vërtet e ndjeshme ndaj problemit të strehimit social.





Pëmrësimi
i rrugëve
ekzistuese



07.1 Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese

Emri i Projektit: Përmirësimi i rrugëve rurale ekzistuese

Vendndodhja: Bashkia Tropojë

Përmasa: -

Kosto e ndërhyrjes: Për t'u detajuar gjatë projektit

Burimet financiare: Bashkia Tropojë, Donatorë

Fazat: 1) 2018-2020

Përgjegjësia: Bashkia Tropojë

Burimet njerzore: -


**Ndryshimet e nevojshme
institucionale dhe ligjore:** -

**Treguesit e monitorimit të
zbatimit:** Materiale informuese

Përshkrimi i projektit:

Qëllimi i projektit është të transformojë rrugët rurale më të përdorura të rajonit në rrugë të sigurtat si për makinat ashtu edhe për këmbësorët. Kjo kërkon ndërhyrje për të përmirësuar kushtet e kësaj kategorie të infrastrukturës dhe për të ngritur standardin në një nivel të mirë. Këto ndërhyrje janë planifikuar në mënyrë të tillë që të kombinohen përmirësimet në fusha të ndryshme të infrastrukturës (elektrike, uji, rrjeti i kanalizimeve) në çdo veprim përmirësimi që lejon buxheti i bashkisë. Këto përmirësime duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të parashikojnë nevojat e infrastrukturës në të ardhmen.





Projekt për
landfill në
Bajram Curri



07.2 Realizimi i landfillit në Bajram Curri

Emri i Projektit:	Realizimi i landfillit në Bajram Curri
Vendndodhja:	Bajram Curri, Bashkia Tropojë
Përmasa:	-
Kosto e ndërhyrjes:	Për t'u detajuar gjatë projektit
Burimet financiare:	Ministria e infrastrukturës, Ministria e mjedisit
Fazat:	1) 2018-2020 2)2020-2022
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë, Ministria e infrastrukturë
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Landfilli

Përshkrimi i projektit:

Menaxhimi i mbetjeve është një çështje e rëndësishme me të cilën bashkia duhet të përballet. Mungesa e burimeve ekonomike dhe njerëzore dhe shpërndarja e gjerë e vendbanimeve në këtë territor e bën këtë menaxhim një sfidë të fortë. E vetmja mënyrë që menaxhimi i mbetjeve të jetë i kënaqshëm në Tropojë është të shihet si një ekonomi. Në të vërtetë praktikatat e mira në administrimin e mbetjeve mund të garantojnë lëndë të para, plehurat, biogaz, ujë të ricikluar për përdorime bujqësore, si dhe vende pune. Kjo duhet të fillojë me ndërgjegjësimin e popullsisë dhe organizimin e praktikave të efektshme të mbledhjes së mbetjeve. Projekti parashikon krijimin e një impianti për përpunimin e mbeturinave ku riciklimi, kompostimi, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza janë të vendosura pranë njëri-tjetrit në mënyrë që të maksimizohet prodhimi i kësaj industrie.





Zinxhir i trajtimit, ligatinat



07.3 Zinxhir i ligatinave për të kryer trajtimin dytësor të ujërave të zeza në Fierzë

Emri i Projektit:	Zinxhir i ligatinave për të kryer trajtimin dytësor të ujërave të zeza në Fierzë
Vendndodhja:	Fierzë, Bashkia Tropojë
Përmasa:	5000 sqm
Kosto e ndërhyrjes:	4 500 000.00 ALL
Burimet financiare:	Ministria e infrastrukturës, Ministria e mjedisit
Fazat:	1) 2018-2020
Përgjegjësia:	Bashkia Tropojë, Ministria e infrastrukturës
Burimet njerzore:	-
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore:	-
Treguesit e monitorimit të zbatimit:	Ligatina

Përshkrimi i projektit:

Ujërat e zeza të qendrave të banuara në bashkinë Tropojë shkarkohen, duke kontaminuar seriozisht mjedisin dhe prodhimet bujqësore. Trajtimi i ujërave të zeza në këtë zonë është një çështje urgjente: ky trajtim duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare Sektorial për Shërbimet e Ujësjetës Kanalizimeve 2011-2017 dhe Direktivat e BE-së. Trajtimi i ujërave të zeza me teknologji specifike është veçanërisht e nevojshme në qendrat kryesore. Kjo ndërhyrje është urgjente në Fierzë, ku rrjeti ekzistues i ujërave të zeza përfundon në gropë septike të përbashkët pranë lumit dhe nuk ka trajtim të mëtejshëm.





4 KONSULTIMET ME PALËT E INTERESUARA





4.1 Raporti i takimeve me komunitetin

4.1.1 Takimi në Lekbibaj

Data e zhvillimit të takimit: 10 Nëntor 2016

Ora e fillimit të takimit: 11:00

Kohëzgjatja e takimit: 3 orë

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi	–	Ekspert i turizmit dhe komunikimit
Hasan Çuka	–	Drejtor i Zyrës së urbanistikës bashkia Tropojë
Ermal Blea	–	Arkitekt, Studio B&L
Saimir Duçellari	–	Arkitekt, Studio B&L
Antonio Paolillo	–	Arkitekt, Dogma
Ezio Melchiorre	–	Arkitekt, Dogma
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma
Martino Tattara	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 16

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Lekbibaj u zhvillua në mjediset e kesaj njesie Administrative Në fillim të takimit Z. Ermal Blea, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA-së Lekbibaj. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohet diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Zona përfaqësohet nga atraksionet turistike:

- *Parku Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur.*



- *Burimi karstik i Qirecit*
- *Kisha e Brisës*
- *Curraj i Epërm*

Çështje mjedisore

I gjithë territori i njesisë Lekbibaj paraqet një pjesë tipike të maleve veriore shqiptare dhe të pjesës jugore të Harkut Dinarik. .

Ajri është shumë i pasur me oksigjen, dhe njerzit për rrjedhojë gëzojnë shëndet të mirë.

Kësaj zone nuk i ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve por çdo shtëpi menaxhon vete mbetjet duke i propozur ato dhe duke i kthyer në pleh organik. Prandaj sipas banorëve zona nuk ka probleme që rrjedhin një menaxhimi jo të mirë të mbetjeve.

Problem për banorët është sistemi i vaditjes. Të pranishmit pohuan që e gjithë zona mbulohet nga një kanal vaditës me gjatesi 8 km dhe nga ana e tyre kërkohet rikonstruksioni i sistemit të vadites. Zona nuk është problematike për sa i takon përmbytjeve.

Çështje të përdorimit të tokës

Fakti i prezencës së zonalitetit të jashtëzakonshëm vertikal tregon se një gamë e gjerë e bimësisë mund të gjendet këtu, ndërkohë që pjesa kryesore e vegjetacionit natyror është ndryshuar ndër vite nga praktikat e përdorimit tradicional. Vetëm në malet e larta mund të haset bimësia natyrore e tillë si: pyjet e ahut, livadhet alpine, dhe ai i vegjetacionit të shkëmbinjve të pjerrët. Zonat më të pershtatshme janë shndërruar kohë më parë në tokë të punueshme, livadhe, pemishte dhe kopshte, ose janë zënë nga shtëpitë, plevicat, rrugët etj.

Banorët e zonës shprehen se toka është pjellore dhe krahas bimëve të arave, në zonë gjen kushte të përshtatshme të kultivohet dhe kultura e gështenjës. Banorët, gjithashtu merren dhe me kultivimin dhe mbledhjen e bimëve medicinal si psh bliri. Ferma të shpërndara, sipërfaqe massive pyjesh cungishte, shumë pak pyje me pisha dhe disa plantacione të gjera gështenje janë karakteristikat kryesore të zonës.

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Në vitin 1991 popullisa e kësaj zone ishte 9150 banorë. Progresioni demografik është në rënie dhe aktualisht popullsia është 2100 banorë. Në Lekbibaj banojnë 270 familje nga 630 që ishin gjithësej. Kjo njësi, shënon dhe vlerat më të larta për sa i takon lëvizjes së popullsisë, por gjithashtu shënon dhe nivelet më të larta për sa i takon grupmoshës së re.



55% të familjeve që jetojnë në Lekbibaj, kanë më shumë se 6 antar.

Karakteristike e zonës janë banesat në formë kulle por që 70% e tyre janë të braktisura. Ndërkohë 6 kulla kanë nevojë për reastaurim sepse jetesa në to përbën rrezik për shkak të gjendjes jo të mirë.

Banesat në këtë njësisë, janë ndërtuar para vitit 1991, gjë që të lë të kuptosh nevojat për të përmirësuar kushtet e banimit dhe kualitetin e jetesës në zonë.

Kjo njësi ka dhe numrin më të lartë të banesave të pa zëna.

Së fundmi, në të gjithë zonën janë ndërtuar 50 shtëpi të reja.

Çështje ekonomike

Sa i takon tokës së punueshme, nga 650 ha tokë, janë mbjelle me kultura të zonës vetem 40 ha. Vlen të përmendet që produktet bujqesore prodhohen pa plehera kimike. Gështenja dhe bimët mjeksore janë ndër kulturat më të përhapura si dhe janë produkte të pastra organike. Këtu gjendet bliri i egër me lule të kuqe. Bimët mjeksore të kësaj zone janë nga më të kërkuarat për shkak të cilësisë së tyre.

Bimët mjeksore të zonës janë të përmbledhura dhe në librin e autorit Zef Mulaj.

Në zonë, mbarshohen kryesisht lopë, dhi dhe dele. Është e njohur për këtë zonë lopa "Gusha" sidomos për qumështin cilësor të saj.

Lekbibaj, dallon për peshën specifike relativisht të lartë në prodhimin e mishit dhe qumështit të të dhirtave

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Qendrat shëndetsore në zonë nuk kanë infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e një shërbimi cilësor. Ekzistojnë ambulancat por nuk janë të pajisur me aparaturat e duhura.

Infrastruktura e shërbimit arsimor. Lekbibaj ka vetëm një kopësht për 15 fëmijë, një shkollë të mesme në qendër të Lekbibaj ku studiojnë rreth 200 nxenës.

Në këtë periudhë pritet të organizohet një event i madh për shkollen, që ka lidhje me 100 vjetorin e shkollës së parë shqipe. Niveli i analfabetizmit kap shirfën e 4 % , kjo tregon nevojën për një strategji për integrimin e kësaj kategorie në jetën ekonomike social dhe komunitare.



Infrastruktura rrugore. Problematikë mbetet gjendja e rrugëve që lidhin fshatrat me njëri tjetrin. Fshatrave Curraj i Epërm dhe Brisë, u mungojnë lidhjet. Zgjidhja e kësaj problematike do të kishte rëndësi sepse fshati Curraj i Epërm është një nga atraksionet më të bukura natyrore turistike.

Energjia Elektrike: Janë miratuar të ndërtohen 11 hidrocentrale në lumin e Currajve. Lugina e Currajt të Epërm, në veri të zonës, rrethuar me maja të larta, kjo e bën një zonë të izoluar tërësisht, pa asnjë akses rrugor apo të energjisë elektrike

Infrastruktura e ujit të pijshëm: 6 % e banesave të Njësisë, nuk mbulohehen nga rrjeti i ujësjetillësit.

Çështje të pronësisë

NJAV Lekbibaj ka gjithësej 650 ha tokë bujqesore dhe sipas banorëve toka nuk është e regjistruar tek Zyra e Pasurisë së Paluajtshme.

Konsultime me komunitetin:

Projekte qëu propozuan për periudhën në vazhdim:

- Rregullimi i Qendrës së Komunës Lekbibaj
- Rikonstruksioni i kanalit vaditës
- Rikonstruksioni i Qendrës shëndetësore
- Ndërtimi i një qendre shëndetësore në Curraj të Epërm.

Nga kjo Njësi Administrative janë evidentuar si prioritete:

- Sistemim dhe asfaltim i rrugës Lekbibaj –Lugu i Ndërmanjave (14 km)
- Rehabilitimi i rrugës Lekbibaj –Tetaj –Qaf Kolcit
- Rehabilitimi i rrugës Ura e Mserrit –Palc –Salce (8 km)
- Rehabilitimi i rrugës Kthesa e Bushatit –Gjon Pepaj (stakaj) (5 km)
- Rehabilitimi i rrugës Hidrocentrali –Curraj (3.7 km)
- Rehabilitimi i rrugës Markaj- Kodër Rrucaj (5 km)
- Rehabilitimi i rrugës Fushë Fierz –Shëngjergj (2.7 km)
- Rehabilitimi i rrugës Kthesa e Zades-Kotec(3.2 km)



- Ndërtimi i rrugës për në Curraj të Eperm (14 km)
- Ndërtimi i rrugës nga Salca për në Brisë(5 km)
- Rehabilitimi i rrugës qender Lekbibaj –Gjonpepaj (2.5 km)
- Ndërtimi i rrugës për Betosh (5 km)

Ndërtimi i ujësjellsve dhe kanale vadites:

- Ndërtim i ujësjellsit Peraj dhe Gjonpepaj
- Reahabilitim i ujësjellesit Lekbibaj, Shëngjergj, Tetaj, Salce, Curraj i Poshtëm
- Ndërtim i kanaleve ujitëse në fshatrat: Gjonpepaj, Peraj, Lekbibaj, Shëngjergj e Curraj

Në arsim e shëndetësi:

- Rikonstrukcion i shkollës së mesme Lekbibaj
- Riparimi i të gjitha ambulancave të zonës

Në sektorin energjistik

- Rehabilitimi dhe sistemimi i të gjithë rrjetit elektrik.
- Ndërtimi i linjës Hidrocentral – Fierzë
- Sistemimi i Qendrës së Njesisë Administrative

Promovimi dhe nxitja e sektorit të turizmit për zhvillimin e zonës Nikaj –Mërturit.

Organizimi i Eventit të 100 vjetorit të Shkollës sëparë shqipe në Malësinë e Gjakovës

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në Zyrat e Njesise Administrative Lekbibaj zgjati rreth 2 orë. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet në të ardhmen.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit.



Gjeter	Gjeneri	Lekb'	0686067144
Gosile	Lekoj	Curp	0693716688
Geg.	Bushaj, pka.	Bfost	0685690146
Mikoll	Zefi	Lekbity'	068467189
Anton	Meste	Deuss	0692783094
Zekë	Paç	Deuss	0692754069
Gezim	Proprni	Solice	0682410402
Relat	Abdaja	Taty	0684337473
Apron	Paçaj	Fery	0683188964
Besond	Mulajj	S.Hengjodj	0682034514
Mark	Abdaja	Tetaj	0693683326
Qneli Gjoli	Paç		0685544030
Mikoll Zefi	Lekbubaj		0685789918
Moharret - Tector			0683923056
Ermond Kolaj			0685961119
Ermond Gjokaj			-> 0693182222





4.1.2 Takimi në Fierzë

Data e zhvillimit të takimit: 10 Nëntor 2016

Ora e fillimit të takimit: 14:00

Kohëzgjatja e takimit: 3 orë

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi	–	Ekspert i turizmit dhe komunikimit
Hasan Çuka	–	Drejtor i Zyrës së urbanistikës bashkia Tropojë
Ermal Blea	–	Arkitekt, Studio B&L
Saimir Duçellari	-	Arkitekt, Studio B&L
Antonio Paolillo	–	Arkitekt, Dogma
Ezio Melchiorre	–	Arkitekt, Dogma
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma
Martino Tattara	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 24

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Fierzë u zhvillua në mjediset e kësaj njësie. Në fillim të takimit Z. Ermal Blea, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA-Fierzë. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohesh diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Liçeni i Fierzës, me sipërfaqe 72.5 km². ofron ndër peisazhet më të bukura malore të vendit. Përbën një rezervë të madhe natyrore hidronergjitike.

Çështje mjedisore



Mbetjet janë një problem për zonën e Fierzës. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet në mënyrë sporadike ose në mënyrë shumë të kufizuar. Qyteti i Fierzës e bën grumbullimin me kazan ndërsa fshatrat e hedhin në përrenj pasi nuk kanë vende grumbullimi. Shërbimi i pastrimit për mbetjet bëhet çdo ditë. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza është pjesërisht present, kështu fshatrat përdojnë gropa septike, ndërsa qyteti ka kanalizime. Sistemi i përrenjëve po sjell erozion që shtohet nga viti në vit. Shqetësuese ngelet dhe sistemi i vaditjes së tokave bujqësore, të cilët nuk mbulojnë gjithë zonën.

Çështje të përdorimit të tokës

Toka është pjellore por sistemi i tokës është dëmtuar nga ndërtimi i hidrocentralit. Pastrimi nga aluvionet i pjesës ku vinte trageti deri te kalatat, do krijojë mundsin e krijimit të një hapësire turistike për njerëzit që përdorin tragetin për lëvizjet e tyre dhe përdorimi i tyre për bujqsinë do të sillte përmirësim të cilësisë së tokës bujqësore.

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Në vitin 1990, sipas pjësmarrësve, Fierza kishte 8700 banorë, kurse sot ka rreth 4500 banorë. Njësia përballet me një numër të lartë personash me aftësi të kufizuara fizike (10.7 %) të cilët përbëjnë një kategori banorësh që duhet të jetë në qendër të vëmendjes, për shkak të nevojave të veçanta që ato kanë, jo vetëm në infrastrukturë por dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për të garantuar barazi sociale dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Çështje ekonomike

Specialistët e bujqësisë theksojnë se tokat janë magneziale dhe raporti ka shkuar 8 me 1. Është i nevojshëm gëllqerizimi i tokave. Vetëm në fshatin Degë nga 500 ha tokë që disponon ky fshat, vetëm 156 ha tokë kultivohet dhe kjo për shkak të mungesës së kanaleve vaditëse. Gjithashtu dhe në fshatin e Tplanit, janë rreth 400 ha tokë pa u vaditur, kjo sepse rezervuari është i dëmtuar.

Është e rëndësishme të ndihmohen dhe stimulohen bujqit sidomos në mbarështimin e bletëve. Mjalti i përftuar prej tyre, është ndër më të kërkuarat dhe përbën edhe të ardhura për banorët.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Qendrat shëndetësore nuk janë të pajisur me



aparartet e duhura për të kryer shërbimet shëndetësore.

Infrastruktura e shërbimit arsimor. Sektori i arsimit ka problematikat e veta sa i takon godinave shkollore. Kështu, përmëdim shkollën e mesme e cila ka disa problematika duke filluar që nga mungesa e rrethimit oborrit, çka e bën të cënueshëm nga jashtë; palestra e dëmtuar duke mos mundësuar realizimin e lëndës së edukimit fizik; mungesa e laboratoreve; e deri te çatia e shkollës e cila është teje e dëmtuar për shkak të cilësisë jo të mirë të punimit dhe amortizimit. Problem shumë shqetësues është dhe transporti i nxënësve, sidomos për fshatrat e Pukës.

Infrastruktura rrugore. Rruga për në Breglumë është e rrezikshme. Banorët e quajnë rrugë pa rrugë. Është një nevojë e menjëhershme dhe asfaltimi i rrugës për në fshatin Tplan. Të pa-aksesueshme ose të aksesueshme me vështirësi janë rrugët që lidhin fshatrat Tplan, Degë dhe Bredashnicë.

Infrastruktura e ujit të pijshëm: Fshatrat e NJA Fierzë nuk janë të mbuluar me sistemin e ujësjellësit. Kështu, fshati Dushaj i Eperm nuk ka ujësjellës.

Pritet që ujësjellësi i Valbonës të mbulojë sistemin e ujit të pijshëm për fshatrat Degaj dhe Tplanin.

Çështje të pronësisë:

Tokat bujqësore nuk kanë dokumentacion të rregjistrimit të tokës.

Konsultime me komunitetin:

- Ndërtimi i rruges së Komanit
- Duhet të merren në konsideratë ndihmat sociale, mobilitetin, aksesin ndaj shërbimeve publike në përmirësimin e cilësisë së jetës të banorëve që shfaqin një paaftësi fizike.

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në zyrat e Njesise Administrative zgjati rreth 3 orë. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit





1. Gëzim Gjoni. ADMINISTRATOR. 0682097556
2. Hektor Ramaj 0685955630
3. Roza Ramaj - - -
4. Françë Selis 0682713305
5. Nohçe Kasaj T 068377718
6. Mirush Rama - i 0684130826
7. Ananit Dushaj 0686402709
8. Vladimir Bonari 0685775981
9. Muaf Hametj Ponari 0683168103
- Adulabë Vukaj 0686417791
10. Erolina Kercay 0692540060
- Ilani Kola 0685721956
- Riutem Hoxhaj 0675591088
- Leri Dori 0672249112
- Nohçe Lefiti 0682016444
- Del Gjokaj 0684638409
- Mjilërishtë Ponari Punorje e Gjendjes Civile 068311248
- Elhamë Ramaj Drejtor i shkolles Matosh-Ukaj 0683016314
- Violëta Zërëmyja E pa Punë 0685546993

- Fotina Dushaj = infermiere QSHF. 0685950206
- Aferdite Pepkollaj = infermiere QSHF. = 0682596723
- Syrlie Dushaj = infermiere QSHF. = 0685778863
- Bashkim Basha = Teologj 0685770675
- Gurim Buzopçaj = 0672291097





4.1.3 Takimi në Tropojë (e vjetër)

Data e zhvillimit të takimit: 11 Nëntor 2016
Ora e fillimit të takimit: 14:00
Kohëzgjatja e takimit: 2 orë e 30 minuta

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi	–	Ekspert i turizmit dhe komunikimit
Ermal Blea	–	Arkitekt, Studio B&L
Saimir Duçellari	-	Arkitekt, Studio B&L
Antonio Paolillo	–	Arkitekt, Dogma
Ezio Melchiorre	–	Arkitekt, Dogma
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma
Martino Tattara	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 23

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Tropojë u zhvillua në mjediset e salles se ish keshillit Komunal te kesaj njesie. Në fillim të takimit Z. Ermal Blea, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA Tropojë. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohet diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Alpet e Tropojës, të cilat përbëhen nga male të larta dhe të thepisur dhe shumë tërheqës si pasojë e veprimit të akullnajave dhe erozionit, me kontraste të lartësive me lugina të thella që përshkohen nga lumenj të vegjël piktoresk.

Malësia e madhe, territor i cili zotëron pasuri të mëdha natyrore dhe përbën një ndër zonat më peizazhistike të të gjithë vëndit

Mali i Shkelzenit



Rezerva Strikte Natyrore e Lumit të Gashit

Çështje mjedisore:

Mbetët shumë problematike çështja e kanalizimeve të ujrave të zeza.

Në disa zona e pranishme është dukuria e erozionit për shkak të shpyllëzimeve.

Problem mbetet dhe mbulimi me sistem vaditje i zonës.

Çështje të përdorimit të tokës

Tropoja ka sipërfaqe mjaftë të madhe të tokave të punueshme, në të cilat kultivohen drithërat, mollët, gështenjat, kumbullat e dëgjuara tropojane.

Toka përdoret për kultivimn e bimëve të arave dhe bimëve të trumzës, nga ku bëhet dhe mjalti shumë i kërkuar për vlerat që mbart dhe boronicës gjithashtu po shumë të kërkuar etj. Në takim u evidentua fakti se shumë toka po shkaterrohen nga erozioni, prandaj është e domosdoshme ndërhyrja me projekte për pyllëzimin e tyre.

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Popullsia në vitin 1990 ka qenë 12000 banorë, ndërsa aktualisht në gjendjen civile janë 5600 banorë. Nga 1927 familje që ka Njësia Administrative, 525 prej tyre trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 225 persona trajtohen me pension inviladiteti.

Për 25 vite janë ndërtuar në gjithë zonën 120 shtëpi të reja. Ndërtimet e reja janë bërë në toka bujqësore dhe 80 % e tyre janë pa leje. 10 % e banesave janë të braktisura.

Çështje ekonomike

Tropoja sot po has probleme për sa i takon çertifikimit të farave, fidanave, pesticideve dhe herbicideve. Përdoret fara e Moravit që është një farë e vjetër e misrit. Në NJA Tropojë nuk ka një ditë tregu. Krahas kulturave të arave, fermerët mbjellin dhe boronicë, trumzë, lule aguliqen etj. Tek pemët frutore ka superprodhim molla, por mungesa e tregut të shitjes e ka bërë të pamundur sigurimin e të ardhurave nga kjo kulture.

Sa i takon bujqësisë, është e domosdoshme të ndërhyet dhe në përmirësimin e sistemit të vaditjes. Gjithashtu dhe kanali i Kojelit që vaditë 50 ha tokë, kërkon ndërhyrje për tu vënë në funksion.

Rezervuari i Tropojës ka dal jashtë funksionit, gjë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Ndërkohë, për zbutjen e problematikës, në zonën e Kernajës është bërë një studim për ndërtimin e një rezervuari i cili do mbulojë me vaditje të gjithëzonën

Komuniteti është i interesuar për rritjen e numrin të bagetive (sidomos dhive) si dhe për



rritjen e numrit të bletëve. Si për bujqit dhe blektorët lind nevoja për ndërtimin e tregut, për tregtimin e kulturave të arave, frutave dhe bagëtive.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Në 18 fshatra janë 8 ambulanca gjithësej, 3 prej të cilave janë të amortizuara (Kernaje, Babinë etj). Qendra shëndetësore në qender të Tropojës është e amortizuar dhe pa ujë të pijshëm. Ambulancat e tjera janë të ndërtuara si objekte por nuk janë të pajisura me mjetet e duhura për të ju shërbyer të sëmureve.

Për zbutjen e situatës janë hartuar projekte për ndërtimin e ambulancave të reja dhe janë dorëzuar pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik.

Infrastruktura e shërbimit ansimor: Janë 13 shkolla në të gjithë komunën. Ndër këto shkolla, ka shkollë edhe me 16 nxënës gjithësejt (Buçaj).

Nuk ka shkollë të arsimit të mesëm.

Infrastruktura rrugore. Vihet re kryesisht prezenca e rrugëve sezonale, të rrugëve urbane kryesore e dytësore

Infrastruktura e ujit të pijshëm: Ekziston një projekt për ujësjellësin që konsiston në ndërtimin e një depoje e cila do të vendoset në kodrën mbi fshatin Tropojë e Vjetër dhe do të jetë në kuotën 459.78 m m.n.d.

Çështje të pronësisë

Tropoja ka 1820 ha toke bujqësore, nga të cilat 1050 hektare të regjistruar. Janë 6 fshatra të cilët nuk e kanë përfunduar procesin e regjistrimit te Zyra e Pasurisë së Paluajtëshme.

Konsultime me komunitetin:

Nga takimi me komunitetin propozohen këto prioritete:

- Hartim i një projekti për përmirësimin e kanalizimeve të ujrave të zeza.
- Rikonstrukcionin e veprave vaditese:
 - o kanali i Gashit dhe
 - o kanali Kasaj-Viçidol-Sylaj-Myhejan
- Infrastruktura rrugore



- o Tropojë- Muhejan- Gosturan (3.5 km)
- o Kernaje–Kovaç (2.5 km)
- o Buçaj- Papaj –Padesh (9 km). (Ekziston projekti)
- o Boshnjake–Tafaj-Treshnjeve
- o Qafë Morinë-Gegaj
- o Qafë Morinë–Kamenice
- o Asfalt–Viçidol (1 km)
- o Pific-Kamen–Lugu i Tropojes (7.7 km) (Profic- Kamen është projekti)
- o Asfalt-Kasaj (2.1 km)
- o Asfalt- Mejdani (2.1 km)
- o Ura e Astës-Kojel Shpat (1.2 km) (Është projekti)
- o Ura e Balishtes-Shumice–Asfalt (3.1 km)
- o Asfalt–Iberhasaj (3.1 km)
- o Boshnjake –Koldet
- Kanalet Vaditese që kanë ndikim të rëndësishëm në bujqësi dhe që duhen reabilituar janë
 - o Kanali i Gashit (25 km) (është projekti)
 - o Kanali i Myhejanit (5.8 km)
 - o Kanali rezervuari Kasaj – Viçidol – Sylaj – Mejdani (projekti është me M.Bujqësisë)
 - o Kanali Viçidol–Sylaj (4.2km)
 - o Ura Aste-Kojel Rrafsh (1.9km)
 - o Kanali Aste–Kojel shpat (2,9km)
 - o Kanali vaditës Treleze Kasaj (1.8 km)
 - o Kanali Shumice–Boshnjak (1.8km)
 - o Kanali Shumice–Bucin (1.4 km)



- o Kanali Kucanes (2 km)
- o Kanali Papaj (1.5 km)
- o Kanali Begaj i Poshtëm (3 km)
- Sektori Arsimit
- o Riparimi i shkollës 9 vjeçare Kovaçe (është projekti)
- o Pajisja e shkollave me kabinete fizike e kimie si dhe me kënde sportive.
- Sektori Shendetesise
- o Riparim i Qendrës Shëndetësore Tropojë
- o Ndërtimi i Ambulancave të fshatrave: Shkëlzen, Myhejan, Kojel, Kucane, Kasaj, Papaj
- Sektori Bujqësisë
- o Subvecioni për mbjelljen e harrdhive, mollëve, vreshtave dhe kumbullave tropojane.
- o Rritja e plantacioneve të gështenjës
- o Ngritja e një fabrike në bashkëpunim me njësitë e tjera për tu krijuar mundësinë fermeve për tregtimin e tyre.
- Sektori Blegtorise
- o Nxitje për shtimin e gjësë së gjallë sipas zonave
- Sektori Turizmit
- o Ruajtja e ekosistemeve natyrore duke investuar në mirë administrimin e pyjeve

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në njesine administrative zgjati rreth 2 orë e gjysem. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit





Uffera Nezoj	Përgjigji shkencor/teorik	0682157416
Beharrem Çelaci	Kryetar shkollë Hydror	0686897750
Hidra Haxhiq	Kryetar shkollë Basin	0682623775
Elec Zela	Kryetar shkollë Gëpjet	0682370780
Rudyl Agaj	P. Gjykatës Civilë Tëprij	0682567084
Zepir Hykaj	Shkollë Ndërkombëtare	0682356989
Isaet Korteci	Agj. omam	0693761180
Arshi Gushorani	U. Zyrt. Kundshkollë	0686245966
Shpend Hoxha	Asistent	0684622620
Ngau Shqiponja	Asistent	0682336238
Bujar Hoxha	Asistent	0685331001
Stefan Tasaku	Rrëzimi shkencor	0685316509
Arçilo Fazlari	Penonjere Sociale	0685687746
Zenel Hoxha	Kryetar shkollë (Tëprij)	0692563519
Ahmet Memij	Kryetar shkollë (Hydror)	0685784957
Valmina Koxhaj	Mjete e përgjithshme	0693688830
Sherif Memij	Penonjere shkencor	0682897707
Ram Korteci	Kryetar njësia vendore Tëprij	
Hydyll Agaj	R/2. GJ. Civile Tëprij	0682367084
Lulzim Tëprij	Kryetar i Fshatit (Tëprij)	0699265130
Jani Koxhaj	Shërbimi Shkencor	0685326414
Elidon Këllaj	Mjete / Përzgjedhje	0685409114
Ilirion Sestari	Administrative (Tëprij)	0682415712





4.1.4 Takimi në Bujan

Data e zhvillimit të takimit: 11 Nëntor 2016
Ora e fillimit të takimit: 10:00
Kohëzgjatja e takimit: 2 orë e 30 minuta

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi	–	Ekspert i turizmit dhe komunikimit
Hasan Çuka	–	Drejtor i Zyrës së urbanistikës bashkia Tropojë
Saimir Duçellari	-	Arkitekt, Studio B&L
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 16

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJAV Bujan u zhvillua në mjediset e objektit të zyrës së Njesise Administrative Bujan. Në fillim të takimit pjesëmarrësit u vunë në djeni për rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA Bujanit. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohet diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

3 kullat historike: Kulla e Mic Sokolit, Binak Alise dhe Sali Mani, të cilat janë kulla 200 vjeçare. Në takim u diskutua që Institutit të Monumeteve të Kulturës duhet ti propozohet Kulla e Binak Alise për tu bërë monument kulture.

Fortesa e Rosunjëse cila është një nga qytezat më të pikasura. Nga viti 1964 nuk është venë dorë. Është një qendër e lashtë mijëvjeçare, e dyta para erës tone.

Është e pa ekspozuar (ka qypa, stoli, monedha).

Liqeni Ponarit



Çështje mjedisore

Menaxhimi i mbetjeve bëhet në mënyrë sporadike ose në mënyrë shumë të kufizuar. Shërbimi i pastrimit mbulohet nga vetë njësia në bashkëpunim me qytetin e Bajram Currit.

Problemi i shembjeve për shkak të mungesës së pritave malore.

Çështje të përdorimit të tokës:

Janë toka bujqësore, kryesisht për prodhimin e drithrave të bukës dhe perimeve.

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Në vitin 1990 zona e Bujanit kishte 7200 banorë. Aktualisht kjo zonë ka 2880 banorë.

257 familje, trajtohen me ndihmë sociale

Regjistron vlera të larta për sa i takonë punësimin të grupmoshave të reja (89 %), megjithatë papunësia është në nivele të larta (55%). Pjesa më e madhe e të punësuarve, janë në sektorin e shërbimeve.

40 % e ndërtesave në Bujan, janë ndërtuar para vitit 1991, çka do të thotë që banorët e kësaj njësia kanë nevojë për të përmirësuar kushtet e banimit.

Çështje ekonomike

Njësia dallohet për prodhimin e gështenjës i cili përbën një burim kryesor të ardhurave të ekonomisë lokale.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

- Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Qendra shëndetësore në Bujan është tek një ndërtesë e vjetër. Fshatrat Rosuje e Gjonaj janë pa ambulancë.
- Në fshatin Markaj ambulanca është brenda ambienteve të shkollës
- Kanalet e Ujrave të Zeza nuk ekzistojnë në asnjë fshat
- Infrastruktura e shërbimit parashkollorë ekziston por kapaciteti i kopështeve mbulët për të plotësuar nevojat e banorëve.



- Shkollat 9-vjeçare kanë nevojë për rikonstruktivim dhe vihet re mungesa e terreneve sportive.
- Mungon shkolla e arsimit të mesëm
- Infrastruktura rrugore. Ka shërbim të transportit publik Bajram Curri- Bujan
- Energjia Elektrike: Janë miratuar të ndërtohen 11 hidrocentrale në lumin e Currajve
- Infrastruktura e ujit të pijshëm: Tre fshatra kanë furnizim me ujë 24 ore (Markaj, Dojan, Bujan). Fshatrat Rosuje, Lekurtaj, Selimaj, kanë problem me furnizimin me ujë të pijshem.
- Ekziston projekti për furnizimi me ujë nga burimet e “Perlinave të Bardha” që ndodhen rrëzë malit të Shkëlzenit

Çështje të pronësisë

Duhet të zgjidhet çështja e administritimit të kullave

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në Bujan zgjati rreth 2 orë e gjysem. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit





EMA I	MBIEMRI	NR. CEL.
1. Bujari	Hasanpajaj	0682538937
2. Anila	Jonuzberi	0684444660
3. Jashari	Oruqi	0692549616
4. Zogaj	Hasani	0694553228
5. Ismail	Stojanovski	0685276714
6. Feriz	PAULI DAKA	0688137320
7. Rifat	Musaaj	0685591645
8. Khalim	Muhammad	0682167846
9. Lenel	Mulgeci	0682405035
10. Sonarta	Malaaj	0696343103
11. Zyri	Hasanpajaj	0683409203
12. Ali	MILUSHI	0682463831
13. KANZA	SHACRUKAJ	0688150893
14. MUSTAF	VATOCI	0682177375
15. ZAHIR	BARIRAJ	0682505376
16. ZESHKE	YINAJA	0682525205



4.1.5 Takimi në Margegaj

Data e zhvillimit të takimit: 11 Nentor

Ora e fillimit të takimit: 14:00

Kohëzgjatja e takimit: 3 orë

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi	–	Ekspert i turizmit dhe komunikimit
Feride Rrahmanaj	–	Drejtor Zëvendës kryetare bashkia Tropojë
Saimir Duçellari	-	Arkitekt, Studio B&L
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 14

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Margegaj u zhvillua në mjediset e objektit të kesaj Njesie Administrative. Në fillim të takimit Z. Ermal Bleta, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJAV-së Margegaj. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohet diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës (192 km²)

Rezerva Strikte Natyrore e Lumit të Gashit (46 km²)

Gryka e Qytetit, ku janë rrënojat e një qyteze ilire

Çështje mjedisore

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është shumë i kufizuar. Shërbimi i pastrimit të mbetjeve, bëhet dy here në javë.

Kanalet e ujrave të zeza përbëjnë problemet shqetësuese të banorëve sepse njësia Mar-

gegaj mbulohet pjesërisht nga rrjeti ikanaleve të ujrave të zeza.

Edhe pse uji i lumit të Valbonës përdoret kryesisht për ujitje, banorët kanë problem sai takon mbulimit të zonës me kanale vaditëse. Kanali i Shoshanit që mund të vadisë 100 ha tokë, është një kanal i vjetër 200 vjeçar, shumë i dëmtuar.

Sistemi i përrrenjëve po rrezikon fshatin Margegaj nga përmytjet.

Çështje të përdorimit të tokës:

Janë toka bujqësore, kryesisht për prodhimin e drithrave të bukës dhe perimeve.

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Njësia ka 2346 banorë. Duke e krahasuar me vitet më përprara, ka një rënie të numrit të popullsisë kjo për shkak të migrimit të popullsisë. Rreth 64 % e popullsisë i përkasin grupmoshës 14-65 vjeç.

Fshatin Çerem, gjatë verës banohet nga 20 shtëpi, ndërsa gjatë dimrit edhe ata banorë që verojnë aty largohen për shkak të mungesës së elementeve bazë të jetesës.

Çështje ekonomike

Ndodhet masivi i gështenjave.

Ndërveprimet ekonomike, më shumë kryhen me Gjakovën (Kosovë)

Bimet medicinale dhe ato aromatike janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash për banorët e kësaj zone.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Disponon një qendër shëndetësore, 7 ambulanca dhe 13 infermierë. Qendra shëndetësore, e ka çatinë e dëmtuar dhe me llamarinë. Fshati Çerem nuk ka ambulance. Dy mjek dhe dy infermiere kryejnë shërbime ekstra.

Infrastruktura e shërbimit arsimor. Shkollat kanë kërkesa emergjente për sa u takon përmirësimin të kushteve për një mësimdhënie të mirë. Nuk kanë terrene sportive për orët e edukimit fizik. Mungonjë banjot e ndara për meshkujt dhe femrat

Shkollës së Shoshanit krahas gjendjes jo të mirë të godinës, mungesave të ambienteve, nuk ka as rrethim shkollë. Në disa fshatra, si në Bradoshnice mungonjë shkollat.



Infrastruktura rrugore. Fshati Bradoshnice nuk ka rrugë. Ka mungesë të sinjalistikës në zonat turistike. Kështu me qindra turistë humbasin rrugën dhe kthehen në Tropojë të vjetër për shkak të mungesës së një table.

Energjia Elektrike: Sipas njërit nga banorët, fshati Çerem ka probleme me energjinë elektrike.

Infrastruktura e ujit të pijshëm: Uji për fshatrat e Njësisë Administrative Margegaj, merret nga linja kryesore e ujësjellësit që furnizon qytetin e Bajram Currit. Fshati Dragobi dhe Çerem janë të pa mbuluar nga ky rrjet.

Çështje të pronësisë

Ka problem në pronësitë e tokave. Mungesa e pronësisë mbi tokat do të pengojë zhvillimin e turizmit. Mosmarrëveshje pronësie ka gjithashtu dhe sai takon masiveve të gështenjës.

Konsultime me komunitetin:

- Ndërtimi i rrugës së Çeremit (8 km)
- Ndërtimi i ambulancave në fshatra.
- Duhet të vendoset një ambulancë lëvizëse gjatë verës në Bjeshkë sepse 300 familje qëndrojnë për mëse 3 muaj atje.
- Mobilimi i qendres shëndetësore dhe ambulancave
- Mirëmbajtja e monumenteve të kulturës.
- Sistemimi i lumit Valbona
- Plane rregulluese sa ju takon ndërtimeve të reja
- Menaxhimi i mbetjeve meqënëse është dhe një zonë me një numër të madhë të turistëve.
- Funksionimi i qendrës së informacionit turistik dhe krijimi i shesheve të pushimit për turistët.

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në Margegaj zgjati rreth 3 orë. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.



Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit.





Hazir Isufaj Arkitekt 0693557500
 SADRİ GOSTYRANI BA/SUKOLLE 0682621711
 Arif Dolepyi ANARREBETI 068321472
 Wjha Yefi Kocany 0675068323
 Bapir Zepi Geron 0685675514
 GANI PROZCOMI BIRDORHNIC 0685580475
 Jetmiriç Muesaj gazetar 0693557567
 Hhol Gulani Program 0673022876
 Zere Barberi Shohom 0686949355
 Xheraldine Mahmudaj drejtor shkolle 0694404349
 Adem Zepi Metalicj shkolle Valbonë 0673109026
 Zylfi Jomeraj Nivuar Gendjeri Liricë 0682182506
 BRAJMIK BRANIT PUNONTES MASHINIC TREPOTE 0682453072
 Tokir Hajdaj Karyerant. PUNONCES 0685625153





4.1.6 Takimi në Llugaj

Data e zhvillimit të takimit: 24 Nëntor 2016

Ora e fillimit të takimit: 10.00

Kohëzgjatja e takimit: 2 orë

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi – Ekspert i turizmit dhe komunikimit

Saimir Duçellari - Arkitekt, Studio B&L

Luciano Aletta – Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 19

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Llugaj u zhvillua në mjediset e kësaj njësisë. Në fillim të takimit Z. Saimir Dujcellari, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA-së Llugajt. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohesh diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Bujqësia

Çështje mjedisore

Mbetjet hidhen në lumë, prandaj kërkohet të mbulohet shërbimi i pastrimit.

Fenomeni i erozionit është shfaqur dukshëm (Llugishta)

Çështje të përdorimit të tokës:

Janë toka bujqësore, kryesisht për prodhimin e drithrave të bukës dhe perimeve.

Në tokat me bonitet të ulët rritet gështenja.



Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Aktualisht janë 2300 banorë. Popullsia e zonës në vitin 1990 ishte 7030 banorë. Sot janë 2300 banorë. Në vitet e fundit vihet re një tendencë e rritjes së popullsisë.

Çështje ekonomike

Ka të zhvilluar vreshtarinë dhe pemtarinë. Bujqësia ka nevojë për mjete mekanike dhe plehra kimike.

Fshati Rragam kërkon të ndërtohen prita malore. Në Llugaj gjithashtu në anën e lumit ka nevojë për prita.

Blegtoria, ka interes nga fermeret por shteti duhet ti ndihmojë

Në fshatin Cernice ka interes në shtimin e frutikulturës. Në fshatin Rragan ekziston një baxho funksionale me parametra bashkohore. Banorët shprehen se fermerët nuk sjellin qumësht pasi nuk prodhojnë shumë për të shitur.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Ambulanca në Luzhë është e dëmtuar totalisht dhe është prioritet për sektorin e shëndetësisë.

Shërbimi shëndetësor është ofruar në të gjithë zonën por kërkohej një ambulance lëvizëse në bjeshkë.

Infrastruktura e shërbimit arsimor. Shkolla e mesme Llugaj nuk ka investime. Kërkon ndërhyrje totale. Shkolla nuk ka shërbim të energjisë elektrike dhe po del jashtë funksionit. Shkolla në Cernice është më e mirëmbajtur.

Infrastruktura rrugore. Lidhet me rrugë të asfaltuar në dy anët në formë ciklike.

Energjia Elektrike: Fshati Rragam ka problem me energjinë elektrike. Sistemi i energjisë elektrike është problem në të gjithë komunën Llugaj dhe kërkohej ndërhyrje emergjente.

Infrastruktura e ujit të pijshëm: Zona furnizohet nga një burim me ngritje mekanike. Fshatrat kanë problem me ujin e pijshëm, kështu në fshatrat Rragam e Llugaj nuk funksionon sistemi i ujërave të pijshëm. Fshati Luzhë është përfshirë në projektin e ujit të pijshëm të Valbones.



Çështje të pronësisë

Nga 3200 hektare tokë bujqesore, vetem 1230 ha janë ndarë në pronësi. Fshatrat Rragam e Cernice kanë problem me çertifikimin e pronësisë së tokës. Janë regjistruar Luzha, pjesërisht Llugaj e Bukova.

Konsultime me komunitetin:

Prioritetet për Njësinë Administrative Llugaj :

- Asfaltimi i rrugës për automjetet në fshatin Luzhë
- Reabilitimi i kanaleve vaditese në Njësitë Bukove, Vrella, Mulliri dhe Madanit
- Zgjerimi dhe reabilitimi i rrjetit ekzistues të ujit të pijshëm
- Rikonstruksioni i shkollës së mesme Llugaj
- Rikonstruksioni i ambienteve ekzistuese të shërbimit shëndetësor
- Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike
- Tregu i përbashkët bujqësor dhe blegtoral
- Instalimi i linjave urbane për nxënësit e shkollave
- Investimi për plotësimin e dokumentacionit të pronësisë
- Ndërtimi i një ambulance në Luzhe dhe në fshatin Rrëzë Mali

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në Llugaj zgjati rreth 2 orë. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit.





1. D. Hinc	gjergji	Hajrushita	0684434028
2. H. Ahmet	M. H. H. H.	H. H. H. H.	0684406643.
3. Blenim S.	Baspapaj	- H. H. H. H.	0674884545
4. H. H. H.	Ryogovii	Fermer	0685531028
5. BRATIM MURTOVAJ	H. H. H.	H. H. H.	0692832199.
6. Begim Gjokaj	R. Nalci	H. H. H.	0682600410
7. H. H. H.	-	H. H. H.	0685361795
8. H. H. H.	Balaj	H. H. H.	0682541607
9. H. H. H.	M. H. H.	H. H. H.	0082349277
10. Z. H.	H. H. H.	H. H. H.	0682664927
11. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0682348777
12. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0685651227
13. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0682350685
14. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	068583636
15. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0685499968
16. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0686949386
17. G. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0686163440
18. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	068334630
19. H. H. H.	H. H. H.	H. H. H.	0682367012





4.1.7 Takimi në Bytyç

Data e zhvillimit të takimit: 24 Nëntor 2016

Ora e fillimit të takimit: 13:00

Kohëzgjatja e takimit: 2 orë

Stafi pjesëmarrës:

Bukurosh Onuzi – Ekspert i turizmit dhe komunikimit

Saimir Duçellari - Arkitekt, Studio B&L

Luciano Aletta – Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 19

Hyrje

Takimi me komunitetin e NJA Bytyç u zhvillua në mjediset e Shkolles mesme Pac. Në fillim të takimit Z. Saimir Duçellari, arkitekt, përfaqësues i studios B&L, njohu pjesëmarrësit me rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe me qëllimin e takimit me anëtarët e komunitetit të NJA-sëBytyçit. Më pas pjesëmarrësit prezantuan veten dhe zonën ose institucionin që përfaqësonin, si dhe u njohën me çështjet kryesore ku do të fokusohesh diskutimi.

Elementet që përfaqësojnë më mirë territorin dhe komunitetin:

Lumi i Bytyçit, në të cilin krijon lugina me bukuri të mëdha natyrore me vlera turistike dhe shkencore.

Zona është e njohur për minierat (krom), blegtorinë, pyjet dhe mjaltin e Zogajve

Çështje mjedisore

Zona nuk ka vend për mbeturinat dhe menaxhimin e tyre. Pra nuk ofrohet ky shërbim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Rrjeti i kanaleve vaditëse përfshin: kanalin e Letajve, kanalin Zherkë – Vlad –Pac, kanalin e Kepenek-Visoce, kanalin e Berishës.



Çështje të përdorimit të tokës:

Është e pasur me kullota alpine

Çështje shoqërore dhe nevoja për strehim

Njësia ka popullsi prej 1563 banorë. Njësitë familjare me më shumë se 6 anëtar regjistrohen në vlera tepër të larta për këtë njësi, çka të lë të kuptosh nevojën e tyre për strehim dhe shkollim.

56 % e popullsisë trajtohen me ndihmë sociale çka tejkalon ndjeshëm mesataren kombëtare. Numri i lartë i familjeve që përfitojnë ndihmë sociale kryesisht në njësitë me karakter rural, tregon vështirësitë ekonomike me të cilat përballen njësitë familjare.

Çështje ekonomike

Bjeshkët e Bytyçit janë të pasura me kullota alpine

Bujqësia: Zona ka 870 ha tokë bujqësore dhe të gjitha janë regjistruar tek Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme. Në të gjithë zonën, ndodhen 6 rezervuare.

Blegtoria: Njihet për dhitë, bletet dhe lopët. Janë rreth 2000 koshere bletesh (800 në Zogaj, 800 në Berishë), por sasia e prodhuar e mjaltit është e kufizuar në krahasim me nevojat e tregut.

Industria fokusohet kryesisht në miniera. Zona e Bytyçit përmban rezerva të larta në kromi por nxjerrja është e kufizuar. Ky sektor mund të jetë një sektor i rëndësishëm për ekonomine lokale.

Çështje të infrastrukturës

Në lidhje me infrastrukturën të pranishmit në takim paraqitën disa probleme:

- Infrastruktura e shërbimit shëndetësor. Jane 4 ambulanca gjithësejt.
- Nuk kanë ambulance fshatrat Berishë, Kepenek, Zherkë, Zogaj, Kam, Leniq.
- Qendra shëndetësore ndonëse është më e largeta e rrethit, nuk ka një ambulancë (makinë)
- Infrastruktura e shërbimit arsimor. Shkolla e mesme Pac, ka nevojë për mjete didaktike,
- kabinetet nuk kanë baze materiale.



- Është e nevojshme hapja e 8 kopshteve ku ka klasa të para
- Shkolla e Qafe Prushit është e demtuar, ndërsa shkolla në Visoçë ka 2 nxënës.
- Ka problem sa i takon cilësisë së rrugëve që lidhin fshatrat me njëri tjetrin.
- Energjia Elektrike ka problemet e veta për shkak të rrjetit të amortizuar.
- Rrjetë të ujësjellësit kanë fshatrat :Pac, Prush, Kepenek, Rodogoshi.
- Me këtë rrjet nuk mbulohen fshatrat Leniq, Vlad, Visocë, Zherkë.

Çështje të pronësisë

Duhet të zgjidhet çështja e administrimit të kullave

Konsultime me komunitetin:

Kërkohet asfaltimi i rrugëve:

- Kam –Qafe Prushi
- Pac –Berishe
- Pac-Zherke
- Pac –Vlad

Mbyllja dhe përfundime të përgjithshme

Takimi i zhvilluar në Pac zgjati rreth 2 orë. Diskutimi ishte dinamik dhe pjesa më e madhe e të pranishmëve morën pjesë aktivisht në të. U dhanë ide dhe sygjerime për përmirësimin e situatës aktuale si dhe mundësitë se ku duhet të ndërhyet.

Në fund të takimit të pranishmit u falënderuan për pjesëmarrjen dhe mendimet me vlerë që shprehën gjatë takimit





Feriz	Hoxha	Admistr.	0686349333
Beqir	Simani	Tanxktor urbani, strit	0686133479
Anxhar	Hajdursulaj	Priztar, strit	0685707811
Emrullah	Licaj	Priztar, strit "MIRAZI"	0688425655
Shkëlzen	Sarajini		0682685474
Mysosfer	Hysomaj	P-Mjorist	0683676032
Fatmir	Mullaushaj	punonjës, Hdt. Et'hem	0693011578
Shkëlzen	Gjidiu	(Punonjës) punonjës i ordinaristit në Kuvendin	
Shajmush	Shorbo	Kryepalok fshat. Pac	0685839673
Iskender	Imami	K. plakun fshatit Vllod	
Jay	Simani	punonjës Mj. Hën	Dijçe
Edmond	Wera	Kryepalok fshatit Ymeri	
Hyson	Hyson	hap. Mjorist	shkël
Jeydim	Bardhoshi	mesues	0692019750
Edona	Sarajini	mesuese	0691682863
Loreta	Kabashi	mesuese	0685160479
Len	Abdullai	mesues	
Shkëlzen	Hoxha	Udh. prirës në Komandë	
Enver	Imami	Tokmit Lyjosh	0682080830





4.1.8 Takimi me përfaqësues të komunitetit në Tiranë

Data e zhvillimit të takimit: 17 janar 2017

Ora e fillimit të takimit: 18.00

Stafi pjesëmarrës:

Feride Rrahmanaj	–	Drejtor Zëvendës kryetare bashkia Tropojë
Hasan Çuka	–	Drejtor i Zyrës së urbanistikës bashkia Tropojë
Ermal Bleta	–	Arkitekt, Studio B&L
Saimir Duçellari	-	Arkitekt, Studio B&L
Luciano Aletta	–	Arkitekt, Dogma
Martino Tattara	–	Arkitekt, Dogma

Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti: 23

Në ambientet e hotel Tirana, më datë 19.01.2017, ora 18:00, u mbajt dëgjesa publike në kuadër të “Prezantimit të dokumentit të Analizës së thelluar të gjendjes ekzistuese”, për bashkinë Tropojë, me intelektualë tropojanë banues në Tiranë.

Pjesëmarrës në dëgjese ishin përfaqësues të studiove konsulente për hartimin e PPV-së për bashkinë Tropojë, studio Dogma dhe B&L, përfaqësues të programit DLDP dhe intelektualë tropojanë të fushave të ndryshme etj.

Në dëgjese u prezantua:

- Qëllimi i Planit; Ecuria e procesit dhe hapat që do të ndiqen për hartimin e PPV-së;
- Prezantimi i Analizës së Territorit duke u ndalur te problematikat e hasura deri më tani.

Çështjet që u ngritën nga pjesëmarrësit në takim kishin të bënin me:

- Parashikimin e masave dhe marrja parasysh gjatë hartimit të PPV-së i thyerjes transversale gjeologjike Shkodër-Tropojë-Prizren, e cila shkakton tërmete;





- Pasurinë e madhe që ka Tropoja me gjeomonumente, me rreth 70 të tilla, të cilat duhet të evidentohen dhe të kthehen të aksesueshme dhe të vizitueshme;
- Marrjen në konsideratë të planeve rregulluese të mëparshme të hartuara për bashkinë Tropojë, si edhe integrimin e planit që po hartohet me planet e vendeve fqinje si: Mali i Zi dhe Kosova;
- Ruajtjen dhe konservimin e zonave me vlera historike si edhe vlerave të mëdha kulturore që kjo bashki zotëron;
- Mundësitë që mund të ekzistojnë për të tërhequr sa më shumë investime jo vetëm publike por edhe private për zhvillimin e bashkisë;
- Ruajtja e zonës lumore, e cila shërben gjatë stinës së verës për turizëm lumor ditor për parandalimin e ndërtimeve hidro-elektrike.
- Mangësitë e theksuara të infrastrukturës rrugore, sidomos në zonat rurale.

Kujtim Arifi

Islam Laukaj

Vladimir Gjoka

Artan Balia

Besnik Mustafaj

Agron Xhelia

Afrim Krasniqi

Skënder Haklaj

Nezir Nekshiqi

Hamit Alia

Adil Neziri

Bujar Vuka

Sami Neza



1914
1915
1916
1917
1918
1919
1920
1921
1922
1923
1924
1925
1926
1927
1928
1929
1930
1931
1932
1933
1934
1935
1936
1937
1938
1939
1940
1941
1942
1943
1944
1945
1946
1947
1948
1949
1950
1951
1952
1953
1954
1955
1956
1957
1958
1959
1960
1961
1962
1963
1964
1965
1966
1967
1968
1969
1970
1971
1972
1973
1974
1975
1976
1977
1978
1979
1980
1981
1982
1983
1984
1985
1986
1987
1988
1989
1990
1991
1992
1993
1994
1995
1996
1997
1998
1999
2000
2001
2002
2003
2004
2005
2006
2007
2008
2009
2010
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
2024
2025



4.2 Forumi i bashkërendimit për Planin kombëtar për zhvillimin e turizmit në alpe

Data e zhvillimit të takimit: 22 Shkurt 2017

Ora e fillimit të takimit: 10:00

Kohëzgjatja e takimit: 2 orë

Takimi nisi nga perfaqesues te konsulentit IP3 (Romina Sahiti dhe Endri Nocka) me prezantimin e gjetjeve te “Analizes Territoriale” per rajonin e Alpeve si dhe nje analize te te dhenave statistikore te ardhur nga INSTAT dhe nga anketat e kryera ne terren.

U vijua me prezantimin nga studio konsulente “Atelier 4” (Ariela Kushi) e Analizes Territoriale dhe aspekteve strategjike sa i perkete PPV te bashkise Malesi e Madhe.

Ne perfundim te prezantimeve, u nderhy nga perfaqesuesi i studios konsulente per hartimin e PPV Vau i Dejes, UTS-01 (Gjergji Islami), i cili e cilesoi bashkine e Vaut te Dejes si porten hyrese me interesante te Alpeve Shqiptare, kjo per faktin sepse hyrja ne rajon kryhet nepermjet liqenit te Vaut te Dejes nepermjet nje pejsazhi teper te vecante. Lidhur me aspektin turistik, vec turizmit natyror duhet ti jepet rendesia e duhur edhe monumenteve te kultures, kalave, siteve arkeologjike, kullave, etj, te cilat nuk jane te pakta ne zone dhe mbi te cilat kjo studio po bazon propozimet e veta pjese e PPV se Bashkise Vau i Dejes. Aktualisht bashkia Vau i Dejes eshte duke hartuar dokumentin e Analizes Territoriale.

Nga perfaqesuesi i studios konsulente per hartimin e PPV Bashkia Tropoje B&L Studio (Saimir Ducellari) u theksua vlera e Parkut Rajonal Nikaj-Mertur, nje park qe per nga vlerat është i krahasueshem me Parku Kombetar te Valbones, por qe eshte ende i panjohur dhe i pa promovuar.

Nga koordinatori i AKPT per PPV bashkia Tropoje, Piro Anastasi, u soll ne vemendje te konsulenti te PKS Alpet, IP3, edhe mundesia e promovimit te “turizmit energjitik”, atij lloj turizmi qe promovon digat e medha hidroenergjitike, liqenet dhe peizazhin qe ato krijojne.

Znj. Kushi solli ne vemendje faktin qe PKS eshte nje plan me i larte ne hierarki se PPV por duke qene nje plan sektorial, ai jep percaktimi vetem ne sektorin turistik dhe vetem keto percaktime jane ato qe i diktohen PPV-ve.

Me pas u be nje prezantim i ideve te para te Strategjise Territoriale per Alpet nga perfaqesuesi i grupit te punes PMG (Gabriale Bonafede), i cili shpalli vizioni strategjik te kesaj zone “Nje turizem i qendrueshem ne Alpe i orientuar drejt permiresimit te cilesise se jetes se komunitetit vendas”. Z. Bonafede beri me dije te pranishmit se ne takimin e






dates 2 Mars qe do mbahet prane ambjenteve te FSHZH, do te prezantohet nje version me i avancuar i Strategjise Territoriale.

Nga studiot konsulente te PPV u kerkua nje set rekomandimesh ne nivel sistemi territorial nga PKS per tu ndjekur nga PPV. U ngrit shqetesimi i gjetjes se instrumentave per te zgjatur Sezonin Turistik duke kombinuar turizmin natyror me ate te aventures dhe ate historik apo turizmin e tradites.



Ne perfundim, pati nje propozim nga perfaqesuesi i Atelier 4 (Alban Efthimi) qe ne takimet e ardhshme, palet prezente te vijne me nje liste te ceshtjeve te cilat do te kene nevojte per tu diskutuar ne grup. Si shembull u morr rasti i nje autostrade te propozuar nga PPV Shkoder e cila nuk mund te vijoj ne PPV Malesi e Madhe pasi infrastruktura rrugore eshte eksistuese dhe per me teper krijon konflikte me rrjetin hekurudhor, kerkon prishjen e shume banesave, etj. Do te kishte qene mjaft me vlere qe i pranishem e takim te kishte qene edhe dikush nga studio qe po merret me hartimin e PPV Shkoder.

Nga AKPT u qartesua se berja bashke e te gjitha aktoreve ne keto procese planifikuese eshte detyre e FBPV/Q, Forumet e cilet jane mbledhur dhe do mblidhen ne vazhdimsi nga ana e AKPT. Natyrsht qe shihen mjaft me vlere edhe takimet teknike te nje rrethi me te ngushte, takime te cilat do te mblidhen edhe ne vijim.

TAKIMI NE AKPT
PLANI I ALPEVE
Tirane, 22.02.2017



Nr.	Emri Mbledhes	Institucioni	pozicioni	Tel.	E-mail
1	Mirinda Spahaj	FSHZH	koordinatore	0686230811	mspahaj@shkoder.gov.al
2	Lera Aliza	IPJ	chp.f	0175771111	aliza.kon@ipj.gov.al
3	Enkelejd Nishe	IPJ	Ekonomist Valim	0695446217	enkelejd@ipj.gov.al
4	ROMINA SAHITI	IPJ	Ekspert Urban	0695990253	rsahit@ipj.gov.al
5	INA TAVANJANI	IPJ	Ekspert Paulligjeshm	0697294960	ina.tavanani@ipj.gov.al
6	SHKURBE BONAPRDE	PMG	Tezhu Leshce	0694823395	shkurbe@pmg.gov.al
7	ALBISA KURTI	Atelier 4	koordinatore Projekti	0692069004	albisakurti@atelier4.com
8	Alban Efthimi	Atelier 4	Team Leader	0682050232	alban.efthimi@atelier4.com
9	Ilirija Kushi	AKPT	seksioni	06957732536	ilirija.kushi@akpt.gov.al
10	Enkelejd Nishe	AKPT	Special	0692054488	enkelejd@akpt.gov.al
11	Enkelejd Nishe	AKPT	Special	0692054488	enkelejd@akpt.gov.al
12	GEN FIQRI	AKPT	Special	0682052305	gen.fiqri@akpt.gov.al
13	Enkelejd Nishe	AKPT	Special	0682054488	enkelejd@akpt.gov.al
14	Rozeta Lagaj	AKPT	Ekspert Histor	0699960931	rozeta.lagaj@akpt.gov.al
15	Enkelejd Nishe	AKPT	Special	0692054488	enkelejd@akpt.gov.al
16	ALBISA DITTO	AKPT	proj. Sektori	0692069181	albisaditto@akpt.gov.al
17					
18					



4.3 Dëgjese publike për strategjinë territoriale dhe planin e veprimeve strategjike/prioritare, investimet kapitale dhe projektet pilot.

Kryetari i Bashkisë Tropojë, z. Besnik Dushaj, bën hyrjen e dëgjesës dhe prezantimin e grupit projektues dhe pasi falenderon grupet e punës, stafin dhe pjesëmarrësit në takim ia lë fjalën z. Ermal Blea prej Studio B&L.

Z. Ermal Blea, pas falenderimit për stafin dhe pjesëmarrësit bën një përmbledhje të punës që është bërë, duke theksuar objektivat dhe mënyrën e punës. Në fjalën e tij z. Blea shprehet për trajtimin e territorit jo si një njësi të shkëputur por si pjesë të një territori më të gjerë që vazhdon përtej qendrave urbane, kufijëve të bashkisë apo atyre kombëtarë. Pas kësaj, pas prezantimit të z. Pier Vittorio Aureli nga studio DOGMA i lihet fjala këtij të fundit për prezantimin.

Z. P. V. Aureli pas një falenderimi për pjesëmarrësit për praninë e tyre e hap prezantimin duke folur për kujdesin e veçantë që i tregohet territorit në këtë plan. Ai thekson se për ne është e rëndësishme të kuptohet dhe të forcohet lidhja që ka njeriu me mjedisin, si pjesë e një territori me një numër të madh pasurish natyrore, qofshin këto në formën e parqeve apo zonave të mbrojtura, apo në trajtën e pasurive nëntokësore. Kjo marrëdhënie, për të duhet të arrije një ekuilibër mes shfrytëzimit për zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Kjo rëndësi që i jepet faktorit mjedis si një nga asetet kryesore të këtij territori vihet re edhe në hartimin e objektivave të strategjisë territoriale ku do të bazohet më tej Plani i Përgjithshëm Vendor, ku kreun e listës e merr mbrojtja e mjedisit. Po ashtu, theksi vihet edhe në bujqësinë si pjesë e ekonomisë vendase dhe më tej në zhvillimin e turizmit, i cili ngadalë po jep një përqindje gjithnjë e më të madhe në të ardhurat e rajonit. Por për të arritur një efikasitet më të lartë duhet së pari të ngrihet infrastruktura për shërbimet dhe plotësimet e kërkesave turistike gjithmonë në rritje të rajonit dhe së dyti të merren masat për mbrojtjen e natyrës për të cilën bëhet ky turizëm në fjalë. Vec zonave të mbrojtura, z. Aureli përfshin agroturizmin, turizmin kulturor, etj. në platformën për menaxhimin e turizmit.

Një tjetër pikë me rëndësi që përmendet këtu është bashkëpunimi dhe vështrimi përtej kufijve administrativë për realizimin e projekteve të përbashkëta si me bashkitë fqinje edhe me shtetet që kufizohen me Tropojën. Kjo sepse rajoni i Tropojës nuk mund të shihet i shkëputur nga zona e Alpeve në të cilin bën pjesë, nga rruga Dinarike, një segment i së cilës kalon në territor, apo nga linjat energjitike e infrastrukturore që e lidhin me rajonet e tjera.

Në përputhje me objektivat e vendosur për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e ekonomisë përmes bujqësisë, turizmit, industrisë, etj. përcaktohet dhe strategjia e ndjekur për qendrat urbane, duke patur si bazë dhe parashikimet për popullsinë në 15 vitet e ardhshme.



Duke vazhduar, jepet programi për menaxhimin e mbetjeve si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të infrastrukturës, hartimi i rrjetit të kanalizimeve dhe ai i ujit të pijshëm. Plani futet edhe më në detaj duke dhënë projekte pilot për secilën nga temat e prekura, duke treguar kështu se është i aplikueshëm në terma realë.

Së fundmi Pier Vittorio Aureli e mbyll prezantimin me vizionin që ka grupi projektues së bashku me Bashkinë Tropojë për zhvillimin e territorit në 15 vitet e ardhshme.

Pyetje, diskutime dhe vëzhgime nga pjesëmarrësit.

PP1. Vë në dukje se nuk u diskutua për prodhimin e energjisë dhe pyet nëse është marrë parasysh në planifikim.

S. Duçellari. Thotë se si projekte të rëndësishme kombëtare, realizimi i strukturave të energjisë është kryesisht në dorë të qeverisë qendrore dhe ajo që mund të merret parasysh nga plani është përmirësimi, rehabilitimi apo ndërhyrja në infrastrukturën lokale rreth këtyre institucioneve, ndërtimeve apo shërbimeve.

PP2. Si inxhinier ndërtimi ngre diskutimin për situatën kaotike në Disdarie, pyet për menaxhimin e mbeturinave sidomos në zonën e Lekbibajt dhe a është e mundur të spostohet kjo në Bajram Curri. Veç kësaj shpreh kërkesën e planifikimit për hapësirat publike dhe prononcimit për HEC-et.

P.V.Aureli. Sqaron se faza në të cilën bëhet diskutimi e trajton territorin ende në shkallë më të madhe se njësitë specifike, të cilave do t'u vije radha në vazhdim, edhe pse natyrisht janë marrë parasysh deri në atë moment. Kjo vlen si për rastin e Disdaries edhe për hapësirat publike, të cilat trajtohen në prezantimin e asaj dite. Ndërkohë që HEC-et siç u përmend edhe me parë i përkasin kompetencave të planeve kombëtare. Për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, duhet të krijohet një rrjet për transportin dhe përpunimin e tyre para se t'i drejtohen landfill-it. ð Ky përbëhet nga nyje sekondare në qendrat locale dhe një qendrore në Bajram Curri.

PP3. Pyet a ka projekt për Bradoshnicën.

S.Duçellari. Vë në dukje se Bradoshnica është e braktisur në shkallë të madhe, dhe veç kësaj është pranë Rezervës Strikte Natyrore të Lumit të Gashit, kështu që mundësia për projekte konkrete në atë zone (ndërtime, ndërhyrje, etj.) është e limituar, por fshati llogaritet gjatë projektimit të infrastrukturës, menaxhimit të mbetjeve, kanalizimeve dhe ujit të pijshëm, dhe në përfshirjen e tij në shërbimet publike si shkolla, qendra shëndetsore, etj.

PP4. Interesohet për projektet që lidhin Dibrin, Gjakovën, dhe Shkodrën dhe për projekte të rrugës së Alpeve.



S. Duçellari. Shprehet se një pjesë e mirë e projekteve janë edhe pjesë e projektit të Alpeve në bashkëpunim me rajonet e tjera, apo të drejtuara nga DLDP dhe se Rruga Dinarike ka qënë prej kohësh në fokusin jo vetëm të autoriteteve planifikuese shqiptare, por edhe vendeve fqinje.

PP5. Pyet për parashikimet e planit për rrugën për në bjeshkë.

S.Duçellari. Përgjigjet se shtigjet dhe rugët në terrenet malore janë duke u evidentuar dhe do të plotësohen me shërbimet e nevojshme, por ndryshimet do të shihen më tepër si rehabilitim për këmbësorë.

PP6. Pyet për situatën e kanalizimeve, drenazheve, furnizimit e mbetjeve në zonën Margogaj-Koçanaj-Shoshan, si dhe për trajtimin e çështjes së bujqësisë.

P.V.Aureli. Tregon se trajtohet raporti mes sipërfaqes së ndërtuar dhe tokës bujqësore për sa I përket tokës së punueshme. Normalisht këto pajisen me infrastrukturën e nevojshme, që nga kanalizimet deri të vaditja, drenazhet dhe transporti I produkteve bujqësore. E rëndësishme është që të ruhet toka bujqësore për të ruajtur kështu edhe prodhimin e këtyre produkteve. Kjo mund të shfrytëzohet si për ekenomi baze edhe për agroturizëm. Ndërkohë që furnizimi me ujë, mbeturinat dhe kanalizimet trajtohen jo vetëm për këtë zonë por për gjithë rajonin.

PP7. Vë në dukje se plani duhet të marrë parasysh dëmet natyrore që janë në përgjegjësi të institucioneve të ndryshme, duhet të jetë më sqaruese për analizën mjedisore, strategjinë e investimeve dhe kostot e larta që kanë një pjesë e tyre, dhe së fundi fuqinë e bashkisë për të përballuar këto shpënzime.

S. Duçellari. Sqaron se këto pika janë marrë patjetër parasysh dhe po zhvillohen më tej, e do të prezantohen në fazat pasardhëse.

PP8. Pyet për projektet në lidhje me bimët mjekësore (boronica), sigurimin e drurëve për ngrohje dhe promovimin e artizanatit e tregëtsisë.

S.Duçellari. Sqaron që promovimi I bimëve mjekësore është I lidhur ngushtë me agroturizmin, tregëtinë dhe pipakt e shtijes si pjesë e eknomisë bazë në rajon. Po ashtu artizanati trajtohet në pikat e turizmit kulturor dhe të tregëtsisë. Specifikimet në shkallë të vogël nuk janë përfunduar ende. Për sa I përket drurëve për ngrohje shihen mundësi për ripyllëzimin e zonave të caktuara, gjë që do të siguronte një pjesë të mirë të lëndës së drurit për përdorime të mundshme dhe do të zgjidhte një pjesë të problemeve me erozionin.





	Funkcioni	Cel / mail	Friday 227 138
Mire Gjoci	Admstr. Uqej	0686434028	
Amila Hykaj	specialist pyje	nila_hykaj@hotmail.com	7.00
TAHIR GABRRI	P/Sik. ZH. Rural	0682501326	
Edita Geci	P/Sik. Nd. Et. unkt	0682211692	drita.nesi@hotmail.com
Jayton Gjermani	P/Sik. Lume. Mq. ac	0673993509	
Rexhip Krasniqi	Org. Statistik	0665966594	rexhipisi@hotmail.com
Ardi Dega	sekretar i K.B.	0694542560	
Adon Brecaqi	Spec. Taktik. Takt.	0685077548	adbrecaqi@gmail.com
Marta Votari	Spec. URBANIT	0682779393	artlok
Merime Brecaqi	P/S PZH	0682750403	merimebrecaqi@yahoo.com
Andita Gjergjezi	Specialist I	0672321511	anditagjergjezi@gmail.com
Wolca Beqani	P/Sim. Dukt.	0686878615	wolcabeqani@yahoo.com
Bajram Gjergjezi	P/Su. P. R. C. unkt	0686515285	
BASHKIM GJERGJEZI	SPECIALIST GJERGJEZI	0682453072	bashkimgjergjezi@gmail.com
Edi. Demir	Z.A. Ni. G. 0108	0683408928	edidemir@gmail.com
Artan Gjergjezi	Inspekt. Mbrojtje	0682466002	artangjergjezi@gmail.com
	Qend. Licit		com
BUKURIE HESHMIRI	GT CIVILF	0682339383	3.00
Mirjeta Gjergjezi	Turb. finance	0682387044	mirjetagjergjezi@hotmail.com
Feride Rrahmani	Zr. Ergj. T. R. unkt	0682366516	4.00
Vatjeqim Demir	Admstr.	0673022862	
Rona Kollari	Administrative	0682415712	5.00



